

Bashkia Shkodër
Biblioteka “Marin Barleti”

Gegnia

e përkohshme kulturore-artistike

4 - 2017
*Vjeti II i botimit,
Shkodër*

Gegnia

E përkohshme kulturore-artistike

4 -2017

Vjeti II i botimit,

Shkodër

Redaksia: Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Ermira Alija

Redaktor gjuhësor: Erzen Koperaj

**Botohet nën kujdesin e bashkisë Shkodër
dhe bibliotekës “Marin Barleti”**

ISSN: 2519-73-91

Adresa e redaksisë: Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër

E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

info@bibliotekashkoder.com

Shënim:

Pikëpamjet e artikullshkruesave nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.

- *Editorial - Vdekja e dr. Elsie humbje e madhe për kulturën shqiptare*...5
- **Albanologji**
 - Lazër STANI** *Letërsia moderne shqiptare*7
 - Willy Gjon KAMSI** *Giammaria Biemmi e la critica*.....14
 - Eduard GRISHAJ** “*Humanistët Italo-Arbërorë*” i Prof. Pipës si kapitull integral i studimeve të tij historiografike mbi letërsinë dhe kulturën tonë ndër shekuj20
 - Olimpia KAKARRIQI** *Puna kërkimore e albonologut Filip Fishta në bibliotekat europiane*30
- *Letërsi shqipe bashkëkohore*
 - Arjola ZADRIMA** *Poezi*.....44
- *Përkthim*
 - Andreas DUSHI** *Shtatë poezi të Pushkinit të përkthyer në shqip*....50
- *Histori&arkeologji*
 - Helidon SOKOLI** *Gjurmime arkeologjike në rajonin e Shkodrës*.....54
- *Tradita arsimore*
 - Njazi KAZAZI** *95-vjetori i Gjinnazit të Shtetit*.....59
- *Muzikologji*
 - Markelian KAPIDANI** *Teoria e xhazit*70
 - Zef ÇOBA** “*Opera*” dhe “*Kendemi*” në librat e studiuesit F. Bala...91
- *Bibliofili*
 - Smajl BALA** *Bibliotekat fetare muslimane në Shkodër*94
- *Letërkëmbim*
 - Gjovalin ÇUNI** *Në gjurmët e një leterkëmbimi*104
- *Ese*
 - Khahid BUSHATI** ... dhe iku “i vizatuar nga hëna”109

-
- **Figura të shqueme të historisë kombtare**
Luigj RAKA *Kapiten Mark Raka*.....125

 - **Reçension**
Genc DRINI “*Malësorja e Bjeshkëve Tona*”, një roman autentik i shkrimtarit *Lulash N. Palushaj*132
Skënder TEMALI “*Shtjellë letrare*” e *Z.Vukajt-shtjellë vlerash të mendimit kritik dhe estetik*139

 - **Ortografija ... (1964)**
“*Ortografija e gjuhës shqipe, enti për botimin e teksteve i Republikës Socialiste të Serbise, Beograd 1964*141

Vdekja e dr. Elsie humbje e madhe për kulturën shqiptare

Para do kohësh, më 2 tetor 2017, u nda prej kësaj jete dr. Robert Elsie (1950), albanolog, shkrimtar, përkthyes i shquem, emri e vepra e të cilit asht e lidhun përfundimisht me kulturën dhe me tokën shqiptare, ku edhe po prehet. Trupi i tij u varros në fshatin Theth të Shqipnisë së Veriut, përmes nderimesh e zisë mortore, tue u ba kështu element i kësaj toke të cilës ia përkushtoi pjesën ma të madhe të veprës së tij studimore e përkthimore. Humbja e Dr. Elsie asht një humbje e madhe për kulturën shqiptare, në kohën kur figura të tilla po i mungojnë përditë e ma shumë albanologjisë, si edhe kur mungon kujdesi e vëmendja e shtetit shqiptar ndaj kulturës dhe artit tonë.

Pa dyshim emni i dr. Robert Elsie mund të radhitet me atë të albanologëve të tjerë të shquem, si: Johann George von Han, Ogyst Dozon, Holger Pedersen, Gustav Majer, Maximilian Lambertz, Edit Durham, Franz Baron Nopça etj., të cilët gjithashtu dhanë një kontribut të çmueshëm për zbulimin e njohjen e kulturës së popullit shqiptar edhe në botë.

Dr. Elsie asht autor i ma shumë se gjashtëdhjetë librave si dhe i artikujve të panumërt për albanologjinë, në fushën e historisë, antropologjisë, kritikës letrare e historisë së letërsisë, përkthimit etj. Një pjesë e këtyne librave janë përkthye e kanë pasë jehonë edhe në gjuhën shqipe. Tek personaliteti i këtij albanologu të shquem spikati kambëngulja dhe idealizmi për t'u marrë gjatë gjithë aktivitetit të tij shkencor me një kulturën e një populli të vogël të nëpërkambun rrjedhave të historisë, por ende të panjohun sa duhet edhe në kohën moderne. Fatkeqësisht, me sa kena informacion, ai punoi dhe botoi tue u mbështetë vetëm në kërkimet e tij, pa mbështetjen, as ma të voglën, prej shtetit shqiptar, si në Shqipni edhe në Kosovë. Por prapëseprapë nuk asht vonë që institucionet shtetnore kulturore ose shkencore me u kujtue për veprat e tij, për publikimin ose ripublikimin e tyne, disa edhe për t'i botue në gjuhën shqipe. Vepra e tij ka ende se çka me u ofrue publikut të huej e shqiptar, studiuesve dhe të interesuemve të tjerë për kulturën, historinë, gjuhën dhe letërsinë shqiptare. Në një intervistë të shkurtit 2012, ai e ka shpjegue qartë qëllimin e jetës së tij studimore, tue u shprehë: Çdo njeri ka interpretimin e vet për albanologjinë por për mua, thelbi i punës sime është të prezantoj shqiptarët, t'i prezantoj Shqipërinë, botën shqiptare, gjithë botës. Unë përpigem t'i transmetoj botës së jashtme njohuritë që kam për këtë vend, që kjo botë të kuptojë se ç'është Shqipëria, kush janë shqiptarët, historia e tyre, kultura e tyre, pra fazat e ndryshme të jetës këtu. Dhe këtë e bëj që të

bëhet e njohur pasi në fund Shqipëria mbete një vend shumë i panjohur.

Me të vërtetë vepra e tij ka si objektiv kryesor publikun e huej, por në mjaft raste ajo asht një burim i pasun të dhanash dhe interpretimesh me mjaft vlerë edhe për vetë publikun dhe studiuesit shqiptarë. Mjafton të përmendim me këtë rast veprën voluminoze *History of Albanian Literature* (Histori e letërsisë shqiptare), Colorado 1995, në dy vëllime dhe polonisht me titullin *Zarys historii literatury albanskiej* (Pasqyra e historisë së letërsisë shqiptare), Torunj 2004, të ribotueme edhe në gjuhën shqipe me titullin *Histori e letërsisë shqiptare*, Pejë 1997, e cila shquhet për larminë e informacioneve dhe sistematikën e studimit të kulturës dhe letërsisë shqiptare që prej fillimeve deri më sot. Në kushtet kur na mungon një histori akademike e letërsisë sonë kombtare kjo vepër e ka krye këtë funksion edhe në studimet tona, qysh kur u botue në gjuhën shqipe. Asht merita dhe mprehtësia e tij që sot kena të përkthyme në gjuhë të randësishme evropiane veprat ma përfaqësuese të kulturës dhe letërsisë sonë kombtare si: *Fjalor i fesë, mitologjisë dhe kulturës popullore shqiptare*, i botuem në gjuhët anglisht (2001), gjermanisht (2002) dhe shqip (2005); *Kanuni: E drejta zakonore shqiptare sipas të ashtuquajturit Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Pejë 2001, në gjuhën gjermane; eposin e kreshnikëve, vëllimin *Këngë kreshnikësh, poezia epike shqiptare* (2004), dhe veprën e poetit atë Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcis: eposi kombëtar shqiptar* (2005), në gjuhën angleze. Edhe sikur të kishte përkthye vetëm këto vepra do t'i përkuleshim me nderim të thellë, e do të kishte një vend nderi në panteonin e kulturës sonë, por këto janë vetëm disa prej dhjetëra të tillash. (Për vepra të tjera ma hollësisht mund të kërkoni në faqen e tij në internet www.elsie.de).

Dr. Elsie ishte një dashamirës i madh i popullit shqiptar, por edhe një kritik i hapun ndaj të metave që i konstatonte në jetën sociale e kulturore. Ai ka shprehë opinionin e tij për shumë çështje të kulturës dhe historisë së popullit shqiptar, në shumë vepra studimore, por edhe në intervistat e dhana në organe të ndryshme të shtypit shqiptar, që shpesh na paraqesin ashtu siç jena në syrin e të tjerëve, dhe duhet të na ndihmojnë për zhvillimin e matejshëm të një vetëdijeje kritike për atë se kush jena në të vërtetë si popull dhe ku synojmë të shkojmë, tue lanë mënjanë patetizmat e retorizmat e trashëgueme nga e kaluemja problematike.

Dr. Robert Elsie na la një vepër madhore për Shqipërinë dhe shqiptarët, por edhe shqetësimin se albanologjisë shqiptare i iku një shkencëtar sistematik dhe skrupuloz, vendin e të cilit do të duhet shumë kohë e mund për ta zëvendësue dikush tjetër...

Redaksia

Lazër STANI

LETËRSIA MODERNE SHQIPTARE

Pas luftës së dytë botërore letërsia shqiptare eci në rrugë mjaft të vështirë e komplekse. Karakteristikë kryesore e kësaj periudhe është shkëputja jo e natyrshme e letërsisë nga tradita e saj dhe ndikimi i fuqishëm, po ashtu jo i natyrshëm, që ushtroi mbi të përvoja krijuese e metodës së realizmit socialist. Veçoria tjetër, mbase më e rëndësishme dhe me pasoja më të rënda, është se letërsia shqiptare do të zhvillohej e ndarë nga një kufi politik brutal dhe kufizimet e një regjimi diktatorial. Kështu do të kemi: letërsi të zhvilluar brenda kufirit të shtetit shqiptar; të shqiptarëve në përbëje të ish Jugosllavisë, kryesisht në Kosovë dhe në Maqedoni, si dhe të shqiptarëve të diasporës.

Këto karakteristika ndikuan fuqishëm në rrjedhën e letërsisë shqiptare në përgjithësi, si dhe në fizionominë, strukturën artistike apo frymëzimin tematik të saj. Gjatë katër dhjetëvjetëshave të parë të shekullit XX e sidomos gjatë viteve '20 e '30 letërsia shqiptare pati një zhvillim të hovshëm dhe të gjithanshëm. U rrit si numri i krijuesve, ashtu dhe numri i veprave letrare të botuara, të cilat u ngritën në një shkallë më cilësore artstike, duke krijuar premisat për një komunikim më të afërt me përvojat e përgjithshme letrare në Evropë. Përmes shkrimtarëve të talentuar, të shkolluar nëpër qendra të ndryshme të Evropës, në letërsinë shqiptare filloi të depërtojë fryma e drejtimeve dhe e ndjeshmërive të reja krijuese letrare të kohës. Siç dihet, gjatë këtij harku kohor shkrimtarë të mëdhenj të letërsisë shqiptare, si : Fishta, Konica, Noli, Poradeci, Koliqi, Migjeni, Kuteli, shënuan disa nga kulmet më të larta të letërsisë shqiptare, në llojet dhe zhanreve e gjinive të ndryshme. Në këtë kontekst letrar llojet e gjinisë lirike do të jenë ato që përparojnë, por një hov të dukshëm do të marrin edhe llojet epike, drama, kritika dhe teorinë letrare. Krejt ky fluks i pasur krijuesish të talentuar të moshave të ndryshme, të nxitur dhe të mbështetur nga shtypi periodik letrar i drejtimeve dhe i shkollave të ndryshme, do të vazhdojë, thuhet po me këtë ritëm dhe gjatë pjesës së parë të viteve '40.

Për çudi, jehona e hovit të tillë krijues nuk u ndërpre menjëherë pas përmbyesjes së pushtimit nazist dhe vendosjes së pushtetit komunist. Pati një tolerancë gjatë ditëve të para të pushtetit të ri ndaj frymës së lirë, liberale në krijimtarinë artistike, e cila do të vazhdojë ta ketë këtë fat edhe për dy-tre vjet. Por siç dihet, tanimë nuk ishte më ai rreth individualitetesh të

jashtëzakonshëm krijuesish të viteve '30. Noli e Koliqi do të vazhdojnë të krijojnë nëpër Evropë e Amerikë, por të shkëputur krejtësisht nga letërsia në Shqipëri dhe pa kurrfarë ndikimi mbi të.

Lasgushi kishte pushuar së krijuari. Migjeni dhe Fishta nuk ishin më. Nga ky rreth kolosësh të letërsisë shqiptare, vetëm Kuteli do vazhdojë të jetë vazhdimi i natyrshëm i letërsisë së pas luftës duke botuar sa herë i hiqej çensura. Do të vazhdojnë fare ndryshe krijimtarin e nisur që më parë : Petro Marko, Vedat Kokona, Shefqet Musaraj, Fatmir Gjata, Sterjo Spasse, Nonda Bulka, Dhimitër Shuteriqi etj. Nga poetët që krijuan në vitet e para të çlirimit dhe që krijimtaria e tyre pati jehonën e entuziazmit kolektiv të këtyre viteve, janë: Aleks Çaçi, Luan Qafëzezi, Llazar Siliqi etj. Kështu, pas luftës dhe gjatë viteve '50 do të duket qartë orientimi i ri në fushën e letërsisë shqiptare, si në rrafshin tematik, dhe në atë të përvojave dhe të metodave e proseedave krijuese. Tematikisht letërsia u përqëndrua kryesisht, në jehonën e lirisë së fituar nga Lufta Nacionalçlirimtare, kurse ngjyrimi i aktualitetit dhe i botës reale u reduktua kryesisht në bardhë e zi. Si përvojë shkrimi, veprat letrare të kësaj periudhe shpesh do të qëndrojnë ndërmjet gjuhës së rrëfimit letrar dhe atij propagandistik. Kryesisht këtë vulë proceduese kanë romanet e para gjatë viteve '50. Po kaq skematik ishte dhe mendimi kritik zyrtar i asaj kohe, që do ta përkrahte këtë letërsi.

Nga fundi i viteve '50, e sidomos me fillimin e viteve '60, pra pas një dekade e gjysmë që nga çlirimi, do të bëhen hapat e parë për t'a nxjerrë nga ky shabllon letërsinë shqiptare. Në këtë kontekst duhet përmendur, pikërisht viti 1958, kur Petro Marko do të botojë romanin e tij të parë "Hasta la Vista", që sjell një tjetër tematikë në romanin shqiptar, një tjetër frymë dhe ndjeshmëri në paraqitjen e personazheve (tanët dhe të huajt). Dy vjet më vonë ai do të botojë dhe romanin "Qyteti i fundit" me prirje për të shmangur skematizmin. Pas tij, Ismail Kadare boton romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur"(1962), që , në shtegun e paralajmëruar nga romanet e Petro Markos, do ta ngrejë në një nivel ndërkombëtar.

Pas romaneve të dy autorëve të përmendur, gjatë viteve '60, Jakov Xoxa do të botojë romanin "Lumi i vdekur" që, nga një aspekt tjetër procedura, do të konsolidojë prirjen e romaneve shqiptarë, për të kërkuar rrugë të reja në paraqitjen e botës shqiptare. Pas Jakov Xoxes do të paraqitet Dritëro Agollime një seri romanesh, Dhimitër Xhuvani, Ali Abdioxha, Skënder Drini, Sabri Godo, Vath Koreshi etj. ndërsa majën e poezisë lirike do ta zënë Fatos Arapi, Ismail Kadareja dhe Dritëro Agolli, të cilët do të çelin një rrugë të mbarë dhe për një brez poetësh të rinj të talentuar, si: Dhori

Qiriazi, Bardhyl Londo, Xhevahir Spahiu, Frederik Rreshpja, Natasha Lako etj.

Letërsia shqiptare

Shqipëria

Në fushën e kulturës në përgjithësi dhe në atë të letërsisë në veçanti, gati për gjysmë shekulli, u ndie e ashpër dhuna e shtetit diktatorial ndaj intelektualëve qoftë nëpërmjet deklaratave apo artikujve në shtyp, qoftë dhe nëpërmjet veprave të tyre. Kështu prej çensurës shtetërore e pësuan shumë rëndë mjaft njerëz të letrave, të cilët ose u pushkatuan, ose qëndruan me vite të tëra në burg apo munden të arratisen dhe ta kalojnë tërë jetën e tyre jashtë atdheut. Të tillë janë: Arshi Pipa, Sejfulla Malëshova, Mitrush Kuteli, Petro Marko, Musine Kokalari, Trifon Xhagjika, Bilal Xhaferi, Kasem Trebeshina, Pjetër Arbnori, Astrit Delvina, Frederik Rreshpja, Visar Zhiti etj.

Sejfulla Malëshova(1900-1971), i njohur me emrin letrar, Lame Kodra, është nga personalitetet e para disidente në kulturën shqiptare të pasluftës. Shumica e poezive të Lame Kodrës janë botuar në vëllimin “Vjersha” (Tiranë, 1945), ku ai e quan veten poeti rebel. Sipas Malëshovës, Shqipërisë i duhej integrimi kulturor dhe jo izolimi nga Evropa Perëndimore. Ai thoshte se detyra e intelektualëve shqiptarë: është që të vendosin lidhje të ngushta kulturele me popujt e Ballkanit, me Bashkimin Sovjetik, me Anglinë, Amerikën dhe me gjithë botën demokratike e progresive.

Në vitin 1953, me një guxim të hapur intelektual, Kasem Trebeshina (1926) i dërgoi një “promemorie” Enver Hoxhës, duke e paralajmëruar se: *...shkatërrimi më i madh do të ndodhë në botën shpirtërore shqiptare*. Shpërblimi për guximin e tij ishin tërë ato vjet burgimesh e persekutimesh dhe ndalimi i botimit të veprave të tij. Edhe pse vepra e tij nuk është botuar e plotë ka vlerësime nga më të lartat.

Ndërkaq, në vitet '60 botohet në Tiranë romani i shkrimtari i Mehmet Myftiut (1930), i cili merret me fatin e artistit në diktaturë. Ky roman është ndër veprat e para disidente në vendet e Lindjes. Ai denoncoi hetuesinë, internimet dhe burgjet komuniste dhe rifuti në letërsi tema dhe personazhe tabu, që i kishte përjashtuar letërsia zyrtare e kohës. Po në vitet '60, me përmbledhjen e tij të parë me tregime “Njerëz të rinj, tokë e lashtë”, Bilal Xhaferi(1935-1987) solli një lirizëm të ngrohtë dhe tepër human në letërsinë shqiptare. Ai rishfaqti personazhin e punëtorit me virtytet dhe

dobësitë njerëzore, duke iu kundërvënë punëtorit të trajtuar bardhë e zi në letërsinë skematike. Ndërsa vëllimi i tij “Lirishta e kuqe” u ndalua dhe u hoq nga qarkullimi. Pati dhe shkrimtarë të tjerë që talenti i tyre u ndërpre në mes dhe ata, madje, as nuk arritën të botojnë deri para viteve ’90 veprat e tyre, si: Astrit Delvina (1920-1990), një vëllim i tij me “Endrra me ngjyra” u botua në vitin (1990): Pjetër Arbnori(1930), disa novela dhe romane të tij janë botuar pas viteve ’90.

Vëllimi poetik i Trifon Xhagjikës (1932-1963), ”Atdheu është lakuriq”, që u botua më 1994, ilustron në mënyrë bindëse jo vetëm evoluimin e tij drejt një koncepti të ri estetik, duke u shkëputur nga realizmi socialist, por ai bën një kthesë të vërtetë në bindjet dhe ndjesitë e tij artistike. Në vjershën me titull “Apoteza e ditëve tona”, autori e vizaton me ngjyra dramatike gjendjen e dyzimit të individit dhe të shoqërisë shqiptare.

Ndërsa, Zef Zorba(1920-1993) me librin e tij të botuar mbas vdekjes “Buzë të ngrira në gaz”(1994), dëshmon se është një poet hermetik, me forma poetike të panjohura në poezinë shqipe. Poezia e tij është shenjë e një tjetër kohe, e kohës universale që nuk e nxinin përmasat e kohës kur ai jetoi.

I lirë të botojë pas viteve ’90 është dhe poeti Visar Zhiti(1952), i cili në disa nga vëllimet e tij me poezi (“Hedh një kafkë te këmbët tuaja”- “Libri i burgut”, “Mbjellja e vetëtimave”, etj.) arrin të reflektojë në një mënyrë tejet të ndjeshme raportin ndërmjet tragjikes individuale dhe asaj kolektive dhe të rrezatojë dashuri e paqe në realitetin më tronditës.

Por përveç këtyre shkrimtarëve që e pësuan me internime apo burgje, çensura shtetërore do të binte dhe mbi veprat e shkrimtarëve të tjerë, paçka se ata kishin mundur të krijonin popullaritet në masën e madhe të lexuesve dhe në një farë mënyre e kishin fituar një status mbrojtës. Kështu vepra e tyre ose ndalohej fare ose detyrohej shkrimtari t’ a ripunonte atë përsëri. Kështu ndodhi me disa vepra të Ismail Kadaresë, Dhimitër Xhuvanit, Fatos Arapit, Qamil Buxhelit, NaumPriftit, Dritëro Agollit, Xhevahir Spahiut, Koço Kosta etj.

Kosova

Pjesa e letërsisë shqiptare që zhvillohej në Kosovë, kishte afërsisht këto shenja paradalluese: e shkëputur nga letërsia amë dhe nga një pjesë e traditës letrare, ajo pothuajse nuk ishte fare në kontakt me të dhe nuk ishte e informuar për atë që ndodhte në fushën e letërsisë, brenda kufirit të shtetit shqiptar. Edhe para luftës, në Kosovën letrare here pas here ilegalisht,

mbase edhe mund të depërtonte ndonjë vepër ose autor nga periudha e viteve '30, kryesisht përmes atyre pak nxënësve që shkolloheshin aso kohë në Shqipëri. Pas luftës, në vitet '50, krijuesit e parë të letërsisë shqiptare në Kosovë, për mbështetje kishin kryesisht letërsinë gojore (të pasur), fare pak vepra nga fondi letrar i traditës, si dhe përvojat e huaja letrare, në radhë të parë ato sllave.

Nga emrat e shkrimtarëve, të cilët e kishin filluar veprimtarinë e vet letrare para luftës, do të përmendim këtu vetëm Esat Mekulin dhe Hivzi Sulejmanin. Mekuli u shqua me lirikën e angazhuar shoqërore dhe kombëtare të shkruar gjatë viteve '30, ndërsa i dyti solli përvojën e parë më serioze në llojin e prozës së gjatë me romanin dy vëllimesh "Njerëzit I" dhe "Njerëzit II", si dhe "Fëmijët e lumit tim". Para tyre, Hivzi Sulejmani do të shkruante disa nga tregimet, që edhe sot tingëllojnë moderne. Ishte poezia ajo që arriti majat e letërsisë shqiptare në Kosovë, duke filluar nga fundi i viteve '50 e sidomos me emrat: Din Mehmeti, Fahredin Gunga, Rrahman Dedaj, Gjerqeku, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Besim Bokshi, Eqrem Basha, Sabri Hamiti. Ndërsa në prozë dallohen: Anton Pashku, Ramiz Kelmendi, Azem Shkreli, Nazmi Rrahmani, Rexhep Qosja, Mehmet Kraja, Musa Ramadani etj. Edhe në Kosovë shumë shkrimtarë patën fatin të burgosen, të persekutohen apo të arratisen e të jetojnë jashtë truallit të tyre. Pushteti serb ushtronte dhunën më të egër ndaj intelektualëve që me pushtetin e fjalës përpiqeshin të afirmonin vlerat kombëtare shqiptare. Kështu e pësuan rreptë nga kjo censurë : Adem Demaçi, Ramadan Rexhepi, Kapllan Resuli (i cili pasi u arratis në Shqipëri u burgos edhe këtu), etj.

Krahas letërsisë shqiptare që krijohet dhe botohet kryesisht në Prishtinë, ajo krijohet dhe botohet edhe në mesin e shqiptarëve të Maqedonisë, kryesisht me prozën dhe poezinë e Murat Isakut, Abdyl Azis Islamit, e më pas, me veprën letrare të Resul Shabanit, Adem Gajtani, Agim Vincës, Din Mehmetit etj. Vlen të përmendet dhe një personalitet i shquar i kulturës, Luan Starova, (shqiptari më i përkthyer sot pas Kadaresës), por shumica e veprave të tij nuk janë në gjuhën shqipe.

Diaspora

Edhe pse e zhvilluar në kushte të një izolimi gjeografik e ideologjik, fati dhe perspektiva e letërsisë bashkohore shqiptare duhet vështruar në një kontekst dhe më të gjërë gjeografik, d.m.th. dhe përtej kornizës ngushtësisht nacionale. Pavarësisht nga zhvillimet brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe brenda viseve etnike, si: Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, kjo letërsi pati dhe

njohu zhvillime dhe në diasporë. Sa i takon zhvillimeve të saj në diasporë, letërsia shqiptare mund të shikohet gjeografikisht brenda dy vatrave:

Vatra historike e diasporës shqiptare: Itali, Greqi, Rumani, Bullgari, Turqi etj. Vatra të reja të diasporës shqiptare: Gjermani, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj.

a. Zhvillimet më të rëndësishme të letërsisë bashkëkohore shqiptare në diasporë ndodhën në Itali, aty ku sot e kësaj dite jetojnë rreth 90.000 arbëreshë, që vazhdojnë të flasin shqipen. Në përgjithësi mund të thuhet se një "rilindje" e letërsisë arbëreshe ndodhi diku rreth fundit të viteve '50, kur dhe nisi të botohej revista "Shejzat" nga Ernest Koliqi në Romë e më pas revistat "Zgjimi", "Katundi ynë", "Zjarri", "Zëri i Arbëreshëve", "Lidhja", "Bota shqiptare" etj. Këto revista ndikuan në krijimin dhe publikimin e një brezi poetësh e shkrimtarësh që shkruan në arbërisht. Veç të tjerash, një pjesë e tyre funksionoi dhe funksionon dhe si shtëpi botuese, duke publikuar kolona të tëra me poezi dhe vepra të tjera letrare.

Ndër shkrimtarët më të rëndësishëm të kësaj vatre duhen përmendur: Françesk Solano (1914), i njohuri me pseudonimin Dushko Vetmo, i lindur në Kozencë. Pas një periudhe të gjatë qëndrimi në Argjentinë, Uruguai dhe Kili, ku dhe shugurohet prift, Solano kthehet në vendlindje. Aktiv në shumë fusha të letrave, ai është kryesisht poet, prozator dhe dramaturg. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë: "Burbuqe t'egra"(1946), "Shkretëtira prej gurit" (1974), drama, "Tregimet e Lëmit", etj.

Domenico Bellizzi (1931), prift nga Frasnita, i njohur me pseudonimin Vorea Ujko, është një ndër trashëgimtarët më të denjë të Jeronim De Radës e Zef Serembes. Ai me poezinë e tij arriti nivele të spikatura të ligjërimit poetik, veçanërisht me veprat: "Zgjimët e gjakut", "Këngë arbëreshe"(1982), "Hapma derën zonja mëmë"(1990) etj.

Karmell Kandreva (1931), poet, bartës i identitetit kombëtar me anë të një ligjërimit poetik original si dhe luftëtar i angazhimit social të arbëreshëve në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës origjinale, ka shkruar triologjinë poetike: "Shpirti i arbërit rron"; "Arbëreshi tregon"; "Vuan dega e hershme".

Zef Skiroi Di Maxhio (1944), poet, përkthyes dhe dramaturg i shquar, i angazhuar edhe si drejtor i revistës "Bota shqiptare", i shquar për tonin e tij ironike shpesh sarkastik, është autor i rreth dhjetë librave poetikë, ndër të cilat vlen të përmenden: "Nëpër udhat e parrajsit", "Shqipëtarë e t'arbreshë", "Poemë gjysmëserioze arbëreshe", "Orëmira", "Për token fisnike të Horës" etj.

Padyshim që letërsia arbëreshe vazhdon jetën me të tjerë shkrimtarë,

shumica syresh të rinj, duke luajtur kështu një rol të rëndësishëm jo vetëm në diversitetin kulturor shqiptar, por edhe atë italian. Një tjetër vatër e rëndësishme historike, ku kanë lulëzuar shkrimet shqipe që në fundin e shekullit XIX dhe ku jeta kulturore e elementëve shqiptarë ka qënë e organizuar më së miri, është Rumania. Një ndër personazhet më të rëndësishëm të letrave bashkëkohore shqiptare është Viktor Eftimiu (1889-1972), autor i rreth njëqind vëllimeve letrare të shkruara në rumanisht. Mjaft prej veprave dramatike të tij janë ndërtuar mbi bazën e motiveve shqiptare e të fëmijërisë së tij në malet e vendlindjes.

Po aq e rëndësishme sa dhe Rumania në pikëpamje të jetës kulturore shqiptare mbetet edhe Bullgaria, ku janë njohur organizime të hershme të komunitetit shqiptar. Një figurë që vlen të merret në konsideratë nga njerëzit e letrave shqipe, është Thoma Kaçori, i cili shkroi disa romane e libra me tregime.

b. Në vatrat e reja të zhvillimit të letërsisë bashkëkohore shqiptare hyjnë ato vende në të cilat emigruan për motive kryesisht politike një pjesë e shkrimtarëve të talentuar shqiptarë, që duke mos u pajtuar me diktaturën dhe duke ndjerë etjen për liri, realizuan në periudha të ndryshme të regjimit komunist eksodet e sforcuara.

Një nga shkrimtarët e diasporës me peshë më të madhe që jetoi e krijoi në Gjermani, është Martin Camaj (1925-1992). Vepra e tij hyn në fondin më të shquar të letërsisë bashkëkohore shqiptare. Ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës zhvilloi veprimtarinë më të madhe studimore e letrare Arshi Pipa (1920-1997), një ndër punëtorët më të mëdhenj të letrave shqipe, intelektual i shquar, poet, përkthyes, studiues e polemist. Më 1944 ai drejtoi revistën “Kritika” dhe po këtë vit botoi librin e parë me poezi “Lundërtarë”. Në SHBA, ku emigroi në vitin 1958, punoi si profesor në disa universitete amerikane deri sa doli në pension. Si dëshmi e asaj që kishte përjetuar në kampet dhe burgjet komuniste ai botoi në Romë vëllimin me poezi “Libri i burgut” 1959, dhe më vonë dhe vepra të tjera. Një ndihmesë të jashtëzakonshme Arshi Pipa do të japë dhe në studimet letrare, sociologjike e politike me vepra të dorës së parë, ku operon me metoda moderne studimi.

Si përfundim, mund të themi, se aktualisht po bëhen përpjekje që të gjitha këto baza dhe këta krahë të shpëputur në kohë dhe në hapësirë të letërsisë shqiptare, të komunikojnë dhe të integrojnë mes vetes për ta përcaktuar dhe krijuar saktësisht nocionin letërsi kombëtare në gjuhën shqipe.

Willy Gjon KAMSI

GIAMMARIA BIEMMI E LA CRITICA¹

La posizione dei detrattori dell' autenticità della vita Scanderbeg del Biemmi, è posta prima di tutto sulla inesistenza dell' Antivarino (Fr. Babinger, 1931, 1934 e, ultimamente, 1967) e sul fatto che l' editore non fosse il Radolt, il quale non avrebbe stampato il suddetto libro (K. Ohly, 1933) poiché non risulta sull' elenco degli incunaboli stampati nella sua tipografia.

Nei primi tempi, sino al principio del XX secolo, fra gli storici non si avevano particolari obiezioni sui fatti storici riportati dal Biemmi nella sua storia di Scanderbeg. Sebbene si conoscessero la sua storia di Brescia ed altro ancora, ritenute dei "falsi", quella dedicate allo Scanderbeg comunque rappresentava una fonte di notizie, in molti casi sorrete, specialmente per le battaglie, dalle relative date, cosa che non si notava nell' opera più che famosa del Barlezio, nella quale queste ultime non risultano, quasi in assoluto, per poter confermare, con un appiglio sicuro, quanto avvenuto in quei tempi.

Già nell' *Illyricum Sacrum* del Farlati (fine del XVIII secolo e inizio del XIX), il Biemmi risulta come fonte di notizie in relazione all' epoca di Giorgio Castriota.

Persino storici di alta levatura quali F.S.Noli e Athanas Gegaj, laureato alla università di Louvain, autore di *L' Albanie et l' invasion turque au XV^e siècle* (1973), accettarono per veritiere le affermazioni del Biemmi, come pure tutte le notizie provenienti dalla sua opera dando un ampio riscontro sulla veridicità ed esprimendone apprezzamento. Inoltre il Gegaj tiene in conto diversi lati della testimonianza dell' Antivarino, per di più afferma che raffrontandolo con altre fonti storiche documentarie, il tutto volge a favore di quest' ultimo, dimostrando che fosse bene informato e imparziale. "*En confrontant les affirmations de l' Antibarensis avec les sources d' archives, il ressort que l' auteur était bien informé et impartial dans ses jugements*" ² . Ecco già una posizione critica sull' argomento confortata

1 Shënim: Artikulli është marrë i daktilografuem pas vdekjes së autorit, nga një pjesë e studimeve të lana në italisht. Nëse verëhet ndonji gabim ortografik, përgjegjësia nuk është autorit, që ka kenë një zotnues i shkëlqyem i gjuhës italiane.

2 Athanase GEGAJ, *L' Albanie et l' invasion turque au XV^e siècle* . Louvain-Paris

da fonti d'archivio. È ovvio che simili affermazioni non provengono da persone sprovvedute. Se documenti ci sono che confermano la veridicità delle notizie del Biemmi, senz'altro devono essere valutati.

È inconcepibile la foga nel bistrattare ed anzi nell'accusare di falso il Biemmi. Se è vero che alcuni momenti della sua *Storia di Scanderbeg* sono poco ligi alle regole della vera storia, e sua fonte principale fosse una pubblicazione della quale mai si reperì una copia, tuttavia ciò non impedisce lo studio dell'opera e la collazione con altre, che senz'altro potranno dare spunto alla verifica delle notizie incluse nella sua Storia, divenendo quindi un contributo valido per una vera storia critica dell'Albania scanderbeghiana, come tuttora avviene, anche dopo le constatazioni e affermazioni del Babinger e dell'Ohly.

Il Babinger non tralascia pertanto di ritornare sull'argomento Biemmi, dopo trentacinque anni, con una sua prefazione dedicata alla ristampa anastatica (1967) di G. T Petrovitch³ svolgendo i suoi argomenti sul Biemmi in ben tre su otto pagine della sua prefazione.

Il Babinger afferma in questo caso "abbé de Brescia n'était rien d'autre qu'un faussaire fort habile, comme il y en existait beaucoup justement – on le sait- au XVIIIème siècle"⁴

Non si deve scartare la possibilità che il Biemmi nel comporre la sua *Storia di Scanderbeg* si riferisse, oltre che all' Antivarino, a documenti inediti reperibili in quell tempo e quindi a disposizione del nostro autore, ma che in seguito non fu più possibile avere fra le mani.

In antitesi con le affermazioni del Babinger e dell'Ohly, abbiamo presenti quelle dello studioso P. Giuseppe Valentini sj, che, su una rivista prestigiosa quale "Shêjzat" (Le Pleiadi), rivista edita da un eminente letterato albanese, Ernesto Koliqi, afferma la genialità di uno storico quale il Biemmi. P. Valentini, intervistato dopo un suo discorso di soggetto scanderbeghiano presso il Pontificio Istituto Orientale (24 aprile 1968) alla domanda sull'argomento, visto che sostiene fino ad un certo punto il Biemmi, replica:

"Risulta che il Biemmi è stato uno di quegli storici geniali, che mai mancarono all'Italia, i quali, avendo piena padronanza delle informazioni

1937, p.VIII.

3 G.T.PETROVITCH, *Scanderbeg* (Georges Castriota). Essai de bibliographie raisonnée. Paris 1881. Ristampa anastatica 1967. Avant-propos di Franz Babinger, pp.XVII-XXIV.

4 G G.T.PETROVITCH, op. cit. p. XIX. N.B.: le sottolineature sono dell'Autore.

storiche, è sicuro che abbiamo potuto redigere racconti storici totalmente credibili fosse pure basati su nomi di autori inventati di sana pianta. Nessun autore come il Biemmi rivela una esatta conoscenza della topografia e della toponomastica delle regioni d'Albania, *dentro e fuori la giurisdizione di Venezia*"⁵

Il Biemmi, quindi, usando diverse fonti riesce a tracciare una storia credibile del nostro eroe nazionale, portandoci quindi a non ritenerlo un volgare "falsario", come generalmente viene definito.

Comunque era posizione che ai atteneva semplicemente alle affermazioni di due noti ed esperti studiosi nel campo, accettando quindi supinamente tutto quanto era affermato da loro senza fare nemmeno un tentativo per sottoporre l'opera ad uno studio critico, visto che in seguito erano già stati ritrovati vari documenti relativi al periodo preso in considerazione.

Ma su questo tasto premetterò prevalentemente per tutto il mezzo secolo di regime comunista, poiché tornava a favore della loro campagna anticattolica e anticlericale, senza tentare una visione scientifica e quindi critica del documento in questione.

Comunque all'epoca del Biemmi, XVIII secolo, pratiche simili erano accettate e non oggetto di scandalo, ma erano ritenute per di più un segno di erudizione da parte di coloro che le praticavano. E questo afferma P. Valentini nella sua intervista. Così come generalmente sono ritenute opera di eminenti artisti i falsi dei quadri di grandi nomi della pittura riprodotti da loro e che non vanno certamente a loro detrimento.

Non dovremmo dimenticare in questo caso un noto autore della letteratura italiana dell'ottocento, Alessandro Manzoni, il quale inizia un suo famoso romanzo storico, *I promessi sposi* sono annunciando il ritrovamento di uno scritto autografo di autore anonimo nel quale si raccontano gli avvenimenti rispecchiati nel suo romanzo. Se *I promessi sposi* sono un romanzo nondimeno i fatti storici riferiti nelle sue pagine sono veritieri e documentabili. Espediente simile si riscontra oltre che nel Manzoni, anche nell'Ariosto, nel Cervantes, nello Scott. Pare proprio che fosse una pratica in auge in quel tempo.

Il Manzoni dopo la pubblicazione dei Promessi Sposi, dà alle stampe un volumetto dal titolo "*Storia della colona infame*", nel quale raccoglie

5 Rezultatet e fundme të studimeve kastrjotjane (Bashkëfjalim me Át Valentinin) [Ultimi risultati dagli studi castriotiani. Conversazione con P. Valentini]. In : "Shêjzat", XII/1968, nr.4-6, p.230.

tutte quelle notizie a carattere storico che potevano servire ad illuminare quanto presentato nel suddetto romanzo storico, dando inoltre anche le rispettive fonti. Quindi non ci si dovrebbe stupire più di tanto, essendo una pratica corrente ed accettata, fra il XVIII e XIX secolo.

Dunque, basandosi semplicemente su due presupposti, non basta per rendere inammissibile una storia che rappresenta vari aspetti che comunque, anche nel passato, l'hanno resa accettabile, ed anzi essenzialmente verosimile, al disopra della stessa Storia principe del Barlezio.

Di qui ci si dovrebbe avviare verso un nuovo metodo per studiare l'opera, l'operato e l'autore, senza giungere a definizioni estremiste.

Storici successivi al Noli e al Gegaj alla fine si sono convinti a seguire il racconto del Biemmi, anzi a far uso non soltanto di avvenimenti ma anche di date, che in molti casi non sono indicate dal Barlezio. Tra questi dovremmo ricordare, ultimamente, Kristo Frashëri che nel suo *Skenderbeu, Jeta dhe vepra* (2002) sebbene criticamente prenda, in un certo senso, le distanze dal Biemmi, comunque lo usa abbastanza spesso facendo tesoro non solo degli avvenimenti ma altresì delle date che li accompagnano. Tutto ciò partendo anche dal presupposto del prof. A. Buda che si esprime:

*“Se noi cancelliamo dalla storia di Scanderbeg, le date, gli avvenimenti e i luoghi (e non sono pochi) per i quali abbiamo come unica fonte l'Antivarino, dalla storia di Scanderbeg scomparirà una serie di avvenimenti, di persone e di luoghi, i quali ci sono diventati familiari”*⁶.

A nostro parere, semplicemente le fonti che sono servite al Biemmi, ricordate dal Frashëri, e che precedono il Barlezio, riferentisi al Filelfo e al Pontano, al Volaterrano, al Phrantza e al Calcondila, vanno tutte a favore del nostro autore, indipendentemente dal discusso Antivarino. È naturale che chiunque intraprenda la stesura di una storia si avvalga di diverse fonti scritte e documentali e che il Biemmi abbia usato liberamente il Barlezio, è naturale che ciò avvenisse.

Ma con questo non può essere tacciato di falsario. Chi può sapere che non avesse fra le mani documenti finora inediti e sconosciuti al mondo scientifico odierno, andati perduti nel volgere degli anni o meglio dei secoli? Non sarà solo, come già dicemmo, la supposta inesistenza dell'Antivarino a scalfire quanto meno la veridicità del Biemmi.

6 Aleks BUDA, Ftyra e Skënderbeut në dritën e studimeve të reja. In: Idem, Shkrimet historike, Vol. I. Akademia e Shkencave. Tiranë 1968, p.163. Affermazione del Buda ripresa da Giuseppe GHETTI, Giorgio Castriata Scanderbeg nella storiografia. In: “Shëjzat”, XII/1968, nr.1-3, p.28.

Il semplice fatto della scoperta del manoscritto di Martino Segonio dedicato allo Skanderbeg, redatto anteriormente al 1485, anno in cui avviene il decesso del Segonio, la dice lunga sulla possibilità dell'esistenza dell'Antivarino e non della sua assoluta inesistenza, visto che del Segonio non se ne aveva notizia sino alla scoperta, pubblicata dal prof. Agostino Pertusi nel 1981.

Non dimentichiamo poi il Tajani e il Pisko che a loro volta apprezzano il Biemmi andando a nutrire la schiera di coloro che non lo negarono.

Subentra il Frashëri affermando che

“Queta accusa, - cioè del falsario, - qualora si rivelasse vera, sarebbe un colpo grave per la storiografia scanderbeghiana, la quale verrebbe ad essere privata di un racconto obiettivo più convincente di quello del Barlezio, a danno della storia dell'Eroe degli albanesi”.⁷

In questo è implicito un riconoscimento del valore intrinseco del racconto del Biemmi.

Inoltre mette in vista la posizione pregiudiziale di alcuni nel loro tentativo di svilire il più possibile il Biemmi. Qui basta ricordare alcuni brani tratti dagli scritti di A. Buda: *“Come Fan Noli, e molti altri precedentemente e in seguito, il Gegaj divenne vittima di un raffinato falsario italiano del XVIII secolo, del prete Giammaria Biemmi”*⁸ e più in là *“una invenzione del falsario professionista Biemmi”*⁹.

Il Biemmi non è da buttar giù in tronco, ma con uno studio diligente, avendo presenti tutti i documenti che si riferiscono allo Scanderbeg ed alle campagne militari che lo accompagnarono nei 25 anni di lotte continue contro l'invasore ottomano, siamo sicuri che anche da un'opinione assolutamente negativa, cioè di plagiatore e di falsario, si giunga a porlo nel giusto e meritato posto.

Dobbiamo convenire che non tutti i cronisti, e specialmente gli storici, dei secoli passati siano credibili al cento per cento. Anzi ! Avendo presenti i documenti ritrovati negli archivi di importanti città, specialmente italiane, che nel XV secolo ebbero relazioni con il nostro Eroe, si possono confermare molte notizie che, altrimenti resterebbero permeate dal dubbio o, in caso contrario, evidenziare la loro inconsistenza. In quel caso avremmo un duplice effetto: *in primis* togliere dal campo tutto ciò che non

7 Kristo FRASHËRI: *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Jeta dhe vepra (1405-1468). “Toena”*, Tiranë 2002, p.13.

8 Aleks BUDA, op.cit., p.162 n.3.

9 Ibidem, p.163

risponde a verità, ed in secondo luogo rendere più credibile e più vera una storia che va ad onore del nostro eroe.

Se le obiezioni relative al Barlezio, sulla credibilità o meno della sua storia di Scanderbeg, sono accettate senza intaccare la veridicità dell'autore e senza tacciarlo di falsario, perché non ci si attiene nello stesso modo anche con i Biemmi?

Dice il traduttore in albanese del Barlezio, Stefan J. Prifti: *“Senza dubbio il Barlezio ha le sue manchevolezze, ma designare la sua opera un “romanzo”, oppure “fantasia e menzogna” ecc.’ “senza alcun valore” è al di fuori di qualunque realtà”*⁹. Comunque in questo caso si trovano alcune attenuanti. Se F. Pall, si esprime dicendo che *“l'opera contiene del materiale di grande valore storico”,* poiché ha dati *“confermati da altre fonti di quell'epoca”,* il Noli afferma che anche il Marinesco

*“dovette concludere ed accettare che le sue informazioni non sono sempre frutto di calunnie e in qualche caso sono confermate da fonti documentarie”*¹⁰.

Concludendo, il Prifti afferma: *“Senza dubbio, il Barlezio deve essere usato con molta precauzione, ma la sua testimonianza può essere accettata, se non è contraddetta da altre fonti”*.¹¹ Lo stesso si potrebbe dire del Biemmi.

Abbiamo visto che anche il Barlezio, autore della vita e delle gesta dello Scanderbeg, abbia vissuto le stesse traversie delle quali fu vittima il Biemmi. Quindi riteniamo che per quest'ultimo sia più che mai onesto, prima di fare un giudizio definitivo, affrontare una rigorosa ricerca scientifica per convalidare uno ad uno, entro le possibilità e alla presenza di validi documenti, tutti quegli indizi che corrispondono ai fatti storici.

Comunque l'Antivarino resta sempre un problema da risolvere, avendo presente che non è né la prima né l'ultima pubblicazione da reperire. Indipendentemente dalle obiezioni nei riguardi del Biemmi, che dette notizia della sua presenza, ma non indicò né la provenienza né tanto meno il possessore.

In conclusione, a prescindere dal fatto che l'opera del Biemmi non sia da recepire, in quanto non soddisfa le esigenze di un'opera storica, deve pertanto restare sempre all'attenzione degli storici il proseguimento delle ricerche e degli studi, per porre una linea di demarcazione fra il vero e il falso, in un distinguo che porterà al riavvicinamento ad una fonte che ha avuto tanto successo negli studi castriotiani.

Eduard GRISHAJ

**“HUMANISTËT ITALO-ARBËRORË”
I PROF. PIPËS SI KAPITULL INTEGRAL I STUDIMEVE
TË TIJ HISTORIOGRAFIKE MBI LETËRSINË DHE
KULTURËN TONË NDËR SHEKUJ**

Nënvizime dhe sugjerime për lexuesin

Vepra madhore e Prof. Pipës mund të thuhet se është e endur në fushat e dijes në dy hapësira: kultura universale dhe etnokultura shqipe. Shumë prej vlerave të veprës së tij sot janë të mirënjohura e të pranuar nga studiuesit dhe lexuesit, pasi që, falë edhe punës cilësore të publikuesit Myftar Gjana, ekziston mundësia e konsultimit të tyre shqip. *Humanistët Italo-Arbërorë* qendron mes këtyre dy hapësirave si ura që lidh në mënyrë të natyrshme kulturën tonë nacionale me atë universale.

Artikulli, për të cilin po flasim sot, është një nga shkrimet akademike të Prof. Pipës, i panjohur për publikun e gjerë. Artikulli është shkruar në italisht dhe është mbajtur në një konferencë shkencore, organizuar nga *American Association of Teachers of Italian*, anëtar i së cilës ishte dhe profesori ynë. Konferenca është mbajtur në Nju Jork, në datat 27-28 dhjetor 1986. ndërsa ligjëratat janë botuar dy vjet më pas në Illinois¹. Si temë është rimbajtur më 1987, në “*Congress on the Italo-Albanian Language, History and Culture*”, zhvilluar në University of Manheim, ndërsa është ribotuar në Revistën *Albanica* në vitin 1992². Deri më sot për këtë artikull nuk është folur nga studiuesit. Arsyeja për këtë heshtje duhet parë në faktin që artikulli është shkruar në sens kritik nga dora e një jokonformisti, ndërkohë që mjerisht, pjesa dërmuese e studiuesve tanë vazhdojnë të ecin sipas modelit konformist të krijuar në diktaturë edhe pse të gjithë pranojmë se jemi ndarë nga ajo periudhë në fund të vitit 1990.

Me të drejtë mund të pyetet: Përse Pipa zgjodhi këtë temë për ta paraqitur

-
- 1 Italiana. *Selected Papers from the Proceedings of the Third Annual Conference of the American Association of Teachers of Italian. December 27-28, 1986, New York*, Edited by Albert N. Mancini, Paolo Giordano, Pier Raimondo Baldini. Rosary College, River Forest, Illinois, 1988, artikulli i Pipës *Umanisti italo-albanesi* f. 127-139. Këtu do t’i referohemi ketij botimi.
 - 2 *Umanisti italo-albanesi, Albanica*, nr. 3-4, 1992, f. 32-44. Artikulli është në italisht, por e pason një përmbledhje në shqip.

së pari në një konferencë të huaj, apo thënë më saktë, jo albanologjike, kur si njohës i thellë i gjuhës, letërsisë, filozofisë dhe kulturës italiane, ai kishte mundësi të pafundme për t'u prezantuar në konferencë me një temë nga italianistika? E dimë të gjithë që ai mund të shkëlqente me tema mbi Danten, Vicon, de Sanktisin, Kroçen, Gramshin, Montalen, Ungaretin dhe poetë apo estetë të tjerë italianë. Parapëlqimi i tij për të bërë të njohur para kolegëve italo-amerikanë kontributin e humanistëve arbërorë, të emigruar në hapësirën italiane gjatë periudhës së ekspansionit osman në shekujt XV e XVI, e ka një domethënie. Pipa e kishte kuptuar me kohë se thellimi i njohjeve tona mbi humanistët arbërorë nuk mund të realizohej pa nxitur kërkimin në këtë drejtim brenda mjedisëve shkencorë italianë, meqënëse humanizmi arbëror u zhvillua thelbësisht, në terrenin italik³. Jo pa qëllim, ai do të theksojë se humanizmi arbëror i përket kësaj marke⁴, duke saktësuar modelin venecian, si pararojë të zhvillimeve kulturore italiane gjatë periudhës së Rilindjes, duke nënvizuar gjithashtu që tetëdhjetë vite të zotërimit venedikas në Arbërinë veriore nuk mund të mos linin gjurmët e veta. Ndoshta ai nuk quajti të mjaftueshme të dhënat mbi Segonin⁵ si humanist arbëror, por mbajti të hapur hipotezën⁶, duke anuar nga Noli, për Ëngjëllin siç do të shohim më tej.

Studimi i Pipës vjen në kohën kur dijet mbi humanistët tanë, mjerisht, jo vetëm që nuk kishin bërë ndonjë hap përpara, por krahasuar me arritjet e publikuara nga LEKA⁷ dekada më parë, apo nga Historia e Letërsisë

3 Vepra studimore e Prof. Lucia Nadin është shembulli më i ndritshëm i këtij pohimi.

4 Shih: Pipa. *Vep. e cit.* f. 127.

5 Pipa nuk e shqyrtoi fare Martin Segonin, ipeshkvin e Ulqinit edhe pse kishte dijeni për të.

6 Këtë hipotezë e gjejmë më të zhvilluar më vonë tek vepra *Arbëria Venedike* e historianit austriak Oliver Jens Shmitt. Këtu Shmidi thotë që *Nëpërmjet kishës, sidomos nëpërmjet selisë arkipeshkvnore të Durrësit (mendimi humanist) depërtoi në Arbëri të mesme në gjysmën e dytë të shekullit 15.* (Oliver Jens Shmitt. *Arbëria Venedike*. Fjala publishing, Tiranë 2014, f. 543-544.

7 Në vitin 1938, revista e etërve jezuitë, Leka, nisi publikimin e një rubrike mbi humanistët arbërorë, që u mbajt nga editori i saj Zef Valentini, i cili u përqendrua tek figura e Beçikemit. Valentini premtoi se do të botonte të plota dy fjalimet e humanistit: *Panegjrikun*, mbajtur para senatit venedikas dhe fjalimin e mbajtur para senatit të Breshias, si edhe pjesë me interes historik nga veprat e tjera të tij. Për shkak të rrethanave të luftës (revista pati një ndërpreme në vitet 1940-1942), Valentini ia doli të botonte vetëm njërën, *Panegjrikun*. Me ardhjen e komunistëve në pushtet, revista u mbyll dhe At Valentini largua për në Itali ku vazhdoi të publikonte studimet e tij albanologjike. Deri më sot, nuk dimë të jenë bërë kërkime mbi fatet e këtij

Shqipe më 1959⁸, përbënin një kthim prapa, censura e vetizolimit u kishte transformuar thelbin e madje kishte edhe cunuar pjesë të veprave. Bie fjala, Shuteriqi⁹, ndërsa fliste për Beçikemin dhe shprehte shqetësimin se duheshin bërë kërkime arkivore e bibliotekare gjithandej, për t'i njohur më mirë këto personalitete, të cilëve, siç nënvizonte ai, nuk u njihnim të plota as titujt e veprave¹⁰, nga tjetër, dukej sikur nuk e kishte vënë re që Panegjiriku i Beçikemit, ndryshe nga botimi i Zef Valentinit më herët¹¹, ishte botuar nga Instituti i Historisë pa dy kapitujt e fundit¹².

Në historiografinë tonë letrare është bërë traditë që të përfshihen,

-
- projekti. Përveç *Beçikemit*, u botuan edhe *Mâ i moçmi humanist shqiptár: Joannes Gazulus, sh. XV (Antiquissimus humanista albaniensis, Joanes Gazulus, saec. XV)*, nga Florio Banfi (vj. XI, 1939, Nr. 1-2, f. 17 - 30) dhe Joan Koduni Maqedhonasi nga Bardhyli (Lluka Karafili), vj. XV, 1943, Nr. 4-5, f. 104-106. Më herët, në vitet 1930-1931, në nëntë numra, revista, nën kujdesin e Kordinjanos, pati botuar; *Nji dokument i çmueshëm: «Breve memoria de li discendenti de Nostra Casa Musachi»*, e në vijim me titullin shqip: Historia e genealogija e Shpis së Muzakejve, shkruar prej Zotni Gjon Muzakës Princit i Epirit, në vjetë 1510.
- 8 *Historia e Letërsisë Shqipe*. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë 1959, Vëll. I
- 9 Shuteriqi, Dhimitër. *Marin Becikemi (1468-1526)*. Revista *Nëntori* (Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë) 7/1982 (korrik, viti XXIX i botimit) Tiranë, f. 172-197; gjithashtu: *Marin Beçikemi dhe shkrime të tjera*. Shtëpia Botuese «Naim Frashëri» Tiranë, 1985, f. 40-77. Këtu i referohemi këtij botimi.
- 10 Shuteriqi, Dhimitër. Vep. e cituar., f. 43.
- 11 Valentini, S. J. Zef. 1938. *Nji humanist shkodran. Marin Beçikemi (kah 1468-1526)* [Fjalim kremtues që i drejtoi Marin Beçikemi shkodranë Fort të Këthiellitit Dogje Leonard Loredanit e të Përndritshmit Senat të Venedikut]. Vjeti X, Nr. 6-7 qershier-korrik 1938, f. 246-269 (shih gjithashtu Errata-Corrige f. 372), Shtyp. «ZOJA E PÁPERLYEME» Shkodër; Nr. 8-9 ... [Meritimet e derës Loredane – Meritimet e Shkodrës ndaj Venedikut]. Nr. 7-8 shtatuer-tetuer 1938, f. 336-344 (Shih: Shtojcë f. 382); ... [Rrethimi i Shkodrës (1474)]. Vjeti XI, Nr. 4 prill 1939, f. 99-103; ... [Rrethimi i dytë i Shkodrës (1478)]. Nr. 5, f. 116-119; ... [Meritimet e Shtëpis Beçikeme – Si u pritën shkodranët në Venedik]. Vjeti XV, Nr. 1 kallënduer 1943, f. 7-11; ... [Meritimet e Leonard Loredanit]. Nr. 2 fëruer, f. 40-42 + fl. portret; ... *Humanizma e jonë: Beçikemi* [Falnderime n'emën të shkodranvet e n'emën të vet]. XV, Nr. 3 mars 1943, f. 75-77.
- 12 Rrethimi i Shkodrës së Marin Barletit, Botimi i II nga Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1967, dhe, Botimi i III, tashmë nga Shtëpia Botuese «Naim Frashëri», Tiranë, 1982, u bashkëshoqërua, përveç parathënies së ripunuar të Prof. Aleks Buda dhe shënimeve, edhe nga *Lufta e Shkodrës* të Gjergj Merulës dhe *Panegjiriku* i Beçikemit. Krahasuar me botimin e Valentinit, tekstit të Beçikemit, në dy botimet e sipërpërmendura, i mungojnë dy kapitujt: *Meritimet e Leonard Loredanit*, dhe *Falnderime n'emën të shkodranvet e n'emën të vet*.

sidomos për periudhën e hershme, e cila njihet me emërtimin *Letërsi e vjetër shqipe* edhe vepra të shkruara latinisht si *Rrethimi i Shkodrës* dhe *Histori e Skënderbeut* të Barletit, dhe disi më shkarazi *Panegjiriku* i Beçikemit (ndonëse jo i plotë) dhe *Komentari* i Frëngut. Kjo sepse nga kriteri tematik ato i përkasin kulturës sonë etnike, ndërsa latinishtja si gjuhë mbinacionale, apo thënë më saktë, si gjuha e elitës intelektuale europiane ishte ende vitale, ndërkohë që nga pikëpamja gjuhësore, humanizmi si lëvizje intelektuale dhe artistike, me të cilën kanë fillësat e tyre shumë kultura nacionale, në fazën e hershme të tij, vazhdonte të shprehej kryesisht në këtë gjuhë.

Ky studim dëshmon gjithashtu se Pipa qëndronte në korrent me jetën studimore brenda Shqipërisë.

Artikulli nis me theksimin e krenarisë legjitime që ndjejnë shqiptarët për periudhën e lavdishme të qendresës antiosmane në shekullin e XV dhe heroin e tyre nacional Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Në këtë, periudhë, sipas autorit tonë “hidhen themelet e një vetëdijeje nacionale në formë të shkruar, me Skënderbeun si strumbullin e saj”¹³.

Në prezantimin e personaliteteve humaniste shqiptare, Pipa prin me Gjon Gazullin, i njohur si humanisti më i vjetër shqiptar. Pipa rievokon me mirënjohje meritën e Florio Banfit¹⁴, i cili kishte përcaktuar definitivisht origjinën etnike të Gazullit, ndërkohë që shpalo kontributet e humanistit tonë në shkencë dhe në diplomaci, gjatë ushtrimit të së cilës, del në pah patriotizmi i tij, një fakt i anashkaluar nga historiografia e diktaturës¹⁵. Për të kuptuar këtë diferencë, le të citojmë autorin tonë: “Në 1451 është ambasador i Raguzës pranë papës Nikolla V për dhënien e një privilegji¹⁶. Nga letra kredenciale rezulton që Gazulli i kishte kërkuar senatit raguzan të ndërmjetësonte edhe në favor të Skënderbeut, aleat i Raguzës kundër turqve¹⁷. Dokumenti vërteton që Gazulli, qytetar raguzan, ishte edhe një

13 Pipa. Vep. e cituar, f. 127. Shih gjithashtu edhe përmbledhjen tek *Albanica* (v. cit.), f. 43.

14 Florio Banfi është pseudonim i akademikut hungarez Holik Barabás Flóris László (1899–1967). Studiuuesi dhe bibliografi ynë i mirënjohur Willy Kamsi e shënon: Ladislá Holik Barabás.

15 Tekstet e Historisë së Letërsisë Shqipe, botimi i Prishtinës 1968 dhe ai i Tiranës 1981, injorojnë faktin tejet domethënës që rikujton Pipa.

16 Shih më gjerë: Banfi, Florio. Vepër e cituar, f. 24.

17 “Ma non ottegnendo essa bolle non possate parlar per el fatto di essa Scanderbeg”. (*Por nëse nuk e merrni atë vulë nuk mund të flisni për Skënderbeun.*). Faksimile (vështirësisht e lexueshme) e pjesshme e letrës kredenciale të fotokopjuar, në Mikel Prenushi, *Kontribut shqiptar në Rilindjen europiane* [Contributo albanese al

patriot shqiptar”¹⁸. Gjithashtu, akoma më të qartë na e bën imazhin e Gazullit patriot, teksa plotëson tablonë familjare të tij me një tjetër të dhënë të rëndësishme. “Vëllezërit e tij, Andrea dhe Pali, figurojnë si ambasadorë të Skënderbeut në Raguzë, i pari nga 1452 deri 1459 dhe i dyti, në 1462”¹⁹.

Personaliteti i Pal Ëngjëllit, i përkufizuar si krahu i djathtë i Skënderbeut, pason atë Gazullit. Përkundër metodologjisë historiografike vetizoluese, Pipa ballafaqon për Ëngjëllin opinionet e dijetarëve autoritarë në fushën e albanologjisë si Noli, nga njëra anë dhe Francisko Pal e Babinger nga ana tjetër, lidhur me pohimin e historianit breshian Xhamaria Biemit, i cili, pretendoi në shekullin e XVIII²⁰ se veprën e tij mbi Skënderbeun e kishte mbështetur kryesisht mbi librin e një autori anonim nga Tivari, dhe për plotësim kishte përdorur edhe *Historinë* e Barletit. Pipa sheh tek Noli një arsye më shumë që ta ketë shtyrë këtë të besonte se pas Tivarasit, nuk qëndronte kush tjetër veçse imzot Pal Ëngjëlli: fakti që nga dora e tij kemi dokumentin më të hershëm në gjuhën shqipe të njohur deri më sot, *formulën e pagëzimit*. Pipa anon dukshëm nga mendimi i Nolit, referuar në një të dhënë nga Pietro Lukari, i cili në librin *Analet e Raguzës*, botuar me 1605, thotë se ka shfrytëzuar një *Histori të Skënderbeut* shkruar nga Arqipeshkvi i Durrësit.

Barleti zë sigurisht një hapësirë të merituar në artikullin e Pipës. Ai i atribuon pikërisht priftit shkodran meritën e përhapjes së famës së heroit tonë në Europë duke theksuar përkthimet dhe botimet e shumta. Por nga këndvështrimi analitik i tekstit, Pipa vlerëson gjithashtu meritat e Barletit si shkrimtar humanist: “Një tjetër arsye për mirëpritjen e veprës është se ajo është shkruar mirë dhe lexohet si një roman. Sikurse historianët e tjerë humanistë, Barleti shkruan jo dhe aq për të treguar faktet, sa për të lartësuar heroin e tij, duke u mbështetur në të gjitha mjetet retorike të kohës. Skënderbeu i fiton betejat e tij më pak falë shpatës së tij sesa falë ligjëratave të tij mjeshtërore para ushtarëve që nuk janë oracione të vogla

Rinascimento europeo]. (Tirana: 8 Nëntori, 1981) 48. Bëhet fjalë për dokumentin e koncesionit papnor. Letra kredenciale i jep leje Gazullit të ndërhyjë në favor të Skënderbeut vetëm nëse do t’ia dilte të përfntonte privilegjinin. (Shih: Pipa... fusnota 6, f. 136)

18 Pipa, Arshi. Vep. e cituar, f. 128

19 Po aty.

20 Biemmi, Giammaria. *Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-begh, di Giammaria Biemmi, prete bresciano*. In Brescia MDCCXLII, dalle stampe di Giam-Battista Bossino, con licenza de’ Superiori, PREFAZIONE, f. 3 (e pasme) - 4 (e parme).

*si ajo e Ulksit, por zënë faqe të tëra*²¹. Me pak fjalë, portretin e Barletit sipas Pipës mund ta përfytyrojmë njëkohësisht si përhapësin e lavdisë së Heroit tonë nacional në Europë dhe burimin gjenerues të literaturës kastriotiane. Nuk duhet të harrojmë gjithashtu që përkthimi dhe botimi i veprave të Barletit në gjuhët europiane ka shkuar pothuajse paralel me përkthimin dhe botimin e Biblës.

Figura tjetër e shquar e humanizmit arbëror, Marin Shkodrani - Beçikemi vjen e skicuar sipas të dhënave biografike që flasin për peripecitë e jetës së autorit, veçorive tekstore dhe shquarsisë së tij si retorist. Pipa rendit një sërë veprash të Beçikemit, por, ndalet të interpretojë vlerat e *Panegjirikut*, thurjen e të cilit e sheh si një gërshetim të patriotizmit dhe lajkatizmit me një zotësi retorike, duke na shtyrë në rrethanat politike të fillimit të shekullit XVI. Pipa e qorton Zenon, sepse u kufizua në përdorimin e të dhënave të nxjerra nga vetë shkrimet e Beçikemit pa bërë kërkime arkivore e bibliografike. Kjo do të thotë se studiuesi ynë njihte mjaft çështje të diskutuara që herët mbi dy humanistët shkodranë, identiteti i të cilëve u ngatërrua jo rrallë, madje duke i paraqitur të dy si një person të vetëm²². Pipa nuk u mor drejtpërdrejt me këtë temë, por dalloj në mënyrë thelbësore që Barleti dhe Beçikemi, edhe pse shpesh flisnin për të njëjtat ngjarje, tema dhe personazhe, apo përdornin të njëjtat burime, shfaqnin diferenca të mëdha. Njëra nga këto ishte që Barleti me epirotë identifikonte arbërit që flisnin arbërisht, ndërsa Beçikemi grekët që flisnin greqisht²³.

Frëngun, Pipa e trajtoi disi më kalimthi, ndoshta ngaqë nuk e rendiste në humanistët e mëdhenj, sikurse Gazullin, Barletin, Beçikemin dhe Tomeun. Gjithsesi ai nuk mungoi t'i njihte meritën veprës së tij, sikurse dhe studiues të tjerë, që, edhe pse një përmbledhje e Historisë së Barletit, në disa raste ishte më kritike.

Tek përshkrimi për personalitetin sokratik të Tomeut, i njohur si humanisti më madh me origjinë arbërore, diktohet vokacioni i hershëm i filozofit tonë. Vepra e një filozofi shqiptar të Pesëqindës interpretohet pas

21 Po aty, f. 130

22 Ai që i ngatërroi i pari autorët tanë ishte dijetari humanist Xhovie (Paolo Jovii). Ndoshta në mirëbesim ndaj autoritetit të tij si dijetar, shumë të tjerë, mes të cilëve edhe Vossio (Joanes Gerardi Vossio) i trajtuan dy Marinët si një autor i vetëm. Në shekullin e XVIII, Xhamaria Biemi dhe Apostolo Zeno, me pohimet dhe studimet e tyre, kontribuan në rindarjen e identetiveve të këtyre dy autorëve. Lidhur me këtë çështje do të flasim në një studim tjetër.

23 Pipa. Vep. cit., f. 132. (teksti latinisht, përkthyer italisht nga autori në fusnotën 25, f. 137).

më shumë se katërqind vjetësh nga një tjetër filozof shqiptar, i cili pa në brendinë e mendimit të të parit, ato hapa që çojnë dijen përpara, në një kohë kur historiografia e vetizolimit i anashkaloi, edhe pse historiografia italiane e njihte prej kohësh si majën e mendimit filozofik në Italinë e shekullit XVI.

Të shkruash mbi humanizmin nuk është një sipërmarrje e lehtë për çdo studiues, sepse lypsen njohuri në disa fusha, por me Pipën nuk është e njëjta gjë. Ai zotëronte gjithë bazën e nevojshme studimore, teorike, metodologjike, linguistike e historike për të shqyrtuar lëndën e për të nxjerrë tezat e konkluzionet. Për këtë ai i bëri një ndarje në dy blloqe humanistëve tanë: në bllokun e parë ai përfshiu autorët që shkruan në latinisht, ndërsa në të dytin, ata të cilët shkruan në gjuhën *vulgare*, ku veçon shpirtin kalorsiaiko-krijues të stradiotit, Manol Blessi, dhe aftësitë strategjike në fushën e luftimeve të gjeneralit të famshëm, Gjergj Basta, i cili, njëhej gjithashtu edhe si teoricien në shkencën ushtarake, falë librave që ai shkroi duke u mbështetur në karrierën e gjatë mbi dyzet vjeçare në krye të betejave. Pikërisht Bastës i atribuohet “shpikja” e shtabit të përgjithshëm të ushtrisë dhe shefit të saj, ndaj dhe Pipa e përfshiu në funksion të një tipizimi të luftëtarit arbëror. *Mjeshtri i përgjithshëm i kampit dhe Për drejtimin e kalorësisë së lehtë*, botuar në vitet e largëta, respektivisht, Venecia 1606, Frankfurt 1612, i erdhën në dorë publikut shqiptar, nga Shtëpia Botuese e Ushtrisë, në 1996, dhjetë vjet pas kumtesës së Pipës, dhe pothuaj tridhjetë vjet pasi profesor Dhimitër Pilika prezantoi figurën e Bastës, në faqet e revitës *Ylli*, më 1967. Pipa, madje, i “kapërcen” kufinj të kohorë të humanizmit për ta pasqyruar këtë shpirt duke iu referuar teksteve të letërsisë së kultivuar italiane, ku janë gdhendur gjurmët e dy kategorive të stradiotëve: kapeletëve dhe kamiçiotëve. (Të parët në shërbim të Venedikut, të dytët në shërbim të mbretërisë së Napolit).

Aty ku Pipa dallon dhe mban qendrim ndaj historiografëve zyrtarë të letërsisë sonë është pozita e dijetarit në raport me faktografinë. Ai dha të kuptohej se universaliteti religjioz i humanistëve tanë (pesë prej të cilëve ishin klerikë) përbënte shkakun kryesor pse këta autorë nuk studioheshin siç duhej nga historiografia letrare e vetizolimit, doktrinë që tashmë paradoksalisht i binte ndesh edhe parimeve të veta të internacionalizmit proletar. Për mungesë të dhënash pohuese, Pipa, konsideroi si të dyshimtë origjinën etnike të dy humanistëve *ballkanas*, Mikel Marul Tarkanjoti, poeti-ushtar mjaft i dashur nga Benedeto Kroçe dhe Maksim Artioti, apo siç njihet ndryshe Maksim Greku. Madje, do të theksonte me këtë rast,

që origjina etnike dhe përkatësia kulturore janë dy gjëra të ndryshme që nuk duhen ngatërruar²⁴. Për më tepër, veç së tjerash, atdheu i Tarkanjotit, i lindur në Kostandinopojë, për Pipën, nuk është dhe aq Greqia Bizantine, sa ai i një atdheu kulturor, i poezisë klasike dhe mitologjisë pagane.

Me këtë studim, të cilin unë e konsideroj si një kapitull i plotë i studimeve historiografike të Pipës mbi letërsinë shqipe dhe kulturën shqipe, mund të themi se ai e kishte konceptuar veprën e tij studimore në atë formë që ajo të mund të lexohej sa aq si një vepër kritike aq edhe si një *Histori alternative e Letërsisë sonë*, që nga zanafilla deri epilogun e realizmit socialist, me një këndvështrim tjetër nga ai zyrtar në Shqipëri dhe në Kosovë. Ai nuk e emërtoi letërsinë e humanistëve tanë si letërsi të mirëfilltë shqipe, por dukshëm e konsideroi atë si një faktor të rëndësishëm letrar e kulturor për vetë letërsinë tonë nacionale, teksa e përkufizoi si pararendësen historike të saj. Nëse e bashkangjisin këtu studim me *Trilogjinë Albanika* dhe me *Letërsinë bashkohore shqipe*, do të shohim se qendron si një kapitull i plotë historiografik. Kjo sepse Pipa i kishte të qarta parimet teorike dhe veprat e tij i hartoi që të shërbenin në disa drejtime dhe jo si shkencë për hir të shkencës.

Për këtë studim, Pipa nuk bëri kërkime të thelluara arkivore. U mbështet kryesisht në një bibliografi të pasur sa dhe të besueshme ku bëjnë pjesë emra me autoritet botëror, si Eugenio Barbaric, Florio Banfi, Apostolo Zeno, Girolamo Tiraboschi, George Petrovic, Pierre Bayle, Zef Valentini, Francisko Pal, Alfred Philipson etj., si dhe në enciklopeditë më prestigjioze, si *Treccani*, *Dizionario degli italiani* dhe *Enciklopedia e filozofisë*. Po kështu, bie në sy, se shumë nga tekstet e humanistëve tanë, të cilave ai u referohet, i ka lexuar e studiuar drejtpërdrejt në origjinal. Duhet nënvizuar që një pjesë e konsiderueshme e literaturës së shfrytëzuar prej tij, bënte pjesë në fondet e rralla të bibliotekave, kështu që nuk ka qenë një punë e lehtë nga pikëpamja e mbledhjes së materialeve. Teknologjia dixhitale që përdoret sot, asokohe ishte ende një ëndërr. Sot, shumë nga ato materiale që Pipa duhej t'i fotokopjonte nëpër biblioteka pas udhëtimit të gjata, gjenden në fondet online, që pak konsultohen, ose dhe kur ndodh, konkluzionet na vijnë të pështjelluara.

Pipa, në të vërtetë, nuk u nis të shkruante një kapitull në pikëpamje të historiografisë letrare. Madje, nëse e kujtojmë sadopak kapitullin bibliografik të tij mbi periodizimin e letërsisë shqipe²⁵, do të shohim

24 Pipa. Vep. cit., f. 134.

25 Pipa, Arshi. *Trilogjia Albanika III. Letërsia Shqipe: Perspektiva Shoqërore*. Bo-

se letërsia humaniste nuk përfshihet aty, siç nuk përfshihej në traditën historiografike të para luftës. Por nëse e trajtojmë këtë problem teorik në sens kronologjik, do na rezultojë që ai ishte pajtuar me kriterin etniko-tematik që përdorej në Shqipëri. Çka ai solli të veçantë, përveç një informacioni të bazuar mbi të dhëna, ishte dhe qendrimi kundër mitizimit dhe hamendësimeve, të cilat, studimet moderne nuk i pranojnë. Ai u kujtoi kolegëve të tij në Shqipëri se e vërteta shkencore është një sfidë që mbështetet tek kërkimi dhe zbulimi i të dhënave pohuese dhe jo tek hamendësimi.

Mund të thuhet se Pipa bëri i vetëm punën e një instituti të tërë. Me studimin mbi humanistët arbërorë, edhe pse në kuadër të studimeve kritike, ai shkante drejt përmbylljes së veprës së tij historiografike mbi letërsinë shqipe. Pa dyshim që pa Pipën, zor se edhe studiuesi i njohur Robert Elsie do t'ia kishte dalë me sukses të kryente veprën e tij historiografike mbi letërsinë shqipe. Ndikimi i Pipës tek ai është i dukshëm, e sigurisht edhe tek studiues të tjerë që merren me historinë e letërsisë sonë apo edhe me kritikën letrare më gjerë. Megjithatë, studiuesit dhe institucionet akademike të Shqipërisë dhe të Kosovës duhet të mbajnë parasysh tezat shkencore të Prof. Pipës, e t'i bëjnë pjesë të programeve studimore në një rrafsh më të gjerë.

Konkluzione

Ndryshe nga historiografia zyrtare që i shihte humanistët shqiptarë nga një tjetër perspektivë, ajo e mitifikimit të vetizolimit, Pipa e shqyrtoi kontributin e tyre si një çështje vetëdijeje etnike, sigurisht në kontekstin e përgjithshëm mesjetar, por edhe si aftësi e arbërve për të qenë të hapur ndaj kulturave më të përparuara. Diktohet lehtë që ai shihte identitetin tonë historiko-kulturor si pjesë të së tërës europiane dhe që ndjehej i shqetësuar nga ai prezantim i shtrembëruar që i bënte doktrina e vetizolimit. Në funksion të tezës së tij, Pipa nuk vë thjesht përkatësinë etnike të autorëve, por përkatësinë kulturore, shprehjen e saj në mënyrë të vetdijshme, materializuar nëpërmjet shkrimit. Për arsye shkencore, Pipa nuk i konsideroi të mjaftueshme të dhënat për të pohuar përkatësinë etnike të disa humanistëve, të supozuar si arbër duke u nisur nga vendlindja, meqë në mesjetë, struktura demografike e qyteteve apo e krahinave të caktuara,

timet "Princi". Përkthyer nga origjinali anglisht: Myftar Gjana, Tiranë, dhjetor 2013, f. 181-190. (Titulli në origjinal: *Trilogia Albanica III. Albanian Literature: Social Perspectives*. Dr. Dr. Trofenik. Albanische Forschungen, vol. 19, Munchen 1978).

të cilat, kalonin pareshtur sa nga një dorë pushtuesish tek një tjetër, ishte aq e përzier. Për Pipën, kontributi i humanistëve tanë arbërorë në periudhën e Rilindjes, mjaft i rëndësishëm për vetë humanizmin në tërësi, është po aq i rëndësishëm për letërsinë tonë nacionale, si precedenti historik i saj. Pipa kritikoi qendrimin antishkencor të historiografisë sonë letrare për injorimin që i bëhej këtyre figurave të shquara. Ai identifikoi si shkak të këtij injorimi faktin që nga humanistët tanë të mëdhenj në rrafsh evropian, shumica e tyre kishin qenë klerikë.

Olimpia KAKARRIQI

PUNA KËRKIMORE E ALBANOLOGUT FILIP FISHTA NË BIBLIOTEKAT EVROPIANE

F.Fishta, (1904-1973) nxënës i albanologut francez Mario Rocques, i njohur si një ndër filologët më të shquar shqiptarë të shekullit të kaluar, (fatkeqësisht thuhet i harruar në vite për shkaqe politike) ka dhënë një ndihmesë të çmuar në gjurmimin e dokumentave të vjetra të shqipes në bibliotekat europiane. F. Fishta do të kërkonte dhe gjurmonte materiale të rëndësishme për Shqipërinë në bibliotekat më në zë të kohës si: në Bibliotekën e Vatikanit, në Bibliotekën Nacionale të Parisit, në Bibliotekën Nacionale të Romës, në Bibliotekën e Beogradit, ku gjendeshin koleksione të shumta me vlera botërore. Shumë artikuj të botuar në të përkohshmet “Hylli i Dritës”, apo “Leka”, janë dëshmi e punës këmbëngulëse në këto biblioteka. Shkrimi i tij “Ndër gjurmimet e veprimit “De Propaganda Fide” në Balkan”, në fillim na njeh me konferencat e mbajtura nga Mario Rocque “Recherches sur la lexicographie du Moyen-Age” në Sorbonë dhe mësimet e tij në drejtim të zbulimit dhe të kërkimit të shkrimeve apo librave të vjetër, të botuar nga Propaganda Fide. Atë çka Mario Rocques thekson për nxënësit e tij, F.Fishta ia transmeton bashkëatdhetarëve të tij, në mënyrë që secili që do të merrte përsipër këtë mision, të ishte i qartë dhe i saktë në kërkimet që bënte. Një nga shembujt që merrej për këtë qëllim, ishte zbulimi nga Rocques i veprës së Pjetër Budit “Speculum confessionis” në Bibliotekën e Vatikanit, ku brënda këtij vëllimi gjendeshin dhe dy përkthime të tjera:

1. “Rituale Romanum” in Epyroticam linguam a Petro Budi (Ritualin romak të Budit me rubrika në gjuhën shqipe, 1621), dhe

2. “Sanctissimi Domini Nostri” (Diftonjësi i meshës romake, 1621)

Këta përkthime mund të merren si vepra në vete, pasi kanë një numërim të veçantë faqesh dhe nuk prezantohen në fillim të veprës me titujt përkatës. Rocques vëren se të tilla raste mund të gjendeshin në botimet e kohës, për arsye të ndryshme të botuesit, por që kjo mënyrë mbante të fshehur një pjesë të veprave, duke bërë mosparaqitjen e tyre në katalogët e bibliotekave të ndryshme në dispozicion të lexuesve. Prandaj ishte detyrë e çdo kërkuesi të identifikonte mirë veprën, duke përshkruar autorin, titullin, vendin e botimit, vitin e botimit si dhe numrin e faqeve të

veprës. Duke marrë shkas nga mësimet e Rocques, F.Fishta gjatë vizitës së tij në Bibliotekën Mazarine të Parisit, përshkruan *besënikisht*, siç shkruan ai, librin e Budit “*Speculum confessionis* (1621) dhe “*u vuna të lypi po n’at bibliotekë tri kopjet e fjalorit të Bardhit* (1635) po nën një numër 20.053, shka ndër këto dit rishtypi Roques, pri prej njëj parathanje të gjatë e të dokumentueme mbi Bardhin”¹

Pjesa që i ngjalli kuriozitet Fishtës, në Bibliotekën Mazarine, ishte se po në vëllimin e Doktrinës së Krishterë të Budit (botimi i dytë, 1636), vëren dy botime të tjera në gjuhën sllave të një françeskani që herë nënshkruan *Pjetër Bogdani*, Kustodi i Bulgaris, herë këtij emri i shton edhe *At Bakscich*. Libri me nr. 24619, pas Doktrinës së Krishterë ka dy vepra të tjera të bashkëngjitura me titujt: “*Meditationes S. Bonaunenturae*” me 208 faqe dhe “*Od dvostruke/Smarti covieka*” që fillon me një letër të datës 26 korrik 1637. Të dy këto libra kanë lejen nga Propaganda Fide. (“*Typis Sacrae congreg. De Propag. Fide / Superiorum Permissun.*”)

“*Dottrina Christiana*” që përshkruan F.Fishta është ribotim i vitit 1618 me disa ndryshime të vogla të cilat mund të ishin dhe gabime shtypi, por që ai i evidenton dhe i korrigjon në detaje. Gjithashtu këtij botimi i mungon një pjesë nga parathënia, të cilën kritikun ynë e quan shumë të rëndësishme për gjuhën shqipe, prandaj ia sjell lexuesve të plotë, bile duke sqaruar dhe zëvendësimin e gabuar nga shtypi të ndonjë shkronje të veçantë. Duke lartësuar shkrimtarët e vjetër shqiptarë Budin, Bardhin dhe Bogdanin, të cilët i quan “*Bari të Kishës Katolike në Balkan*”, dhe veprat e tyre të një rëndësie kryekrejë, ai thekson se këta autorë “*ruejten me nderim të pathyem karakterin kombëtar, tuj këqyrë edhe me psime të mdha të mbajn gjall gjuhën, shejin ma të çmueshmin qi na kemi si kombë*”²

GJURMIMET E NJË MUAJI NË ROMË

“Gjurmimet e njëj mueji në Romë”, është tjetër studim i rëndësishëm mbi historinë, letërsinë e kulturën kombëtare ku trajton:

- Pjetër Budi e veprat e tij.
- Kuvendi i Arbërit.
- Pseudo-edicionet e veprës apologjetike të Bogdanit (1685, 1691, 1702) në Bibliotekën Nazionale të Romës.
- Cvietni Triod i Stefanit “ot Skadra” e vendbotimi i vazhdimit të këtij libri fetar (botim i vitit 1563)

1 F.Fishta, Hylli i Dritës, Shkodër, 1932, Nr.7-8, f. 378.

2 Po aty, f. 384.

- Relacioni i vizitës baritore të Marin Bizzi-t nëpër Shqipëri e Sërbi të vjetër nr vitin 1610, botimi i Franjo Raçki-t në “Starine XX” të Zagrebit, ndryshuar e plotësuar pas krahasimit të bërë me origjinalin e dorëshkrimit të Bibliotekës së Vatikanit.

PJETËR BUDI E VEPRAT E TIJ.

Në vitin 1939, F.Fishta ngarkohet nga Ministria e Arsimit të fotografojë në Bibliotekën e Vatikanit veprën e Pjetër Budit “Speculum Confessionis”, “Pasqyra e të Rrëfyemit”. Kjo ishte hera e dytë që do të përshkruante dhe fotografonte këtë veper, pasi herën e parë e kishte fotografuar në Bibliotekën Mazarine të Parisit, në vitin 1932 me kërkesën e D. Ndre Mjedës. “Sivjet në rasë qi Z. Filip Fishta shkote në Parigj me krye këndimet e veta, ju lutshë m’u orvatë për këtë punë; e ai me drejtime të profesorit të vet Z. Mario Roques, qi përmendme, jo veç se e gjet librin, por edhe me një zell të pashoq u vu e e përshkroi krejt.”³ Por fotografimi ishte bërë me foto negative (gërma të bardha në shesh të zi), prandaj vepra ishte e papërshtatëshme për botim. Megjithatë D. Ndre Mjeda në emrin e tij dhe të revistës “Leka” e falenderoi “ të flaktin atëdhetar”, F. Fishtën, për kopjimin me dorë të veprës dhe fotografimin e saj. Ai botoi në revistën “Leka” fac-similen dhe dhjetë faqe të parathënies së veprës të transkriptuar. Fotografimi i dytë i veprës së Budit ishte vazhdimi i një pune të lënë përgjysëm disa vite më parë. Kjo veper,



Rituali Roman me foto negative



Doktrina e Krishterë e fotografuar në Bibliotekën Mazarine

3 D. Ndre Mjeda, „Përmbi një libër të panjoftun të T’imzot Pjetër Budit“, Leka, Shkodër, 1932, Nr.7-8, f.221.

me titullin e përbashkët “Rituale Romanum et Speculum Confessionis” së bashku me fashikullin (që besohet që qarkulloi si botim më vete) “Shpjegimin e Meshës Romane” prej 16 faqesh, e tëra me “fotografi pozitive”, e përshtatshme për botim, u bë në Bibliotekën e Vatikanit, duke plotësuar kështu veprën e plotë të Budit. Megjithë këtë punë të shkëlqyer, asnjë nga studiuesit tanë nuk e zë me gojë emrin e Filip Fishtës si fotografuesin e parë të veprës së Budit dhe emërtimit që i bën ai pjesës ndërmjetëse të veprës. Me të drejtë Gjovalin Çuni në studimin e tij për këtë autor shkruan: “...një kopje e fotografuar e kësaj vepre ndodhet në Bibliotekën Kombëtare. A mos vallë është kopja e Filip Fishtës?”⁴ Po në këtë bibliotekë gjendeshin edhe vepra të tjera të Budit, të cilat ishin të rëndësishme për historinë dhe letërsinë tonë.



Speculum Confessionis

KUVENDI I ARBËRIT

Vepra latinisht-shqip “Concilium Albanum” (Kuvendi i Arbërit) i Vinçens Zmajevich, arqipeshkëv i Tivarit, është një tjetër vepër e rëndësishme që tërheq vëmendjen e Fishtës. E botuar në Romë më 1706 në shtypshkronjën e Propagandës Fide, ajo paraqet historinë kishtarë të Shqipërisë, por në të njëjtën kohë është një ndihmesë e çmueshme në fushën e historisë, të gjuhësisë dhe letërsisë. F. Fishta fotografon fletët e librit në gjuhën shqipe dhe bën një përshkrim të përmbajtjes duke na sjellur të plotë fjalimin e Zmajevich-it, i cili ishte ngarkuar nga Papa Klementi XI (1649-1721), të vizitonte gjithë Shqipërinë e pastaj të mblidhte një Kuvend Kishtar në Mërçi (dioçezë e Lezhës). Kuvendi u mbajt në vitin 1703 me pjesëmarrjen e arqipeshkvive të Shkupit, të Durrësit, të Sapës, të Lezhës, të Pultit e të Shkodrës dhe u drejtua nga Vizitatori Apostolik, Arq. Vinçens Zmajevich. Rregjistrimi i numrit të faqeve, i kërreve (kaptinave), i dekreteve apo ligjeve të Kuvendit, i bërë me skrupolozitet tregon punën e admirueshme të F. Fishtës. Përveç përshkrimit të faqeve të fotografuara dhe të kopjuara na bie në sy vështrimi kritik nga ana gjuhësore. Shpesh, ai

4 Gj. Çuni, Studime Shqiptare 14, Autorët e trevës së Veriut të traditës, në vështrim gjuhësor, letrar dhe historik“, Shkodër, 2007, f. 250

bën komente të përdorimit të alfabetit të përdorur. “Nji veçori e orthografisë së këtij vëllimi në lidhje me alfabetin e moçëm të Gegnis në të cillin janë të shkrueme me radhë veprat e Buzukut, të Budit, të Bardhit apo të Blankut e të Bogdanit, Kuvendi i Arbënit përdorë në shum rasa edhe gërmën “k”, si e kemi n’orthografin e soçme të shqipes në vend të “c-s” e cila ka qenë shkruie prej shkrimtarëve të tjerë para tij, pa dyshim nën influencën e gjuhës latine apo të ndonjij gjuhe tjetër neo-latine(italishte).”⁵ Ai vazhdon me konstatime të tjera të përdorimit të shkronjave duke iu referuar edhe studimit të Justin Rrotës “Për historin e alfabetit shqyp”.

PSEUDO-EDICJONET E VEPRËS APOLOGETIKE
TË BOGDANIT (1685, 1691, 1702)
NË BIBLIOTHEKËN NACIONALE TË RROMËS.

Gjatë qëndrimit në Romë, Fishta vëren se në Bibliotekën e Vatikanit gjendet vetëm një kopje e veprës së Bogdanit, “Cuneus Prophetarum”, kurse në Bibliotekën Nationale të Romës gjenden tre botime të së njëjtës vepër: i pari në Padova i vitit 1685(“Cuneus Prophetarum” de Christo Salvatore mundi...), i dyti në Venedik më 1691(“L’infalibile verita”, Spiegata in due Copiose lingue Italiana e Schiava...), dhe i treti përsëri në Venedik më 1702(“L’infalibile verita”, Spiegata in due Copiose lingue Italiana e Schiava...). Duke parë se në botën letrare mendohej se ishin tre botime të ndryshme, mbasi ndryshonte titulli, numri i faqeve apo vëndi i botimit, Fishta duke bërë një krahasim të hollësishëm të teksteve, arrin në përfundimin se “na kemi vetëm një botim të mbarë veprës së Bogdanit, me gjithse tri datat e vëndet e ndryshme na e tresin gjurmën. Botuesi ka mundun t’a bajë për arsye tregtare këtë pseudo-edicjon të Padovës dhe atë të Venedikut”.⁶ Këtë pohim e jep dhe G.Petrotta në veprën e tij “Popolo, Lingua e Letteratura Albanese”(Palermo, 1931, f.97).

CVIETNI TRIOD I STEFAN-IT “OT SKADRA”
E VEND-BOTIMI I VAZHDIMIT TË KËTIJ LIBRI FETAR
(BOTIM I VJ. 1563)

Hulumtimi i Fishtës në Bibliotekën e Vatikanit vazhdon me shfletimin e veprës “Cvietni Triod” i Stefanit “ot Skadra”. Këtë vepër e kishte gjetur edhe në bibliotekën e Beogradit “Narodna Biblioteka”, por pa fletën që

5 F.Fishta, Hylli i dritës, “Gjurmimet e një mueji në Romë”, Shkodër, 1940, Nr.10-11, f.511.

6 Po aty, f. 513.

kishte të shënuar autorin, vendin e vitin e botimit. Në studimin e tij “Çashtja e dy shtypëshkrojeve të shekullit XVI në Skënderi (1563) e n’Epidamos (1584)”, trajtohet rëndësia që i dha N. Jokli çështjes së vendit të botimit të “Mesharit” të Buzukut (1555), duke e krahasuar atë me veprën “Cvietni Triod” që mendohej të ishte botuar në Shkodër. Pra N. Jokli hidhte hipotezën e botimit të “Mesharit” në Shkodër. Qëllimi i studimit të Filip Fishtës ishte të vërtetonte ekzistencën e një shtypshkronje në Shkodër në vitin 1563, dhe nëse vepra sllave ishte botuar në këtë shtypshkronjë, mund të vërtetohej dhe pohimi i Jokl-it për “Mesharin”.⁷ Me kërkesën e J. Rrotës, F. Fishta iu vu punës për historinë e shtypshkronjave Jugosllave. Duke u paraqitur si bashkëpunëtor i së përkohëshmes letrare “Hylli i Dritës”, Fishta iu drejtua akademikëve serbë Jovan Tomiç e Ljubomir Stojanoviç, të cilët u treguan të gatshëm të bashkëpunonin. Duhet theksuar se ishte Profesori i Universitetit të Beogradit, Henrik Bariç, që e drejtoi Fishtën të fliste me këta personalitete serbe.

Nga kërkimet dhe studimet e tij në Bibliotekën e Beogradit, Fishta, në vitin 1930 i dërgoi J. Rrotës një dorëshkrim prej 103 faqesh mbi shtypshkronjat e vjetra jugosllave të shek. XV dhe XVI. Ai i dërgoi njoftime, për shtypshkronjën e Obodit, për të cilën Rrota ishte shumë i interesuar. Nga polemikat dhe shkrimet e akademikëve serbë, vërtetohej se shtypshkronja më e vjetër ishte ajo e Obodit në Cetinë, e themeluar në vitin 1496 dhe jo e Obodit të Rjekës. Kështu, hipoteza e J. Rrotës binte poshtë. Por Fishta vazhdoi punën për vërtetimin e tezës së tij. Duke krahasuar “Mesharin” me “Triodin”, mund të shikoheshin më qartë shkronjat nistore, stolitë e fytyrat në fillim të krerëve, por kjo arrihej nëse Rrota do të sillte në Beograd, kopjen e fotografuar të “Mesharit”. Atëherë do të ishte i mundur

7 Eqrem Çabej, duke folur për vendin e botimit të “Mesharit” në hyrje të punimit të tij, (në mungesë të frontespicit), shkruan se nuk mund të jepet ndonjë shënim i sigurtë apo përgjigje e prerë në këtë drejtim dhe se dija do të lëvizë në fushën e hipotezave. Ai përcakton dy grupet e dijetarëve: - njëri grup mbronte mendimin se “Meshari” ishte shtypur në ndonjë vend të Shqipërisë së veriut (Obot, Shkodër, Durrës, Tivar), - grupi tjetër mendonte se ishte shtypur në ndonjë qytet të Italisë (Napoli, Venedik). Këtu, Çabej vendos një shënim duke na dhënë emrat e dijetarëve dhe vendet ku ata mendonin se ishte shtypur vepra. “*Më fort për Shkodër mendon N. Jokli, për Obot afër Rjekës J. Rrota, për Durrës F. Fishta te Hylli i Dritës, X, (1934), 568 vv., për Tivar M. Domi, Historia e letërsisë shqipe, Tiranë, I (1959), 187 v. Për nga Italia, e më fort për Napoli, anon J. Tomiç (f.144). Për Venedik mendon M. Roques; po ashtu C. Tagliavini në Studi albanesi, V-Vi...*” (Meshari I Gjon Buzukut (1555) Botim kritik, Tiranë, 1968, f.17).

edhe krahasimi me libra të tjerë të shtypur në shtypshkronjat jugosllave. Kjo ide e Fishtës nuk u realizua.

Në studimine tij “Çashtja e dy shtypshkrojeve te shekullit XVI”, Fishta sjell pohimin e Stojanoviq-it mbi ekzistencën e një shtypshkronje në Shkodër duke u nisur nga pasthënia e librit “Cvietni Triod”, ku shkruhej “Stefan ot Skadra” dhe “u grade Skenderi...u Makedoniji”. Me ardhjen e turqve Shkodra u quajt “Skenderi”, por shënimi në libër nuk vertëtonte se libri ishte shtypur në Shkodër, aq më tepër kur në botimet e vjetra në gjuhën serbe, “Shkodra” shënohet “Skadar”. Dyshimin e Fishtës mbi shtypshkronjën e shek. të XVI në Shkodër, e argumenton Petar Kolendiq, profesor i Universitetit të Shkupit, i cili duke shkruar mbi librin “Cvietni Triod” thekson se ai u botua sipas porosisë së rregulltarit shkodranë Shtjefnit, në vitin 1563 nga Camilo Zanetti në Venedik. Rocques e hedh poshtë mundësinë e botimit të “Mesharit” në shtypshkronjën e Camilo Zanettit. *“Mario Roques është i mendimit se Buzuku i përket kulturës slave e se asht nën influencën e françeskajve boshnjakë-venedikas e jo nën influencën e atyne prej Rrome një për një sikuer argjipeshkvi shqiptar Pjetër Budi.”*⁸

Duke vazhduar hulumtimin e tij në Bibliotekën Nacionale të Parisit, Fishta shfleton Bibliografinë e Stein-it, në të cilën ishin shënuar veprat e shtypura në shtypshkronjat e njohura të botës, në mes të cilave ishte dhe Epidamnus, Durrachium, e shkruar sipas fletës 459 të bibliografisë. Sipas katalogut të famshëm të Èiller-it, në shtypshkronjën e Epidamnosit (të Durrësit) ishte shtypur libri “Apotheosis”(1592), i ekspozuar në ekspozitën e librit të organizuar në Frankfurt. Për këtë libër shkruan dhe P. Deschamp në *Fjalorin e Dheshkrojes*, gjithnjë sipas bibliografisë së Stein-it. Megjithatë, Fishta nuk arriti të gjente kopjen e librit në asnjërën nga bibliotekat ku kërkoi. Ai mendonte se një kërkim i ndërgjeshëm në bibliotekat e Frankfurtit do ta realizonte këtë zbulim shumë të rëndësishëm të egzistencës së një shtypshkronje në Durrës gjatë viteve 1564-1592. Gjithsesi duke u nisur nga Katalogu i Èiller-it, ai është i mendimit se ka shumë mundësi që “Meshari” i Buzukut, të jetë shtypur në Durrës e jo në Shkodër si besojnë disa studiues. *“Në favor të këtij pohimi kemi një folje në mbasthanien e Buzukut prej së cillës lexuesi ka përshtypjen se Meshori i Don Gjon Buzukut u shtyp në Shqipni. Mbas kësaj folje, fakti i existencës së një shtypshkroje në Epidamnus a në Durrës në vjetin 1584,*

8 F.Fishta, Hylli i Dritës, Shkoder, 1934, Nr.12, f.570.

në një qytet qi ka luejtë një rrol aq të randësishëm, mbas Shuflay-it (Serbët e Shqiptarët, Biblioteka e Arhivit për vjetërsi shqipe gjuhë ethnologi, Serje historike.), ky “kufi trish i Grekëvet, i Rromakëvet e i Slavenëvet”, letë shtojmë edhe qandër e elementit shqiptar, na ep në posibilitet të besojmë se përveç këtij libri latinisht, i botuem me gërma latine, u shtyp edhe një libër i çëmueshëm shqip: Buzuku i gjysmës së dytët të shekullit të gjashtëmbëdhjetët.”⁹ Ndoshta në këtë shkrim mbështetet prof. Eqrem Çabej, kur jep hipotezat e disa dijetarëve për botimin e veprës së Buzukut dhe specifikon F. Fishtën për botimin e librit në Durrës. Në fund të studimit “Çashtja e dy shtypshkrojeve të shek. XVI...”, Fishta bën një resume në gjuhën frënge.

RELACIONI I VIZITËS BARITORE TË

MARIN BIZZI-T NËPËR SHQIPËRI E SËRBI TË VJETËR

NË VITIN 1610 - *edicioni i Dr. Franje Raçki-t në Starine XX të Zagrebit, ndryshuar e plotësuar, pas një krahasimi të bërë me origjinalin e dorëshkrimit të Bibliotekës së Vatikanit (Ms. Barberini, lat. 5334).*

Në sektorin e dorëshkrimeve të Vatikanit, F. Fishta lexon relacionin në dorëshkrim të Marin Bizzi-t. I vetmi botim i këtij relacioni të rëndësishëm për historinë e mesjetës në Shqipëri qe bërë nga akademiku kroat Franje Raçki në bl. XX të Starine, botuar në Zagreb më 1886. Relacioni quhej: “Njohtimi i Argjip. të Tivarit Marin Bizzi-t mbi udhëtimin e tij të vjetit 1610 nëpër Shqipni e Serbi të vjetër”, dhe u paraqit në mbledhjen historike-filologjike të vitit 1886. F. Fishta bëri një krahasim të relacionit të botuar nga Raçki në “Starine” dhe dorëshkrimit që gjeti në Bibliotekën e Vatikanit “ms. Barberini, lat. 5334”. Meqenëse, vetë Raçki pohonte në parathënien e botimit kroatisht, se “njohtimi nuk asht gjithkund i sigurtë”, Fishta iu vu punës për korrigjimin e ndonjë fraze, fjalie apo emri që ishte shkruar gabim.

Qëllimi im nuk është të vë në dukje krahasimet apo korrigjimet që bën Fishta duke iu referuar dorëshkrimit që ka në dorë, por t’ju paraqes përmbajtjen e këtij relacioni shumë të rëndësishëm për historinë e kulturën shqiptare, të cilën e dëshmojnë relacionet e shumta të dërguarve apostolike në vendet e Ballkanit.

Në fillim përshkruhet jeta e Marin Bizzi-t, i cili kishte lindur në Rab rreth vitit 1570. Në vitin 1608 u emërua nga Papa Pali V arqipeshkëv i

9 F.Fishta, Hylli i Dritës, Shkodër, 1935, Nr.2, f. 84.

Tivarit. Ai u nis nga Roma për në Venedik, pastaj kaloi në Dubrovnik, Kotorr e Budva ku qëndroi për pak kohë. Budva ishte nën sundimin e Venedikut e Tivari nën sundimin e Turqisë. Arqipeshkëvija e Tivarit ndër të tjera ishte dhe metropolite e ipeshkëvisë së Pultit, së Shkodrës, së Drishtit, së Danjes etj. Në vitin 1610, Bizzi i vizitoi të gjitha këto famulli dhe sipas detyrës që kishte mori njoftime mbi gjendjen e popullsisë katolike dhe zhvillimin e meshtarisë duke dhënë udhëzime për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e jetës në këto famulli. Në vitin 1924, kur rrethanat historike u bënë të vështira ai dha dorëheqjen, duke mos dashur më të vazhdojë detyrën e arqipeshkëvit të Tivarit. Vdiq një vit më vonë në Romë, në vitin 1625.

Marin Bizzi përshkruan me hollësi emrat e fshatrave ku kalon, gjendjen e popullsisë, gjendjen e kishave, marrëdhëniet me prelatët e tjerë të kishës duke dhënë kështu fakte historike. Në faqen 23 të dorëshkrimit, ai shkruan për vendin ku është varrosur Skënderbeu, dhe për këngët e shumta që i dedikohen këtij heroi, të kënduara edhe në prezencën e turqve. Mendohet se edhe Milan Shufly i është referuar dorëshkrimit të Bizzit, kur flet për këngët kushtuar Skënderbeut (“*në të 17tin qindvjet, poene pranë Turqvet, Shqiptarët këndoreshin (da tutti gl’Albanesi) vjersha mbi Skënderbeun*”) në veprën e tij “Srbi i Arbanasi”¹⁰ Me rëndësi është fakti që sjell Bizzi mbi shkallën e ulët kulturore të disa priftërinjve. Ai sjell shembullin e ipeshkëvit të Lezhës, që dinte të lexonte, por nuk dinte të shkruante. Shumë nga meshtarët nuk dinin cermonitë e meshës. “*Këndeje, mbas mendimit t’im, do kërkue edhe një pjesë e shkakut pse Budi, i përmendun në ket relacjon, muer përsypri përkëthimin e njëj rendi veprash shqipe e latine të këtij qëllimi.*”¹¹ Meqënëse Bizzi nuk mund të vizitonte disa vende të largëta malore, Budi i bën thirrje të gjithë klerikëve të këtyre zonave të paraqiten tek arqipeshkëvi i Tivarit.

Fishta sjell të plotë faqen 67 të dorëshkrimit të Bizzit-t të pabotuar nga Raçki në Starine XX, në të cilën janë rreshtuar disa dëshmi nga vizita e tij baritore. Mbi këtë dokument të rëndësishëm të Bizzit-t, kishte shkruar edhe françeskani Pashk Bardhi te “Zani i Shna Ndout” të vitit 1917-1918, duke iu referuar botimit të Raçkit në Starine XX, por F. Fishta bën krahasimin dhe zbardhjen e këtij relacioni duke patur në dorë origjinalin me nr. 5334 të Bibliotekës së Vatikanit.

10 F. Fishta, Hylli i Dritës, “Gjurmimet e një mueji në Rromë”, Shkodër, 1941, Nr.1-2, f.52 .

11 Po aty, f. 54.

Me durim, me profesionalizëm e me një shkallë të lartë përgjegjësie, Fishta hulumton relacione e dorëshkrime të vjetra shqipe që hedhin dritë mbi të kaluarën historike, sociale e kulturore të popullit shqiptar.

NJOFTIME HISTORIKE MBI ARQIPESHKVINJTË E SHKUPIT.

Duke u mbështetur në dokumentet e Propagandës Fide si dhe në studimin e bibliografive të autorëve vëndas e të huaj, F. Fishta na sjell “Njoftime historike mbi Arqipeshkvinjtë e Shkupit”. *“Besoj se nuk asht e pa interesë të bashkatdhetarëve t’onë t’u paraqesim permbledhtas rendin e Barijve’ të Kishës n’at qander të randësishme në historin e Balkanit. Bri kombësive’ tjera në ket ndeje randsiplote shohim dhe bashkatdhetarët e jonë. Veçanërisht gjatë shekullit XVII nder ato ana ban shej dera e permendun e Bogdajvet, nji nder të cillët Pjetri xen nji vend të meritueshëm edhe në historin e letratyrës së popullit t’onë”*.¹² Megjithëse studimi i takon historisë së Kishës kristiane, në të gjejmë material të bollshëm mbi historinë, gjuhën, letërsinë e kulturën kombëtare. Në mënyrë kronologjike paraqiten “Barijtë e Kishës” që kanë drejtuar Arqipeshkvinë e Shkupit. Secili prej tyre dha ndihmesën e vet në kryerjen e detyrës kishëtare, por unë do të ndalem te disa prej tyre, që lanë shenjë në historinë e letërsisë dhe të kombit shqiptar.

Duke folur për familjen e Bogdanëve, Fishta ndalet në figurën e Ndre Bogdanit, veprimtaria e të cilit përmendej edhe nga studimet e Colettit në “Illyricum Sacrum” për aftësitë e tij intelektuale dhe drejtuese. Ai emërohet nga Papa Aleksandri VII Arqipeshkëv i Shkupit, që kishte në mbikqyrje të gjitha arqipeshkëvinjtë e tjera, përfshirë edhe atë të Tivarit si dhe Kishën e Beogradit. Coleti në shkrimet e tij e paraqet Bogdanin si një njeri me shumë energji dhe të zotin të përballonte situatat e vështira të krijuara nga mizoria e pushtuesve turq. Ndërsa Gaetano Petrotta në veprën e tij “Popolo, lingua e letteratura albanese”, e cilëson si “autore di una Grammatica latino-albanese che ando perduta”(autor i një gramatike latino-shqiptare që humbi).¹³ Nipi i tij Pjetër Bogdani, u emërua nga Papa

12 F. Fishta, Hylli i Dritës, “Njoftime historike mbi Arqipeshkvijsht e Shkupit”, Shkodër, 1934, f. 428.

13 G. Petrotta, “Popolo, lingua e letteratura albanese”, Palermo, 1931, f.88, (Petrotta, duke shkruar për Pjetër Bogdanin, jetën dhe veprën e tij, përshkruan vështirësitë e botimit të veprës “Cuneus Prophetarum”. Paraqet letrën që Bogdani i dërgoi Papës, për t’i lejuar botimin e veprës, si dhe kërkesën që Kardinal Gregorio Barbarigo, ipe-shkëv i Padovës, Mik e mbrojtës i Bogdanit, i dërgoi Kardinal Cybos për të njëjtin qëllim.)

Aleksandri VII, ipeshkëv i Shkodrës, për “*vetit e tia të shkëlqyeshme, dien e urtinë nder punë e sidomos zellin apostullik për fe*”.¹⁴ I ndjekur nga turqit detyrohet të lërë Shkodrën dhe të strehohet në fillim në Barbullush e më vonë ndër male, gjithnjë nën mbrojtjen e malësorëve. Pasi Ndre Bogdani e lë detyrën e arqipeshkëvit të Shkupit, Pjetër Bogdani emërohet nga Papa Innocentius XI në vendin e ungjit të tij. Në këtë pjesë të jetës së Pjetër Bogdanit, F. Fishta na jep dy njoftime të rëndësishme:

- I pari, Për ardhjen e tij në postin e arqipeshkëvit ishte kujdesuar Ndre Bogdani, i cili i shtyrë në moshë nuk mund t’i shërbente *ma Kishës n’at dhe*.

- I dyti, Ndihma dhe përkrahja që i dha në krijimin e veprës *Cuneus Prophetarum* jepet në rreshtat që vijojnë “...*Ky zot fort i urtë (d.m.th. Ndre Bogdani) më dha fort zemër me votë paret ndë ket vepër ende tue më ndimuem pakuer fort ndë shum fjalë t’Arbënesha, të sijat i kish udob e per duer, tne pasum bam ende aj një Gramatikë fort të godiçime Latin e Shqyp*”.¹⁵

Po në veprën e tij Pjetër Bogdani na njofton për humbjen e kësaj “Gramatike” të hartuar nga Ndre Bogdani “*Ma, mbassi vdiq, 13 dit ndë Deç. 1683, m’u desh mue ndeper punë t’ushtëris, nden Becit, shum herë me ngrehun e me çkrehun librarin t’eme, tue jau porositun krojebet, gozhduem arkëvet e lidhun thasëvet e vetë tue ikun malevet; aqa sa Gramatika ndë ket të perzieme më treti si krypa nd’ujët*”.

Pas familjes së Bogdanëve, na njeh me veprimtarinë antiturke të Mhill Summës, i cili ishte i njohur dhe i vlerësuar nga malësorët e maleve tona dhe malpezët. Sipas veprës së akademikut I. Tomiq “Mbi Shqiptarët në Serbin e vjetër e në Sanxhak”, Mhill Suma organizoi së bashku me patriarkun Arseni IV, një kryengritje të madhe kundër turqve, në vitin 1737, në luftën Austro-Ruse-Turke, ku u përfshinë edhe malësorët e Kelmendit, të Hotit e të Grudës, kurse malpezët nuk iu përgjigjën kësaj thirrjeje. Për Mhill Sumën nuk ka të dhëna të mjaftueshme, por sipas Coletit në “*Illyricum Sanctum*”, njoftohemi se ka lindur në Sapë, në Shqipëri më 1695. Duke e lidhur mbiemrin e tij me atë të Lukës (Lukë Suma), që e gjejmë në veprën e Pjetër Bogdanit me një vjershë prej dy strofash katërshe, të nënshkruar “*D. Luka Summa prej Skodre*”, mund të hedhim hipotezën se këta të dy, pra

14 F.Fishta, Hylli i Dritës, “Njoftime historike mbi Arqipeshkvijt e Shkupit“, Shkodër, 1934, Nr. 9-10, f.436.

15 Po aty, f. 437.

Mhill Suma e Lukë Suma i përkasin së njëjtës familje.¹⁶ Më pas duke folur për Gjon Kazazin e paraqet jo vetëm si zbuluesin e librit të Buzukut, por edhe “*autor të njëj Doktrine, botue në Romë në vj. 1743, qi mbetet ende sot ndoshta ma i vjetri dokument shqip, botue në djalektin e vend-lindjes së tij Gjakovës*”¹⁷. Nga Mati Masreku trashëgojmë *nji leksikon italisht shqip*, që i takon vitit 1635, të zbuluar nga Mario Roques në Romë dhe të botuar në Paris në vitin 1932.¹⁸

BIBLIOTEKA E MYFTIS SË TABAKËVE NË SHKODËR.

Bibliotekat janë ndër institucionet më të vjetra social-kulturore të njerëzimit. Koleksionet e librave në këto biblioteka përbëjnë një prej pasurive më të rëndësishme kulturore të popullit shqiptar në të gjitha kohërat. Në Shqipëri, në vitin 1938, numëroheshin njëzet e gjashtë biblioteka të rëndësishme, pa numëruar bibliotekat private të familjeve që ishin të shumta, sidomos në qytetin e Shkodrës. Njëra nga këta biblioteka ishte dhe ajo e Myftis së Tabakëve në Shkodër, të cilën e përshkruan F. Fishta në të përkohëshmen “Shkëndija”.¹⁹

Ai na njofton për vjetërsinë e kësaj biblioteke, që gjendej në afërsi të *atij monumenti historik të Shqipnis s'onë, quejtë Xhamija e Plumbit*. Krijuesi i bibliotekës ishte Myftia i Tabakëve, i njohur për zgjuarsinë e tij dhe nderimin që gëzonte jo vetëm nga qytetarët shkodranë, por edhe nga Porta e Lartë e Stambollit. Duke i tërhequr vëmendjen një fakt i dhimbshëm

16 Dh. Shuteriqi, Shkrimet Shqipe në vitet 1332-1850, Tiranë, 1976, f.84, (Dh. Shuteriqi duke përshkruar veprat dhe shkrimet e shek.XVII, në vitin 1685, në veprën Cuneus Prophetarum, shënon të dhënat e vjershës që Lukë Suma ia dedikon Pjetër Bogdanit:”Lukë Suma, Shumë ndriçimit e shumë ndershmit zotit, zotit, tim zot për ndeer, zoti Pietër Bogdan. Vjershë. 2 str. Katërshe, me vargje të alternuar, shtypur në fl 17a të Cuneus të P. Bogdanit. Datohet e firmoset nga “Viena 30, dit ndë Gusht, 1685. Këndoj D. Luka Summa prej Skodre”. Duhet vështuar si i pari tekst i njohur në të folmen shkodrane. Mbi autorin nuk dimë gjë. Ribotuar nga: Jubany 62.)

17 Po aty, f. 428, (Gjon Kazazi është i trajtuar më gjërësisht në kapitullin e “Historisë së letërsisë shqipe” nga F. Fishta.)

18 Ky njoftim i jepet S. Congreg. de Propaganda Fide nga Pjetër Mazreku, arqipeshkëv i Tivarit. (Nga Arhivat e Propagandës. Scritture riferite nelle congregazioni generali, vol. 263, Servia, Albania, Dalmatia, Illiricum ab anno 1630 ad 1639).


19 *Artikullin në fjalë, me ndryshime fare të pakëta, i a pata dërgue numrit të mbramë të Përprjekjes Shqiptare, numër që për një arsye a tjetër nuk qarkulloi. Të panjohtun për lexuesin t'onë apo të huej, kët shkrim po e botoj, i sigurtë se duhet të zgjojë ndonji interesim ndër njohsit e së kaluemes s'onë.* (F.Fishta, Shkëndija, Tiranë, 1941, Nr.1, f.15)

mbi këtë bibliotekë, ku një pjesë e librave po bliheshin nga turistët, Fishta vendos të shkruaj një artikull sensibilizues për gjithë opinionin shqiptar. Ai e viziton vetë këtë bibliotekë dhe vëren se aty gjendeshin rreth tre mijë libra dhe dorëshkrime të mbajtura në gjendje të mirë dhe të shkruara (dorëshkrimet) me një kaligrafi që mund të krahasohej me atë të bibliotekave të Evropës Përfundimtare. Dorëshkrimet ishin të shkruara me alfabetin e vjetër turqisht dhe kishin vlera të mëdha për historinë e zhvillimit të lëvizjes kulturore myslimane. Fishta ia bën të njohur këtë thesar edhe prof. Ettore Rossit, njohës i gjuhëve dhe çështjeve të Orientit, përfaqësues i Institutit për Evropën Lindore, në mënyrë që të *vente në dijëni botën intelektuale mbi te*. Me përshkrimin e Bibliotekës së Tabakëve, Fishta kishte qëllim:

* Të bëhej shtysë për kontrollin apo pengesën e daljes së librave, dorëshkrimeve apo dokumentave të rëndësishëm jashtë kufijve të Shqipërisë.

* Të nxiste njohësit e gjuhëve lindore, vëndas apo të huaj, të interesoheshin për këtë Bibliotekë duke dhënë njoftime të sakta. Fishta e fton edhe z. Mehdi Frashëri, që ta vizitojë e pastaj të shkruaj diçka rreth saj.

* Të gjurmohen me kujdes dorëshkrimet e kësaj Biblioteke, pasi do t'i bëhej një shërbim i çmuar lëvizjes kulturore myslimane, ende e panjohur. Botimi i veprave me alfabetin latin do të ishte një ndihmesë e madhe në këtë drejtim, por edhe botimi i dy fjalorëve Shqip-Turqisht e Turqisht-Shqip me 23500 fjalë i Hafëz Ali Ylqinit i litografuar në Stamboll më



Skedë e plotësuar nga dora e Filip Fishtës. Arkivi i Bibliotekës "Marlin Barleti"

1880, do të ishte me shumë interes.

F. Fishta na njofton se gjatë qëndrimit të prof. Ettore Rossit në Shqipëri, ky i fundit kishte lexuar nga disa dorëshkrime shqipe me alfabetin e vjetër turk (fond i z. Jashar Erebara), disa vjersha në gjuhën shqipe, “*hartue mbas metrike klasike të letratyrove të lavrueme e ndër to edhe Arabe, përpjekje të bame edhe nga letrarët t’onë prej Hilë Mosit, (botues i ma së parës vjershë heksametrike në gjuhën shqipe “Natyra” ke Albania e vjetit 1906 fq. 188-191), e prej G.Jakova-Mërturi, t’a ushtrojnë vargun Shqip dhe në vargjet klasike*”.²⁰

Shkrimi i F. Fishtës ishte nxitje dhe detyrë e të gjithë qytetarëve, për ruajtjen dhe vlerësimin e dorëshkrimeve, librave apo dokumentave të vjetër që gjendeshin në bibliotekat private, pasi brënda tyre gjendej e kaluara me kulturën historike, gjuhësore e letrare të popullit tonë.

Duhet theksuar se pasioni për librat dhe bibliotekat, e shoqëron deri në fund. Ai posedoi një bibliotekë të pasur, me shumë libra me vlerë, një pjesë e të cilëve iu shitën pas vdekjes së tij, Bibliotekës Kombëtare dhe një pjesë tjetër Bibliotekës së Institutit të lartë Pedagogjik në Shkodër. Mund të përmendim dispensën “Historia e Letërsisë Shqiptare” e hartuar nga vetë F. Fishta, “Vargjet e lira” të Migjenit, botim i vitit 1936, që u çensurua nga shteti (kopja e vetme gjendet në Bibliotekën e Universitetit “Luigj Gurakuqi”), “Përpjekja shqiptare” e vitit 1939 edhe kjo e çensuar etj.

20 Shkëndija, “Bibliotheka e Myftis së Tabakëvet në Shkodër“, Shkodër, 1941, f.17

Arjola ZADRIMA**POEZI****Në shtëpinë time**

Në shtëpinë time
 muret mbajnë aromën e kujt nuk asht ma.
 Xhamat veshin avuj e ndër to çamarrokët
 vizatojnë zemra.
 Brenda zemrave shkruhet Babi.
 Malli i fëmijëve më plak çdo ditë nga pak.
 Heshtja kacavjerret në sytë e mbërthyem në korniza.
 Ah, sa e bukur lumturia aty brendë.
 Po përpiqem me shkruar një poezi
 me flokët e butë të fëmijëve,
 zjermin bubulak në oxhak,
 duert e mia me aromë grueje,
 por gjithçka ndalet në kujtimin e tij.
 Atë çast kjo grueja e çeliktë dramcohet
 dhe e ndjen se kështjella të reja nuk ngrihen mbi lot.
 Në shtëpinë time fle një engjëll,
 t'falemnderës ZOT...

Zgjedhohem NANË

Tue dashtë,
 tue bamun,
 tue dhanë,
 tue ndig'ju ,
 tue u perballë...
 Tue gzu',
 tue kërcy,
 tue kja,
 tue rrokë,
 tue ledhë,
 tue puthë,
 tue ndje,
 tue kuru,

mbështët,
tue u thy , tue dekë
prapë t'nesërmen tue u njall,
tue lexu ,
tue mësu,
tue pastru, tue gatu,
tue vrapu, tue bërtitë,
tue u pendu e tue pëshpëritë,
tue kendu,
tue vuejtë,
tue fal, heshtun tue u brenjtë,
tue mbrojtë,
tue sjell në jetë,
tue uleritë pse kam të drejtë...
Zgjedhohem NANË

Pa fjalë

Erdha në jetë pa fjalë.
Brishtë, në lot.
Fola pa mend, tue ndërrue hapat,
kje drejtë, fushë,
e lehtë.
Kur m'erdhën mendt msova me heshtë.
Fjalë të tepërta,
n'mend një e thuej një tjetër, ma e mirë heshtja.
E kur stuhi të forta ma msyen jetën,
prisha togjet e fjalëve,
tue ba kompromis me heshtjen,
këtë mike të vjetër.
Do të shkoj pa fjalë.

Nanë e tim biri

Jam grueja e atij që s'me njeh e s'din
se andrrat e mia
ngjallin shpirtën t'vdekun.
Jam nana e parë dhe e fundit e tim biri.
Parmaku i time bije.
Isha dashnorja e burrave që s'ekzistojnë,

e s' dinë si kapërcehen male me një frymë.
 Atyne që më deshtën u fala
 veç një poezi.
 Boheme fatesh lidhun.
 Zgidhun mendsh, ogur i fatit tem.
 Isha, jam dhe do të jem
 ajo që mbys vehten,
 veç mos me kenë arlekini i dramave
 pa autore.
 Jam grueja e pamarre,
 që dashnisë ia ka mbjell' farën bash në bark të vet.
 Vdes e ngjallem
 nanë e Tim biri.

Unë jam

Jam e mirë se ti më sheh të mirë.
 Jam e bukur se ti me sheh me sy të magjepsun.
 Jam e dashtun se ti më ban,
 jam e veçantë sepse ti e mendon.
 Unë të jam sepse ti don.
 Por në të errun të jetës unë jam
 dikush që më duhet me jetu në këtë njeri që kam.
 Vetveten.

Melankonia

Melankonia s'ka emën,
 ajo ka trup të mpimë,
 ka të dizenjueme hartën e dhimbës.
 Asht paralajmërim,
 heshtje,
 virrmë,
 zgavra e grryeme e gjoksit,
 psherëtima e kobshme për ndihmë.
 Melankonia ka tingull,
 akustike të përsosun .
 Andrren e një nate të ftohtë ta veshë për shpindë,
 e të ther.
 Ajo veç vjen ,

si veri, të rrok , të ulet afër,
të ndin, të shurdhon,
ti hap plagët, e të gjurmon deri në shpirt.
E ti s'ban asgja, veç perëndon edhe një herë,
jashtë vedit.

Ditët

Ditët e mia boshe,
ditët e mia të vrazhda,
ditët e mia të gjata,
ditët e mia të pafundme,
ditët e mia të pakendueme,
ditët e mia me një akustikë që jehon;
ku je?
Shtrëngatat e mia natë,
shtrëngatat e mia të turbullueme,
shtrëngatat e mia të mjegullueme,
të thepisuna ; të kanë degdisë në veri të qënies teme.
Qënia jeme e vetme
qenia jeme e palëkundun,
zemërshkamb,
andërrkputun; të mendon
në çastin kur gjinjtë kërcejnë prej inatit,
kur vetmia plas shpirtin,
kur cepi i buzës plasun mjekohet me një kujtim.
Kujtim që ikë,
që zbret prej qiellit e shkrepin në sy
në një çast që nuk asht,
që më don ,
që çirret e më dron,
kujtimi jem i vetëm ti
që të kam lanë.

T'zotit t'shpisë

Kur i Zoti i shpisë nuk asht më
marimangat mblidhen qoshesh ,
nuk ke kohë me pa rrjetat e uluna deri poshtë.

Dyert kërcasin,
bravat hingëllinjë,
dritaret rrinë të avituna.
Nji në fund nuk mbyllet.
Qeni lehë natën vonë e ti shkërmoqesh
prej dhimbës.
Gjithçka mbi kry,
nji qiell të vranët mbi supe,
nji kalë mërzi mbi shpindë.
Pa dalë drita shihesh në pasqyrë,
dikush duhet me të pa tue qeshë.
Sa veshë maskën e butë,
ndin mbas krahëve
“Mam si ke njeh?”
Kur i Zoti i shpisë ikë
zemrat rrinë ndezë.

Ti veç lexo atë që nuk tham,
kur t’i kem dhanë za,
damarët janë ça
tue rrjedh mungesa jote.
Nuk i kam dy jetë
ku mundet me hy krejt dielli i kësaj bote,

ndër plasaritjet e kohës
rrezatojnë dramca dashniet t’përjetshme!

Dikujt

edhe unë i kam dashtë burrat e bukur,
me flokë valë,
shpatullgjanë,
buzëpërdredhun e nazeli.
Por mbas tyne ishte gjithmonë vjeshta,
mbas tyne kishte rrebesh,
stuhi,
mbas tyne vinte dreqi e i biri.
Mbas tyne porta nuk mbyllej ma,
brava heshte,

çele si nuk tringëllinte nëpër natë.
 E ti vdes ka pak,
 si qiri shkrihesh territ pafund ku dënohesh,
 e s'pyt pse trishtimi ka një mbretni aq të popullueme.
 Ata s'janë,
 s'dinë,
 s'bajnë.
 Ata veç të pushtojnë,
 prej atyne pushtimeve shekullore,
 sa të ndryshojnë e ti ma nuk ngjan as me Marinë
 e as me vedin.
 Ikin mbas çdo fundi të shkurtë
 e të vjedhin kohën.
 I kam admirue burrat e bukur,
 por ti erdhe vonë , bash at'herë kur msova
 me u dashtë...

N'heshtje

Në heshtje ke hy në trupin e paktë që mbaj,
 derdh mungesen me doza të vogla,
 tue mbushë krahët me asgjanë ,
 dhe shpindës m'ke varë hijen e dashnisë.
 M'shfaqesh teh i hollë
 i një dite që më ther deri në amë të qënies,
 tue ra mbi nudon e Magdalenës.
 Mbytem në brigjet e syve tuej,
 zhytem n'at' shikim të thellë
 me u gjetë,
 a me vdekë sa kur të ngjallem ta ndjej
 si thërrmohesh brenda meje,
 pre tue ra...
 O zgjim, kputje,
 andërr diku të kam pa.

Ndjej hijen tande
 tuj gurgullu brenda meje, e kam frikë,
 i rrebelohem natës, pa e ditë
 sa e flaktë mundet me kenë.

Andreas DUSHI

**SHTATË POEZI TË PUSHKINIT
TË PËRKTHYERA NË SHQIP**

Gjithnji kam mendue se shqipnimi i poezisë asht çështje dialektesh. Kështu mendosha se përkthimi i poezisë ruse i takon tosknishtes ndërsa përkthimi i asaj gjermane i takon gegnishtes. Sa për atë helene e italiane, tuj lexue “Komedinë Hyjnore” të përkthyme prej Pashko Gjeçit apo “Iliadën” të përkthyme prej Gjon Shllakut, nisa me besue se edhe përkthimi tyne i takon gegnishtes, ndonëse një gegnishteje “moderne”, jo asaj të dikurshmes që do t’i shkote për shtat gjermanishtes.

Për shembull, në revistën “Malësia”, numër 11, viti 2016, asht një artikull interesant që ka për autore Luljeta Dushin. Para studimit, ajo vendos disa variante të përkthimit të poezisë “Mbreti i Tulës”, marrë nga “Fausti” i Gëtes. Mes tyne asht edhe ai i Dom Ndre Mjedës i cili ngjan si një filiz i sapočilun mes disa luleve të thame.

Por e gjithë idea e ndasive dialektologjike në shqipnim ra kur lexova “ABC e përkthimit letrar” të Ardian Klosit. Aty, për herë të parë lexova evoulimin e përkthimit qysh nga dy ndamjet e mëdha të Ciceronit, duke vazhdue me idenë, tashma të pavërtetë se përkthimi i një poezie ose proze të shkruar në dialekt duhet të ishte po në dialekt e duke ardhur deri në ditët tona. Për çdo konkluzion të dhanë, ai jepte shembuj prej Kafkës të cilin e kishte përkthye po ai.

Sipas tij, randësi kishte për me ruejt të njajtin kompozicion fjaliet e poeziet tuj i qëndrue besnik (aq sa të ishte e mujtun) rimës dhe ritmit.

Në vazhdim janë shtatë poezi të poetit, shkrimtarit dhe dramaturgut rus Aleksandër Pushkini. Për herë të parë jam njoft me Pushkinin nëpërmjet “Eugjen Onjeginit” e më pas, tuj lexue “Vajza e Kapitenit”, “I burgosuri i Kaukazit” e të tjerë, më lindi dëshira me eksplorue në të panjoftunen e tij.

Kështu mujta me gjetë një libër me lirikat e tij në anglisht ku mes tyne, në zemër e në mendje më mbetën këto që vendosa edhe me i shqipnue e me jua paraqitë ju.

Secila prej poezive të maposhtme flet për një nevojë që me mujt me e jetue dashtuninë. Në poezinë “Ajo” flitet për një dashni të pamujtun e cila në pamje të parë nuk ka asnjë pengesë. Asht pikërisht kjo që e ban me vujtë autorin, mbasi ai as vetë nuk arrin me shpjegue arsyen e asaj mosmundësiet

për të jetue atë dashtuni. Në fund, i rraskapitun, si të vetmen arsye gjen fjalët e asaj: *Për te, ne s'mund t'jetojmë t'gzum'.*

Në poezinë “Du ty”, qysh në titull tregohet një dëshirë për ta pasë ate, vajzën e tij. E në fund, kur kupton se ajo s'mund të jetë e tija, vazhdon me e rujt të nji trajtshme dashtuninë për te, aq sa i uron *që me u dasht kshtu përsëri!*.

Fola për vetëm dy prej poezive të shqipnueme, ndërsa të tjerat, e la në doren tuej me i ndje pa u kufizu në kornizen që komenti jem mund të krijojë.

Përkthyesi

Ajo

“M'thuj ç'a ke? Je myt n'mërzi.”

- Kam ra n'dashni! “Cila vajz' t'ka ba për vedi?”

- Ajo m'ka ba. “Griselda, Sheila, Lili n'dor' t' meti?”

- O, jo! “Cila vajz' t'asht ba për shpirtin shpi?”

- Ajo! “Je i përvujtun. Pse më kaq pendim?”

Pse dukesh kaq zyrt'isht i trishtum?

E kush duhet faj'su? I shoqi, i ati kam mendim

- Asnjeni. – “Po çka?”

- Për te, ne s'mund t'jetojmë t'gzum'.

Du ty

Du ty, ndoshta dashnia që kam ala

Do t'des' mrenda shpirtit tem

Por s'du ti t'tmerroresh ma

Du te pikllimi tjera gja t'xajn vend.

Du ty n'heshtje, i pashpresë

Me shum' turp ose xheloz

Du ty me but'si t'sinqert'

E i lutem Tenzot që ti me u dasht kshtu përsëri.

Jam lidhun n'zingjirë

Jam lidhun n'zingjirë, O Virgjesh' e butë

E ala jam, për paturpsinë e ktyne rojeve;

Nji bylbyl, kshtu ndër gjeth larit fut

Krajli i tan zogjve që k'ndojn ktyne trojeve,

Nji tis drandafillash plot krenari

N'nji robni jetojnë për jetë

Te tan bashkë k'ndojn një kangë që ti me ndi
Nën mlojen që nata i ka thurun vetë.

Muza

N'rini teme, ajo m'dote; jam i sigurtë
Mbi fyll' ajo i zgiat'te durt
Dhe lute për mu buzqeshje t'ngurt'
Tek harkote gishtat m'i fyll' but' but'.
Filloi t'luej me gishtat e pazot'
Kangen e thjesht' t'kang'tarve t'katundit bar'kosit,
E hymnin e randësishëm që Perenditë njer'zit kishin porositi.
Prej n'nadje der' n'mramje n'hijen e qetë t'dushkut
Me zell ndigjoshja virgjneshen misterioze
Shikjoshja ftyren e saj t'mahnitshme e serioze
Ajo shpesh për mu e lete flautin si barren mushkut.
Fylli u ba i gjallë prej frymës t'shejtë
Dhe zemrën ma mbushi me shejt'ni pandërpre.

Nata

Zani jem, n't'cilin dashnia jep një but'si e dishir t'zajrrt,
Shqetëson andrrimin e qetë t'natës... i zbeht n'ballin e shtratit tem,
Një kandil i lanun tej... prej jasht' zemres teme, çohet nalt
E butësisht lëvron një rrymë dashtuniet që kërkon t'zajn vend.
Dhe plot me ty nxiton, me pasion që derdhet.
E unë që du t'shof sytë tuj n'naten që zverdhet,
Takoj t'mitë... shof buzëqeshjen tande... M'flet vetëm mu
Shok, shok i dashtun jam e jotja, bashkë du me gzu.

Plaku

Une s'jam ai dashnori, i mushun me pasion
Ai i riu që e len boten me habi.
Mjerisht pranvera dhe vera jeme maroi,
Dhe asnjë gjurmë nuk la përbmi.
Kupid, Perendi e t'rijve, dashtunisë' e vyrtytit
Kam me ken shërbëtori jot i palëkundun
Po t'mujsha me rilind, s'kisha me prâ t'shërbymit
Edhe me ma shumë pasion zemren mbushun.

T'kam dasht një herë

T'kam dasht një herë, zemra s'ka mujt me ken e qetë
Për ket duket se dashnia do t'rrij' ktu përjetë
Por ti mos ji e shqetësime prej kësaj
Ti e dashtun prej ktyne idhnim mos mbaj.
Unë t' du ty pa shpresë, me një t'ardhme shurdhe
Çfarë disprimit i turpshëm, ndërgjegje xheloze e cungume,
Një dashni kaq e thellë, kaq e butë kaq e vërtetë,
Tenzot ma ofroj që te ti me mbetë.

+ Tekstet e masipërme janë përzgjedhë prej "Pushkin Poems". Maestro Publishing Group 2015.

Helidon SOKOLI

**GJURMIME ARKEOLOGJIKE
NE RAJONIN E SHKODRËS**

(Vijon nga numri i kaluar)

Edhe në rajonin e Shkodrës siç vërehet edhe në pjesët e tjera të Shqipërisë ka një sërë vendbanimesh prehistorike që përfshihen në kategorinë e qendrave protourbane. Kjo periudhë që shkon nga shek. VIII-V pr.K është periudha tranzitore midis vendbanimeve të cilët zhvillohen në këtë epokë dhe ngelin në formën e fortifikimeve apo kullave të kontrollit, si rasti i fortifikimit të Rrencit (foto 1), dhe atyre që marrin formën e qyteteve të mirëfillta më vonë¹. Kjo periudhë përfaqësohet në rajonin e Shkodrës me vendbanime protoqytetare si Vorfa, Zagora, Kratuli. Në fortifikimin e Vorfës vërehet qartë mënyra e ndërtimit me gurë të mëdhenj, në të thatë pa element lidhës, dhe në mënyrë primitive. Muret rrethojnë pjesën më të pambrojtur të kodrës. Trashësia e murit të ruajtur më mirë, ai në anën lindore arrin në 3, 50 m dhe në brendësi të tij është mbushur me gurë më të vegjël (Foto 2).

Një vendbanim tjetër tarracor që ngjason me atë të Grunasit është ai i "Gjytetit" në fshatin Kir, Pult. Vendbanimi përbëhet nga një bllok parcelash të vogla, të varura në një terren shumë të thyer, ku ndërtuesi ka ngritur një kështjellë natyrore mbi luginë. Në qendër të saj ka konstruksione muresh ilire të cilët ruhen deri në lartësinë 1 m. Ky vendbanim qarkohet prej një muri mbrojtës të ndërtuar në periudhë më të vonë, ndoshta mesjetare e që ndjek konturet relievit më të thyer (Foto 3).

Drisht. Kur flasim për këtë qytet të njohur në mesjetë na vjen ndërmend Kalaja që ngrihet në pjesën më të lartë të kodrës. Vetëm Shufly në 1924, përmend për here të pare një "civitas vetus" përballë me kodrën e qytetit të Drishtit². Ky "civitas vetus" që përmendet që në mesjetë lidhet me egzistencën e një kalaje që banorët e zones e quajnë si Kalaja e Muzhillës. Perimetri i mureve rrethuese të saj ndiqet sot me vështirësi pasi janë në gjëndje thuajse totalisht të rrënuara. Brënda perimetrit të saj ruhen ende rrënojat e një kishe mesjetare. Materiali arkeologjik që ka dal nga vrojtimitet e sondazhet e kryera here pas here aty kanë të bëjnë me fragmente

1 S.Islami. Qyteti në Iliri dhe Epir. ILIRIA 2, 1984

2 M.Shufly. Stadte und Burgen Albaniens, Wien, 1924 fq, 26



Foto 1. Fortifikimi i Rrencit



Foto 2. Fortifikimi i Vorfës

anforash dhe gjetje kryesisht te shek. I-II mbas.K duke përforcuar kështu tezën që kemi të bëjmë me një fortifikim në origjinë të tij që në periudhën ilire.

Fortifikimet e periudhës së hershme romake janë të pakta në rajonin e Shkodrës. Ato shfaqen për herë të parë nga shek.I pr.K të lidhura kryesisht me ngjarje të zhvilluara në Ilirinë e kthyer në fushë beteje



Foto 3. Fortifikim tarracor në Kir, Pult

mes trupave të Çezarit dhe Pompeut. Ndërtimet me karakter ushtarak kufizoheshin kryesisht tek riparimi i fortifikimeve egzistuese. Ndërtimet mbrojtëse u intensifikuan në periudhën e dyndjeve barbare duke filluar nga shek. III dhe vazhdojnë deri në shek. VI, kryesisht në periudhën e sundimit të Justinianit I (527-565). Kësaj periudhe i përket dhe Castrumi i Vigut. Ky tip Kështjelle për garnizone fillon shumë më herët, duke nisur që nga periudha e Dioklecianit. Këto kështjella ndërtoheshin në zona kryesisht fushore, pranë luginave të lumenjve. I pari që e identifikoi këtë stacion ishte dijetari austriak J.G. Hahn³. Planimetria e saj paraqet një katërkëndësh të çrregullt me brinjë 75 x 98m (Fig. 4) gjatësi dhe është e pajisur me 2 porta monumentale që janë të vendosura përballë njëra-tjetrës me drejtim lindje-perëndim dhe me plot 12-kulla madhështore, ku 4 kullat (2 x 2) të cilat mbrojnë portat hyrëse janë me forme U-je dhe të pajisura me oborr të brendshëm (Foto 5).

Kjo kështjellë është ndërtuar përgjatë rrugës së rëndësishme tregtare-ushtarake Lis-Naisus dhe në kryqëzimin e saj me rrugën Shkodër-Orosh.

Duke filluar nga fundi i shek. IV për shkak dhe të sulmeve gote filluan



Fig.4 Planimetria e Kështjellës së Vigut. Gj. Karaiskaj

3 J. G. Hahn. Albanesische Studien. Vol. I. Wien 1853. fq 80-113




Foto 5. Castrumi i Vigut

të marrin përparësi fortifikimet malore. Muret e këtyre fortifikimeve jo domosdoshmërisht ndiqnin linja të drejta, por më shumë i përshtateshin formës së terrenit. Në periudhën e vonë antike dallojmë kryesisht teknikën e ndërtimit të mureve me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Këto fortifikime ndërtoheshin kryesisht në gryka lumenjësh, lugina, liqene dhe si qëllim parësor kishin kontrollin e kalimit në brendësi. Të tillë mund të quajmë dhe Kalanë e Hotit. Në jug-perëndim të fshatit Hot, në lagjen Ivanaj, afër me gjirin e Liqenit të Shkodrës njohur ndryshe si Liqeni i Hotit ngrihet një kodër shkëmbore rreth 180 m e lartë që mbizotëron të gjithë Liqenin e Shkodrës dhe sistemin kodrinor përreth tij. Në një tarracë natyrore të kësaj kodre gjenden rrënojat e një fortifikimi që banorët e fshatit e njohin me emrin “Kalaja e Qytezës”. Ky fortifikim përmendet për herë të parë nga Franc Nopça në 1912 dhe më vonë nga Praschniker dhe Schobër⁴ që e vizituan këtë monument. Këta autor bënë një përshkrim cfarë arrinin të dallonin, të mureve rrethuese si dhe të tre kullave mbrojtëse që ruheshin ende. Në bazë të asaj cfarë ata kane vëzhguar, të tre autorët shprehin mendimin se ky fortifikim i përket periudhës antike. Ky objekt zë një sipërfaqe afërsisht 1 ha, duke rrethuar pothuaj të gjithë kreshten e kodrës. Muret rrethuese arrijn deri në 1, 70 m të gjëra dhe në anën veriore të Kalasë ruhen më mirë duke arritur lartësinë deri në 3 m. Në anën veriore dallohen ende rrënojat e tri kullave, dy në formë katërkëndore dhe tjetra në formë ovale. Ndërsa në anën perëndimore ruhen ende gjurmët e dy kullave

4 C.Praschniker , A.Schober.Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro. Wien.1919

të tjera. Gjerësia e mureve tek kullat shkon nga 2, 10-2, 50 m. Hyrja në këtë fortifikim është në anën jugore me gjerësi 1, 80 m. Një mur, rreth 30 m nga fortifikimi nga ana lindore ruhet ende edhe sot. Ai ka një gjerësi që shkon deri në 2, 50 m, gjatësi 25 m dhe lartësi që ruhet deri në 2.50 m. Ky mur mund të ketë qenë pjesë e një sistemi mbrojtës ose paramur meqë në këtë pjesë të kodrës terreni është më i butë dhe lehtësisht i depërtueshëm. Nga teknika e ndërtimit ky fortifikim ngjason shumë me Kalanë e Sebastës në Laç edhe ky një fortifikim i antikitetit të vonë.



Planimetria e Kalase së Hotit. Gëzim Hoxha, Luan Berzhita. Candavia. Kalaja e Hotit. 2004⁵.



Foto 6 . Hyrja ne anën jugore të Kalasë së Hotit

Njazi KAZAZI

95-VJETORI I GJIMNAZIT TË SHTETIT

1. Hyrje

Monografia **“Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër (Nga fillimet deri në vitet ‘20 të shekullit XX)’** Shtëpia botuese “Rozafa”, Shkodër, 2014, që po paraqesim, synon të ndriçojë sado pak historinë e traditën e arsimit të mesëm në trevën e Shkodrës e kësisoj të japë një ndihmesë modeste në punën e këtyre shkollave, për rëndësinë e tyre në arsimin e kulturimin e masave të popullit, për përgatitjen e intelektualëve që punuan dhe kontribuan në fushat e ndryshme të jetës, që nga drejtimi i shtetit e deri si mësues në shkolla të ndryshme të vendit.

Gjatë këtyre 20 viteve janë botuar shumë vepra madhore dhe monografi, të cilat në mënyrë të përmbledhur do t'i përfshijmë në këtë botim, si:

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më pas ASHSH): Fjalori Enciklopedik Shqiptar (më pas FESH). Botim i ri. Grup autorësh. Vëll. 1-2. Tiranë, 2008. Vëll. 3. Tiranë, 2009.

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (më pas MASH), Instituti Studimeve Pedagogjike (më pas ISP): “Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar”. Grup autorësh. Tiranë, 2003.

- Shefik Osmani: “Reflekse etnopedagogjike”. Vëllimi 1. Tiranë, 1998.

- Shefik Osmani: “Shpalime etnopedagogjike- Panoramë retrospektive e mendimit pedagogjik shqiptar”. Vëllimi 2. Tiranë, 2008.

- Shefik Osmani - Njazi Kazazi: “Abetaret Shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike”. Botim i MASH dhe i Shtëpisë botuese “Idromeno”, Tiranë, 2000.

- Tomor Osmani: “Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918)”. Shtëpia botuese “Camaj-Pipa”. Shkodër, 2004 (Rib. 2009, 2012).

- Tomor Osmani: “Udha e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit”. Botim i ASHSH. “Ilar”, Tiranë, 2008.

- Vehbi Hoti: “Luigj Gurakuqi, për shkollën shqipe dhe arsimin kombëtar”. Monografi. “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2002.

- Vehbi Hoti: “Ethem Osmani “Mësues i Popullit” (Monografi), “Camaj- Pipa”, Shkodër, 2012.

- Mentor Quku: “Historia 100-vjeçare e shkollës së Barbullushit (1901-2001)”, Shtëpia botuese “Lilo”, Shkodër, 2001.
- Iljaz Gogaj: “Shkolla teknike dhe Harry Trevlye Fultz”. (Botim i rivështruar). Tiranë, 2010.
- Ilir Kanini: “Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore”. (Zona e pushtimit Austro-hungarez, 1916-1918). Tiranë, 2001.
- Ludovik Shllaku: “Shkollat klerikale”. (Vështrim historik nga fillimet deri në vitin 1924). Monografi. “Camaj-Pipa”. Shkodër, 2002.
- Pipa, Fehime: “*Një shekull shkollë shqipe*”, (1861-1961). “Shëjzat”, Romë, 1961, nr.7-8; 1962, nr.1-2; 1962, nr.3-4; 1962, nr.5-6; 1962, nr.7-8; 1962, nr.9-10; 1962, nr.11-12; 1963, nr.3-4.
- Smajl Bala: “Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës (1662-1945)” në dy vëllime: Vëll. I, Vëll. II. Shkodër, 2011
- Fiqiret Hoxhës “Fletët e Jetës, Histori pedagogjike ndër vite”, (Historiku i shkollave Rus, sot “Skenderbeg”), Botimet “Camaj- Pipa”, Shkodër, 2010.
- Abdullah Poti- “Shkollat e mësuesit në Anën e Malit”, Shtëpia botuese “Camaj- Pipa”, Shkodër, 2010.
- Kujtim Shimajt- “Historiku arsmi në Zonën e Bushatit”, Shtëpia botuese “Pakti”, 2011.

Ajo që na shtyu për t’i hyrë kësaj pune ka qenë qëndrimi zyrtar i partisë-shtet gjatë 47 vjetëve të regjimit komunist. Ky qëndrim është paraqitur zakonisht: në lënien në heshtje të këtyre shkollave, në denigrimin e tyre, pa parë asgjë pozitive tek ato.

Nga propaganda zyrtare “*Shkolla e vjetër feudo-borgjeze e paraçlirimit u godit rëndë si në përmbajtje, ashtu edhe në metodë*”, mbasi Partia e udhëhequr nga Enver Hoxha, përcaktimin e rrugës së zhvillimit revolucionar të arsimit në Shqipëri e realizoi “...në luftën që i bëhej shkollës së vjetër”. Në kushtet e një totalitarizmi të tillë dhe të një politizimi të tejskajshëm “...autorit i lejohet liria e mendimit në trajtimin e historisë, por brenda caqeve ku ajo nuk binte në kundërshtim me disa postulate të ngurtësuara marksiste-leniniste.”¹

Studiues - titullarë të këtyre fushave kanë theksuar se këto shkolla kishin “*frymë fetare e klerikale, reaktionare dhe antikombëtare, në shërbim të padronëve të huaj...*” dhe se ajo ishte “...shkollë me karakter antidemokratik e mbi të gjitha me një frymë të tërbuar agresive antikomuniste” dhe më poshtë si për merak rithekson “*një këshjtjellë*

1 S. Pollo, Skematizmi-dhunë në historinë e popullit, “Drita” 12.5.1991, fq. 5.

(Kolegja Saverjane dhe Gjinnazi “Illyricum” - shënimi im - Nj.K.) e vërtetë e reaksionit kulturor dhe ideologjik në shërbim të të huajve.... me frymë jo vetëm antipopullore, por, siç thamë edhe antikombëtare.”

Pikërisht për të ndriçuar sadopak punën e mësuesve dhe të nxënësve të këtyre shkollave, ndihmesën që kanë dhënë ato në çështje kombëtare dhe në edukimin e breznive të reja, ndërmorëm këtë studim me pretendimin për të vënë në vend atë që është mohuar për gjysmë shekulli, për të zënë edhe ato vendin që u takon në historinë e arsimit shqiptar, këtë të drejtë të ligjshme që ua japin ditët e bardha të demokracisë që erdhën tek ne. Por, ashtu si për një poet tonin të njohur, edhe për mua “...demokracia nuk është një makinë elektronike llogaritëse për të gërmuar në koleksionet e gazetave dhe të revistave gjysmëshekullore dhe për të numëruar fjalitë dhe frazat e botuara nga njëri apo tjetri dhe për t’i përdorur si argumente akuzimi.”²

Natyrisht kemi synuar t’i bëjmë të njohur studiuesve të arsimit, shkollës dhe të mendimit pedagogjik shqiptar, si dhe opinionit tonë në përgjithësi disa probleme që lidhen me:

- Hapjen e këtyre shkollave (kuadri i të cilave plotësohet në fillimin e viteve ’20 të shekullit XX.);
- Programet e teksteve me të cilat kanë punuar;
- Punën e mësuesve dhe nxënësve që dolën nga këto shkolla;
- Vendin që zinin lëndë të ndryshme dhe formimi teoriko-praktik që jepnin ato;
- Rregullsinë e punës në dokumentacionin shkollor;
- Lidhja e shkollës me prindërit dhe njohja e opinionit me rezultatet shkollave në fjalë;
- Punën edukative dhe kulturore të shkollës;
- Botimet për shkollën dhe kualifikimin e mësuesve;
- Bazën materiale dhe bibliotekat shkollore.

Në fund të punimit kemi bërë një paraqitje të shkurtër për disa portrete mësuesish të shkollave të mesme me veprimtari të shquar arsimore e pedagogjike në fusha të ndryshme, të cilat ishin lënë në heshtje ose denigruar nga pushteti komunist për “faje të ndryshme”, ndonëse qenë mësues në kuptimin e plotë të fjalës atdhetarë dhe punëtorë të palodhur, njerëz të ndershëm dhe të devotshëm, qytetarë dhe intelektualë që janë për t’u pasur zili. Në mes të tyre mund të përmendim: Mirash Ivanaj, Gjergj Fishta, Daut Boriçi, Mati

2 Dritëro Agolli, O tempora, O mores!, “Drita”, 13.01.1991.

Logoreci, Ethem Osmani, Isuf Tabaku, Gasper Beltoja, Rexhep Kruja, Kol Kamsi, Gasper Jakova, Haxhi Sheh Shamia, At Donat Kurti, Konsilja Muzhani, Simon Rrota, Ndue Paluca, Zef Mark Harapi, Engjëll Ndocaj, Haxhi Hafiz Abaz Golemi, Musa Tabaku, Jusuf Kraja, etj., etj.

2. Gjimazi i Shtetit-1922

Për gjimnazin e shtetit në Shkodër, hapur më 1922, është folur dhe shkruar shumë. Janë botuar shumë artikuj nga autorë dhe studiues të ndryshëm, si dhe një libër (i cituar) nga Xh. Repishti e F. Luli (me rastin e 50- vjetorit të krijimit të tij). Në historinë e Arsimit Shqiptar i kushtohen disa faqe kësaj shkolle.

Hapja e gjimnazit të shtetit në këtë qytet me tradita të lashta në të gjitha fushat, por edhe me kontribut në fushën e arsimit kombëtar, ishte një ngjarje me rëndësi në historinë e tij, por “*ishte edhe nevojë e kohës*”.³

Është i njohur fakti që Ministria e Arsimit nën presionin e opinionit publik të qytetit, që përfaqësohej nga një peticion prej 56 nënshkrimesh, i cili përmbledhte “*shtresa të ndryshme të popullsisë e nga shumica e lagjeve të qytetit*”⁴, u detyrua të hapte këtë shkollë shtetërore laike.

Në botimet e sipërpërmendura tregohet me hollësi edhe lufta, përpjekjet, por edhe kundërshtimet për hapjen e kësaj shkolle.

Synimi ynë është që t’u japim diçka për planin mësimor të shkollës, programet me të cilat mësonte, nivelin e nxënësve me aq sa kemi mundur të gjejmë të dhëna, për bazën materiale të shkollës, për personelin mësimor etj. duke menduar se kësajsoj plotësoj në një farë mënyre mangësitë e botimeve të mëparshme për këto çështje.

Në informacionin e parë që kemi gjetur për hapjen e shkollës, dërguar Ministrisë së Arsimit më 13.10.1922, njoftohet se “...më 5.10.1922, Gjimnazin e hapme” dhe vazhdon “*deri sot janë shkruar 29 vetë, 26 në klasën e parë dhe 3 në klasën e dytë, të ardhur prej shkollave qytetse, tre prej Gjimnazit Françeskanë, 4 prej shkollës tregtare të jezuitëve.*” Në një informacion shtesë tregohet e janë regjistruar 38 nxënës, prej të cilëve 35 në klasën e parë.⁵

Lëndët e mësimin u ndanë: Kol Kamsi - gjuhë shqipe, Kol Margjini - histori e dheshkronjë, Ruhi Zeka - matematikë, Kol Kraja - frëngjisht, Simon Rrota - vizatim, Luigj Shala - shkenca natyrore. Letërdërguesi, Luigj Shala, bënte punën e drejtuesit të shkollës në rangun e nëndrejtorit.

3 Xhevat Repishti, Faik Luli: “Gjimnazi i shtetit”, Shkodër, 1972, fq. 24-25.

4 MASH, ISP: “Historia e arsimit...”, Grup autorësh, Tiranë, 2003, fq. 401 e 403.

5 AQSH, F. 6, D. 21, Fl.4, V.1922.

Janë njohur gjithashtu edhe diskutimet e bëra lidhur me gjuhën që do të hapej gjimnazi dhe përpjekjet për të sjellë nga jashtë një drejtor me autoritet shkencor, dihet edhe propozimi që iu bë albanologut të njohur Maksimilian Lambertz.

Informacioni shtron kërkesën për futjen në planin mësimor të lëndës “gjuhë latine” se “një gjimnaz pa gjuhën latine nuk mund të hapet tuj qenë se kjo asht landa ma e parë e gjith kësaj katëgorije shkollash. Për mësues nuk kemi. Ju lutëm mësuesve françeskanë, por ata janë shumë të zënë me punë të veta dhe s’mund ta përballojnë.”⁶

Nga informacioni marrim vesh për gjendjen shumë të keqe të bazës materiale, orënditë e vjetra, mjetet mësimore shumë të pakta, për të cilat në një informacion tjetër do të kërkohej me hollësi nevoja e tyre, duke i bërë lutje Ministrisë që të jepte një fond për sigurimin e tyre.

Mendojmë se është me interes të sjellim një paraqitje të planit mësimor të plotë me të cilin punoi gjimnazi në dy vitet e para të jetës së tij. Plani mësimor në fjalë miratuar nga Ministria e Arsimit i përcillet drejtorisë së shkollës nga inspektori i atëhershëm i arsimit Ismail Anamali.

PROGRAMA E GJIMNAZIT SHQIP CIKLI I PARË

KL. I.

E ndamja A	Gj. Klasik	E ndamja B	Gj. Qytetuer
Shqip e latinisht	10 orë	Shqip	6 orë
Gjuhët e gjalla	5 orë	Gjuhët e gjalla	5 orë
Histori e gjeografi	3 orë	Histori e gjeografi	3 orë
Njehsim	2 orë	Njehsim	2 orë
Shkenca natyrore	1 orë	Shkenca natyrore	1 orë
Vizatim	2 orë	Vizatim	2 orë
Shuma:	23 orë	Shuma:	22 orë

KL.II

E ndamja A	Gj. Klasik	E ndamja B	Gj. Qytetuer
Shqip e latinisht	10 orë	Shqip	6 orë
Gjuhët e gjalla	5 orë	Gjuhët e gjalla	3 orë

6 AQSH, F. 699, D. 2; V. 1922, Fl.2.

Histori e gjeografi	3 orë	Histori e gjeografi	3 orë
Njehsim	2 orë	Mat. e viz. gjeomet	1 orë
Shkenca natyrore	1 orë	Shkenca natyrore	1 orë
Vizatim	2 orë	Vizatim	2 orë
Shuma:	23 orë	Shuma:	22 orë

Për të krijuar një ide se ç'kishte plani mësimor po e ilustruam me ato që shkruheshin për lëndën e gjuhës shqipe: - Në gramatikë në klasën e parë fillohej me studimin e sintaksës (këtë mënyrë të fillimit të mësimin të gjuhës me sintak- sën e kemi gjetur edhe tek tekstet e tjera, madje që në klasat fillore; për këtë ana- lizë që i kemi bërë tekstit të gjuhës nga G. Mikeli, e gjejmë edhe sot të zbatuar në librat e rinj të gjuhës shqipe, klasa e dytë dhe e tretë që zbatohet për herë të parë këto dy vitet e fundit në shkollat tona). Qëllimi ishte që të ushtroheshin nxënësit në gjuhën e folur dhe në ortografi. Programi parashikonte dhe njohuri për dialektet. Në klasën e dytë vazhdohej studimi dhe thellimi i përvetësimit të sintaksës, vazhdohej me stërvitje të të folurit dhe ortografi, por në këtë klasë fillohej edhe puna për realizimin e hartimeve të thjeshta. Nga programi dukej qartë se i jepej rëndësi anës praktike të përdorimit të gjuhës në të folur dhe në të shkruar dhe pas tyre *“do të mësohen rregullat”*.⁷

Në lëndën e letërsisë i jepej vend i gjerë këndimit, shpjegimit dhe mësi- mit përmendësh të autorëve tanë, por edhe nga prozatorë dhe poetë të kohës së mesme të përkthyer në shqip. Nga autorë shqiptarë do të zhvilloheshin: Budi, Kristoforidhi, Sami e Naim Frashëri. Se si u zhvilluan mësimet dhe në ç' nivel qe puna e mësuesve gjatë vitit të parë na tregon një informacion i dërguar nga drejtori i shkollës për këtë.

Natyrisht që po japim në mënyrë të përmbledhur disa nga problemet kryesore të punës mësimore edukative gjatë vitit të parë të punës së gjimnazit. Informacioni në fjalë është prej 6 faqesh të daktilografuara, punuar me shumë rregull e qartësi, me të mirat e të metat dhe paraqiste gjendjen faktike pa zbulu- rime. Këtë praktikë e kemi gjetur edhe në vite të tjera nga drejtorët pasardhës të kësaj shkolle, por edhe të shkollave simotra të kësaj kohe. Informacioni mban datën 3.2.1923, ndonëse firma nuk është e lexueshme plotësisht. Nga burime të tjera e dimë se drejtor në këtë vit ishte Xhevat Korça.

Nga ky informacion mësojmë se:

7 AQS, F. 669, V. 1922, D. 3, Fl. 4-9.

- Gjimnazi deri në atë kohë mund të quhej real kurse nga janari e këndej ishin plotësuar mësimet në të dy degët (real dhe klasik).

- Kishte shumë mangësi dhe vështirësi në plotësimin e mjeteve mësimore gjë që “*kanë shkatue një fryt jo krejt të kënaqshëm*”.⁸

- Trupi mësimor, ka punuar mjaft mirë, por bëhen edhe diferencime në punën e tyre.

- Drejtoria kishte bërë kontrolle në punën e mësuesve dhe në nivelin e përvetësimit të njohurive nga nxënësit sipas saj mjaft nxënës paraqitnin dobësi prandaj me ta duhej bërë punë e diferencuar për të arritur shokët, “*ndryshe nuk mund të vazhdojmë me to,*” theksohet aty.

I rekomandon Ministrisë së arsimit që në gjuhët e gjalla është më e dobishme që në vend të frëngjishtes të vihej gjermanishtja ose italishtja, meqë nxënësit do të vazhdonin më tepër mësimet në Itali e Gjermani dhe më pak në Francë.

- Vlerësonte në mënyrë të veçantë lëndën e muzikës, e cila “*asht mjeti ma efektiv për dëfrimin dhe naltësimin e shpirtit të nxanësve*”,⁹ dhe kërkon nga Ministria një fond për të blerë instrumente muzikore, të cilat sipas mendimit të tij, do të jepnin frytet e duhura.

Siç kuptohet nga informacioni, gjendja dhe pajisja e nxënësve me libra ishte shumë e vështirë, prandaj i kërkohej asaj Ministrie që veç të tjerave t’u jepte edhe një shaptilograf për të kopjuar disa nga tekstet që u mungonin.

I sollëm këto mendime që studiuesit të krijojnë një ide sa më të qartë për interesat, metodën e punës, problemet, shkallën e formimit, kulturën, marrë- dhëniet me dikasterin, sa korrektë dhe kërkues ishin në punë, marrëdhëniet në ndërmjet drejtorisë dhe mësuesve.

Nga viti në vit shkolla erdhi duke u plotësuar me klasë. Deri në vitin 1924-25 kishte klasën e katërt dhe në vitin 1925-26 kishte edhe klasën e pestë. Drejtori i atëhershëm në pasqyrën e regjistrimit të fillimit të këtij viti shkruan: *Nxënës gjithsej janë nënshkrue 89 të ndarë sipas klasave në këtë mënyrë:*

Gjithsej sipas viteve

Klasa e parë	32	32
Klasa e dytë -R-	14	
Klasa e dytë -K-	4	18
Klasa e tretë -R-	16	16

8 AQSH, F. 669, D. 8, V. 1923, Fl. 2.

9 AQSH, F.669, D. 8, V. 1923, Fl. 2

Klasa e katërt -R-	13	
Klasa e katërt -K-	5	18
Klasa e pestë -K-	5	5
		89

Siç e kemi përmendur edhe në fillimet e arsimit të mesëm, në vitin shkollor 1925-26 hapet pranë gjimnazit edhe dega normale. Në një lajm të drejtorisë së shkollës, me firmë të dr. Mirash Ivanajt theksohet se Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit me tel. nr. 1860, dt. 26.10.1925, lajmëron se pëlqen propozimin e kësaj drejtorie për çeljen e degës normale në të cilën vetëm për këtë vit do të pranoheshin nxënës të klasës së katërt. Mësimet fillojnë më 2.11.1925.¹⁰

Duke krahasuar planin mësimor të vitit të parë me këtë të viteve 1924, 1925 dhe 1926 shohim disa ndryshime që më tepër synonin në forcimin e shkollës gjë që pasqyrohet në plan dhe në shtimin e lëndëve të reja, kështu sasia e orëve javore shkon nga 25-23 në 26-27. Për të ilustruar këtë mendim po sjellim dy pasqyrat që vijojnë:

Pasqyrë nr. 1

viti 1924-25

Rendi	Dega	Lëndët											Orë	
		Shq	L	Fr	Mat	Gjr	His	Shk	Viz	Muz	Kal	Moral	Gjer	Javore
I	Klas	5	5	4	3	2	2	2	1	1	1	-	-	26
	Real	5	-	5	5	2	2	2	2	2	1	-	-	26
II	Real	5	-	5	5	2	2	2	2	2	-	-	-	25
III	Klas	5	5	3	3	2	2	2	2	2	-	-	-	26
	Real	5	-	4	7	2	2	2	2	2	-	-	4	26
IV	Klas	4	6	3	3	2	2	2	2	2	-	1	-	27 ¹

¹⁰ AQSH, F. 669, D. 47, V. 1925, Fl. 29.

Rendi	Dega	Lëndët												Orë		
		Shq Fr Gjer Lat Mat Gjgr Hist Shk Fiz Viz Kal V.gj M Fiz												Javore		
I	Klas	4	4	-	-	3	2	2	2	-	-	2	2	2	2	25
	Real	4	4	-	3	4	2	2	2	-	-	2	2	2	2	29
II	Real	4	4	-	-	4	2	2	2	-	-	2	2	2	2	26
III	Klas	3	3	4	-	4	2	2	1	2	-	-	2	1	2	26
	Real	3	3	-	4	3	2	3	1	2	-	-	2	1	2	26
IV	Klas	3	4	3	-	4	2	3	1	2	-	-	2	1	2	26
V	Klas	2	3	-	4	4	2	3	-	3	1	-	2	-	2	26 ²

Për të dhënë një mendim të plotë dhe të saktë për përparimin e nxënësve dhe nivelin e tyre në gjimnazin e shtetit e kemi të vështirë në mungesë të materialeve për këtë problem megjithatë po përpiqemi të sqarojmë diçka nëpërmjet statistikave dhe ndonjë burimi tjetër.

Rezultatet e vitit të parë të shkollës ishin këto: Nxënës gjithsej 37:

Kalojnë	Riprovim	Mbeten
21	13	3

Riprovimet do të bëheshin në lëndët: gjuhë shqipe - 5 nxënës, frëngjisht - 11, histori - 5, gjeografi - 3, matematikë - 1, histori natyre - 5.11

Siç duket Ministria e Arsimit dhe inspektoria nuk kërkonte përqindje të plotë kalimi dhe notë mesatare të lartë, parametra të cilat nuk i kemi parë absolutisht në asnjë statistikë të shkollave të paraçlirimit, por i kemi ndeshur çdo herë dhe kanë qënë shifra referimi për të treguar sukseset e arsimit në të gjithë shkollën shqiptare pas vitit 1944.).

Për të gjykuar sadopak për nivelin e përvetsimit të njohurive shkencore dhe përgatitjen e nxënësve na jep dorë një gjykim i Ministrit të Arsimit të atëhershëm; Rexhep Mitrovica, që në një letër të hapur dërguar arsimitarëve (letra e dytë e tij) duke trajtuar probleme të të mësuarit në shkollë thekson se “mësuesi duhet të zhvillojë sidomos energjitë natyrore të fëmijës, t’i zgjojë t’i vejë në lëvizje t’i ngacmojë. Rëndësia nuk asht me derdhë njoftime të cilat i merr pozitivisht përkundrazi me e sjellun fëmijën të vërejë, të kujdeset, të men- dojë, të gjejë.”¹² Për ilustrim po sjellim një shembull nga Gjimnazi i Shkodrës: “merrni nxënës të këtij gjimnazi dhe bëni një pyetje

11 AQSH, F. 669, D. 8, V. 1922, fq. 9.

12 Po aty, fq. 31.

*mbi historinë. Do të shihni se përgjigja e tij nuk do të përmbledhet në të thurur përmendsh të ngjarjes, por ka për t'analizue faktorët e ksaj, u bën kritikën, ua gjen gabimet dhe jep një gjykim mbi përfundimin mbas kapacitetit t'arsyetuemit të tij.”*¹³

Në kuadrin e Gjimnazit ka pasur gjithmonë mësues të nderuar. Natyrisht për të bërë një listë të tillë është tepër e vështirë, mbasi aty renditen me qindra. Por emrat e Dr. Mirash Ivanajt, Ndue Palucës, Loro Rashës, Anton Dedës, Kolë Krajës, D. Mozalit, Januz Boliqit, L. Prelës që punuan në vitet e para të jetës së këtij gjimnazi do të mbeten në kujtesën e brezave të nxënësve që mësuan në këtë Gjimnaz e në Historinë e arsimit të rrethit të Shkodrës.

Pas provimeve të maturantëve të parë në degën klasike e reale, që u bë në qershor të vitit 1929 që ishte një ngjarje e rëndësishme në historinë e qytetit për të cilën në librin e procesverbalit të provimeve është shkruar “*Për herë të parë bahet në Shqypni në gjuhën shqipe e në gjimnaze shtetërore provimi i maturës i gjimnazit të lartë*”¹⁴, kanë dalë dhjetëra breza maturantë që kanë kontribuar në fusha të ndryshme të jetës dhe kanë ngritur lart lavdinë e këtij Gjimnazi.

Në jetën time të gjatë në arsim kam pasur rastin të njihem më shumë personalitete të arsimit që kanë punuar në këtë shkollë dhe po japim vetëm dy miq e mij, (që njëri ka kaluar në botën tjetër) dhe i dyti vazhdon punën edhe sot:

Ndër personalitetet e shquara të arsimit, të shkencës dhe kulturës shqiptare zë vend të nderuar edhe Prof. dr. Jup Kastrati- “*Mësues i Popullit*” (me rastin e 100-vjetorit të Mësonjëtores shqipe të Korçës-1987) dhe “*Mjeshtër i Madh i Punës*” (dekurohet nga Presidenti i Republikës në vitin 1999) dhe në vitin 2002, Këshilli bashkiak i Shkodrës i dha titullin “*Qytetar nderi*”, cili këto ditë mbushi 90-vjetorin e lindjes.

Përveç teksteve mësimore universitare dy kanë qenë “*fushat e zemrës*” të Prof. Kastratit: fusha e albanologjisë, gramatologjisë dhe fusha e studimeve deradiane.

Kështu që studiuesit seriozë kanë theksuar se gjatë viteve 1956-2003, Prof. Jup Kastrati, studiuesi i afirmuar i gjuhës amtare dhe është veprimtaria shkencore botuese, që trashëguam prej tij: rreth 900 studime dhe artikuj të përfshira në 14.000 faqe shtypi shkencor dhe divulgativ, si: traktate, libra, monografi, studime, artikuj, kumtesa, referate etj., të botuara

13 Rev. Pedagogjike, fq. 29, nr i posaçëm.

14 Xh. Repishti, F. Luli, libri i cit. fq. 11.

në revista dhe organe të ndryshme të peridikut brenda dhe jashtë vendit dhe e thënë me fjalë të tjera ka botuar mbi 35 libra e monografi shkencore gjithsej.¹⁵

Ndësa i dyti është z. Ahmet I. Boriçi, mësues, drejtues shkolle, didakt dhe botues tekstesh shkollore. U lind në Shkodër, ku mori mësimet e para, duke kryer gjimazin (1972). Më 1977 ka kryer Universitetin e Tiranës, dega matematike. Ka punuar për shumë vite në fshatra të rrethit dhe në vitin 1987 punon në Gjimazin e Shtetit, Shkodër, (Shkollën “28 Nëntori”), i cili ka veprimtari të dendur botuese në fushën e teksteve mësimore (si autor i vetëm dhe me bashkautorësi) të 27 teksteve të ndryshme, që përmbliohen në 2700 faqe të llojeve të ndryshme me teori, ushtrime etj.¹⁶

3. Dy fjalë si mbyllje:

Duhet të jemi të kujdesshëm në raset e përvjetorëve të shkollave të mesme të tjera të Shkodrës si: Medresetë, Kolegji Saverian i Jezitëve, Shkolla Normale e Motrave Stigmatine dhe Shkolla Normale (1917) (*Për të cilën kemi shkruar në “ZANI I NALTË”, themeluar më 1923 - Viti V, Nr. 19 (172), fq. 44-49.*)

Në bakat e kësaj shkolle kanë mbaruar me qindra e qindra nxënës, që pasi kanë kryer studimet e larta kanë shërbyer në të gjitha skajet me të largëta të Shqipërisë, të përgatitur nga një staf prej qindra mësuesish të talentuar që i kanë bërë nder kombit dhe arsimit tonë.

15 Përgatitur për botim në librin “Portrete të shquara...”, Prof. dr. Personalitet i shquar i arsimit, shkencës dhe kulturës shqiptare”, fq. 153-160, Shkodër, 2017.

16 Përgatitur për botim në librin “Portrete të shquara...”, “Një jetë me dinjitet...” (Për mësuesin Z. Ihsan Boriçi), , Shkodër, 2017. fq. 247-253.

Markelian KAPEDANI

TEORIA XHAZ

Po e filloj këtë shkrim, duke i ba të ditun lexuesit që, me koncentruar teorikisht në pak faqe një muzikë kaq rinovuese siç është Xhazi, duket diçka tepër e vështirë dhe ndoshta e pamundur. Sidokjoftë, mue gjithmonë më kanë pëlqye sfidat, prandaj edhe po i shkruaj këto rreshta teorijet muzikore të koncentrueme në maksimum brenda së cilave, lexuesi muzikant shpresoj që ka për të mësue një pjesë të mirë të idiomës muzikore të kësaj muzike fantastike e cila nuk ka kufij, mbasi Xhazi në fund të fundit i përket të gjithë popujve.

Historikisht, Jazz është muzika dhe arti i prodhuar nga artistat e popullit të zi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Teknikisht bahet fjalë për muzikantë dhe artistat të cilët përvetësojnë kulturën e popullit të bardhë evropian dhe e përshtasin atë për nevojat e veta. Në muzikë kjo gjë shprehet përmes asimilimit të teorisë muzikore klasike nga ana e muzikantave me ngjyrë të zezë dhe më pas e aplikimit të saj mbi ritmet dhe motivet muzikore afrikane.

Praktikisht, Jazz është muzikë kryesisht e improvizueme në moment. Për t'ja arritë kësaj gjëje, xhazi, me kalimin e kohës ka krijuar një gjuhë të komplikuar *Ritmike* dhe *Harmonike* të cilën mund ta pagzojmë me një neologjizem: **Ritmoharmonia**.

Xhazi nuk ka rregulla statike, Ai ka disa principe të cilat duhen respektue, p.sh:

Në Xhaz nuk na bahet vonë se zanet po shkokan në të njajtin drejtim e me quinta paralele, apo sepse po përdorim ose jo e të ashtuquajturat (*nota kaluese dhe ndihmëse*), gjithashtu nuk preokupohemi se *Dominanta* po shkon ose jo drejt *Tonikës*!

Në Xhaz preokupohena që gjuha harmonike të mos ketë triada konsonante! *Akordet Jazz quhen "Voicings" dhe perbahen normalisht me nga katër nota*. Gjithashtu në Xhaz kemi në plan të parë *Ritmin* i cili zhvillohet me nën-ritme, sinkopa e me "*pattern*" që ndërthuren mes një-tjetrit, dhe kur improvizojmë, veprojmë me dashje në mënyrë të tillë që motivet tona (të cilat luhen mbi akorde "*Voicings*") të jenë teknikisht sa ma të sofistikuar e sa ma personale dhe njikohësisht sa ma Jazz. Kjo e fundit don me thanë që, muzikantit i duhet me ditë në çdo moment të lojës se mbi cilat nota me i vëre sipër duart.

Aktualisht, kjo muzikë i ka hapë dyert kundrejt gjithë popujve mbasi ajo lind si pasojë e kombinimit të kulturave të ndryshme. Gjithashtu Jazz është muzika e shtresave të shtypuna, mbasi ai lindi prej mendjes së muzikantave të popullit të zi në një moment të historisë, ku të zezët ishin skllëvër nën sundimin e të bardhëve. Ky “*mëkat i lindjes*” i detyroi muzikantat Jazz që fillimisht (*për pamundësi*) të lozin nëpër kafene dhe bordello. Ma tej me nxjerrjen e skllavënisë jashta ligjit, Xhazit i jepet mundësia me hypë mbi skenat e teatrove ... Jazz lindi brenda Getos së zezë. Harlem është një nga këto Geto. Kjo lagje gjendet në Manhattan dhe është e populluar nga shumica e njerëzve me ngjyrë të zezë. Lindja e Xhazit përkon me Rilindjen e Harlemit, eng: (**Harlem Renaissance**) një lëvizje artistike dhe intelektuale që lëvroi rreth viteve 20 të shekullit XX. Nga kjo lëvizje linden ide të reja (*progresiste*) të cilat u përhapen fillimisht në USA dhe më pas në gjithë botën duke joshur popullin e bardhë të interesohej seriozisht rreth kulturës së popullit Afro-Amerikan.

Teknikisht, mendoj se Teoria e Xhazit mund të ndahet në katër pjesë ku seicila nga ato merret me një aspekt të kësaj muzike fantastike:

- **ritmika** (“*Sëing and ëalking bass*” dhe “*Clave y Tumbao*”)
- **harmonia** (*akorde - “Voicings” dhe Mode*)
- **forma** (*Standard Jazz dhe kthesa tipike harmonike*)
- **frazimi** (*improvizimi*)

Këto katër elemente lidhen mes tyre përmes një mënyre tipike të xhazit. Kjo mënyrë bashkon thekset ritmike me notat e akordeve përmes frazave të linjës melodike dhe Basit. Për tu spjegue ma në detaj, imagjinoni që muzikantit, pikë së pari i lypet të njohin mirë strukturën ritmike mbi të cilën ka vendosë me improvizue. Kjo njohje ka të bajnë me thekset e pulsit ritmik. Më pas, këto thekse ritmike duhet të lidhen me notat e akordeve “*Voicings*”. Këto akorde shërbejnë për partin e shoqimit. Gjithashtu këto akorde janë të lidhuna me mode e shkalla muzikore. Mbi këto mode, muzikanti krijon **motivet e veta** (*personale*) për improvizim. *Këto motive janë si puna e fjalëve të gjuhës së folun, të cilat kur bashkohen në varg njena mbas tjetrës, krijojnë frazimin personal të muzikantit improvizues.* Muzikalisht, këto “*fjalë*” mbështeten mbi notat e modeve, ku disa nga këto nota bijn mbi theksa të fortë ndërsa disa tjera bijn mbi theksa të butë. Duke analizue frazat simbas thekseve ritmike, muzikanti improvizues arrin të bajn përzgjedhjet e veta për të krijuë gradualisht gjuhen e vet improvizuese. Por le ti shohim konkretisht sejcilen nga këto katër aspekte të muzikës Jazz.

RITMIKA: (“*Sëing and äalking bass*” dhe “*Clave y Tumbao*”)

Ritmika është aspekti kryesor i kësaj lloj muzike. Pa ritëm nuk ka Jazz. Me ritëm përgjithsisht nënkuptojmë renditjen e njëpasnjëshme të një numri të caktuem goditjesh me thekse të ndryshme të ndame mes tyre nga pauza.

Afro Beat

The image shows five staves of musical notation for Afro Beat. From top to bottom, they are labeled: Ternary Son, Ternary Rumba, Bembé, Swing, and Beat. Each staff contains a sequence of notes and rests, with brackets above indicating groups of three notes. The Beat staff at the bottom has numbers 1, 2, 3, and 4 below it, corresponding to the four measures.

Në muzikën xhaz kemi të bajmë me disa modele kryesore ritmike mbi të cilat ndërtohen frazat melodike dhe shoqërimi. Këto modele, në formën e tyre bazë identifikohen me kohen 4/4. Gjithashtu strukturat ritmike në fjalë, janë të transformueshme në shpejtësi dyfishe, me gjysmëshpejtësi gjithashtu dhe në kohë muzikore tjera si 6/8; 3/4 deri tek kohët e thyeme. **Simbas eksperiencës seme, mendoj se strukturat ma të dukshme ritmike në Xhaz i përkasin pulsit *Sëing* dhe *Klaves (Clave)*.**

Modeli ritmik tipik i xhazit në U.S.A është ai “**SËING**”. Ky term pëveç emrit të ritmit në fjalë, shpreh gjithashtu edhe idenë e lëvizjes në ekuilibër mes vallëtarëve. Këtu duhet të kemi parasysh faktin që muzika xhaz është jo vetëm muzikë dëgjimi por edhe vallëzimi, prandaj edhe aspekti ritmik është me randësi të madhe.

The image shows a musical staff with a 4/4 time signature. It features a series of notes and rests, with brackets above indicating groups of three notes. This represents the Sëing rhythm.

Ky ritëm, për thjeshtësi shkrimi përfaqësohet grafikisht si ma poshtë:

Swing

The image shows a musical staff with a 4/4 time signature. It features a series of notes and rests, with brackets above indicating groups of three notes. This represents the Swing rhythm.

Mbi këtë model ritmik ecën linja e Basit në “*Ëalkin Bass*” gjithashtu edhe shoqimi me “*Voicings*”. Shembulli i maposhtëm ilustron ecjen e Basit tek dora e majtë e pianistit si dhe shoqimin me sinkopë tek e djathta.

MED: SWING

C^{6/9} A^{7(b9)} D^{m9} G^{13(b9)} C^{maj9}

Pulsi Sëing determinon frazimin e muzikantit i cili interpreton në lojen e tij muziken e shkrueme, duke “sëingue” si më poshtë:

C^{6/9} A^{7(b9)} D^{m9} G^{13(b9)} C^{maj9}

Modeli tjetër ritmik është ai në **Klave** (*Clave*) 3/2 ose 2/3 dhe i perket Amerikës Latine. Kjo strukturë ritmike shtrihet në dy masa në kohën 4/4.

4/4

Duke i ndërrue vendin masave mund të ndërtohet një tjetër frazë ritmike e cila ruan të njëjtin thelb, por praktikisht sjell një tjetër sens ritmik.

4/4

Kjo strukturë ritmike gjendet në forma të ndryshme në vendet e Amerikës së Jugut. Variantet më të rëndësishme të këtij pulsi ritmik, i gjejmë në Kubë me dy format e saja: *Son Clave* (3/2 & 2/3) dhe *Rumba Clave* (3/2 & 2/3)

Son Montuno 2|3

Toms

Kick

3|2 Rumba Clave (Guagancó) *2|3 Rumba Clave (Songo)*

Clave

Katá

Palitos

Congas

Tumbão

Gua - gan - of

Mbi këtë model ritmik, ecën linja e Basit në “Tumbao” dhe shoqërimi i pianos “Montuno”.

Son Montuno 3|2

C^{6/9}

Dm⁷

G⁹

Cmaj⁷

Gjithashtu në Brasil ekzistojnë forma ritmike të ndërtueme simbas sensit të Clave-s.

Partido Alto *Reverse Partido Alto*

Accent Pattern

Pulse

Cuica

Congas

Baião

Këtu poshtë, një ritmikë Braziliane me dy variantet **“Partido alto & Reverse Partido Alto”**

Një transkriptim i pulsit Partido Alto dhe Reverse Partido Alto mbi pianoforte mund të jetë kështu:

Partido Alto

Reverse Partido Alto

Pulsi i Clave-s gjendet në mjaft forma tjera ritmike:

Güiro

<<Mësojini permendësh këta struktura ritmike dhe mundohuni ti dalloni me vesh, ashtu siç mësoni me dallue notat apo akordet mes tyre. Kini në mendje faktin që këto ritme mund të shkruhen edhe në forma të ndryshme. Si perfundim, është e rëndësishme njohja me vesh e tyre.>>

HARMONIA: (akorde – Mode dhe “Voicings”)


Flamenco - Soleá

Harmonia është elementi i dytë për randësi në muzikën xhaz. Ajo ka të bajn me akordet e shoqërimit. Akordet në xhaz identifikohen me termin anglez “VOICINGS”.


Akordet Jazz, zakonisht janë të ngarkueme me tension *permes tingujve të septimës së madhe, kuintës së zvoglueme, nonës së zmadhueme, undiçezimës dhe tredicëzimës*.

Për këtë arsye lypet të mësoheni të konsideroni akordet jazz ndryshe nga ç’ndodh në muziken Pop në të cilën kryesisht kemi të bajmë me akorde konsonante. Në Xhaz, (siç do ta shohim ma tej), akordet janë të lidhuna ngusht me modet perkatëse dhe simbas kontekstit muzikor, muzikantat shfrytëzojnë notat e modeve per krijimin e strukturës së frazave të perdoruna ndër improvizime.

Funksionet harmonike klasike të perdoruna në muziken Pop, janë treshe notash.



Funksionet harmonike Xhaz perfshijnë katër dhe më shumë nota.



Gjuha harmonike xhaz, gjithashtu ka ngjashmëri me gjuhen harmonike të muzikës franceze: Ipresionizmit. Akordet e xhazit i gjejmë tek muzika e Debussy, Ravel, ... ma tej tek muzika ruse e kompozitorëve Skrjabin, Stravinsky e të tjerë kompozitorë të cilët të influencuem nga zbulimet e reja shkencore të kohës, krijuan muzikë gjatë një prej periudhave ma interesante të historisë moderne: “*La Belle Époque*”. Për të spjegue sistemin harmonik të xhazit në mënyrë sa ma të përmbledhun, kam perdorë një mënyrë origjinale e cila bazohet mbi **pesë modele**. Këto modele kanë të bajnë me sintetizimin që praktikisht mund ti bajmë akordeve të xhazit duke i grupue bashkë me modet dhe shkallët perkatëse, ku seicili prej modeleve përmban akorde të ndryshme por që i referohen të njëjtes bashkësi notash.

Përpara se të futemi tek spjegimi i modeleve, lypet të kjarhtësojmë

aspektin semiografik lidhun me harmoninë e xhazit. Për të shënue akordet, xhazi përdor një seri simbolesh, të cilat me kalimin e kohës janë sofistikue dhe kanë arritun sot të jenë forma ma praktike e emertimit të akordeve. Në fillim zanë vend siglat e notave: A, B, C, D, E, F, G të cilat korrispondojnë me emnat e shtatë notave: *La, Si, Do, Re, Mi, Fa, Sol*. Ma tej kemi identifikimin e akordit në mazhor ose minor ku gjendja në mazhor nuk ka simbol mbasi merret si pozicioni natyror i akordit, ndërsa gjendja në minor shënohet me shkronjen *mi* ose *m*. Vazhdohet me simbolin *sus* i cili na jep të kuptojmë që akordi nuk është as mazhor dhe as minor, por “pezull”! Kështu, në vend të *tercës mazhore ose minore, treshja e notave perbahet nga prima, quinta e paster dhe sekonda e madhe ose kuarta e paster*. Identifikimi i kësaj triade përfundon me kuinten. Në shkrimin e akordeve, Kuinta shënohet simbolikisht vetëm atëherë kur gjendet e alterueme (*e zmadhueme ose e zvoglueme*) me simbolet <5 ose >5. Akordet konsonante me tre nota në formen e triadës bashkë me permbysjet e saja, perbajnë ABC-në e harmonis. Ndërsa harmonia xhaz nis një hap ma tej. Akordet Jazz në formen ma të thjeshtë janë me katër nota, pra i përkasin dominit të *septimës*. Septima, në formen tradicionale të akordit të Dominantës [D] (*septima dominante*), në xhaz shënohet thjesht me numrin 7, ndërsa septima e madhe shënohet me shenjën $\wedge 7$ ose *Ma* apo *Maj*. Po në këtë kontekst, kena edhe simbolet 07 ose *dim7* për akordin e zvogluar të septimës si dhe \pm për akordin minor të septimes me kuintë diminuite (*Akord gjysmë-i zvogëluar i septimes*). Nona, në akordet e xhazit gjendet në tre pozicione: nona e madhe (pozicion normal) = 9, nona e vogel = >9 dhe nona e zmadhueme = <9. Undicezima është e perbame nga një oktavë + një kuartë e paster. Kuarta mund të jetë p.sh (*e paster ose e zmadhueme*) kështu që edhe njimbëdhjeta do të gjendet në format 11 dhe <11. Tredicezima (teorikisht) është intervali ma i naltë i strukturës së akordeve Jazz. Ky interval perbahet nga një oktevë + një sekstë. Kështu, simbas gjendjes së sekstës (*mazhore ose minore*) edhe tredicezima do gjendet në 13 ose >13. Tredicezima është një akord politonal. Gjithashtu, po ti vendosim notat e tredicezimes në formë shkalle brenda oktavës, do t’na krijohet një mod me shtatë nota. Me të arritun në këtë pikë, kompozitorët dhe teoricienët e muzikës klasike preferojnë të flasin për *Harmoni Modale*. Ky arsytim na çon me i njehsue seicilit akord 13, nga një shkallë apo mod mbi të cilin mund të luhen (improvizohen) melodi apo shoqnime duke ndejtë në perputhje me siglat Jazz. Si fillim le të marrim bashkësinë e perbame nga notat: (*Do, Re, Mi, Fa#, Sol, La, Si*). Të vëndosuna njëra mbas tjetres, këto

nota krijojnë modin Lidian. Kjo bashkësi notash përban modelin që unë do ta quaj “**Modeli i Parë**” dhe përfshin kombinime të ndryshme mes këtyre notave prej të cilave unë kam zgjedhë disa akorde të përdoruna në muziken Xhaz. Seicili akord shoqërohet nga një mod i përbamë nga shtatë nota. (Jena në dominin e modeve të traditës Greko/Romake).

Model I
(akord i trembëdhjetës)

The image shows two systems of musical notation. The first system features three chords: Cmaj11, Em11, and Gmaj9. Below each chord is a scale: Lydian* (under Cmaj11), Aeolian (under Em11), and Ionian (under Gmaj9). The second system features five chords: Em7, Cmaj7b9/b, D9, F#m7b9, and Am11. Below each chord is a scale: Phrygian* (under Em7), Mixolydian (under Cmaj7b9/b), Locrian (under D9), and Dorian* (under Am11). The F#m7b9 chord and its corresponding Locrian scale are not clearly visible in the image.

“**Modeli i Dytë**” rrjedh prej modelit fizik të renditjes së harmonikëve ose *Obertoneve*. Këtu kemi të bajmë me një formë natyrore të gjenerimit të harmonikëve të cilët kanë të bajnë me dridhjet e kordës së tendosun mes dy ekstremeve kur ajo pickohet. Çdo dridhje është një *Oberton*.

The image shows a musical score for Model II, consisting of a single line of music with a treble clef. The scale is marked with fret numbers 1 through 16. The notes are: 1 (C), 2 (D), 3 (E), 4 (F), 5 (G), 6 (A), 7 (B), 8 (C), 9 (D), 10 (E), 11 (F), 12 (G), 13 (A), 14 (B), 15 (C), 16 (D). The scale is marked with -31, -49, +40, and -31.

Përshtatja e këtij modeli natyror mrenda sistemit kromatik të temperuar, është në këtë formë:

Model II
(dominanta trembëdhjetë)

C13(b9) *Em11(b9)* *Gm9*

*Lydian Dominant** *Half diminished** *Bach's Minor**

Bbmaj7(b9) *D/Db* *D7* *(Shejabin)* *Mystic chords* *F#7alt* *A(b9)* *Bbmaj7(b9)/A*

*Lydian Augmented** *Hindu* *Super Locrian** *Prometheus scale* *Dorian b2*

“Modeli i Tretë” është i lidhur me shkallën pentatonike.

Model III
(akord pentaf)

C major *D9(b9)* *Am7(add4)/E* *Am7(add4)/G* *Am7(add4)*

*Major Pentaton** *Egyptian, suspended** *Blues Minor* *Blues Major* *Minor Pentaton**
Gong Pentaton *Shang Pentaton* *Jiao Pentaton* *Zhi Pentaton* *Yu Pentaton*

“Modeli i Katërt” është një akord në katër pjesë ose i përbam prej katër tonalitetesh.

Model IV
(një akord në katër pjesë)

A7 *C7* *D#o7* *Eo7*

*Symmetric Octatone** *Korakovian scale* *Diminished Octatone**

“Modeli i Pestë” i referohet gjashtëtonshit ose shkallës tonale.

Model V
(Debussy)

whole tone scale*
Hexatonic scale

Perveç këtyre pesë modeleve, duhet të shtojmë edhe disa forma folkloristike modesh të cilat i japin ngjyrë të veçantë muzikës. Janë modet popullore të Mesdheut, të cilat janë të importueme shumë kohë ma parë nga Mesopotamia. Prej tyre, unë kam bërë një përzgjedhje simbas gustos seme muzikore.

Hungarian (Hungarian Minor)
(Notat Blu dhe Shkalla Mazhore)

Roman (Roman Minor)

Ulmantian (Ulmantian Minor)

Hungarian Minor

Sardinian Minor

Napolitan Minor

Kjo përmbledhje e koncentruar e harmonis Jazz, përfundon duke shtue dy elementa tepër të randësishem për muziken xhaz: **Notat Blu** dhe **shkallat Bebop**.

(Shkalla Bebop)

Bebop Mazhur

Bebop Dominant

Bebop Minor

Bebop Minor (maj7)

Bebop Minor (kuarta dim)

1 2 3 4 5 6 7 - - x
1 2 3 4 5 6 7 - - x

“Voicings”.

Kur lexojmë siglat e akordeve Xhaz, duhet të dini që ato luhen në një mënyrë tipike, gjë që ban të mundun dallimin e të ashtuquajturave akorde Xhaz prej akordeve të traditës klasike. “Voicings” (ky është emri i akordeve Xhaz) zakonisht janë të formuara me nga 4 nota muzikore, me disa dallime prej akordeve tradicionale: këto në vend të përdorimit të tonikës, përdorin tensionet përtej gradit të shtatë, gradit të nëntë, njimbëdhjetë dhe trembëdhjetë. Gjithashtu ka raste që në “voicings” të hiqet edhe kuinta. Për lehtësi përdorimi jena mësuë t’i ndajmë ato në familje akordesh duke veçue agregatat ma të përdorura, por ka shumë të tjerë Voicings që mund të mbivendosen në disa pika të Akordit tonë teorik: “Voicing” ka dy pozicione themelore e që shpesh korrispondojnë me pikënisje nga gradi i tretë dhe nga gradi i shtatë.

VOICINGS

FORMA: (Standard Jazz dhe kthesa tipike harmonike)

TABELA E AKORDEVE “JAZZ”

DO Bass	DO pesull 2	DO pesull 4	DO minor	DO mashor	DO i zmadhuar	DO i zvogëluar
8	L-A minor me DO në Bas	L-Ab mashor me DO në Bas	F-A mashor me DO në Bas	F-A minor me DO në Bas	DO minor qashta	DO mashor qashta
14						

Në muziken Jazz, forma e pjesëve muzikore është e lidhur ngusht me traditën e këngës. Tre janë format më të përdorura. Forma më e thjeshtë është periudha e përbërë nga dy fjali muzikore. A dhe B, si p.sh:

STELLA BY STARLIGHT

Med: Swing A VICTOR YOUNG

Three staves of musical notation in G major. The first staff contains notes with chords $Ab^{13}(\sharp 11)$, $D7/\flat B$, and $B\flat^6$. The second staff contains notes with chords $Em^{11}(\flat 5)$, $A7_{ALT}$, $Dm7(\flat 5)$, and $G7_{ALT}$. The third staff contains notes with chords $Cm7(\flat 5)$, $F7_{ALT}$, and $B\flat maj7$.

Nji tjetër formë muzikore është ajo dy pjesëshe e përbame nga dy periudha prej 16 masash me nga dy fjali muzikore me nga 8 masa: A - A1 dhe B - A1, p.sh:

BLUE MOON

Med: Swing **A** RODGERS & HEART

Musical notation for "Blue Moon" in G major, 4/4 time, medium swing. The notation includes five staves with various chords and section markers:

- Staff 1: F $D7(\flat 9)/F\sharp$ $Gm7$ $C7$ F $D7(\flat 9)/F\sharp$ $Gm7$ $C7$
- Staff 2: $A7(ADD13)$ $D7$ $Gm7$ $C^9(SUS4)$ F $D7(\flat 9)/F\sharp$ $Gm7$ $C7$
- Staff 3: **A**¹ F $D7(\flat 9)/F\sharp$ $Gm7$ $C7$ F $D7(\flat 9)/F\sharp$ $Gm7$ $C7$
- Staff 4: F $Dm7$ $Gm7$ $C^9(SUS4)$ F $Dm7$
- Staff 5: **B** $Gm7$ $C7$ F $Dm7$ $Gm7$ $C7$ F $B^9(\flat 5)$

Këto dy forma i përkasin traditës muzikore evropiane.

Ndërsa forma Blues, është tipike e folklorit afro-amerikan. *Blues ka një strukturë prej 12 masash X 2 = 24 masa në kohën 4/4 ose 6/8.*

ONE FOR BUD

Balkan Bop

by: Markelian Kapidani

Swing



Këto tre forma të thjeshta: shpesh herë bahen pjesë e një forme më të komplikuar siç është ajo e Rondos: (*strofë - refren*) ku në vend të strofës kemi improvizimet mbi temën ndërsa si refren përdoret Tema e cila funksionon si ndarëse ndërmjet improvizimeve të secilit instrument. p.sh: **TEMA - Solo Piano - TEMA - Solo Basi - TEMA - Solo Bateria - TEMA dhe FINALE**. Në ato raste kur mbi një Temë Jazz vërehet puna e një arranzhuesi, mund të ndeshemi gjithashtu me disa masa muzikore që luejnë rolin e *Introduksionit*, ose me zgjatje të ekzekutimit *Temës* mbyllëse me shtesa frazash muzikore të cilat përbajnë elementat përfundimtarë të formës muzikore dhe që klasikët e thërrasin CODA. Gjithashtu në muzikën Jazz, shpesh herë ndeshena me pasazhe “*unison*” ose me oktava paralele dhe me nenvizim ritmik nga ana e perkusioneve ku të gjitha instrumentat luajnë së bashku. Zakonisht të tilla pasazhe i gjejmë si përgatitje përpara ekzekutimit të Temës për herë të fundit. Në Jazz, forma muzikore është e lidhur ngushtë me strukturën ritmike dhe me ndërrimet harmonike. Në këtë kontekst, struktura ritmike luan rolin e skeletit mbi të cilin mbështëten akordet e artikulueme me figura ritmike që i pershtaten stilit të ritmit të përzgjedhur. Nga ana e harmonis, lidhjet **T - D apo S - T**, janë formula të thjeshta lidhëse mes akordeve, ndërsa një formë tipike e lidhjes harmonike xhaz, është lidhja (**T -> VI(d7) -> II7(dd) -> D7**) që në Jazz identifikohet si xhiro harmonike “*Turn Around*”.

TURN AROUND



Kjo xhiro harmonike është gjithashtu e përshtatshme për aplikimin e mekanizmit harmonik: **ZËVENDËSIMI I TRITONIT**. Ky mekanizëm, në muziken Klasike identifikohet tek **Seksta Napolitane** e cila zëvendëson dubëldominanten **DD**.

Zëvendësimi i Tritonit në Jazz, praktikisht do të thotë zëvendësimi e një akordi me funksionin e Dominant-Septakordit me një tjetër septakord i cili përmban mbrenda të njëjtin Triton enharmonikisht të përbashkët. Simbas kësaj “lidhëze harmonike” <-> “zëvendësimi i tritonit” është fiks një Triton (tre tone) larg nga basi origjinal. Kjo lidhje harmonike mbështetet mbi lidhjen harmonike: [II – V – I] apo mbi lidhjen [DD – D – T]

Le të marrim si tonalitet fillestar Do mazhorin: *Dominanta e tij është nota Sol*. Tritoni i septakordit **G7**: [(Fa) – (Si)] vlen njësoj dhe për Tritonin e septakordit **D>7**: [(Si) – (Mi#) = (Fa)]. Ky zëvendësim, luen një rol të randësishëm në harmonizimet Xhaz. Me përdorimin e (zt), ne ndryshojmë rolet e funksioneve harmonike duke krijuar modulacione (spostime tonalitetesh) në mënyrë krejt të natyrshme, por gjithnjë duke u lidhë me Toniken fillestare tek e cila mund të kthehemi vazhdimisht pa problem, ose jo.

ZËVENDËSIMI I TRITONIT

The image displays two systems of musical notation for the 'ZËVENDËSIMI I TRITONIT' concept. Each system consists of a treble clef staff with chords and a bass clef staff with notes. The first system shows the progression: D⁹ (II(DD)), G⁹ (D), Cmaj⁹ (T), D⁹ (II(DD)), D^{b9}(add13) (zt), and Cmaj⁹ (T). The second system shows: D⁹ (VI), C#7(b9) (D), F#m⁹ (T), D⁹ (VI), G7(b9) (zt), and F#m⁹ (T). The notes in the bass clef are: D, G, C, D, F, C for the first system and D, C, F, D, G, F for the second system.

Tashti mund ta kuptoni Termin “*Standard Jazz*”. që do të thotë konkretisht: *Të bash muzikë mbi Tema të njohuna të cilat mbështeten mbi forma tipike të kësaj muzike, të harmonizueme me akorde dhe kthesa harmonike tipike të xhazit.*

Me të arritun në këtë pikë, mendoj me ba një si tip permbledhjet duke citue elementat e dukshëm të gjuhës muzikore të Xhazit të permenduna deri tashti:

- Ritmika Afro (**Afrika** – 12/8 ose 6/4 = 4/4 *me tercina*)
- Ritmika Sëing (**U.S.A** – tradicionalisht në 4/4: *Silloë; Medium & Fast Sëing*)
- Ritmika Latin (**Kuba** – CLAVE 3/2 dhe 2/3: *Rumba dhe Son*)
- Ritmika Latin (**Brazil** – *Samba – Bossa Nova e.tj*)
- Ritmika Flamenka (**Spanjë** – *Buleria – Soleà – Seguiriyas*)
- Modeli harmonik I (*modet e traditës greko/romake*)
- Modeli harmonik II (*modet e muzikës moderne*)
- Modeli harmonik III (*pentatonika*)
- Modeli harmonik IV (*shkalla oktatonale*)
- Modeli harmonik V (*shkalla tonale*)
- Notat Blu (*nota tipike të muzikës Jazz*)
- Shkallat Bebop (*shkallë me 8 nota mbi të cilat bazohet improvizimi Jazz*)
- Voicings (*akordet Jazz ose mënyra se si luhen siglat e akordeve në muziken Jazz*)
- Turn Around (*nji gjiro harmonike tipike Jazz*)

SHEMBULL FRAZIMI

MED: SWING

The musical score consists of three systems of piano accompaniment. The first system has four measures with chords C^{6/9}, A⁷(b⁹), Dm⁹, and G¹³(b⁹). The second system has four measures with chords C^{6/9}, A⁷(b⁹), Dm⁹, and G¹³(b⁹). The third system shows a turn-around with a C^{maj9} chord in the first measure, followed by a double bar line.

-Zevendsimi i Tritonit (*nji mekanizem harmonik Jazz*)

-Forma e kangës (*dy pjesëshi*)

-Forma e Bluezit (*këngë e traditës Jazz*)

FRAZIMI: (*këshilla të përgjithshme mbi improvizimin*)

Frazimi ka të bajn me sensin ritmik dhe kanorë të muzikantit i cili duhet të perpiqet me krijue motivet e veta melodike duke u bazue mbi notat e pesë modeleve të shtjellueme tek kapitulli i harmonisë. Ju mund të zgjidhni motive të shkurta ritmike mbi strukturen bazë të ritmit të pjesës muzikore që keni zgjedhë: (*Sëing, Latin, Funk, 8 Stright etj*) duke krijue përgjatë frazimit tuaj pika tensioni dhe pika lehtësime të cilat kanë për të ra respektivisht mbi disa nota nën theksa të fortë dhe mbi të tjera nota nën theksa të butë. Konkretisht, duhet të ndërtoni fraza simbas modeve perkatëse duke përzi brenda *notat Blu e shkallat Bebop*. Gjithashtu do t'ju duhet me vendosë se cilat nota kanë për të ra nën theksat e fortë dhe cilat nën theksat e butë. Mbas kësaj, ju keni për të krijue pasazhe të përbamë nga *një perzierje arpezhesh dhe shkallësh me ndarje ritmike simbas dëshirës*. Këto pasazhe duhet të studjohen në të gjitha tonalitetet. Pasazhet duhet të përshtaten simbas akordit të dhanun duke alterue notat perkatëse. Në këtë pikë, do t'ju vijnë në ndihmë pesë modelet e masipërme. Këshilloj: mos u hallakatni poshtë e përpjetë tastierës duke harxhue energji. Pasazhet tuaja mund të jenë ma efikase duke e rreduktue relativisht hapsinen e lojës brenda intervalit të oktavës (*pak a shumë kështu*):

Të njëjten frazë mund ta përsërisim, ku në vend të shoqimit me "Ealkin Bass" (tek dora e majtë), përdorim shoqënimin me voicings. Në këtë mënyrë, ndërsa dora e djathtë luen frazen e masipërme, dora e majtë fokusohet tek shoqimi me sinkopa. Normalisht, shoqimi me voicings ndërtohet duke rrespektue përgjithësisht pulsën ritmik. Kjo do të thotë që ritmi bahet telajo ku montohen akordet ritmiksht. Gjithashtu (brenda mundësive), mund të varjojmë edhe thekset ritmike duke spostue akordet përgjatë ritmit.

Varianti i masipërm është një variant shoqimi në të cilin dora e majtë, herë mbas here varjon ritmiksht duke sinkopue sa para e sa mbrapa. Muzikanti improvizues zakonisht krijon një mënyrë të vet shoqimi të cilin ai e përdor si model të përgjithshëm përgjatë lojës mbi instrument. Sidokjoftë, kur pjesa është e arranzhueme, theksat e shoqimit janë të shkruem dhe normalisht respektohen prej muzikantave në mënyrë që të evitohen përplasje ritmike në mes të instrumentave. Të dyja variantet e masipërme mund të thuren së bashku në një partiturë të vetme për

SHEMBULL FRAZIMI ME "VOICINGS" TEK DORA E MAJTE

MELODY: SWING

pianoforte. Në këtë rast, shkrimi i muzikës mbi partiturë e merr emnin Piano/Conductor (*pianoforte drejtuese*). Kemi të bajmë me një partiturë në të cilën kombinohen njëherësh të dyja mënyrat e masipërme. Konkretisht, me dorën e djathtë luejm frazimin tonë, ndërkohë që me të majten lozim së bashku një përzimje mes “Ëalkin Bass” dhe “Voicings”. Kjo është mënyra për me luajt Jazz SOLO në Pianoforte. Kjo mënyrë interpretimi është e lidhur me lojën “Rag” mbi pianoforte në të cilën pianisti luan rolin e *Solistit*, *Basistit* dhe *Shoqnesit* shtu këtu edhe *aspektin ritmik* i cili krijohet nga kombinimi i *Basit* dhe *Shoqëruesit* tek dora e majtë.

Më tej, mbasi të keni krijuar një sasi të konsiderueshme motivesh Jazz, ju duhet të ushtroheni direkt mbi modelet e Xhazit të quajtura: “**Standard Jazz**”. Kjo mënyrë studimi dhe krijimi i muzikës nuk ka të sosun, prandaj edhe muzika Jazz, për natyrën e vet improvizuese është vazhdimisht në zhvillim dhe si konsekuencë nuk është kurr perfekte.

SHEMBULL FRAZIMI

MEC: SWING

Chord progression: C⁹ A7^(b9) Dm⁹ G13^(b9) C⁹ A7^(b9) Dm⁹ G13^(b9) C⁹ A7^(b9) Dm⁹ G13^(b9) C⁹ A7^(b9) Dm⁹ G13^(b9)

Final system: Cmaj9

Zef ÇOBA

**“OPERA” DHE “KENDEMI”
NË LIBRAT E STUDIUESIT FERIT BALA**

Pedagogu i kantos Ferit Bala, ka vendosur të sfidojë çdo pengesë dhe vështirësi, duke u treguar i palodhur në punën serioze për të përmbushur plotësisht misionin e tij. Megjithëse prej vitesh gëzon moshën e pensionit, ai punon në qetësinë e punës studimore, duke i sjellë kryesisht artistëve të rinj dhe opinionit publik, një lëndë me vlera të veçanta. Përvoja e tij si këngëtar dhe në mënyrë të veçantë përvoja e gjatë pedagogjike në fushën e kantos, kanë sjellë në dinamikën e laboratorit të tij, një eksperiencë që kërkon ta vendosë në altarin e dijes, për t’i shërbyer në tërësi mendimit studimor të fushës që ka lëvruar, e në mënyrë të veçantë studiuesit shqiptar të kudo ndodhur, e opinionit publik në tërësi.

Duke e zhvilluar aktivitetin kryesor në qytetin e Shkodres, njëkohësisht edhe qyteti i tij i lindjes, ai ka vendosur në tryezën e punës pedagogjike e studimore dy institucione të rëndësishme, të cilat me kalimin e viteve vetëm janë konsoliduar, për të përforcuar bindjen se në këto dy kolona qëndron edhe suksesi i shkollës sonë vokale kombëtare:

1. Përvoja botërore në studimin e vokalit dhe përsosjen e teknikës vokale, si dhe krijimtaria muzikore botërore e shkruar për këtë instrument.

2. Përvoja kombëtare e pasur me larmi e stile tradicionale të interpretimit vokal të krijimtarisë popullore, dhe arti i kultivuar.

Arti i këndimit, siç dihet është mjeti më i pasur për të transmetuar në mënyrë shumë organike gjuhën e shpirtit. Si i tillë, ka të bëjë me ndjeshmërinë, psikikën, natyrën, historinë, vlerat e jetës të një populli që jeton në një trevë të caktuar, në një krahinë, të një kombi apo në tërësi të shoqërisë njerëzore. Në këtë vështrim edhe Shkolla e jonë e Kantos, ka përgatitur artistë të aftë për të interpretuar me vetëdije e profesionalizem muzikën vokale të kultivuar, dhe i ka shërbyer në tërësi edhe evidentimit e konsolidimit të artit të këndimit tradicional të të gjitha trevave shqiptare. Këtë dukuri profesori Ferit Bala, e ka mbajtur parasysh dhe e ka realizuar në vitet që drejtonte degën e kantos në Shkollën “Prek Jakova”, si dhe e ka afirmuar edhe me mendimin profesional të shfaqur në punën studimore.

Sipas dëshmisë së tij, që në vitin 2000 kur ishte në emigracion, fillon e plotëson fletët e librave që na paraqiten të përfunduar, me diapazon

shumë të gjërë për operan. Sukses i operas si krijimtari e gjini muzikore, në punimin e Ferit Balës, nuk është parë i shkëputur nga eksperiencia njerëzore e përdorimit të tingullit vokal si mjet artistik komunikimi, deri tek nivelet më të larta studimore e shkencore shumëshekullore, për njohjen e zotërimit të këtij instrumenti të pasur muzikor. Çështje, të cilat i ka trajtuar pjesërisht edhe në librat që ka botuar ndërmjet këtyre viteve. Po ashtu është vepruar edhe për evidentimin e të gjitha gjinive muzikore të aplikuara në shekuj e në vende të ndryshme për instrumentin e vokalit, e terminologjitë specifike të përdorura.

Katalogu i këngëtarëve lirikë shqiptarë, paraqitet shumë i gjërë dhe i realizuar me portrete e profile të plota, të pershkuara me kujdes me të dhënat kryesore për secilin prej tyre. Ai zë fill me nismëtarët, ato që ngriten bazat e shkollës së këndimit në Shqipëri, e përfshin deri këngëtarët e afirmuar vitet e fundit, me sukseset e tyre në teatrin e operas në Shqipëri, Kosovë dhe në skenat prestigjioze të botës. Ky katalog, jep një paraqitje të admirueshme dhe të mbush me kënaqësi të veçantë. Nga njera anë është tabloja me hapësirën e artit dhe kulturës botërore në Shqipëri, nga ana tjetër artistët shqiptarë përkrah emrave më të shquar lirikë botërorë, protagonist në veprat më të famshme të literaturës operistike. Sukses i këngëtarëve shqiptar në skenat e botës, shembull i shkelqyer, model edhe për aspiratat tona kombëtare, **është përshkruar me dokumentacion të pasur**, realizëm e ilustrime fotografish, të cilat autori i ka siguruar me durim e këmbëngulje.

Për t'i sherbyer mirë çështjeve studimore mbi vokalin, kur ndalon tek «Pedagogjia vokale në shekuj», me vend autori nënvizon nocione filozofike mbi domethënien e tingullit vokal, këndimin e këngën në tërësi. Citon mendimtarë, filozofë, psikologë, studiues, muzikologë etj., me definicione të rëndësishme e bindëse, për të arritur sipas studimit të tij tek kuptimi i sotëm, se kënga është *”modulimi i zërit sipas ligjeve të intonimit, të ritmit, të frazeologjisë, të ngjyrës dhe të shprehjes së ndjenjave njerëzore.”*

Historia njerëzore e përdorimit të zërit, mundësive shprehëse të tij dhe e studimit të teknikës vokale, në përmbledhjen e Ferit Balës vjen e plotë që nga kohët e hershme, në Mesjetë, tek lindja dhe zhvillimi i operas, e deri tek kohët moderne. Janë prekur e trajtuar stilet e interpretimit, format e gjinitë muzikore të lindura e të praktikuara për vokalin, si në lëvrimin e artit tradicional në vende të ndryshme të botës, ashtu edhe për artin e kultivuar. Janë shpjeguar format e gjinitë muzikore komplekse si Oratori,

Mesha, Rekuemi, Kantata etj., që i paraprinë lindjes së teatrit muzikor, Operas. Janë trajtuar gjërësisht shkollat e ngritura në vendet e ndryshme e përfaqësuesit më të spikatur të mendimit studimor, që me vlerat e punës së tyre e sukseset rrezatuan dije e art, me të cilat u bë e mundur që të lindin vepra monumentale, e të ngrihen në vende të ndryshme të botës trupa prestigjioze, të cilat kënaqin e mahnisin spektatorët me forcën e madhe shprehëse.

Në kapitujt e fundit jo rastësisht ndalon tek Shkolla Shqiptare e Kantos dhe Figura të Shquara Pedagogjike Shqiptare, sepse pedagogu i kantos e studiuesi Ferit Bala me këtë përmbledhje voluminoze, i dëshmon lexuesit e studiuesit shqiptar, angazhimin serioz dhe përgjegjësinë e tij, për t'i sherbyer artit e kulturës sonë, e në *mënyrë të veçantë shkollave të kantos* të kudo ndodhura në hapësirën shqipëfolëse.

Kam kënaqësinë t'i uroj prof. Ferit Bala shëndet, jetë të gjatë, e t'i shpreh mirënjohje e respekt për kontributin që vazhdon të japë.

Smajl BALA

BIBLIOTEKAT FETARE MUSLIMANE NË SHKODËR

Fjala bibliotekë e ka origjinën e saj nga greqishtja e vjetër βιβλιοθήκη, dhe më pas është huazuar në latinishte, e duke përhapur në vijim në gjuhët më të reja evropiane. Në kohët e hershme fjala bibliotekë përdorej për të treguar vendin ose depozitimin (më saktë raft librash), ku ishin vendosur arkivat komunale, ose administrative si dhe të materialeve të këtij lloji, që i dhanë emrin, “bibliotekë”. Më vonë ky emër u shtri edhe për depot e librave letrarë, shkencorë dhe të çfarëdo lloji tjetër. Krijimi i tyre filloi që në shekullin e 6 p.e.r në Athinë prej Pisistratit (shih, Hylli i Dritës VII-VIII, 17, f.616).

Bibliotekat u krijuan (u formuan) për t’i shërbyer njeriut në rritjen e dijeve shkencore, kulturore, fetare dhe në fusha të tjera të dijes. Këto shërbyen me qëllim të rritjes së aftësive prodhuese, në të mirë të çdo gjëje, që ka të bëjë me rritjen e të mirave materiale dhe të dijeve shkencore, prandaj, shpeshherë janë quajtur institucione bamirëse, të vlefshme sa shkollat, ku mësohet dhe edukohet shoqëria njerëzore. Sa më shumë të shtohen institucionet (bibliotekat) e këtij lloji, aq më shumë dije e kulturë do të marrë populli, si dhe ato që i shfrytëzojnë për njohuri të thella shkencore. Bota e qytetëruar e Lindjes dhe e Perëndimit i kanë dhënë një rëndësi të posaçme institucioneve (bibliotekave) të këtij lloji, meqë kontribuojnë për të mirën e shoqërisë. Krahas studimit të librave në sallat e tyre të leximit ato merreshin dhe merren edhe nëpër shtëpi për t’i lexuar e mësuar, me një farë garancie në të holla si një frekuentues i rregullt.

Nga studimet e ndryshme rezulton që edhe shqiptarët, në rrjedhën e kohës ishin dhënë pas shkrimeve, studimeve dhe dijeve shkencore. Këtë traditë shekullore nuk e lënë mangut, por e pasuruan dhe e përparuan me gjithë vështirësitë, nga pushtimet e huaja, dhe rreziqet që kaloi kohë pas kohe vendi ynë.

Të gjithë ato që u morën me shkrime, nga vendasit dhe të huajt, na kanë lënë një thesar të çmuar kombëtar. Këto libra, revista, broshura, gazeta e artikuj të shkruar, të cilat ndodhen nëpër biblioteka, na bëjnë të ditur se kemi patur një traditë në të shkruar.

Studimet e thella shkencore dhe të njëpasnjëshme, të studiuesve na

kanë bërë të ditur se një shumicë e tyre gjindet akoma nën pluhurin e harresës, të një bote që ka vdekur e s' vjen më. Edhe ato pak libra që janë gjetur të strukura (fshehura) në mes të librave të ndonjë biblioteke të vjetër të cilat kanë qenë të ruajtura dhe herë u është dhënë vlerë, e shumë herë janë harruar nga pakujdesia. Një pjesë të rëndësishme në këtë traditë (për të mos thënë krijueset e mirëfillta të kësaj tradite tek ne), zënë padyshim bibliotekat e institucioneve fetare. Në vijim ne do të përqendrohemi në bibliotekat që i kanë përkatur klerit mysliman, që kanë pasur histori dhe ndikim në jetën kulturore të qytetit tonë.

Bibliotekat fetare, për të cilat jemi duke folur, janë administruar nga myftinitë, medresetë, nga mësuesit, myderrizët, hoxhallarë e intelektualë e nga ndonjë tjetër, dhe ishin pronë e tyre. Themeluesit e tyre kishin grumbulluar libra me kujdes, duke filluar nga kodi hyjnor e deri te librat e ndryshëm.

Bibliotekat që herët erdhën duke u shtuar, si në numër ashtu dhe në sasi të fondeve të ndryshëm të cilat i kanë shfrytëzuar nxënësit, studentët, mësuesit, myderrizët.

Sundimi i Perandorisë Osmane, në Shkodër dhe Shqipëri, solli me vete, përveç të tjerave, edhe kulturën islame (ndonëse edhe përpara se të vinin osmanët ka pasur muslimanë në Shqipëri) dhe filloi të përkrahet besimi islam.

Për këtë qëllim u ndërtuan institucione fetare myslimane, objekte kulti, shumë xhami, shkolla, ruzhdije, mejtepe e medrese. Për këtë qëllim nevojiteshin hoxhallarë, mësues dhe myderrizë. Këto institucione frekuentoheshin gjallërisht nga populli, mbasi këtu, në këto shkolla rinia myslimane gjente ushqimin shpirtëror. I vetmi burim që qëndroi si fener e kulturë për popullin, qënë medresetë (për të cilat kemi folur) dhe studentët që dolën prej tyre.

Pas ndërtimit dhe çeljes së Medresesë së Qafës dhe asaj të Pazarit të Vjetër, në Shkodër lindi si domosdoshmëri krijimi i bibliotekave pranë tyre.

Fillimisht ato quheshin *qytyphane*, të cilat patën një fond të konsiderueshëm librash fetar e shkencor. Me kalimin e viteve, me shtimin e numrit të nxënësve e të hoxhallarëve, ato erdhën duke u shtuar në sasi e cilësi, në fonde të ndryshme dhe në lëmenj të tjerë të dijes njerëzore dhe jashtë teologjisë islame, mbasi në këto shkolla, u futën edhe lëndë të kulturës së përgjithshme.

Pjesën kryesore të fondit të këtyre bibliotekave, në hapat e para të

krijimit të tyre e përbënin librat fetarë të dhuruar apo të lënë vakëf, fillimisht nga hoxhallarë, mësues dhe myderrizë të huaj, të cilët dhanë mësim, si dhe nga bibliotekat e pashallarëve të Shkodrës, nga Mehmet Pashë Plaku, Karamahmud Pasha, Mustafa Pasha dhe të tjerë.

Ka të dhëna të dokumentuara që flasin se fondi i bibliotekës së Mehmet Pashë Plakut ia kalonte bibliotekës së Medresesë së Qafës dhe të Medresesë të Pazarit të Vjetër. Këto libra mbanin vulën e pashallarëve Bushatlinj. Se ç'pasuri pati kjo bibliotekë na tregon edhe ky episod: *“Kur i shkonte një njeri i serës së tij, Mehmet Pashë Plakut për vizitë, ai sëpari e shoqëronte në dhomën e bibliotekës. Aty i tregonte mikut se ishte duke parë gjysmën e librave, pasi pjesën tjetër e kishte në pallatin e tij, në Bushat”*.

Përmes vakëfnames të Mustafa Pashës, të vitit 1833 mësojmë se, në ndërtesën me shumë dhoma të Medresesë së Pazarit, biblioteka ishte e vendosur në një godinë të veçantë me dy kate, ku kishte salla studimi, dhoma e rafte për sistemimin e tyre.

Biblioteka e Vakëfit.

Kjo bibliotekë origjinën e vet e ka shumë të hershme. Se kur është krijuar ende nuk dihet, por fillesat i ka që me ardhjen e Perandorisë Osmane. Ajo filloi të shtojë fondet e librave nga persona të ndryshëm, si hoxhallarë, mësues e myderrizë që merreshin me edukimin shpirtëror të besimtarëve, me besimin islam, të cilët filluan t'i dhuronin vakëf bibliotekës. Gjatë viteve ajo u shtua më tepër me fonde të reja. Po ashtu kur ndonjë hoxhë apo mësues besimi ndërronte jetë dhe nuk linte trashëgimtarë, e linte amanet që biblioteka e tij, t'i dhurohet Myftinisë.

Shumica e librave të kësaj biblioteke u trashëguan nga Medreseja e Vjetër e Qafës dhe ajo e Pazarit të Vjetër, por edhe prej dhurimit të bibliotekës së Pashallarëve Bushatlinj të Shkodrës, të Mehmet Pashë Plakut, të Karamahmud Pashës e të Mustafa Pashës, bazuar në vakëfnamen e tij të vitit 1833. Shumica e librave në këtë bibliotekë mbajnë vulën e tyre e cila në fillim ndodhej në Medresenë e Qafës dhe të Medresesë së Pazarit të Vjetër. Më pas kaluan në ndërtesën e Myftinisë Shkodër. Biblioteka pasurohej dhe shfrytëzohej vazhdimisht, si nga Myftinia e Shkodrës, myderrizët, mësuesit dhe nga populli.

Biblioteka e vakëfit i kalonte 3000 volumeve teologjike, jurisprudence si dhe libra të ndryshëm fetar. Aty ndodheshin tekste shkencore mbi fizikën, shkencat e natyrës, matematikës, gjeometrisë, filozofisë, astronomisë, historisë etj. Ndër libra të rrallë ishin, *“Historia e Ibni Haledunit”*, e

përkthyer turqisht, “*Historia e Xhevdet Pashës*”, 12 volume, *Tarihi Vasiv, Tarihi Tabiri*, etj. Prej filozofëve qenë tekstet e autorëve Ibni Sina, Ibni Ruzhdi, Imam Gazaliu, Fahrudini Rrazhi, Majuddini Aribi, etj. Në bibliotekë gjendeshin edhe libra shqip të Tahir Efendi Gjakovës e të Ahmet Pashë Dukagjinit. Librat kanë qënë në 2-3 kopje dhe si bibliotekë popullore, ato nga përdorimi u vjetruan shumë. Më së shumti ato kanë qënë në gjuhët klasike orientale, arabe, turke e perse, si dhe në gjuhën shqipe. Aty gjindeshin libra shumë të rrallë fetarë, të fushave të tjera të dijeve njerëzore, por dhe të kolosëve të letërsisë së Orientit. Për administrimin e tyre kanë punuar intelektualë të njohur, poliglotë të shquar e hoxhallarë, që njihnin me rrënjë e themel këto gjuhë, si Hamdi Bushati, Hafiz Muhamet Kuçiqi, Hafiz Abdullah Bërdica (Neziri) dhe së fundi Hafiz Esat Myftia, i cili punoi edhe mbas vitit 1967, kur të gjitha bibliotekat e institucioneve fetare dhe të hoxhallarëve që patën në shtëpitë e tyre u mblodhën nga shteti në vitin 1967, në bibliotekën e qytetit Shkodër “Marlin Barleti”. Në vitin 1990, ky fond, natyrisht u reduktua, mbasi u ruajtën nga dy kopje për çdo libër. Në vite, nga Myftinia e Shkodrës, fondi iu kalua bibliotekës së Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, ku dhe përsëri lëvizi prej aty në një vend tjetër.

Biblioteka, në Pazar të Vjetër ka qënë pranë Medresesë së Pazarit të Vjetër në një godinë në vete prej dy katesh, me disa dhoma e salla studimi. Me mbylljen e Medreseve, biblioteka kaloi sërish në zyrën e Myftinisë, por thonë se një pjesë e saj kaloi në duart e mësuesve e myderrizve që patën dhënë mësim.

Në arkivin e hershëm të vakëfit ka qënë një vakëfname (dokument që tregon se është lanë vakëf) e cila tregon se biblioteka ishte shumë e moçme (hershme).

Biblioteka është shfrytëzuar edhe nga studiues dhe nga populli për arsye studimi dhe kushdo mund të merrte libra me firmë dhe t’i kthente mbas leximit përsëri.

Biblioteka e Bushatllinjëve

Është shumë e hershme, e krijuar dhe e ideuar nga Mehmet Pashë Plaku. Data e saktë nuk i dihet, por një gjë është fakt, se krijimi i saj ka filluar para se të bëhet veziri i Shkodrës, në vitin 1757 kur Mehmet Pasha ishte student në Stamboll, në akademinë ushtarake. Të dhënat tregojnë se ishte e pasur me fonde të ndryshme librash. Këtë na e thotë shumë të qartë doktori i Bushatllinjëve, Atë Balteza, më parë prift në Kastrat. Ai,

në ditarin e tij, në një episod shkruan, se ç'pasuri kishte biblioteka. "Kur i shkonte per vizitë një njeri, një njeri i sërës së tij, Mehmet Pashë Plakut, ai së pari e shoqëronte në dhomën e bibliotekës që kishte në kala. Aty i tregonte mikut se ishte duke parë gjysmën e bibliotekës, pasi pjesën tjetër e kishte në pallatin e tij, në Bushat" e cila me vonë u soll në Shkodër dhe u administrua dhe u pasurua nga pasardhësit e tij, brez pas brezi.

Siç thamë me sipër, biblioteka kishte një sasi të konsiderueshme librash dhe volumesh, por edhe dorëshkrime shumë të hershme, si ato të vitit 1451, të bazuar në "Tavseri Kuran", ku radhiteshin edhe shkrimet e Aristotelit, filozofit Avicenes e Averroes, histori më të vjetra arabe, osmane e perlat e poezisë persiane, te Seadiut dhe te Siraziut. Këtu ndodheshin edhe histori shqiptare, si të Ahmet Pashë Dukagjinit. Kishte edhe dorëshkrime personale, që lidheshin bukur me kopertina lëkure. Lidhja e tyre në këtë formë tregon shijen e hollë dhe kujdesin e tyre të veçantë për librin. Gjatë viteve biblioteka u pasurua me fonde e libra të shumtë të autorëve të huaj dhe vendas. Biblioteka arriti të ketë mbi 3000 volume, ku afro 2/3 ishin nga letërsia jo fetare, që tregon vlerat arsimore e kulturore dhe te gamës së preferencave të interesave të intelektualëve të sundimtarëve Bushatllinj. Librat mbanin firmën dhe vulën e pashallarëve.

Për këtë bibliotekë ka shkruar albanologu i njohur austriak, Ippen, në librin e tij, " Shqipëria e Veriut ". Po kështu kanë shkruar, Gazmend Shpuza dhe Ali Basha, të cilët i kanë bërë një përshkrim mbi pasurimin e fondeve dhe të vlerave të saj.

Në vitin 1833, bazuar në sehatnamen e Mustafa Pashës, bibliotekën ia dhuroi Medresesë së Pazarit të Vjetër. Me mbylljen e medresesë fondi i disa librave të bibliotekës i kaluan bibliotekës së vakëfit të Myftinisë Shkodër. Një pjesë e vogël, prej 150 librash shkuan në bibliotekën Kombëtare, në Tiranë. Nën kujdesin e drejtorit të Bibliotekës Kombëtare, Aurel Plasari ky fond u ekspozua në javën e "Trashëgimisë Kulturore Europiane në Tiranë". Ekspozēja tregonte për vlerat e saj kombëtare që mbante, si një bibliotekë private kombëtare e hershme, me fonde të shumtë librash që ajo ka pasë, që në kohën e Mehmet Pashë Plakut e më vonë nga trashëgimtarët e tij. Ekspozita u vizitua nga shumë intelektualë e persona të veçantë të cilët u njohën vetëm me një pjesë të vogël librash të saj dhe të thesarit kombëtar të bibliotekave.

Biblioteka e Medresesë se Qafës dhe të Pazarit të Vjetër.

Krijimi i tyre është i hershëm dhe ka filluar njëheri me ndërtimin e Medreses së Qafës, rreth viteve 1760-1770 dhe me vonë të Medresesë së

Pazarit te Vjetër, nga Karamahmut Pasha. E gjykueshme është te themi se me çeljen e Medresesë më të hershme në Pazar të Vjetër, e cila edhe kjo mund të ketë pas biblioteke. Bibliotekat u krijuan nga ndërtuesit e tyre, të cilët vazhdimisht u blenin libra dhe e pasuronin me volume dhe fonde librash. Pasurimin më të madh biblioteka e Pazarit të Vjetër e pati në vitin 1833 nga Mustafa Pasha, i cili ia dhuroi bibliotekën e tij, e bazuar nga vakefnamja e tij. Shumica e librave u sollën nga bota islame në gjuhë të huaja arabe, persiane e turke. Shkrimtari anglez, Urqurhart, në veprën e tij “T.E.V spirit of the East “ shkruan: *“Mustafa Bushatliu qe njeri studioz dhe kishte mëkembur një bibliotekë me libra frengjisht dhe turqisht, të cilin në fund ia fali vakefit të Shkodrës”*. Bibliotekës, në vitet e hershme, ka pasur raste që i dhuroheshin libra, nga hoxhallarët apo ish student të kësaj medreseje të cilët, linin amanet, që mbas vdekjes, biblioteka e tyre personale t’i kalonte bibliotekës të medresesë. Më vonë, mbas vitit 1848, Mustafa Pasha dha fonde për ndërtimin e godinës së bibliotekës. Ajo u ndërtua përballë Medresesë të Pazarit të Vjetër, në skajin e djathtë, duke hyrë te xhamia e madhe (Xhamia e Kullukhanes S.B). Më parë se të ndertohej biblioteka, librat ruheshin në një vend të veçantë në bexhisten, në rafta (dollape) të veçantë, bazuar nga vakefnamja e Mustafa Pashës, ku ndër të tjera thuhet: *” Mbasi të zbriten shpenzimet për riparimin e dyqaneve, etj, nga të ardhurat e vakëfeve të përmendura do të paguhet rojtari i bibliotekës, që do të ndërtohet”*. Në vakëfname shkruhet: *“ Tepricat do të ruhen më parë për ndertesën e bibliotekës që do të ndërtohet edhe për t’i paguar detyrën e caktuar vjetore kujdestarëve të asaj biblioteke”*.

Me këtë kuptohet dhe del e qartë interesi i pashait në përhapjen e diturive të atdhetarve të vet. Ai edhe jashtë shtetit nuk rreshti ta pasuronte këtë bibliotekë sa ishte gjallë, deri në vitin 1860. Ndërtesa e bibliotekës ishte dy katëshe me dhoma dhe salla ku mbaheshin librat dhe vende studimi për lexuesit. Fillimisht, u emëruan dy kujdestarë të cilët ishin të detyruar të zbatonin rregulloren e bibliotekës.

Në vitin 1848 kur, Mustafa Pasha ishte vali në Edrene, formuloi vakëfnamen e tij dhe e deklaroi solemnisht para një shumice dëshmitarësh e personalitetesh vendore, që ishin prezent në sallën e pallatit të guvernaturës së Edrenesë, duke thënë: *“Po le vakth të gjitha librat e bibliotekës sime, që kam lanë në Shkodër të Shqipërisë e që janë të vulosura me vulën time edhe të rregjistruara dhe të rujtura në depon e veçantë. (Në këtë kohë nuk ka qenë e ndërtuar ende ndërtesa e bibliotekës). Për ato libra kam vu kusht, që pikësëpari : mbi çdo libër duhet të shkruhet çmimi i*

caktuar ndershmërisht prej një grupi të ylemave, në të holla sermi. Kur ndokush dëshiron të marr një libër për studim në shtëpi, ai person do të parapaguaj, të paktën 1/3 e çmimit si peng, pa u paguar ajo shumë, libri t'i mos i jepet. Së dyti : Ylematë e qytetit do të zgjedhin 2 kujdestarë, të parin e të dytin për librat e bibliotekës. Këto do të subvencionohen prej myrte veliut nga të ardhurat e vakëfeve të mia". Në vakëfname flitet edhe për lënien e pasurive të tjera dhe veprimet se si duhet zbatuar. Me mbylljen e medresesë, me vendim të Kongresit III Mysliman të Shqiperisë, biblioteka i kaloi kryemyftinisë të Shkodrës. Siç duket rregullorja që vuri Mustafa Pasha nuk u zbatua. Nga pakujdesia e kujdestarëve, të cilët lëshonin libra në duart e të tjerëve pa i siguruar. Ato ranë në duart e të tjerëve pa u kthyer asnjëherë dhe humbën e u harruan. Ka pasur raste që marrësi ka vdekur dhe libri është zhdukur. Në vitin 1912-1913, një pjesë e saj u dogj dhe u plaçkit nga ushtria malazeze, një pjesë e saj, siç thuhet, shumë libra janë parë nëpër dyqanet ushqimore, të djathtit në Pazar të Vjetër. Pjesa tjetër e librave i kaluan bibliotekës të vakëfit. Nga ky fond një pjesë e tyre u morën nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Hafiz Sulejman Myrtja, për ta pasuruar bibliotekën e Komunitetit Mysliman.

Biblioteka Këlliçi (Myftiej), në lagjen Qafë (Tabake)

Kjo bibliotekë ka qenë një ndër më të vjetra dhe më të hershme në Shkodër, e krijuar nga Hafiz Hasan Këlliçi, në vitin 1230 hixhri, i cili ishte kadi zyrtar i Shkodrës dhe kishte tërhequr simpatinë e gjithë banorëve të Shkodrës pa përjashtim. Ishte njeri studioz e inteligjent. Ky nëpunës i gjendjes civile, gjyqtar, e kadi (siç i thoshin në atë kohë), për vetë funksionin që mbante ju desh një përgatitje e mirë. Për këtë qëllim, si njeri i ditur krijoi këtë bibliotekë. Me këtë kadi filloi hapat e parë të saj, si një bibliotekë më të vërtetë serioze.

Pas vdekjes së Hafiz Hasan Këllicit, bibliotekën e trashëgoi nipi i tij, Jusuf Efendi Tabaku, i cili edhe ky si gjyshi i tij veproi për të mirën e popullit të Shkodrës dhe gëzonte simpatinë e banorëve të qytetit dhe të rrethëve. Ai shpesh herë me anën e fjalës kish bindur pashallarët osmanë që të mos i cënojnë të drejtat e popullit. Jusuf Tabaku e trashëgoi këtë bibliotekë dhe luajti një rol të rëndësishëm në pasurimin e kësaj biblioteke.

Shtëpia ku ndodhej biblioteka ka qenë nën kalanë "Rozafa", në lagjen Qafë (Tabakë) dhe pranë lumit Drin.

Biblioteka u pasurua shumë, por më vonë, filloi të dëmtohej. Në

shënimet që ka lënë Jusuf Efendia, mësojmë se: “një rrufe që ra në depot e municioneve të kalasë dogji dhe shtepinë e këtij dietari të lartë musliman të Shkodrës”, që pastaj u bë Myfti i Shkodrës deri në vitin 1904, kur vdiq. Ai la përshkrimin se: “Me 8 të muajit Qanuni Evele, ditën e diel në orën 3 allaturka të vitit 1290 xhybehaneja që u gjend, në kala të Shkodrës mori flakë, nga një rrufe e mndershme me të ndezun të municionit u bë zhari krejtësisht dhe shtëpia e jonë mbrenda së cilës mbaroi gjithçka. Unë dhe djali i jem pështuam 5 veta të tjerë sharruen zhar në atë zjerm. Gëzoshin paqen e Zotit. Bashkë me teshat e shtëpisë e shumta e librave më mbaruen. I madhi Zot ma shpërblejt në kohën që shpërblehen tana punët.”

Nga ky përshkrim i tij kuptohet se Jusuf Tabakut nuk i shpëtoi gjë, po edhe ne rast se i shpëtoi gjë këto i mori lumi Drin dhe ajo që shpëtoi u mblodh prej tij dhe u ruajt në bibliotekë, me afro 2000 volume në gjuhën arabe, turke, persiane e pak frëngjisht. Më pas trashiguesi i kësaj biblioteke qe Hafiz Esat Myftia, i cili e sistemoi në bazë të inventarit të vjetër të lënë nga Jusuf Efendia. Ato i ndau dhe i sistemoi në 30 grupe ose lëndë të ndryshme gjithë librat e bibliotekës së tij, si filozofi, teologji, theosofi, letërsi, gramatologji, gjuhë shqipe dhe pak frëngjisht, lëndë të lidhura ngushtë me fenë islame.

Nga inventari që ka lënë Jusuf Efendia, biblioteka përmbante këto libra, në këto lëndë: 1. Tefsire = Interpretime të Kur’anit. 2. Texhvit = si shqiptohet Kur’ani, tematika e Kur’anit. 3. Kiraet = si shqiptohet Kur’ani, fonetika e Kur’anit. 4. Hadis = Fjalë profetike. 5. Meuiza = Predikime. 6. A-Kaid = Teologji. 7. Hiqmet = filozofi. 8. Fikh = Udhezime feje. 9. Fetava = Gjykime. 10. Usuli Fik = Baza e fikhut. 11. Feraiz = Përpjesëtim pasurie mbas vdekjes. 12. Tessavul = Misticizëm. 13. Meanij = Litaratyrë. 14. Bejan = Retorikë. 15. Nahv = Sintaksë. 16. Urus = Rima, rrjedh-vjersha, zbukurimi i fjalës. 17. Sarf = Etemologji e fjalëve arabe. 18. Lugat = Fjalorë të ndryshëm. 19. Mantike = Logjikë. 20. Adab = Avokaturë. 21. Tarih = Histori. 22. Qimia = Kimi. 23. Hisan-Mendese = Matematike (numeratore), gjeometri, trigonometri. 24. Xhografia = Gjeografi. 25. Mytemviat = të ndryshme. 26. Mexhmua = Përmbledhje. 27. Astolab = Astronomi. 28. Shqip. 29. Frëngjisht.

Veç librave biblioteka ka pasë edhe shumë dorëshkrime të moçme, njëri prej të cilëve kishte një rëndësi të veçantë (të posaçme) “Vehbije”, shkruar nga Tahir Efendi Gjakova i njohur me emrin Tahir Efendia i Madh. Kjo bibliotekë mbas librave me shume vlerë, mbante edhe dy tahte astronomike të Hoxha Tahsinit, të botuara në Paris ne vitin 1284 (Hixhri).

Një pjesë të librave është e kuptueshme se kanë qenë edhe të Jusuf Efendisë, i cili mbasi i dorëshkruante ato i lidhte vetë me karton, kështu që formonte volume me radhë. Në këtë bibliotekë ka qenë dhe një nga dorëshkrimet e tij mbrenda të cilit përmbante shumë ngjarje me rëndësi historike, si psh. datat e qeverisjes të pashallarëve, me emrat e tyre. Herë herë tregon edhe ndonjë ngjarje me karakter historik si dhe vetjak, etj.

Simpatia e mbarë popullit të Shkodrës që pat për Jusuf Tabakun e tregoi me rastin e rrënimit (djegies) së shtëpisë, ku menjëherë pas ngjarjes i shkon në ndihmë (këtu përfshi dhe katolikët) dhe më plot respekt i ofruan këtij të fundit, një shtëpi të pajisur me gjithcka, ku të donte, ndër lagjet e tyre të qytetit Shkodër.

Më vonë, siç ka thënë Hafiz Esat Myftia, në lidhje me krijimin e kësaj biblioteke se: *“Biblioteka themelet e para të saj i vuri me të përmendurin Hasan Efendi Këllici.”* Për datë s’kemi dokumenta, vetem dimë mbas të nipit të tretit brez simbas një dorëshkrimi që dokumenton duke e datuar rrënimin e parë të shtëpisë si edhe të bibliotekës. Ka datën 1290, të vjetit rumi.

Me vonë biblioteka ka pësuar përsëri dëmtime nga një djegie tjetër. Dëmtimin më të rëndë e pat nga shteti, në vitin 1967, kur u mor prej tij dhe shumica e librave kaluan në bibliotekën “Marin Barleti” të qytetit të Shkodrës, së bashku me bibliotekat e tjera fetare të hoxhallarëve, të cilat u sistemuan në këtë bibliotekë nga Hafiz Esat Myftia i emëruar enkas për këtë qëllim.

Megjithatë sipas thënieve të Mit’hat Myftisë, administrues i mëvonshëm mësojmë se, *“një pjesë shumë e vogël e librave u fshehën nga ne, në vende të padukshme të shtëpisë. Por për fat të keq edhe këto u dogjën, me djegien e shtëpisë pas demokracisë.”*

Biblioteka Myftiej në lagjen Ndocej

Biblioteka Myftiej në lagjen Ndocej radhitet ndër më të hershmet, më të vjetrat dhe më të pasurat e rrethit të Shkodrës. U krijua rreth 300 vjet më parë, nga Salih Efendia i Madh, dhe u trashëguua dhe u pasurua brez pas brezi, mbasi kjo familje trashëgoi hoxhallarë dhe myftilerë, të cilët u interesuan direkt për ruajtjen dhe pasurimin e saj, me fonde të reja librash. Siç thuhet, që herët pjesën më të madhe të librave, Salih Efendia i solli nga Stambolli me karvan me kuaj, të cilit ia dha vet Mustafa Pasha për t’i sjellur në Shkodër, kur e pranoi propozimin e tij për t’u emëruar myderriz në Medresën e Qafës. Ai u emërua myderrizi i parë shqiptar, së bashku

me Myrteza Shoshin, të cilët dhanë mësim, në këtë Medrese. Biblioteka numëronte mbi 2000 volume librash fetarë, filozofik, e të jurisprudencës shkencore, letrare dhe artistike, të shkruara të gjitha në gjuhët orientale dhe më vonë në shqip. Biblioteka me vdekjen e Salih Efendisë u pasurua gjithnjë nga pasardhësit e tij Salih Efendia, Tahir Efendia të cilët qenë myfti të Shkodrës, dhe hoxhallarët e tjerë të kësaj familje.

Më vonë trashëguesi i kësaj biblioteke, qe nipi i tij Salih Myftia. Edhe kjo si bibliotekat e tjera u muer nga shteti, në vitin 1967, ku një pjesë e saj u sistemua në bibliotekën “Marin Barleti” të Shkodrës.

Është për t’u përmendur edhe biblioteka e Medresesë të viteve 1944-1947, në lagjen Zdralej, ku më parë qe Mejtepi i Mollah Medos, e cila u krijua nga biblioteka e Vakëfit, por edhe nga ato të dhuruara nga familjarët e disa hoxhallarëve, siç qenë psh. të familjes Hafiz Jusuf Kelmendit, Sheuqet Ymeraj, etj, fakt të cilën na e vërteton një letër e Myftinisë së Shkodrës, me anë të cilës falenderohet kontributi i tyre.

Biblioteka ka pasur dhe ka edhe në objektet e kultit, në xhami, teqe etj. të cilat shfrytëzoheshin nga besimtarët. Ato ruheshin e mirëmbaheshin nga Myrte Velia dhe nga myezini i xhamisë.

Në qytetin e Shkodrës ka pasur me dhjetra e qindra mini-biblioteka familjare, në familjet e hoxhallarëve dhe të intelektualëve të kohës. Qenia hoxhë me shkollë të nivelit të medreseve apo të shkollave të larta teologjike të kryera jashtë shtetit, të intelektualëve me një kulturë të gjerë, të kohës nënkuptonte dhe qënien e bibliotekave të vogla, por me libra të shumtë. Ato pasuroheshin herë pas here dhe sistemoheshin në rafte, dhoma e studio të veçanta. Fondi i tyre shtohet pa ndërprerje, si në numër të bibliotekave ashtu dhe të fondeve të librave që mbanin në to. Më kanë treguar familjarët e këtyre hoxhallarëve, se në vitin 1967 u janë marrë nga shteti librat dhe dorëshkrimet me sharabajka apo karroca.

Thuhet se në Shkodër ka pas mbi 25.000 volume vetëm në gjuhët klasike orientale dhe mbi 10.000 volume nga bibliotekat private familjare.

Gjovalin ÇUNI

NË GJURMËT E NJË LETERKËMBIMI

Në bibliotekën françeskanë “Át Gjergj Fishta”, vend të rëndësishëm ze edhe epistolari i çmuem i shumë figurave të njohuna intelektuale të Botës shqiptare.

Mes tyre asht edhe epistolari i Át Luigj (Jakob) Marlekës, (1906-2002), professor i glotologjisë në disa universitete italiane, me figurat e njohuna shqiptare dhe të hueja. Janë me dhjetra letra, shkëmbime mendimesh të lira dhe origjinale; ásht shpirti i trazuem por shpesh edhe i lumtun i njatýne njerëzve, mërgimtarë, që, edhe pa dashtjen tonë kanë hý në historinë e shqiptarve.

Mes letrave që ndodhen në fondin Marleka, një vend të rëndësishëm zânë edhe letrat që i ka dergue atij, Ernest Koliqi. Lëterkëmbimi kâ nisun qësh në vitet ‘50 të shekullit që sapo kaloi, e do të vijonte deri në kalimin në amshim të jetës, së Luigj (Jakob)Marlekës .

Epistolari i analizuem zhvillohet mes dý njerëzve që ndonëse me pozicione të ndryshme sociale ishin intelektualë të shquem të kulturës shqiptare. Letërkëmbimin që Koliqi e cilësonte: “shfrim dhe shtysa”, ndonëse i njëanshëm (njohim vetëm letrat e Koliqit drejtue L. Marlekës), pa dýshim mund të cilësohet si një mjet për t’i folë shqiptarëve.

Miqësia e Koliqit me Marlekën filloi diku rreth vitit 1952. Shtysa e vendit ku lindën, të kenunit nga Malet, por edhe bashkëpunimi politik dhe kulturor i Koliqit me françeskanët, ishin faktorë që sollën miqësinë e përjetshme dhe vlerësimet reciproke për njëri-tjetrin.

Në letrën e 9 korrikut 1953, Koliqi shkante : *“Ne mjerisht nuk njihena mirë bashkë, s’patëm rasë të kemi shpesh të përpjekun, por megjithëatë më duket si me ju pasë mik të vjetër. Shof dhe ndjej të tjerë françeskanë qi më nderuen me miqësinë e tyre, P. Gjergji, Antoni (të cilin e kishim të afërt tuj pasë t’amën Çin Koliqen) e shoh padër Benardinin me të cilin na lidhë një miqësi vëllazënore”*.

Miqësia me fratin ishte shprehje e vendosmërisë nga ana e Koliqit për me vijú veprën françeskanë, por edhe qëndresën e intelektualëve shkodranë të goditun fuqimisht nga diktatura, që siç shkruente Koliqi: *“.....kishte mbyt ajkën e fisit shqiptar, kishte lëndue në themel traditat e vlefshme”*. Shpirti i trazuem i Ernestit, *“rrethue me hije të deknish, me hije*

të dashtuna, që na kanë lanun..” gjente prehje në letrat drejtue fratit.

“*Ju- i shkruente- Koliqi, në letrën e datës 6 maj 1953, Marlekës- keni dhënë dëshmi të kjarta se jeni në naltësinë e misionit që ju ra përsipër t’a merrni. Bashkë do t’a ndjekim radhën, bashkë do t’a vazhdojmë veprën, bashkë do të rropatena t’i mbajmë emnin Shkodrës*”.

Studimi i tansishëm i letërkëmbimit mundet me u ndâ, në tri periudha: letërkëmbimi në fushën politike që përfshin vitet 1950-1960; letërkëmbimi intelektual i viteve 1960-1970, dhe së fundmi ai shpirtnuer, “i pleqnisë dhe i vetmisë”.

Letërkëmbimi në fushën politike ishte mâ tepër informues. Në atë ndjehej nevoja e një gjykimi nga ana e L. Marlekës për veprimet e tija, por dhe dëshira e pa arritun për me e tërhjekë atë (L. Marlekën- shën. im) në politikë. Në letrat e tija, Koliqi shpesh herë i drejtohej Marlekës, tuj e grishë të angazhohej në politikë në rolin e ndërmjetësit në diasporën shqiptare.

E megjithëse figura politike e Ernest Koliqit ishte mjaft e debatueshme edhe në rradhët e mërgatës shqiptare, si një figurë mes patriotit, por edhe kolaboracionistit, në letrat e tija E. Koliqi i pohonte haptazi Marlekës, se nuk kishte me hjekë dorë nga politika deri at’herë kur në Shqypni të formohej desidenca shqiptare.

“*Shtyllat u damtuen, ato qi mbeten në mos u damtojshin mâ përtej i ka ligshTue vuejtja, burgu*”- shkrunte ai.

Veprimtaria politike e Koliqit, në letrat e drejtueme Marlekës, mundet me u cilësue si veprimtaria e një njeriu të besuem, me mjaft ndikim te autoritet italiane, sidomos në rastet e deportimeve të kundërshtarëve të komunizmit shqiptar nga Jugosllavia drejt Italisë.

Përmes letrave del në pah ndihma që Koliqi jepte, me ndërmjetësinë e organizatave të ndryshme politike që vepronin në Evropë, intelektualëve shqiptarë në veprimtarinë e tÿne shkencore dhe letrare.

Në letra ndihet edhe dëshprimi që shkaktonte përçamja e thellë e diasporës shqiptare siç ishin: denigrimi i njipasnjishëm i figurave politike, abuzime, mungesa dëshirash për bashkëpunim etj. Në letrën që mbân datën 2 dhetuer 1953, ai shkruente: “*Komiteti (nënkupto Komitetin Shqipëria e Lirë – shën. im) përmban turli-turli njerëzish, por ka edhe burra të njoftun për atdhetari*”.

I ndodhun në krye të grupit “Indipendentist”, Koliqi interesohet për me tërhjekë klerikët në Komitet. Ata duhej të merrshin drejtimin kulturor të diasporës. Tuj mbetë në të njëjtën fushë, në letërkëmbim pasqyrohet edhe përçamja e thellë e mërgatës shqiptare të Amerikës. Në 60-të vjetorin

e gazetës “Dielli” të Vatranëve, Koliqi i thirrur prej një pjese të tyne, por edhe i kundërshtuem nga një pjesë tjetër, mes të cilëve edhe Arshi Pipa, i dalluem për ndjenjat antifashiste, kje i detyruem me mbajtë fjalën përshëndetëse i rrethuem prej njerëzish të armatosun, kryesisht malcorë e mirditorë, që rrejshin jetën e tij.

Mbas një aktiviteti mjaft të gjatë politik, në moshën 50-vjeçare edhe Koliqi, âshtu si shumë të tjerë, detyrohet me pranû që ishte mjaft e vështirë me u kuptû prej shumicës, dhe kësisoj duhej me ju kushtû mâ tepër jetës intelektuale dhe familjare.

Kjo pakënaqësi shprehej në letrën e datës 29.VI.1955, gjatë pushimeve që bânte në Sperzano Albola, kû mes të tjerave, në një poezi kushtue Át Luigj Marlekës shkruente:

N'shekull plot mashtrim/ Me ba mirë s'kurseva mundin tim/ Tue fitue si shpërblim/ Anmiq t'pafarë e t'shame/ E shpifje e mnû si t'ishem/ Ma bakaqi nder bakaqi/ E ma i poshtmi n'Shqipni....

Periodha e dytë e viteve 1960 -1970 ishte një periudhë e pareshtun letrash mes dy personave që bashkëpunuen në fushën akademike. Impenjimet në këtë fushë ishin thuejse të njëjta. Koliqi ishte për shumë kohë titullar i “Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqype”, n'Universitetin e Romës (1949); drejtues i punëve në botimin e vëllimeve: “Studime dhe tekste”; themelues i revistës “Shêjzat”(Le Pleiadi); shkrimtar e mik i shumë shkrimtarëve, ndërsa Marlekaj, kryeredaktor i revistës “Zani i Shnandout”; bashkëpunëtor tek “Hylli i Dritës”; doktor në letërsi, lektor gjuhës dhe i letërsisë shqipe në universitetet e Milanos, Bolonjës e Barit; autor i disa studimeve dhe përkthimeve.

Me këshillat, sugjerimet dhe autoritetin e tij, Koliqi do t'a ndihmonte Luigj Marlekën, por njëkohësisht edhe do të gëzohej, për arritjen nga miku i tij të fitimit të licencës në vitin 1955, për me dhânë mësim në çdo universitet të Italisë. Në fond gjinden mjaft letra, në të cilat Koliqi i kërkonte një seri impenjimesh shkencore, “mikut të tij të mirë”.

Ndihma e Marlekës mund të ishte një shërbesë e mirë kryesisht në fushën e letërsisë brenda organizimit “Shërbimi Shoqnor e Kulturor”, ngritur në vitin 1957, nga refugjatët shqiptarë, si pjesë e organizimit politik: “Komitetit Shqipnia e Lirë”.

Emnimi i L.Marlekës në universitetin e Barit u prit me entuziazëm nga Koliqi. Me një elegancë intelektuale dhe qytetare në shkrimin e letrave, në një të tillë që mban datën 13 .XII. 1961, mes të tjerave ai shkruente:”*Pritni urimet e mija për emnin e stërmerituem n'atë Universitet, të cilin afërsija*

me Shqipnin e ban shumë të randësishëm. Jam gezue per Ju e shpresoj se edhe aty ka me u krijue një qendër e gjallë albanologjike”.

Në vitet '60, bazu në rritjen e interesit për albanologjinë nga mjaft autoritete shkencore gjermane, Koliqi e thërret për me bashkëpunue në këtë fushë.

Në letrën e datës 26.11.1965, mbështetë në aftësitë e Marlekës ai i shkruente: *“Edhe ju padre duhet me hý në valle. Në jetën universitare shkohet përpara me botime, natyrisht serioze. Ju keni cilësitë e duhuna me dalë në rend të parë”.*

Koliqi, ia besoi Marlekës pasunimin e bibliotekës së Institutit të Studimeve Shqiptare në mënyrë që ky organizëm, ashtu siç theksonte Koliqi, të kthehej në qendër të gjallë të studimeve albanologjike.

Bashkëpunimi mes miqve nuk mungoi as në fushën e studimeve akademike. Marlekaj ishte i ftuem nga Koliqi në të tana kuvendet shkencore, si: konferenca, seminare, përkujtimore etj. Prej leterkëmbimit mësohet pjesëmarrja e L. Marlekës në evenimentet më të randësishme të zhvillueme në Itali, siç ishte râsa e festimit të 90-vjetorit të lindjes së Fishtës, ku emni i tij gjendej mes organizuesve, krah G. Valentinit, Z. Skiroit, F. Solanës, D. Gjeçajt, M. Camës etj.

Si një vëzhgues i vemëndshëm i zhvillimeve kulturore në Shqipni, Koliqi për shumë probleme kërkonte ndihmën dhe mendimin e Marlekës.

Tuj diskutu për një shkrim të fundit të vitit 1961, në revistën ”Nëntori”, ku Koliqi shahet dhe të tjerët mohohen, në letrën e 27.XII.1974, ai shkruente Marlekës për mundësinë e hartimit të një antologjie me *“shënjime bibliografike e copa të zgjedhuna autorësh (janë afro 60 të mëdhaj, tytanikë) qi kuqaloshët e Tiranës i dëbuen nga Historija e Letërsisë, përpilue prej tyne. Asht një trashigim i Shenjtë që duhet ruejtë e kalue breznit e ardhshme. Unë po më dha Zoti shëndet e fuqi me këtë nisjativë, që ja dedikoi miqve të dekun (e shumta e të cilëve miq të përbashkët) due me mbyllun ciklin e jetës s’eme kulturore”.* Në punën që do të niste Koliqi kërkon të dhana nga vetë Marlekaj, që e cilësonte si pjesë e antologjisë shqipe.

Vend të veçantë në leterkëmbim zen edhe qëndrimi i Koliqit ndaj gjuhës së unifikueme, tuj e cilësue atë si mjet kundër *“pasunisë shpirtnore të grumbullueme në letërsi të Veriut”*

Luigj (Jakob) Marlekaj ka kenë gjithnji i pranishëm dhe i vlerësuem në të tana revistat e botuemme nën drejtimin e Koliqit. Në letrën e datës 20.01.1955, lexojmë: *“Ju (nënkupto Marlekën) me stil bashkoheni me P. Vincensin (V. Prendushi-shën. im) në kjarhtësi me Justinin (J. Rrota-shën. im)”.*

Koliqi dhe Marlekaj kanë bashkëpunue edhe në fushën pedagogjike. Janë entuziastë për punën e tyre, por shpesh herë shprehin edhe rezervat e pakënaqësitë. Ndonëse tepër të rralla nuk mungojnë as letrat konfidenciale për fëmijët e profesorëve, studentë të kurseve të tyre.

Në letrat e Koliqit vend të randsishëm zënë përpjekjet për t'a mbështetur financiarisht, por edhe për t'a nxitë Marlekën në punën e tij për gjurmimin e shkrimeve të vjetra të shqipes.

Nxitja intelektuale e L. Marlekës bahej në kuadrin e kërkesave që Koliqi i drejtonte, organizmave të aleatëve për mbështëjen financiare të mërgimtarëve. Disa letra të gjenduna në fond janë bilanc i asaj që është arritë dhe shpresohet, se ka me u arritë edhe në ardhmen. Në letrën që mban datën 13.10. 1974, Koliqi i shkruente: *“Mos qit menjëanë përgatitjen e ribotimit të transkriptuem dhe me shënjime sa ma të begatshme të vëllimit “Rivale Romanun & Specvlvm Confessionis” (P. Budi, 1621)*

Letra e citueme është shprehje e dëshirës intelektuale, por edhe e përpjekjeve të gjata të Marlekës, në fushën e glotologjisë që ka me u realizue me veprën madhore: *“Pietro Bogdani l'Albania del suo tempo”*, botuar në Bari në vitin 1989.

Faza e tretë e trajtueme ndër letra është padyshim faza e mplakjes dhe e trishtimit. Vdekja e grues, Vangjelisë (Vuçani- shën. im) e trishton shumë Ernesti. Ndonëse ka dy fëmijë, ata janë larg dhe shihen gjithnji e më rrallë, vetëm në rasha festash.

Vujtjet personale Koliqi dëshiron me i nda me mikun e tij të vjetër. Mbas një vizite në SH.B.A-të, në letrën e 24 dhjetorit të vjetit 1969, ai shkruente: *“Kthimet tesh në shpinë tonë, janë pak trishtim. Nuk gjej Vangjelinë qi delte tuj ndejë te dera (njifte dorën teme, nji krizmë e vetme) për me më përqaftue”*.

Në disa letra Koliqi i rikthehet trishtimit që të sjell vetmia, aq ma tepër kur gjendesh i sëmundë. Vdekja e Koliqit në vitin 1957, shënon një detyrim për L. Marlekën, atë të përjetësimin të veprës së mikut të tij, E. Koliqit.

Miqësinë e hershme me mikun e tij, Marleka e mishiron përmes punës së studentave të tij. Në punimet e diplomave të drejtueme nga Luigj Marleka, pjesa më e madhe i kushtohen studimit dhe analizës së veprave të mikut të tij, Ernest Koliqit.

Në mbyllje, marrëdhانيت Koliqi-Marleka, ishin më së pari njerëzore, të sakta dhe bujare. Vetë Marlekaj i mbrujtun me cilësitë e vendlindjes së tij, u kujdes gjithnji, që *“... të huejt t'a shihnin shqiptarin si njeri me karakter dhe pa hile”*.

Xhahid BUSHATI

... DHE IKU “I VIZATUAR NGA HËNA”...

- Në kujtim të poetit Frederik Rreshpja-

1. Trëndafilat...

Kam filluar ta kujtoj më shpesh Frederikun ose Fredin, siç e thërrisnim për shkurt.

Kujtoj at’ rrugicë që mbante emrin e patriotit Dedë Gjo’ Luli. Jam kthyer shumë herë, e shumë herë do të kthehem, e do të kthehem, aty. Hera ime e parë ka qenë, kur isha gjimnazist.

Ajo rrugicë ka fiksuar në kujtesë ecjen e shpejtë e pa zhurmë, shpesh vetmitare të Fredit. Ajo ecje, si një gjurmë poetike, mbarte në vetvete kontrastin mes njohjes dhe mosnjohjes së këtij njeriu me shtat të vogël e të mençur, nga banorët e kësaj rrugice. Mbartte deri diku edhe indiferencën e tyre për komshiun e heshtur. Nuk e di pse kjo frazë më kujtoi psikologjinë e mentalitetin e amullt, të mbylljes në vetvete e të asaj ‘matanë murit’, të shumë personazheve të tregimeve realiste e moderne, të trishtuar dhe ekzistencialë të E. Koliqit, për Shkodrën dhe mjedisin e saj, me gjithë nënshtresa që i njohu aq mirë.

Bota e Frederikut, nuk përkonte me ‘botën’ e lagjes ku banonte. Planeti i tij poetik, edhe pse shpesh i përjashtuar, tharmin, thelbin e tij e kishte ‘Në këtë rrugicë...’, ku Fredi me përulësi dhe nderim kishte vënë shpirtin e vet si një gur qëndrese, lavdie e jetese, e më vonë si muranë. Kishte vënë lirikat si dëshmi, tregimet, legjendat dhe përrallat, si ëndrra magjiplote.

Ai me talentin dhe personalitetin e tij të spikatur po i shtonte gjurmët e vlerat rrugicës së tij të dashur.

Është një rrugicë-muze. Rrugicë plot histori, ku personalitete të fuqishme, gjurmë të thella lanë aty.

Është një rrugicë, që në të shkuarën e largët të saj kishte fiksuar gjurmët e atdhetarit, poetit e dramaturgut Hilë Mosi, i cili pati mbjellë aty, shumë e shumë vite më parë, një shëgë për djalin e tij të vdekur. Historia e tij, akti i tij na kujton motivin e dhimbshëm të baladave të moçme, ku vdekja animizohet përmes një simboli, ku personazhi bëhet i gjallë dhe i përvetshëm.

Është një rrugicë, ku shkeli e la gjurmët e tij personaliteti i shquar poliedrik, piktori, arkitekti, fotografi... Kolë Idromeno.

Gjurmët e kësaj rrugice, janë pjesë e lavdishme e historisë së kulturës së vendit tonë.

... E pikërisht në këtë rrugicë, shëtiti, u mbujt dhe lulëzoi fëmijëria e më pas personaliteti i Frederikut. Ishte një fëmijëri e vështirë, por me një përkujdesje të ëmbël mëmësie.

Ishte një fëmijëri brenda mureve të gurta të asaj rrugice, ku lulëzonin e gjallonin kopshte trëndafilësh.

Ishte kjo rrugicë dhe fëmijëria, që do të linin gjurmë të pashlyeshme në kujtesën dhe shpirtin e tij, të cilat do të përbënin më pas kodet e poezisë së Fredit. Ishte fëmijëria në këtë rrugicë, me një botë plot ëndrra, ku edhe ‘ngjyrat ishin shpirtra’, siç shprehej Fredi, për të cilat poeti trishtohej e qante, vetmohej dhe ndiente mall, se ishte fëmijëri e “vizatuar” përmes ngjyrave të trëndafilave, të pëllumbit, të lotit të nënës e të harresës. Në kontekstin poetik simbolika e trëndafilinës të “shenjën” më të thellë, shenjën më të spikatur, aq sa bëhet personazh i poezisë së tij, kthehet në simbol. Po në këtë kontekst, në të shumtën e herës humbet përftesa e elementit zbukurues, si kuptim i parë etimologjik. Kështu që, prej tij përftojme rrjedha të tjera, e të tjera ngjyrime. Nga i gjithë cikli me poezi, “rrënjën” e ruan ajo me titull “Trëndafilat e fëmijërisë”. Veç shpirtëzimit të fëmijërisë së autorit, jetesa e tyre bëhet e mundur në saje të lidhjes ngushtësisht me mitiken. Ato sjellin në mënyrë biblike një modelim përrallor, të cilin e gjejmë si truall në krijimet dhe në kujtesën popullore. Autori shkon më tej. E shenjtëron, duke pohuar: “*Në fund të kopshtit banonte mitologjia / në një Olimp prej trëndafilash.*” Kjo figurë gjatë gjithë ciklit përfaqësohet në dy mënyra: a) përdorimi i njëjësit për shumësin për t’i dhënë më shumë frymëmarrje, dhe b) përdorimi i shumësit për njëjësit për t’i dhënë konkretësi. Si në rastin e parë, ashtu edhe në rastin e dytë, raportet e konkretes me abstrakten sjellin dhe ruajnë imazhe e përfytyrime ireale. Spektri i krahasimeve, me objekt të vetëm dhe në qendër trëndafilin, (që nga psherëtimat, e deri te drurët e vdekur) nuk është gjë tjetër veçse vibracion i gjendjes shpirtërore të Fredit. Në finale, pasi ka mbartur gjatë gjithë “udhës” përjetime poetike, mendoj se nuk bën gjë tjetër veçse përvijon dukshëm elemente të profilit të tij. E thellon atë. Në komunikimin artistik, këtë gjendje emocionale, këto akuarele nga bota floreale, i ruajnë dhe i shprehin “me fanatizëm” e bukuri të rrallë faqe të tëra të romanit “Zëri i largët i kasolles”. Një roman që është i dallueshëm në letërsinë tonë shqipe për tiparet e një proze poetike. Një roman që kritika letrare pati shumë ngurrime dhe nuk ishte aspak entuziaste në gjykimet e saj. Zakonisht kështu ndodh prej këtyre

soj dogmash, të cilat në mënyrë diktatoriale e të sforcuar i krijoi metoda e realizmit socialist.

Nuk gaboje po të them se poezia e Fredit lulëzoi së pari te ai gjelbërim spontan që shfaqej në oborrin e tij, gjelbërim që i ngjante një mrekullie të pashoqe. Kjo mrekulli i ngjante një pikture surreale, veçanërisht netëve kur hëna vinte mike e hidhte rrezet e saj lodërtare. Kjo mrekulli kishte “çelur” edhe në shpirtin e Fredit dhe ruhej po e tillë në lirizmin e poezisë së tij. Lulëzoi edhe te ato trëndafila, që u bënë metafora ëndrrash e dhembjesh, heshtjesh e pikëllimesh. Çelën, lulëzuan e kurrë s’u thanë në vetminë poetike të Fredit; u dha jetë talenti i tij. Jo më kot “Në pjesën dërmuese të vargjeve të lirikave të Frederik Rreshpjes, jepet një dramë e brendshme përvëluese. Lirizmi i këtij poeti rrëshqet prore brigjeve të revoltës. Poezia e tij është përplot shqetësime, shqetësime të mëdha që buronin nga përditëshmëria e jetës së tij. Vargjet e lirikave të Rreshpjes rrëfejnë botën e tij personale, me ngarkesa shqetësuese shpirtërore. Duke gjurmuar finesat e artit të Rreshpjes, pahetueshëm rrëshqasin në të dhënat e tij jetëshkrimore, që përbëjnë këpujën lidhëse: krijuesi-vepra e tij.¹

Veçanërisht vitet e fundit, në konceptin filozofik e poetik të krijuesit Frederik Rreshpja, metafora e VETMISË u bë domethënëse dhe e dukshme, gjalluese, ripërtëritëse, duke u bërë lajtmotiv i krijimtarisë tij, siç ishte edhe lajtmotiv i jetës së Fredit. Shpërfaqja e tij e plotë u duk në vëllimin e fundit poetik “Në vetmi”², vëllim që i ngjan një testamenti lamtumire, që është në fakt një gur i çmuar dhe i rrallë në fondin e lirikës shqiptare.

Duke pasur si objekt e shqyrtim librin e fundit, metafora e VETMISË gjen mbështetje në dy rrafshe:

a) në lirikën surreale, e cila përbën dhe tiparin themelor të krijimtarisë së tij.

b) në spontanitetin, i cili përbën një nga veçoritë e personalitetit poetik dhe krijimtarisë së tij me theks veçanërisht në lirikën moderne.

Anatomia e poezisë së Rreshpjes është pazgjidhshmërisht e lidhur me jetën e tij. Një simbiozë në dukje e çuditshme, por e vërtetë. Aty duhet t’i kërkojmë fillesat dhe bulëzimet poetike, për të qenë më të qartë për rrugën e tij krijuese që, nga libri në libër sillte befasi e imazhe të reja, dukuri, vlera e risi. Njëkohësisht, për të kuptuar përse metafora e VETMISË dhe mistikja, si element i krijimtarisë poetike shëtiti aq lirshëm në hapësirat e tij

1 Eshrefi, Isak: ARS, revistë letrare shqiptare, Nr.2 (40), 27. 08. 2006; shkrimi: Lirizmi i Rreshpjes, brigjeve të revoltës.

2 Rreshpja, Frederik: Në vetmi, (poezi të zgjedhura), Arbëria, Tiranë, 2004.

poetike, duhet të kërkojmë po aty, tek jeta. Po aty do të gjejmë përgjigjen se përse gjatë kësaj hapësire gëlojnë simbole të fëmijërisë, të dhembjes, të fatit e të vdekjes.

Unë nuk mund t'i harroj ato vite, se ato vite jetojnë ende brenda meje, kur unë kam ngrënë te ajo sofrë e drunjtë, nga duart dhe zemra e nënë Drandes. Ishte nëna e Fredit. Një grua fisnike. Çdo gjë fisnike kishte tek ajo grua malësore!

E kam parasysh si tani atë grua të pashme, të gjallë, shumë e shoqërueshme dhe mirëbërëse. Ajo kishte lindur për të qenë e tillë.

Vështrimi i saj, Fredit gjithëherë i sillte një paqe hyjnore. Kurse vështrimi i Fredit ishte një kurorë nderimi për nënë Dranden.

Di, që ajo qepte bukur rrobat kombëtare, posaçërisht ato të trevës së Shkrelit, ku kishte lindur. Ishte mjeshtre e vërtetë. Mjeshtër i vërtetë ishte edhe Fredi në këtë zeje, që ia trashëgoi e ëma. Mjeshtër, në qepjen e xhamadanëve. Shihet dukshëm që lidhja nënë-bir ishte shumë e fortë, edhe ndikimi prej saj gjithashtu. I lidhte një dashuri e madhe.

Prandaj poeti Rreshpja i kushtoi figurës së nënës, dy poezi, "Vendlindja e nënës" dhe "Elegji për nënën". Ndonëse të para në këndvështrime të ndryshme, ato fokusohen në një pikë të përbashkët, në dhënien e dimensionit artistik të portretit të njeriut më të shtrenjtë, më të paharrueshëm e më të dhembshur për Fredin. Poezitë nuk mund të kuptohen pa njëra-tjetrën, janë plotësim i njëra-tjetrës, përparësisht në dhënien e detajeve për të plotësuar "biografinë" dhe cilësitë e saj. Në komunikimin artistik, prania e poetit ndjehet dukshëm. Ngjan si pikë loti.

Në poezinë e parë figura e nënës është shkrirë me Vendlindjen, ku si arketipe të poetit gjejmë fjalët kyçe, shkallë drite, greminë, druri i lahutës, pasqyrime krojesh, përmes të cilave njëjtëson adhurimin dhe përjetësimin e figurës së Nënës dhe Vendlindjes të shkrira në një, si sinonime të njëra-tjetrës.

Poezia krahas përjetimit lirik, ruan si dekor edhe ca tise të lehta tragjizmi, përzies me flade dashurie.

Në poezinë e dytë pikëllimi i poetit pikon mbi elegjinë që ka thurur me plot dhembje. Një pikëllim që përlij pesimizmin e poetit. Momentin tragjik të ikjes së nënës, e cila ka një hapësirë homerike, Fredi e shpreh: "Ishte një botë e tërë kur ishe ti / por erdhi kjo vetmi e madhe që fshin gjithçka".

Poezia, ndonëse ruan tiparet e elegjisë, në mënyrën e ndërtimit të saj strukturor, me përdorimin e anaforsë e të apostrofit përmes kadencave e

ritmeve, na bën të ndiejmë e të pohojmë se ajo është parë dhe konceptuar, duke u bazuar mbi shfaqjen dhe natyrën tradicionale të vajtojcave të Veriut. Ky rit në këtë poezi mbart vlerën e mitit, sepse është parë në tre aspekte: në atë të trishtimit, të madhështisë dhe të përjetësimit.

Sado që askurrë, sa herë që lexoj e rilexoj me ëndje poezitë e Frederikut, nuk gjej diçka që do ta doja ndryshe, diçka që s’shkon apo ka vend për përmirësim, e as sesi diçka për të mos u pranuar, por ai shumë herë gjatë rrugës së tij krijuese u ndje i papranuar, se i tillë qe për kritikën e para vite ’90... Prandaj unë nuk mund të harroj atë ditë maji. Frederiku sapo ishte kthyer nga Tirana. Më tregon se, sapo kishte marrë recensionet e librit më të ri që kishte çuar për botim, atë me titull “Në këtë qytet...”. Unë në fakt nuk i lexova recensionet, por të gjitha shënimet me laps, i lexova një për një. E shumë pikëpyetje mbi vargje, pashë. Shumë pikëpyetje mbi metafora e mbi guximin krijues të Frederikut. Të shumta. Tani ishin përballë njëri-tjetrit, bota e shënimeve me lapsa të zinj si nata të recensentëve dhe bota fisnike, e lirizmi poetik i Frederikut. “Po tani, ç’do të bësh?!”- e pyeta. Frederiku qeshi. Tundi një herë dorëshkrimin në ajër dhe nuk u përgjigj. Paso i një heshtje, që mua m’u duk se edhe ajo heshtje ishte poetike.

Më pas libri me vjersha dhe poema “Në këtë qytet” u botua në vitin 1973. Me një format të vogël. Nuk e di çfarë ka ndryshuar Frederiku në atë libër? Çfarë ka hequr, e çfarë ka shtuar. Sa i ka marrë në konsideratë mendimet e recenzentëve, por për sa e njoha, për një jam i sigurt. Ai nuk bënte kompromise. Frederiku, me talentin e tij, kishte ardhur në fushën e artit për të bërë art, jo kompromise. Dhe i tillë mbeti, ndonëse shumë herë e kryqëzuan, por artin e tij, jo.

Ashtu si në lëndën artistike të krijuesve të Qarkut të Veriut, edhe te poeti Rreshpja, nuk mund të kuptohej krijimtaria e tij, pa pasur një motiv për qytetin e tij të lindjes. Dhe e mishëroi atë, në poezinë me frymëmarrje poeme të titulluar “Në këtë qytet”, që shoqërohej me një shënim: “Për Shkodrën, ku kam lindur.”

Duke vështruar poezinë, duke mos e larguar nga koha dhe klima kur është shkruar, ia vlen të thuash se ajo është ndërtuar përgjithësisht mbi një raport intim të poetit me të. Përmes lajtmotivit “Qytet i dashur”, legjenda dhe historia, përceptimi i tyre në kohë, evidentimi i detajeve artistike si produkt e përgjithësim i realiteteve të caktuara historike, shoqëruar si dekor me plot ngjyra lirike, tenton t’i bëjë portretin këtij qyteti, që siç

thotë edhe vetë: “Figura jote lëviz, si një portret që s’e kapin dot penelat / dhe para meje telajua e poemës mbetet e bardhë.”

Dashuria, dhembja, malli e lëvizja mbeten “gurët e themelit”, ku ngrihet godina e kësaj poezie të ndjerë, me varg të lirë si element përcaktues, jo vetëm formal por edhe shtresor, për të mos qenë i ngurtësuar, por si tendencë drejt një shtrirjeje dhe frymëmarrjeje sa më hapësinore.

Vite më vonë, poeti Rreshpja do ta ketë përsëri Shkodrën motiv të krijimtarisë së tij. Tani ai ka kualitete të reja artistike për të sjellë, pasuri imazhesh e teknikash. Vargu i tij është më i ngjeshur e i mbarsur me figura artistike të gjetura që të mahnisin. Ndjeshmëria e fantazia flasin për një botë poeti për t’u pasur zili. Lirikat e tij, tani, janë modele.

Kam patur fatin të shoh edhe fletët e bardha të shkruara me stilograf, me një shkrim jo të rregullt që dukej sikur mbartëte trishtimin apo vuajtjen e tij. Nuk e harroj edhe zamin (ngjitësin) me furçë në atë shishen e vogël, me të cilën bënte korigjimet dhe vendoste herëpashere shirita letrash të shkruara. Kjo tregonte për një laborator krijues, të cilit shkrimtari i kthehej dhe i rikthehej shumë herë në kërkim të përsosmërisë.

Në atë kohë po i jepte “shikimin” e fundit dramës “Andrra për tokën”, e cila pati fatin të shfaqej vetëm një natë. Një dramë në premierë. Fati e deshi të jem spektator i saj. Ishte një dramë që lindi, u rrit dhe vdiq brenda asaj premiere. E trishtueshme dhe e dhimbshme! Më pas u bënë disa mbledhje. U bë zhurmë. Zhurmë, sepse shumë telashe u nxori konvencionit dhe simbolikat e asaj drame. Shumë telashe i nxorën edhe poetit. U mbyll perdja e asaj shfaqjeje-premierë, për t’u mos u hapur më. U mbyll edhe loja brilante e shumë aktorëve që interpretuan në atë pjesë, që njëri e quajti ‘fatlume’, por...

Drama “Andrra për tokën” pati fatin e shfaqjes së vetëm një nate. Edhe pse teatri e ruajti në kujtesën e tij, mbi të ra pluhuri i harresës. Po drama tjetër, ajo me titullin “Myku i kaltër”, ç’u bë? Vallë, nëse jeton sot, në ç’sirtar ndodhet?.. Sa do të kisha dashur ta shihja, qoftë edhe një herë. Sigurisht në skenë!

Nuk e di pse më lindi ideja t’i kërkoja librat e Frederikut atëherë në bibliotekën e qytetit. Punonjësja më tha t’i kërkoja në skedar. Ashtu bëra. I kërkoja te germa R. Nuk i gjeta. Mendova t’i kërkoj te germa Rr, se mos ndoshta kanë ngatërruar germën e parë të mbiemrit. Edhe aty nuk gjeta gjë. Pyes punonjësën: “Përse nuk janë?!” Ajo e qetë më përgjigjet: “Mos ka qenë i ndaluar?” “Po, në kohën e diktaturës” – i përgjigjem. “Atëherë, janë në fondin e ndaluar! Kështu që e kam të vështirë t’i gjej” – më përgjigjet

përsëri punonjësja e qetë.

Mbeta i habitur, por më shumë i hutuar. Dhe i fola vetes: “Ende të ndaluara veprat e tua, Frederik?! Ende i “ndaluar” liriku më i madh i letërsisë shqipe?!.. Dhe ku është ndaluar... në vendlindjen e tij, për të cilën poeti Rreshpja këndoi: “E dua këtë qytet / ...o, më merr malli për vjeshtën tënde, për gurët! / kur jam larg teje / më merr malli për këngët që këndojnë erërat e tua netve”. Si është e mundur që më të dashuruarit e saj ndalohen?!

Në çast m’u kujtua se ka qenë një vit i zi kur Fishtës së madh ia hodhën eshtrat në lumin Drin, se ka qenë një tjetër kur Migjenit ia thyen mermerin e varrit, e pjesë nga busti i tij ia copëtuan në mënyrë çnjerëzore, Por ka qenë edhe një tjetër, kur Koliqi i la porosi në formë testamenti së bijës: “... shko lum bija n’at Shkodrën time / ... Atje si t’gjindesh, sytë e mi / n’ball tandin do t’hapen! / N’ty kena me u ngjall, / për mue ti Shkodrën / për mue sodite / mallin e sjellun n’vorr / shafite, / . Pak si rrallë kam lexuar një perlë të tillë për Shkodrën!..

Kisha kohë që nuk e kisha takuar Fredin, sepse nuk jetonte më në qytetin e lindjes. Fati e deshi të takoheshim përsëri në hotel “Argenti”, ku çdo ditë pi kafënë. Kur kamerieri më solli kafënë, më tha, si padashur: “Janë mbledhur ca njerëz rreth një njeriu të çuditshëm, atje te tavolina e fundit. Thonë për të se është poet...”

Kamerieri iku. Unë ktheva kokën dhe nuk e pata të vështirë të njihja mikun tim të vjetër. Më kishin thënë për Fredin, se vinte herëpashere në qytetin e tij të lindjes, por nuk kisha patur fatin ta takoja. Gjithnjë e mirrja vesh pasi ai largohej nga qyteti. Ndoshta vinte për t’u çmallur, ndoshta për të kërkuar fëmijërinë e tij, që tani “jetonte” edhe ajo “Në vetmi-në” e moshës e të poezisë. Vinte në qytetin e dashur, për të cilin Fredi-poet kishte shkruar: “Bekoje këtë qytet që lindi nga një grua”.

U takuam, u takuam, u përqafluam me mall. Ashtu si unë, edhe Fredi qau.

Po e vështroja me dhembje e mall. I mbështetur në karrige, me kapelën republike si gjithmonë e me jelek. Ishte dobësuar. Sytë ruanin ende gjelbërim maji e magji të veçantë smeraldi. M’u dukën si sy të pafajshëm fëmije. Më foli me një zë prej përralle. Më kujtuan përrallat e tij brilante në libri i fundit “Aventurat e fundit të Gishtos”. Nuk e di pse më kujtuan edhe Andersenin..., apo përrallat e mbledhura prej At Donat Kurtit.

Folëm gjatë. Njerëzit përreth rrinin si të hutuar dhe nuk e kuptonin dot. Ishin jashtë botës së tij. Ai fliste dhe një metaforë natyrshëm çelte si

një gjethe nga shpirti i tij tashmë i lodhur e i drobitur. Kishte qenë takimi i fundit, sepse pas një muaji ai ndërroi papritur jetë.

Kam filluar ta kujtoj më shpesh Frederikun ose Fredin, siç i thoshim për shkurt...

Kujtoj kompozimin e ngjyrave brenda poezisë së tij, bashkëjetesën në parregullsinë e rregullsisë së tyre, tingullin e zërit të aedit me jehonën e lashtë të mitit, aromën lirike dhe autentiken e saj, finesën, elegancën, poetiken, magjinë e një mjeshtri që na dhuroi një poezi të papërsëritshme me botën e saj të haluçinacioneve që e krijojnë vetëm poetët e mëdhenj, dhe dehem prej vargut të tij. E kjo dehje më sjell ndërmend rrëfimin e poetit dhe studiuesit Përparim Hysi në një shkrim për Frederikun, ku thotë: “Dua të shpjegojem: jam mëdyshuar e mëdyshuar, në është **alien** Frederik Rreshpja, dhe përgjigjja vjen vetvetiu: Po **alien** ka qenë se nuk ka se si të jetë ndryshe. I shikon poezitë që na ka lënë si trashëgim dhe nuk ke se si të mos mahnitesh. Të lënë me gojë të haptë se nuk gjen notë që ta vlerësosh. Njëra poezi më e bukur se tjetra. Dhe thotë diku **alieni Frederik**: ‘Unë shkruaj se jam i trishtuar’. Pra, ky poet unik, sikur e shtrydh me duar trishtimin që kurrë nuk iu nda nga pas, si një atavizëm apo si një apendiks. Çudi është se nga kjo ‘shtrydhje’ vjen e buron një verë e pastër poezie, nga e cila nuk ndahesh dot.”³

E përsëri zhytem në kujtime, e me kujtimet më përzihen vargjet e Fredit: “Na zuri mëngjesi në udhë / moj kapelja ime e vjetër.”, e më duket se po ec përsëri krah tij dhe i dëgjoj pëshpërimën: “Unë vetëm nga një vizitë u bëj stinëve, o njerëz, / kurse zemrën e kam tek ju.”

2. Një lirikë për lirikun...

Perëndimi si vrasës me thika ndër duar,
Nëpër dhimbje, nëpër hënë,
Tërë jeta ime, si këto ujëra nën thika
Por mua asnjë vdekje nuk më zë.
(F. Rreshpja “Por mua asnjë vdekje nuk më zë”)

Poeti Frederik Rreshpja vdiq në vetmi. Ca miq, sigurisht të paktë në numër, mbi varrin e tij vunë ca lot kurorash a kurora prej loti, atë ditë shkurti.

3 <http://www.fjalaelirë.com>; 16.02.2015

E shkurti erdhi përsëri. Iku, siç ikin muajt. Më saktë data 18 erdhi dhe iku... Ajo do të vijë në ritualin e saj të zakonshëm, por pa Frederikun. Në fakt, Ai erdhi, por i heshtur dhe i vetmuar siç e kishte zakon. Sigurisht, miqtë e atëhershëm, të paktët miq, përsëri do ta kujtojnë me mall. Ndonjë lirik, vetmitar, i pasionuar pas vargjeve të Fredit, do të pëshpëritë ca vargje mbresëlënëse, sa do të bëjë një mimozë të çelë në kujtim të poetit. Kujtesa dhe memoria do të janë gjithmonë të gjalla për miq që e deëshën dhe e vlerësuan aq shumë. Përsëri diçka do të gdhendet për të. E di, ngadalë. Ato shenja dhe konvencione, herë të dëshifruara e herë jo, do të jenë faqe të reja e plotësuese, sigurisht të pakta, të testamentit poetik të Fredit.

“tani erdhi ora të vdes përsëri...” – thotë në një poezi Fredi. Iku nga kjo botë, në heshtje dhe i vetmuar, liriku më i shquar i letrave shqipe, mjeshtri i lirikës moderne, së cilës i dha zërin e vet të magjishëm e fluror, tronditës e të pikëlluar.

Poeti Shpëtim Këlmendi thotë për poetin Frederik Rreshpja: “Shumë njerëz nuk e dinë në është gjallë, disa të tjerë shfryjnë se ai e meriton fatin që ka, po për një gjë të tillë janë të detyruar të bien dakort: që ai është një nga poetët më të mëdhenj të poezisë shqipe. Fredi po shmanget pak e nga pak, ashtu si dielli që prihet kah perëndimi pa i interesuar nëse ndokush asht i kënaqun apo mirënjohës për ngrohtësinë e tij. Po perëndon. Dalëngadalë po hyn në legjendë. Pa zhurmë, pa tërsëllimë, pa bujë, pa lavde. Thjesht po shkon në periferi të vëmendjes sonë të ngarkuar me gjëra të rëndësishme, ashtu siç shkoi De Rada, Serembe, Mjeda, Lasgushi, Asllani. Nesër do ta kujtojmë me respekt. Do t’ia festojmë praninë e tij të dikurshme midis nesh. Nesër do shfaqet e do zhduket lirisht nëpër kujtesat tona. Nesër...”⁴

Statusi i lirikës së Fredit lidhet me përjetimin tragjik të fatit të tij. Është një përjetim solid, bashkëveprues dhe i ndërsjelltë për të vazhduar, përsëri, më tej, që nga imazhet e deri te konceptimi, për të vazhduar më tej nga stilemat drithëruese, te përfytyrimi, dhe edhe më tej, nga raporti i ngjyrave, te ndërtimi i arketipeve.

Peizazhi i endur në vargjet e tij, për nga mënyra e ndërtimit arkitekturor, ruan frymën dhe parafytyrimin poetik të Fredit, për të cilat ka sigurinë e plotë. Në poezinë e tij çdo fjalë është e shenjtë, se di t’i shenjtërojë fjalët! Ato fjalë që kthehen në figura të krijuara nga “uni” i poetit Frederik Rreshpja, janë tiparet, mjetet e shprehjes, emocioni dhe shpirti i tij. Janë përcaktuesit e individualitetit të lirikut Rreshpja.

4 Këlmendi, Shpëtim: Në muzgun e një poeti lirik, f. 7.; Në vetmi (poezi të zgjedhura) F. Rreshpja, Arbëria, Tiranë, 2004.

Metafora e hënës shëtit kudo në hapësirat e poezisë së Frederikut. Ajo është më shumë se një bashkudhëtare, është bashkëjetesë në fatin e poetit. Mënyra e perceptimit, shfaqja e saj, copëzat që zë, pesha që mbart si ngarkesë emocionale, “shenja” që lë si element i kudo- pranishëm, sa në rrafshin horizontal, aq edhe në atë vertikal të krijimit, i bën dritë jo vetëm poezisë, por edhe vetë poetit. Sepse, ashtu siç shprehet ai: “dhe hëna projekton profilin tim në xham. / Kështu do të iki, vizatuar nga hëna”. E me hënën poeti bisedoi gjatë...

Po sjell në vëmendje ato biseda të poetit me hënën për t’u magjepsur me drithërimat e shpirtit të tij.

1. Hëna si dëshmitare e ngjarjes

“Ndoshta shkallët e kësaj nate, deri te Hëna, / Do t’i ngjisnim dorë për dorë”, “Tani te Hëna shkoj i vetëm”.

2. Hëna në ornamentikën e peizazhit

“Hëna mbi lumë vizaton / Një urë për ëndrrat e yjeve”, “Rreth drurëve të galvanizuar me hënë”, “Pikon hëna”, “Hëna ikën nëpër mjegulla”, “Edhe dimrit kur ranë gjethet / pema frushullonte mbi përrrenjtë prej hëne”, “Hënë e artë mesdhetare, / si zemra ime rri varur mbi pemët”, “Hëna po shuhet në pëllëmbët e gjetheve”.

3. Hëna si element tipizues i personazhit

“Vijnë ciganët me daulle dhe me hënë”, “Po kthehen barinjtë por hënën e harruan ndezur në mal”, “Ti erdhe nëpër udhën e hënës”, “Atje hëna ngre shkallë drite mbi gremina”, “Dhe hëna projekton profilin tim në xham”, “Por, e dashur, ç’je hënëzuar kështu?”, “Tani jam bir i hënës, tërë ishujt e tjerë janë të rremë”.

4. Hëna – dhembje, adhurim, mall, shpresë, trishtim, kujtim...

“Mallkuar me dashuri dhe me hënë”, “Për daulle dhe për hënë i trishtuar”, “Hëna e pikëlluar nëpër re”, “Hënë s’ka”, “Por, zemra ime, hëna nuk ekziston, / Që ditën që u shfaqe ti”, “Nëpër dhimbje, nëpër hënë!”, “Tingulli i kabanës, si gjësim hëne”, “... Nga ç’qiell ra tërë kjo dhembje, / Që hënëzoi këtë dimër?”, “Ah, ndofta së mbrami kujtoi me mall / Atë hënë argjendi, korijen e gëzuar”, “Nën një hënë që më do”, “Do desha të shkoja në hënë”, “O Medaur! Bekoje këtë qytet që lindi nga një grua, / Tani që ra hëna e syve të mi”.

5. Hëna si element përrallor e mitologjik

“Për hënë e për magji”, “Shi hëne”, “Me një qiri prej hëne në dorë”, “Hëna dhe zanat fshihen”, “Qiri i hënës në duart e erërave”, “Një hënëz argjendi e larë me flori”, “Kasolle prej hëne!”, “O hënë e shiut, / Bëje një

Iliadë për mua”.

6. Hëna si element tragjik

“Ah, hëna që më vrau mua”, “Nën hënën e një nate të prerë përgjysmë”, “Fshehur nën shira hëne”, “Hëna e shqyer në dhëmbët e vetmisë”, “Dal netëve pa hënë i vetmuar”, “Ndaj më keni parë netëve pa hënë të vetmuar nëpër rrugë”, “Kështu do të iki, vizatuar nga hëna”, “Prerë nga hëna e majit”, “Nën një hënë që nuk di të buzëqeshë”, “Vizatohen në sfond të vetëtimave / Hënëzat që hëngrën dhentë e vjeshtës”, “Kur vdesin hënëzat, kur vdesin yjet”.

E në këtë pemë gjenealogjike të “përpiluar” me mjeshtri nga autori Frederik Rreshpja, ku në trung të saj ka METAFORËN E HËNËS, është e pamundur të mos vësh re hyjnizimin e hënës si hyjni e natyrës, besimin tek ajo, së cilës i falet, e adhuron, i lutet përmes “formulave sa poetike aq dhe magjike rreshpjane”. E hëna shfaqet herë si kult e herë si simbolikë përmes përjetimeve të poetit, por duke ruajtur si gjithnjë universin e saj. Po universi i Fredit ku është?.. Mbase te poezia “Fat” apo te poezia “Kur vdesin hënëzat”, apo...? Ndoshta edhe te këto vargje: “Mirëpo, unë jam pagan i vjetër; / Pa këtë fat të keq nuk ndihem mirë, / çdo njeri e ka një fjalë ku vë kryet / kam edhe unë për prehje dhembjen time.”

Ky ishte Universi i Fredit!..

3. Në shtëpinë e poetit Frederik Rreshpja,

pas 50 vjetësh...

O hënë e shiut,

Bëje një iliadë për mua

Kur të rrëzohet edhe Troja e fundit!

(F. Rreshpja, poezia: “Tors”)

Më shoqëron një shi i imët korriku, që bie e pushon herëpashere si një motiv i bezdisshëm, teksa marr rrugën e “Gjuhadolit” në Sarreq. Kjo rrugë e rikonstruktuar, në imazhin e saj arkitekturor, ka ruajtur portretin e vet me elementet e traditës.

Marr kthesën e parë në të djathtë dhe hyj në rrugicë. Në këtë rrugicë kam ardhur 50 vite më parë. Më duket sikur kërkoj shumëçka... Kërkoj... Edhe gjurmët e hapave të mi mbase kanë mbetur diku... Kërkoj edhe ndonjë kujtim të vagëlluar si një fluturim zogu...

Është po ajo rrugicë. Nuk ka ndryshuar. Rrugicë që nëpër vite e ka kërkuar heshtjen, siç duket edhe sot jeton me heshtjen. Ca dyer të mëdha

që të kujtojnë rikthimin në origjinë dhe ruajnë paqësisht vjetërsinë e drurit. Autoktonë.

Shiu ende më shoqëron... I afrohem asaj porte përmallshëm. Në veshë më kumbojnë vargjet e poetit kushtuar Shkodrës së tij: *“U ktheva përsëri në qytetin ku kam lindur. / Një shi biblik / Lan prej shekujsh gjakun e perandorive të mundura.”* dhe më tej... *“Më ka marrë malli për shirat e tu të qeshur, ...”*.

Edhe pse vij pas një kohe të gjatë, nuk e ngatërroj portën. Por nuk është më ajo e drunjtja. Është tjetër. Me ca silueta si fragmente antikiteti. Bëj të trokas... por nuk është e nevojshme. Dera është pakëz e hapur. Mos vallë më ka pritur mua?... Mos më njohu dhe m’u bë mikpritëse. Gjithçka mund të hamendësoj... Ndoshta... derën e hapi... aventura e fundit e Gishtos...

Ajo rrinte hapur... Unë e preka ngadalë. M’u duk sikur më foli ajo portë e drunjtë me gjuhën poetike të Fredit: *“Lulëzoi druri i portës së vjetër. / Ah, druri i vdekur çeli lule!”*⁵

Hyj aq lehtas, sikur nuk dua të trazoj qetësinë e atij kopshti, të cilit tashmë i mungonte surrelizmi i luleve që të falte dikur. Tashmë kishte lule të tjera ëndërrimtare. Pak së tepërmi ishte zvogëluar kopshti. Sjell nëpër mend përkujdesjet plot dashuri të Fredit për kopshtin e lulet, mënyrën se si si bisedonte me ta... magjinë që i jipnin njëri-tjetrit. *“Këndonin lulet dhe tregonin legjenda... / Ah, tërë trëndafilave të botës do t’u bie në gjunj / Veç ato legjenda s’kam për t’i dëgjuar më kurrë”*. Por, medet, mungonin trëndafilat! Siç duket *‘... janë mbyllur në pikëllimin e vet’ pas ikjes së të zotit. Tani në këtë kopsht imcak shëtit vetëm trëndafilat i heshtjes e i shiut.’*

Pas kopshtit që *‘s’i them lamtumirë’*, ngjit ca shkallë. Në njërën nga dhomat më pret i vëllai i Frederikut, Gjovalini. Është mjek. I pamundur nga ana shëndetësore prej kohësh. Në sytë e tij shoh lodhje dhe një dëshpërim të dukshëm. Nuk mund të lëvizë. Mezi merr frymë. Dëshira për një cigare është e padurueshme.

Teksa flet Gjovalini, ndonëse me ndërprerje, zëri i tij më ngjan si i Fredit. Po ashtu tiparet, po ashtu lëvizjet. Gjovalini jeton me vetminë heshtare, si i vëllai, me kujtimet e të vëllait dhe të prindërve. Rrëfimi i tij ka ngjyra trishtuese dhe të ngadalta: *“Fredit zakonisht punonte natën.*

I vetëm në dhomë. Në qetësinë e natës dhe të heshtjes. Shpesh në prani të hënës dhe të yjeve. Me dritë abazhuri. Nën at’ kurorë drite i shkruante vargjet. Por asnjëherë nuk kam dëgjuar në këtë shtëpi një varg të shqiptuar

5 Rreshpja, Frederik: Në vetmi, (poezi të zgjedhura), Arbëria, Tiranë, 2007; poezia: Druri i portës, f. 27.

prej tij. Kurrë nuk i recitonte poezitë e veta. Ndoshta zakon i tij. Ndoshta ngaqë ishte i thjeshtë. Mbase ka pëlqyer dhe vetminë, miqësinë me të, një miqësi e pafjalë...

Shpesh nga lodhja që i jipte drita e zbehtë e abazhurit, ndizte llampën elektrike. Teksa rrinte syzgjuar gjithë natën, nga dhoma tjetër vinte një zë i butë, që i thoshte: “Fred, fike dritën! Harxhove shumë! Shumë po harxhon, Fred!..” Dhe atij zëri, Fredi nuk i kthente fjalë. Në heshtje fikte llampën, po në heshtje ndizte dritën e abazhurit.”

Dhe kjo histori përmes rrëfimit të Gjovalinit, më kujtoi një histori tjetër të ngjashme, që e pata lexuar. “Pamja e sikletosur e fytyrës sime e bëri të picërronte sytë me qesëndi. – Dua të flasim si burri-burrit. Harroje që jam yt atë dhe më dëgjo. Mos merresh gjë me poezi ti? – tha dhe më vështroi sikur do të më tregonte ndonjë faturë të papaguar. – Po ti nga e di? – belbëzova. – Si e zbulove? - Fare thjesht, - tha babai. – Çdo muaj filloi të vinte një faturë e lartë energjie elektrike. Fillova të shoh se kush harxhonte në shtëpi kaq shumë energji elektrike dhe zbulova se ti e mban dritën ndezur deri pas mesnate. Meqë desha të merrja vesh se ç’bëje, fillova të të përgjoj. Kështu zbulova se shkruan e shkruan vazhdimisht, Kafka më zgjati dorën. (Gustavit, - shënimi im) – S’ke pse turpërohesh nga unë. Edhe mua më vjen një faturë e lartë energjie, - tha ai dhe qeshi. Ndjeva se ndrojtja m’u zhduk krejt”).⁶

Fredi dilte pak, - vazhdon bisedën Gjovalini. - Nuk kish shumë shokë. I pëlqenin karafilat, lulekëmbanat dhe veçanërisht lulet që vështrojnë nga dielli. I pëlqente të pikturonte. Bënte natyra të qeta, portrete. Edhe nudo ka bërë. Ka dhe vizatime. Lapsin e përdorte mirë. Por merrej edhe me skulpturë. Zakonisht bënte vajza me fustane të bardha, simbole dhuratash për martesë. Ishte edhe dizinjator. I shkëlqyeshëm ishte! Por më vjen çudi në ato fletore me vjersha që më kanë mbetur dhe kam ruajtur, është një shkrim i imët dhe i pakuptueshëm. Më ngjajnë germet si hieroglif. Më vjen çudi dhe s’e kuptoj... Mbase kështu ishte shkrimi i Fredit, për të mos u kuptuar nga bota.

Fredi nga natyra ka qenë i ashpër. Dhe kjo ‘ashpërsi’ i ngjante një rrebeshi vere, i cili shfaqet dhe ikën shpejt. Pas tij i zbutet shpirti, qeshte papushim dhe para teje ishte tashmë para një Fred paqësor, i ngjashëm me

6 Janouch Gustav: Biseda me Kafkën (Shënime dhe kujtime), përktheu: Gëzim Qëndro, Dituria, Tiranë, 2012; f. 9, 11.

lirikat e tij. Ky ishte Fredi.

Ne prindërit i kemi pasur malësorë, - vazhdon rrëfimin Gjovalini. - Baba Mark ishte nga Plani i Dukagjinit. Njeri i qetë. Dy herë nuk ka folë. Asnjë tipar të tij nuk trashëgoi Fredi. Nëna, Drandja ishte nga Xhani i Dukagjinit. Ishte inteligjente, burrneshë, e singertë, plot në mirësi në shpirt. Cilësitë e nanës i trashëgoi më së miri Fredi.”

Hyj në dhomën ku punonte Fredi. Rikujtoj portretet e vajzave që ka bërë, rikujtoj dhe nudot. Ndoshta shenjat i la si dashuri, ku “Këndoi bilbili i vetmuar deri në dhembje, / Por askush nuk e dëgjoi zërin e tij, / Sepse i mungoi kafazi. Ndoshta si amanete i gdhendi në shumë tituj poezish, si: “Për një vjollcë”, “Peizash vjeshte”, “Peizash nate”, “Pastel”, “Akuarel”, “Tors”, “Vizatime”. Dhe në këtë vazhdë sjell ndërmend poezinë e Lornës dhe vargjet për të: “Por ti në këtë botë erdhe për mua, jo për qiejtë. / Kemi qenë përherë bashkë, që të rinj, / Dhe tani më le! ... Mua më trishtojnë stinët. Ti e ke ditur, / Dhe me botën më ndan një udhë me kilometra vetmi. / ... Kemi thënë gjëra që s’kanë për t’u kuptuar kurrë. / kemi ecur në tërë shekujt, para piramidave. / Emrat tanë kanë qenë gdhendur / Edhe kur nuk kishim shkëmbinj.”⁷

Hap ngadalë dhe një raft të vjetëruar, ku mola kishte bërë shumë ‘fole’ e plot rrugëza ishin me pluhur druri. Aty ‘strehoheshin’ disa këmisha të Fredit, disa kollare dhe kapelja ‘mbështjellur me dimrin e dhembjes’, që më kujton vargjet e poetit: “Na zuri mëngjesi në udhë. / Moj kapelja ime e vjetër. ... Do të vijnë zogjtë do të bëjnë fole. / Moj kapelja ime e vjetër / ... Dhe ne nuk do të jemi më të vetmuar. ...”⁸

Ky ishte takimi i fundit me Gjovalinin. Do të ishin shënimet e fundit në bllokun tim. Do të ishin edhe shkrepjet e fundit të aparatit në atë shtëpi plot kujtime. Çdo gjë do të ishte e fundit... U largova, aty nga ora 11.00; për të ardhur të nesërmen që të vazhdoja bisedën me të përsëri..., se kështu e kishim lënë... Të nesërmen, me datë 13 korrik, kur unë po shkoja ta takoja ... papritur, u gjenda keq. Pashë letrën e vdekjes dhe fotografinë e tij... Hyra përsëri në atë shtëpi. Tani për ta nderuar për të fundit herë, por... me bllokun tim të shënimeve që s’do të hapej më për ta. As për Fredin, as për Gjovalinin.

Të afërmit e tij më thanë se kishte ndërruar jetë, mbrëmë. Qofsh i parajsës, miku im!..

7 Rreshpja, Frederik: Në vetmi, (poezi të zgjedhura), Arbëria, Tiranë, 2007; poezia: Vdekja e Lorës, f. 30.

8 Po aty: poezia: Dita e gjahtarëve, f. 143.

4. Nanë Drandja

Në vizitën e asaj dite u ndala para portretit të nënë Drandes. U ktheva pas në vite. M'u kujtua kur erdha për herë të parë në këtë shtëpi.

Tani u bënë 50 vjet..! Vështrimin dhe ecjen burrërore të saj nuk e harroj kollaj. As dhe bukën e sofrën që më ka nxjerrë shumë herë me dashuri, nuk e harroj! Eh, nanë Drande, nanë Drande!.. Dhe... më ngjan se dëgjoj zërin e Fredit “Ecën ngadalë nëpër dhomë. / Nganjëherë më pyet për librat që po shkruaj, / Por s’më ka pyetur kurrë pse s’kam shkruar gjë për të. / ... Se nëna e di: / Fjalën e parë në këtë botë ia kam thënë asaj. / Dhe fjalën e fundit në këtë botë asaj do t’ia them.”⁹

Kthehem përsëri dhe qëndroj para portretit në vaj të nënë Drandes. E vështroj. Nuk është thjesht nëna e Fredit, është diçka më shumë. E vështroj përsëri. Ndoshta për të zgjuar ndonjë kujtim të vonuar. Afrohem dhe mundohem të gjej firmën e piktorit. Më në fund ‘e zbuloj’. Është peneli i piktorit Hilmi Tafa, që për fatin tim, është një miku im i vjetër dhe i mirë. I telefonoj dhe takohemi në një nga lokalet e shumta të qytetit tim. Dhe Hilmiu¹⁰ me atë sportivitetin e tij dhe me plot kujtime nga lagjja ku jetuam pothuajse si komshi, nis rrëfimin e tij: “Po... e kam pikturuar. Shpresoj të mos gaboj, në vitin 1981. Ishte vjeshtë. Se si më dukej..., një vjeshtë si në poezitë e Frederikut. E në këtë stinë vjeshte, vjeshta e oborrit ishte e veçantë. Si unë, si nënë Drandja e shihnim me admirim e përmallim, nga dritarja. Kur i thashë se do të pikturoj, ajo m’u përgjigj: “Hajt, ma!” Ishte një shprehje e zakonshme e saj. E përdorte për çdo gjë. Ishte një grua që besonte shumë. E dashur, e varfër. Besnike! Besnike deri në adhurim! Fliste pak, me një zë të trashë. Në at’ shtëpi ajo ishte nanë, babë, shoqe. Ishte njeriu që mbante at’ shtëpi. Ishte shumë e fortë, ndaj dhe shtëpia ishte e fortë, sepse e mbante nanë Drandja.

“Nanë Drande, do të pikturoj. Mos më kundërshto, ” – i thashë për së dyti. “S’jam për resme” – më tha. Mbas shumë kambënguljeve të mia, ajo u “dorëzua”. I vuna mbi kry një shami jeshile me lule të kuqe, pasi ishte e veshun me të zeza. E kujtoj se bluzën e kishte të zezë e pak të hapun. I afrova një stol. Dhe aty u ul. Ndërsa e pikturoja, thoshte herëpashere: “Qy, qy, e shkreta unë! Mos luj me plaken!..” Gjovoja, i biri, i thoshte: “Du me t’pikturo, se du Nanë, me t’pas!..”

E kujtoj... në këtë shtëpi vija pothuajse çdo ditë, Frederiku e kishte adhurim. Bashkë qepnin xhamadana, shamitë me thekë, tirq.

9 Po aty: poezia: Nëna, f. 33.

10 Sipas bisedës e kujtimeve të piktorit Hilmi Tafa.

E kujtoj... edhe oborrit. Kishte plot pemë, si: hurma, shega. Pak shkurre... Një rrëmujë në mënyrën e vet. Drita ishte deficitare. Te cepi i oborrit dilte drita e diellit.

E kujtoj... kur mbarova pikturën, ajo më tha: “Me ndejt, e me pi kafe!” Më thoshte pothuajse çdo ditë. Dhe unë nuk largohesha pa pi kafën e saj. Pastaj bisedonim çiltër. Se zemrën të çiltër e kishte nanë Drandja.

E kujtoj... kur u ulëm përballë njeni-tjetrit, unë në karrigë e ajo në stol. Duarte, edhe pse i kisha me ngjyra, kafën e pija me qejf. Ajo herëpashere thoshte: “More Hilmi... Eh, e paskam shkru... Sa të varfën... I kam pru në kosh përmes vorfnisë, këtu në Shkodër”.

Largohem nga kjo shtëpi... Më shoqërojnë: trishtimet, fati dhe pafati; plaga dhe shpirti, trëndafilat dhe puthja në sy, ëndrrat e yjeve dhe dhembja, fjala e pathënë dhe bekimi, ndarja dhe pritja; dimri, pabesia dhe dashuria; arkeologjia e perëndive dhe porta lënë hapur për zogjtë, lutjet e Shën Mërisë dhe lavdia e Iliadave, mallkimi dhe fjala e lirë, vdekja e ngjyrave dhe stina e harrimit, shtëpia e gjetheve dhe miti i statujave, qefini i gjetheve të thara dhe shpirtrat e pyjeve, planeti pa diktaturë dhe shtegu i mbuluar me lule-harrese, ulërimat e ciganëve me daulle dhe agimet e përgjakura nga thika e hakmarrjes, lahuta e muzgut dhe folklori i harruar i qeraxhinjve, gravurat e vjetra dhe bukuria që ende s’ka vdekur, shalli i ylberit dhe retë gri si mall i harruar, lutja e foshnjës dhe mermeri i zërit të thyer të Fredit që pëshpërit përjetësisht: “Unë do të mbetem në këtë tokë që quhet Shqipëri”.

Po largohem... nga kjo shtëpi... E di, që do të vij përsëri e përsëri... Portën, si gjithnjë, do ta gjej hapur... Do të hyj ngadalë në këtë shtëpi vetmie me kujtesë prej ajri, ku janë gdhendur sytë dhe shpirti i poetit Frederik Rreshpja në momente pikëllimi, e që pikëllueshëm të thonë: “Unë kam qenë trishtimi i botës”.

Sidoqoftë, unë mund të shkruaj lirika moderne,

Por, për mua është tepër vonë të shpik gjëra që nuk ekzistojnë

Si për shembull lumturia. (poezia: “Sidoqoftë”)

... dhe iku “i vizatuar nga hëna”.

Luigj RAKA

KAPITEN MARK RAKA PATRIOT DHE DEMOKRAT I VËRTETË

Libri mbi figurën e shquar të kapiten Mark Rakës, me autor Tonin Krajën (nip i tij), pasqyron aktivitetin dhe personalitetin e njërit prej oficerëve shqiptarë nga Shiroka (Shkodër), që me punën dhe kontributin e tij dha një ndihmesë të dukshme në ndërtimin e shtetit shqiptar, ashtu si dhe shumë ushtarakë të tjerë patriotë dhe demokratë .

Kapiten M.Raka u lind në Shirokë me 20.01.1890. Shkollën fillore e mbaroi në Shirokë. Kjo shkollë qe hapur që në 1876, nga famullitari i asaj kohe Dom Zef Ashta. Shkollimin e mëtejshëm e kreu në Kolegjin Saverian. Më pas dërgohet në Austri ku kryen Akademinë ushtarake, dhe në vitin 1912 vjen në Shkodër si oficer i ri.

Në vitet 1913 – 1914 shkon për një kurs ushtarak njëvjeçar në Bari të Italisë. Për këtë periudhë Gjon Kamsi, njohë shkruan: *“E kam njohur dhe ndjekë si shok në jetën dhe veprimtarinë e tij kombëtare prandaj po shkruaj për të, për t’u kujtuar në rradhën e atdhetarëve më në shenjë. Në vitin 1913, 1914 erdhi me 12 shokë oficera në Bari për një kurs plotësimi, që u mbajt në rregjimentin e 10-të të këmbësorisë nën drejtimin e kapitenit të shquar Karlo Ferri”*.

Me mbarimin e kursit gradohet Toger i këmbësorisë Italiane, *“dhe si i tillë-sipas Gjon Kmasit- u caktua në shërbim, që i ata bajë në Romë...”*, më 28.12.1914. Italia që akoma nuk ishte angazhuar në blloqet e Luftës së Parë Botërore, më 30 Tetor pushton Sazanin. Në këto rrethana grupi i oficerëve shqiptar me qëndrim në Itali protestoi në mënyrën më kuptimplotë, me 5 pajtona me flamurin shqiptar parakalojnë para insitucioneve shtetërore në Romë. Në këtë ditë shpërndajnë edhe pjata dekorative në të cilat qe shtampuar në qendër shqipja dykrenare dhe bordurat kuq e zi. Një nga këto pjata është ruajtur në shtëpinë muze të Gurakuqit, e dhuruar nga mësuesi i vjetër Pjetër Pali.

Këtë ngjarje të shënuar ai do ta paguajë me internim. Autoritetet ushtarake italiane e interpretuan këtë veprim, si dhe korrespondencën me patriotë të tjerë me anë letrash (patjetër të interceptuara nga shteti Italian) si një qëndrim defakto armiqësor ndaj politikës Italiane në Shqipëri.

Për këto veprime internohet në ishullin e Favinianos në fund të Siçilisë

përballë Trapanit. Atje takohet me Mustafa Krujën, i cili për kapiten Rakën shkruan : *“Në luftën e madhe gjendja në atë vend për ndryshime politike e kishte dërgu atë si edhe mua në të njëjtin vend, atje kemi kalu bashkë ma shumë se një vit. Kisha gjetë qysh atëherë në Kapiten Rakën shpirtin e një patrioti, e bashkë me këtë të një demokraci të vërtetë, dy cilësi këto që është e pamundur për nacionalistin shqiptar me i nda njëra prej tjetrës”*.

E kishte vuajtur vetë dhe në familje e pastaj gjatë gjithë karrierës së vet shtypjen e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar. Kishte dhimbje për popull dhe një pasion të pa kufi për t’i shërbyer Atdheut.

Pas hyrjes së SH.B.A. në Luftën e Parë Botërore, jepet amnistia, dhe Raka rehabilitohet edhe si ushtarak, me ndërhyrjen e Eilsonit. Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore njihet edhe shteti shqiptar. Në këtë kuadër krijohen regjimentet e milicisë shqiptare, dhe Kapiten Rakës i ngarkohet detyra e krijimit të regjimentit të milicisë në Gjirokastër.

Meqë qeveria e Durrësit nga një pjesë e atdhetarëve shqiptarë çmohet si shumë pro Italiane filluan përgatitjet për Kongresin e Lushnjës .

Lidhur me zhvillimet e asaj kohe, Myfit Libohova, Ministër e Punëve të Brendshme dhe i Drejtësisë në Qeverisë së Durrësit shkruan: *“Si ministër lypsej të ndaloja mbledhjen e Lushnjës me fuqinë e xhandarmërisë , por trupa ushtarake ishte bashkuar me kongresistët dhe qeveria kishte mbetur pa fuqi. I kërkova Gjeneral Piacentinit në Vlorë që me makina bani të mundur që dy kompani të milicisë shqiptare t’i dërgojë për Lushnjë nga Gjirokastra nën komandën e Kapiten Mark Rakës”*

Kapiten Raka duke qenë se e njihte qartë që në Romë dhe më pas në internim, politikën e Italisë në Shqipëri, vendosi kompanitë në kodrat e Lushnjës dhe i dërgoi fjalë kongresistëve *“ me vazhdu punën se ai gjallë nuk zhgulej nga kodrat”*.

Në kujtimet e Gjon Kamsit, thuhet se me milicinë e Kapiten Rakës ishin planifikuar edhe forca italiane me qëndrim në Vlorë, por kur morën vesh se shqiptarët nuk e lëshojnë Lushnjën pa luftë, u tërhoqën. Kongresi vazhdoi punën pa asnjë incident, dhe me trupat që kishte nën urdhër, ai shoqëroi Qeverinë e Lushnjës me Sulejman Delvinën kryeministër, deri në Tiranë.

Teksti i historisë së Shqipërisë këtë fakt e përmend kështu: *“Kongresi i Lushnjës në Janar të 1920 rrëzoi qeverinë antikombëtare të Durrësit dhe zgjodhi qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës . Shteti i pavarur shqiptar u rimëkëmb. Qeveria e vendosur në Tiranë filloi punën dhe rruga për demokratizimin e vendit u hap”*.

Mark Raka dhe shumë oficerë të brezit të tij, për të cilët kishte aq nevojë vendi, vihen në dispozicion të shtetit shqiptar. Ky brez ushtarakësh u bë një mbështetje e fortë për qeverinë. Gjatë kohës që Zogu ishte Ministër i Punëve të Brendshme, Kapiten Raka ishte Komandant i Ushtrisë Shqiptare.

Në vitin 1922, shteti shqiptar mori vendimin e çarmatosjes së popullsisë nga armët e gjata. Ahmet Zogu si Ministër i Mbrëndshëm emëron Kapiten Rakën si komandant i ngarkuar për plotësimin e kësaj detyre për Shqipërinë e Veriut .

Më 06.02.1922, Parlamenti Shqiptar dekretoi ligjin. Ishte hera e parë në historinë që shqiptari të ç'armatoste shqiptarin. Detyra ishte delikate. Pasi kishte kryer ç'armatimin në pjesën më të madhe të Shqipërisë së Veriut, vjen radha e ç'armatosjes së krahinave të Shalës dhe e Shoshit. Ç'armatosja e këtyre krahinave për arsye tradicionale bëhet më e vështirë se në zonat e tjera .

Fishta si Nën/kryetar i Parlamentit bën përkrahjen e vet përmes revistës “Hylli i Dritës, mbështetëse këë veprim:

“Populli duhet të ketë besim në fuqinë dhe vullnetin e qeverisë, sepse oficerët e edukuar nëpër shkollat e klerit si Kapiten Raka, Toger Ndokë Gjelijoshi, Major Preng Jaku dhe toger Preng Tusha janë të gatshëm për me ba shërbime të mëdha atdheut, kështu besojmë edhe për oficerat e tjerë kudo në Shqipëri”.

Fjala e Kapiten Rakës në Kodër Shëngjergj ku qenë mbledhur burrat e Shalës dhe të Shoshit është botuar në shtypin e kohës, dhe në revistën Policia, sot organ i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nëntor 2003.

“Kjo ushtri –thoshte ai- që ju po shihni sot në keto male nuk është ushtria e turkut që na ka mbajtur në robni për 500 vjet e as ushtria e Malit të Zi që ka mësy këtu për me grabit trojet tona me ikjen e Turkut. Kjo sot para jush është ushtria shqiptare. Këto ushtarë janë bijtë e vëllezënve të tuaj . Këto nuk kanë ardhë t’ju robnojnë, por duhet të vemë rend e qetësi që deri dje ju e keni vendos me anë të kanunit. Është e mira juaj dhe e mbarë Shqipërisë që të çarmatoseni, për punën , lulëzimin dhe përparimin e atdheut. Mos veni dorë, as mos dëmtoni një njeri me uniformë. Të gjithë janë shqiptar. Ju i dini mirë zakonet. Mos i bini ndesh ligjeve të shtetit tuaj. Sot duhet të ecim përpara, duhet të gjithë bashkë të punojmë dora dorës për mëkambjen e shtetit të ri shqiptar”.

Me mirëkuptim ashtu si dhe në krahina të tjera, arriti të mblidhte armët e krahut në Shalë e Shosh, duke bashkëpunuar gjithnjë me krerët e fiseve.

Dorëzimi i armëve ngjalli admirim dhe habi. Populli filloi t'a besonte.

Teki Selenica në librin “10 vjet mbretëri”, (Tiranë 1938), shkruan se u mblodhën 34. 140 armë krahu pa asnjë gjakderdhje. Pa dyshim merita e jashtëzakonshme i takon Kapiten Mark Rakës që u tregua oficer me gjykim të mprehtë, edhe si ushtarak, por edhe si diplomat .

Të gjitha shtresat e shoqërisë u treguan të vëmendshëm ndaj këtij fenomeni . Kështu ndodhi edhe me atdhetarin Kel Marubi, që i thirri njerëzit pjesëmarrës dhe i përjetësoi në fotografi këtë akt heroik me rëndësi kombëtare .

Fotografia u quajt prej tij “*Dorëzimi i armëve. Kapiten Mark Raka dhe Bajraktari i Shales Lush Prela*”. Fotografia rezulton me vlera të jashtëzakonshme artistike dhe është një dokument i vërtetë historik dhe artistik. Të gjithë personazhet në fotografi janë të njohur .

Talenti i tij ushtarak dhe veprimtaria e tij patriotike spikasin edhe një herë gjatë Revolucionit të Qershorit 1924, ku ai me kërkesë të L. Gurakuqit, që në atë kohë ndodhej në Shkodër vihet në shërbim të tij dhe të qeverisë së Fan Nolit.

Si komandant i këmbësorisë së batalionit të tretë në Shkodër, i lidhur me forcat më përparimtare të qytetit ai merr pjesë në operacionin e rrethimit të Prefekturës së Shkodrës . Pasi çlirohet Shkodra nga forcat zogiste, me propozim të Gurakuqit dhe të Hasan Prishtinës , caktohet komandant për çlirimin e Lezhës, Krujës dhe Tiranës.

Më 8 Qershor, me forcat që komandonte kryen çlirimin e Lezhës duke e thyer ushtrinë zogiste që komandohej nga majori austriak, Gilardi.

Me 10 Qershor hyn ndër të parët në Tiranë. Profesor Xheladin Kosturani në shkrimin e tij mbi Kapiten Mark Rakën, titulluar: “ *Luftëtar i çështjes kombëtare, luftëtar e shquar e luftës për liri dhe pavarësi*”, shkruan:

“*Madje ma i pari që hyn në Tiranë me pushkë në dorë dhe me reparte të rregullta qe Kapiten Mark Raka, në oren 11:15. Pjesa tjetër e ushtrisë kombëtare ndodhet në Fushë të Krujës dhe po i drejtohet Tiranës me hapa të shpejta*”.

Në qeverinë e Fan Nolit është komandant i parë për disa kohë dhe më vonë emërohet Komandant i ushtrisë për operacionet në Qarkun e Shkodrës, detyrë të cilën e kryen deri në hyrjen e forcave zogiste, më 24.12.1924.

Si kundërshtar i hapur i regjimit zogist, me rikthimin e tij në pushtet nuk ikën, por arrestohet dhe internohet në kalanë e Krujës bashkë me

atdhetarë të tjerë. Pasi del nga burgu pushon çdo aktivitet dhe shkon pranë familjes. Duke parë tentativat e Zogut për t'a eliminuar fizikisht kërkon të dalë jashtë shtetit “për mjekim” në Cetinë . Vdiq më 19 gusht 1926, në një aksident automobilistik .

Trupi bashkë me arkivolin vendoset në shtëpinë e një shqiptari me banim në Cetinë, ku të merguarit politik, shqiptar të Cetinës dhe të Malit të Zi, por dhe banorë bëjnë homazhe pranë trupit të të ndjerit. Komandanti ushtarak i Cetines urdhëron që të varroset me nderimet ushtarake sipas Gradës .

Mustafa Kruja, që e kishte njohur në Favignano dhe në Shkodër, kur ishte prefekt, me rastin e vdekjes, në gazetën “Liria Kombëtare”, të 1 shtatorit të vitit 1926, shkruante:

“Vargut të dëshmorëve të kombit shqiptar iu shtua edhe një verigë e re, se Kapiten Mark Raka qe ndër ato oficera shqiptar që dinte të pajtojnë disiplinën ushtarake, pa të cilën asnje komb në botë s’mund të mburret se ka ushtri, me ndjesinë patriotike, pa cilën asnjë popull nuk mund të qendrojë si shtet më vehte, se ai kishte dhimbje për popullin e një pasion të pakufi për t’i shërby, se energjia , mjeshtëria e trimëria e tij si komandant e si ushtar ishte me të vërtetë e pa shoqe. Ai karakterizohej nga dy cilësi: Shpirti i patriotit dhe bashkë me këtë të një demokraci të vërtetë, se ai me burrëri të pa shoqe e mbajti deri në fund besën që i dha L.Gurakuqit në Shkodër” .

Është interesante të përmenden kujtimet e At Benardin Palaj, dëshmitar i gjallë i natës së 24.12.1924, kur në Shkodër vjen lajmi se Zogu po hynte në Tiranë me matjanët e tij dhe ushtarët rus të Vrangelit.

“Qyteti-shkruan ai- ziente. Kapiten Raka dhe Ndokë Gjeloshi marrin në dorëzim prefekturën, sepse prefekti kishte ikur. Qesin kasnecat me thirrë përfaqesuesit e popullit, mundohen me ba një qëndresë ushtarake, por u pa mirë se veç Vasë Kirit, Ndokë Gjeloshit , Gaspër Palit, Kapiten Mark Rakës, Gaspër Mosit , Adem Boletinit, të tjerët nuk kishin mendje qëndrese. Del Kapiten Raka si komandant i grupit të oficerave me lyp prej qytetit nderën e armëve duke i thënë popullit : Ju e dini se ne jemi ushtar dhe armët nuk jua dorëzojme kurrë kaçakëve. Shkodra në dashtë me qendruë, ne kena me vdekë të parët. Ndokë Gjeloshi donte me ngrëshë shokët rrëshanë, me shpall shtettrëthimin dhe me arrestu e me vra oficerat tradhëtar kudo ku shiheshin se po bishtnojnë. Kapiten Mark Raka, ishte kryekomandant i përgjegjshëm, me shokë i butë dhe i arsyeshëm , me të tjerët: ushtar, oficer, nacionali. Propozimit të konsullit Italian për të

ç'mobilizuar ushtrinë ai iu përgjigj menjëherë: "Ne nuk kishim luftu kundra Ahmetit po të dojshim me e shit independencën e popullit shqiptar. Shumë ma vonë mbasi doli prej burgut e donte me shku në Cetine u poqëm bashkë disa herë, folëm gjanë e gjatë për një lëvizje; të mramen herë në gjimazin tone në odë të harxhit, e u morëm vesh këso dore, me ngushtue Jugosllavinë me bashkëpunue me elementin nationalist e të shëndoshë nën mbulojën e diplomacisë franceze për me zhba një gabim të saj që nuk rrjedh as prej Gurakuqit e as prej Gurakuqaneve, por drejt për drejt prej Ahmetit e Ninçiq e Lzaroviçit, ambasadori serb në Tiranë.

Më bjen në mend si sot kur u falëm ne ma të mramën herë me të ngratin Rakë, të cilin para kësaj kohe nuk e çmojshe pse nuk e njëjshë. Tuj më marrë dorën, në kamb më tha: "Per LL mos mendo, sepse po qe se don me i ndërru fjalët kur të vijmë në Shkodër asht kollaj puna e tij". Ju vec bani çmos që kryengritja të fillojë në Jug dhe në Dibër, me bashkëpunu me Jugosllavi vetëm për një Shqipëri - Zvicër Ballkanike po, por me bazë të sigurta e me njerëz uzdaje, të pa trandshme për TE po se po, por edhe për ne, dojshe me i thanë, dhe i thashë Ruju LL, por ai ushtar nuk e di a e bani te vetën idenë teme . U ndamë për mos me u pa ma në këtë jetë. Mbas pak kohe prej Padër Marjen Prelës, famullitari i Grudës , mora vesh se në një mbledhje që u ba në Qelë, që tij tuj fole për një program që u kishte ardhë, më tha qe ishte ma i urti i asaj pleqnie. Asnjë nuk flite fjalë ma të matuna se ai".

Duke qenë se ishin arratisë bashkë dhe ndodhej në Cetinë, fjalën në varrim e Kapiten Mark Rakës e mbajti Dom Lazër Shantoja, një ndër miqtë më të ngushtë të tij .

"Dëshmor re edhe ti! Vdiqe në rrugë të madhe si ushtar, vdiqe në detyrë, bash në një kohë kur vepra, energjia dhe trimëria jote ishin të nevojshme ma shumë se kurrë për çlirimin e Shqipërisë tonë. Në kllapi të vdekjes kë pamun shokët e bashkëpuntoret tuaj, të largëtit e të afërtit, oficerat në mal, Shqipërinë në veriga, prej Vermoshit deri në Himarë të tana viset e saja ku kamba yte shkeli, qytetet tona Shkodër, Lesh, Durrës, Tiranë e Vlorë ku ndërsa lufta e revolucione hynë, dole gjithherë ngallnjyes.

Shko krenar o Kapiten Mark Raka! E kur kanë me të dalë përpara dëshmorët e Shqipërisë na u fal me shendet! Na e rrok Gurakuqin me shokë, përshkruja gjendjen e Shqipërisë së mjerë, popullin e robnum, tokën e shitun, burrat ndër burgje, nationalistat rrugash, ndërsa tirani i këtij populli tallet ndër vila luksoze si Neroni! Por thuja atyre shokëve se ditët e tiranit janë të numëruara".

Ushtria e Malit të Zi ka ndërtuar një lapidar në vendin e ngjarjes, lapidar i cili ekziston edhe sot e kësaj dite .

Më vonë, Ernest Koliqi ka shkruen poezinë “Për Kapiten Rakën”, ndërsa Dom Lazër Shantoja, shkruan më 1927, poemën dramatike titulluar : “Kuvendi i Dëshmorëve”. Personazhe të dramës janë figurat e njohura historike, si: Ismail Qemali, Bajram Curri, Luigj Gurakuqi, Elez Isufi, Avni Rustemi, Zija Dibra, Mark Raka, *që ashtu si në legjendat e moçme shoqërohen nga orët dhe zanat e malit.*

Prof. Ndoc Raka, nipi i Kapiten Mark Rakës punoi me përkushtim për të ndriçuar figurën e Kapiten Mark Rakës, si dhe për të insitucionalizuar kthimin e eshtrave në Atdhe. Kontributi i tij ka qenë i madh në grumbullimin e fakteve dhe të dokumentacionit për jetën dhe veprën e Kapiten Mark Rakës. Me interesimin e tij, Kapiten Mark Raka, më 04.11.1993, është dekoruar nga Presidenti i Republikës me “*Urdhërin për Veprimtari Patriotike të Klasit të Parë*” .

Genc DRINI

**“MALËSORJA E BJESHKËVE TONA”,
NJË ROMAN AUTENTIK
I SHKRIMTARIT LULASH N. PALUSHAJ**

Rrethanat e gjeopolitikës dhe përpjekjet e shqiptarëve që çuan në krijimin e shtetit të dytë shqiptar, atë të Kosovës, një e drejtë e ligjshme, ndihmuan dhe ndihmojnë dhe për afirmim kombëtar të shqiptarëve në Maqedoni, Preshevë, në Mal të Zi, dhe Çështjen Çame që përpiqet të vitalizohet, dhe të gjitha bashkë shkojnë në hulli të Bashkimit Kombëtar. Por një pjesë e klasës politike shqiptare në gjithë arealet e shqiptarëve, me zhveshjen moral politike të pashoqe, dallaveret e pa fund dhe korrupsionin e thellë, po zhvasin dhe rrënojnë shqiptarët, po rrënojnë dhe shanset e mëdha historike që do çonin kombin shqiptar drejt përparimit. E pra, e nesërmja e shqiptarëve mvaret pikërisht nga mënyra si do reagojnë shqiptarët ndaj këtyre politikanëve fenomen-bartës negativë dhe shansit historik për bashkim që nuk duhet humbur. Duket sikur këto dy fjalë hyrëse me karakter politik nuk kanë të bëjnë me një kritikë letrare për një roman, po nuk është ashtu. Romani “Malësorja e Bjeshkëve Tona”, brenda vlerave letrare në mesazhin që përçon ka një meritë të veçantë se i thërret ndërgjegjes kombëtare, duke na kujtuar se çfarë e mban në këmbë dhe e ngre një komb dhe çfarë e rrënon, dhe kjo që dhe një ndër shtysat për të shkruar këtë kritikë.

Vështirë se gjen një autor tjetër që të jetë bërë një me personazhet që i përshkruan, ua grabit fjalët si askush tjetër, gjuhën po ashtu, i merr për vete vuajtjet e tyre, mundimet shqetësimet e tyre, ndan me ta gëzimet e shkurtra, përpjekjet, shpresën, është një prej tyre. Ky mishërim i njëmëndtë i kthyer në një stil funksional, është instrumenti letrar në të cilën realiteti dhe fikcioni kthehen në një, dhe me të cilin shkrimtari Lulash N. Palushaj në romanin e tij “Malësorja e Maleve tona” përcjell me vërtetësi palcën e botës malësore të Malcisë së Madhe e me jehonë më të gjërë atë gjithëshqiptare.

Sjell bjeshkët me zanat e shtojzavallet, por jo për t'i kundruar si frymëzime romantike. Nuk është e magjishmja e tyre që e përfshin. Është hymnizimi i reales, i femrës malësore që krijon mitet. Ajo e mahnit, e bën

për vete, e drithëron, malësorja “si gastare” po që nuk thyhet dhe kështu kthehet në lindëse, e mbështetje e fortë e vatrës, vatrës që e mbush plot me fëmijë, me shumë meshkuj lindjen e të cilëve e përshëndesin martinat. E mbushin shtëpinë e ke pse të jesh gjallë. Nga vatra lindin Oxhaqe, e kullat mbeten të pathyeme. Romani na merr me vete për të na treguar një vistar të vlerave malësore, shqiptare burrnore që s’i gjen kund, ku gjithçka mbahet me “Nder e jo kori”, e kjo është shtylla e parë e botës malësore ku mbështetet vijimi i asaj jete epike dhe i përjetësisë së shqiptarëve.

Ashtu, linear si në një stil kronike përzgjedhëse, është befasues i gjithë rrëfimi “i ngutur”, ku duket sikur zhvillohet veç një ngjarje që nuk ka të ndalur. Janë veç dy familje, pak personazhe, por ndjehet kaq përgjithësues sa të ngjet sikur gjithë Malësia ndodhet në ecje edhe zhvendoset tash e parë nga një vend në tjetrin në tërë hapësirat e Malësisë, të njëjtët njerëz. E i gëzohet kësaj ecjeje, ku malësorët kudo që drejtohen nuk harrojnë asgjë, duket sikur marrin me vete në rropamën e tyre, në ndërgjegjen e tyre, në çdo hap të gjithë fshatrat e tyre, me shtëpitë, bëmat historitë, jetën e përditëshme me gëzimet, shpresat dhe vuajtjet, sikur i përjetojnë në palc të gjitha njëherësh dhe shkrintari i përjeton bashkë me ta. Një ecje unike brenda vetvetes, një sjellje brenda territoreve të veta, e që shtrihet më gjërë kudo në gjithë shqiptarinë. E nuk kuptohet sesi ndonjë lexuesi, sidoqë e konsideron epike, ajo jetë i duket e varfër e me pak ngjarje që përsëriten. Nuk është kështu, as në realitet dhe as në libër. Është një jetë e përditëshme plot ajkë ku rrjedhin së bashku ngjarjet dhe mendimi që projekton dhe të ardhmen. Ecin mendimi edhe malësori, “ngjiten” për në bjeshkë. Kalojnë në Jutbinën e kreshnikëve, Deçiq, Veleçik, në gjithë Bajrakët e në Shkodër e më tej. E në Bajrakët e Malësisë, malësorët lidhen në krushqi, e në krahina të tjera të veriut, deri në Kosovë, oxhakë me shumë lidhje gjaku, krushqi ngjizëse në mes shqiptarëve... E shpërthenin në dasma, kanga, vallet dhe loja e bajrakut. Një jetë e pasur për tu pasë lakmi. Nuk e gjen në ritmin e qyteteve të bujshme, që shpesh vetëm i përulan njerëzit në rutinën e pa ndalur, i rrëmben në një ngut pa thelb që ua lë bosh ndërgjegjen, që vetëm e vetëm ajo kur është e plotë e bën të pasur jetën e njeriut. Nuk është ritmi dhe sasia e ngjarjeve që “çon peshë, po pesha e tyre”. Është qëllimi i veprimit që synon idealen, morali që i përshkon e lartëson ngjarjet i ngarkon ato emocionalisht, dhe e bën të pasur jetën. Një përkushtim i thellë për çdo hap që hedh malësori i jep peshë jetës së tij, se pesha e çdo hapi është e lidhur me jetën. Po dhe me vdekjen. Kjo e bën atë jetë më të pasur dhe të vyer se çdo tjetër dhe nuk mvaret as nga ritmi bosh dhe as nga

kamja.

Malësorët, e më gjërë të gjithë shqiptarët, bëmat e tyre i masin me lartësitë e maleve. Kjo botë e paraqitur kështu mund të dukej e sajuar butaforike e vetëmitifikuar dhe irrealë. Po jo, malësorët nuk dështojnë, se ndërgjegjen e balancojnë në ligjësitë, traditat dhe doket e vyera, dhe progresin e synojnë me maturi. As autori nuk dështon, se në po ato ligjësi, në kontrast të thellë me majat e larta të maleve, majat e vlerave, ai e sheh dhe humnerën e turpit edhe më të thellë. Zgjidh e merr po deshe të keqen rrënuese, që larg moralit të lartë është e zhytur aty thellë në humnerë. Autori nuk e fsheh me naivitet të keqen që përvidhet për t'i prishur vlerat, po e shfaq pa ngurrim para malësorëve, para të gjithë shqiptarëve, duke e ballafaquar me kodet e traditës më të mirë. Kërkon tua kujtojë dhe t'i shmangë nga ato përjashtime devijuese të karakterit dhe moralit që mbeten si njolla turpi për ata që i bëjnë, po dhe ua shuajnë tymin e oxhakut. U kujton se gjithnjë kërkohet ajo që është kulmore për malësorët, për shqiptarët, “Nder e jo kori. Nder për malësoren, gastare që nuk thyhet, e mjerim për një thërmim në copa-copa që kthehet në një kori që djeg shtëpi, fise e male. E vatrat, oxhaqet nuk qëndrojnë në këmbë pa nder, shëmben. Ruaje burrninë se je i nderuar, e kundërta është zhburrnim, një fjalë të çon ose të rrëzon, është shërim dhe helm për të helmuar. Besnikëri e jo hjekësi se konsiderohesh si vrashtar..të prish rodin e nderit shtëpiak. Mos u bëj spiun se faqen e zezë kush s'ta lan. Një përshkrim i drejtpërdrejtë, i vërtetë, gati hiper realist, dhe me ndjenja të forta i shtyllës së parë të botës malësore i “nderit e jo korisë”, përbën dhe shtyllën e parë mbajtëse të prozës së autorit. Shkrimtari Palushaj shpalos një vistër të pa fund kontrastesh që mbajnë në tokë ngrehinën madhështore të ndërgjegjes së malësorëve të Malësisë së Madhe dhe që në nuancat e veta të larmishme shtrihet njëlloj madhështore në të gjithë shqiptarët në gjithë hapësirat shqiptare. Nder e jo kori. Është një ekuilibër që e kthen gjithë epikën në një realitet të pa përsëritshëm. Kontrasti i thellë i bën majat e vlerave më të larta, maja bashkuese të shqiptarëve. Prej burrave që kishin arritë ato maja vlerash lëshohej kushtrimi e të gjithë u besonin e u shkonin pas sa herë qielli mbulohej nga re të errëta, “turku në njërën anë, në tjetrën malaziasi”. Kushtrimi jehonte në gjithë shqiptarinë, dhe autori i sheh malësorët, të gjithë shqiptarët, të bërë një. E u deshtën tubime e pushkë për të çarë “retë”, shumë pushkë e shumë gjak. U desht Greça e Memorandumit, si shkruan, që e siguruan trimat e Malësisë. Malësorët e pritën Luigj Gurakuqin e Dedë Gjo Lulin., Mehmet Shpendin e sa të tjerë përfaqësues të Malësisë

të të gjithë bajraqeve, që gjetën mbështetje e siguri. Aty është dhe Isa Boletini i Kosovës shqiptare.” Identifikimi nga malësorët i vetes së tyre brenda kombëtares, ndërgjegjëja identitare e tyre e theksuar është shtylla e dytë e vërtetë dhe e lartë ndërgjegjësore që i ngren dhe mbron malsorët, e të gjithë shqiptarët, dhe që është e pa shkëputëshme nga shtylla e parë. E përcjellur kjo në libër dhe si porosi kombëtare dhe morale për malësorët, për të gjithë shqiptarët e sotëm dhe të brezave të ardhshëm, ruejtja e ndërgjegjes identitare, ruejtja e identitetit kombëtar është dhe shtyllë e dytë po më thelbësorja që mban në këmbë fort ngrehinën e romanit të Palushajt. Se aty matanë malesh , dhe ma larg, qenë ata të tjerët banorë, e prap do të jenë, që nuk rrinin në caqet e tyre po kalonin malet e mësynin bjeshkët e fshatrat shqiptare, për të grabitur tufat, shtëpiat e malësorëve, e vra malësorët, e ua vështirësonin jetën deri ku nuk shkon më. Kështu lëshoheshin ç’njeh koha malazezët në një lodrim të egër një mijë vjeçar shpatash, pushkësh, plagësh, vrasjesh, e grabitjeje tokash. Malazez e serbë lëshu mbi Malësi, mbi Shkodër për ta pushtu, e mbi Kosovë. Përplasje pa fund, përsëritur në një cikël mbijetese që i frenonte malësorët e gjithë shqiptarët të mëkëmben dhe të përparojnë me kohën. Autori e vuan historinë. Vuan kur sheh sesi shumë kohë më parë, malaziasit ia dolën të lëkundin një masë malësorësh, si ata shqiptarë të Kuçit, që i thyen, i kthyen në puthadorës deri dhe i sllavizuan. Me zjarrin e armëve prej Rusie dhe me vendime të Fuqive të Mëdha malazezët dikur ia arritën, rrëmbyen disa toka shqiptare. Nuk gjetën qetësi derisa dhe emrave të disa shqiptarëve t’ua shtonin një “viç”, e kënaqeshin kur shihnin në vend të qeleshes së bardhë mbi kokat e shqiptarëve me prapashtesën “viç”, të vume kopicën e zezë malazeze. Ishte mjerim të përfytyroje sesi i përçanë shqiptarët. Sidoqë zakonet nuk i kishin ndryshuar dhe vijonin të flisnin shqip, malazezët dhe serbët arritën t’i ndërsenin shqiptarëkopicëzinjtë”, dhe të gjithë së bashku iu vërsulën egërsisht malësorëve me qeleshe, shqiptarëve. Malazezët ia dolën përsëri të përllanin të tjera territore me Luftat Ballkanike që shpërthyen, sidoqë shqiptarët luftuan me të gjitha fuqitë e veta kundër tyre. Në atë orë të keqe të vitit 1913, kur Fuqitë e Mëdha përsëri i hynë në hak Shqipërisë, e përgjysmuan, e lanë Kosovën e vise tjera jashtë kufirit nën pushtimet sllave e greke, e ndanë në mes Malësinë e Madhe, e ndanë vëllaun me vëlla, në dy anë, “gur e kufi” krajlitë, kufiri mes permes shqiptarëve.” Një epikë e dhimbshme shpaloset nga autori për ato ngjarje: “Luftërat Ballkanike e tërë ato dallavere për të marrë Shkodrën, lodroheshin ushtritë serbomalazeze mbi Malësinë e Madhe, kryq e tërthuer. Gjak e

tmerr. Lëshoheshin shtëpiat për të shpëtuar pleq e fëmijë. Luftonin malësorët e shkretëtë... pa armë e bajoneta.. I futet Mali i zi ...duke regjistruar mbiemrat shqiptare me prapashtesën “viq”. Dekrete të forta mbretërie në Kosovë, Plavë e Guci, Malsi që mbeti nën Mal të Zi, dhe Krajë e Ulqin ... Këndej nën Mal të Zi frikë e trishtim a po shpëtojmë gjallë. Shqiptarët s’i pyet kush, si të mos ishin gjallë.. Andej në Shqipni ngatërresa për pushtet; Nga t’ia mbaje nuk e dije e as ta merrte mendja. Je në token atnore po sundon knjazi i Cetinjës, je nën sllavin.. duhet ose të jetosh ose të vdesësh! Duhej qëndresë! E pra duhej jetë, duhet të jetohej e të fitohej. Virtytet nuk ua kishin lejuar malsorëve të jenë ksenofobë, as në ato kushte të vështira robnie. E kthehet autori e flet për shqiptarët e sllavizuar duke kujtuar se që herët “lypën probatini ua dhamë, lypën të falim gjaqe, ua falëm, ..duke menduar se ato fise ish shqiptare po tash malazeze ishin të rrjedhës së Dukagjinit, flisnin shqip dhe mbanin veshjet shqiptare, por nemaqiqët u kishin dhënë helmin” . Nuk u duhej atyre as fisnikëria as miqësia e malësorëve, e sllavëve të vërtetë jo që jo. U duhej veç zhdukja ose tjetërsimi i shqiptarëve . Dhe sa të jetë e mundur dhe gjuha shqipe e zhdukur. Një letër nuk mund të lexonin malësorët, as shkrim e këndim nuk i lejonin të mësonin, veç vonë shumë pak. Tash e parë nën dhunën dhe kërcënimin e shtetit të Malit të Zi, kërcënimin që mund të kthehej në vdekje. Dhe ja, ku autori na tregon për dy hije të veshura si ushtarë me “kopicë” që një ndër ditët i ngjiten kodrës dhe befas lëshojnë në dorën e Prëtit, që mendonte për djalin e vet ushtar, një letër të rrethuar me vijë të zezë. E hutuar, ngado që e sillte ajo nuk kuptonte asgjë, vetëm ca germa, cirilike veç... Nuk kuptonte, por duart po i dridheshin ..e..kur dikush i tha se i biri nuk ishte më..si ta çante thika, iu mpi qënia..e më pas lotë rrëke e gjamë, e mbet me lotë, e vetëm lotë. Heshtje. Askush nuk u tregoj as si kish ndodhur dhe as ku është varrosur... I duhej dikuj të penetronte nëpër atë mjegull të errët pushtuesish për të gjetur si e ku. E patën marrë ushtar malësorin Gjergj, ” në ushtrinë ku nuk flitet shqip e gjuhën nuk ia merr vesh”. Është më lehtë të përballësh me armikun në teh shpatash e grykë pushkësh, se kur je ushtar. Nuk e di kur të sulmon, kur je zgjuar apo në gjumë. Sa herë dhe i vritnin ushtarët shqiptarë. Shkrimtari, ndal turrin kësaj rradhë dhe përcjell ankthin, e me hapa të heshtun përpiqet ta ndjekë djaloshin ushtar, si për ta mbrojtur, po diku ia zhdukin. Familjes dhe autorit. E asnjë lajm më prej ushtarit, ditë të tëra dhe shumë muaj ankthi, deri te letra e errët që çoj peshë vajin e pa shterrshëm! Dhimbje e thellë. Kërkohet një forcë si e Anteut për të dalë nga ajo gjëndje, një forcë

për të jetuar dhe luftuar, një shpresë. Nuk mund të ndodhë ndryshe, jeta duhet të vazhdojë që të përtërijë dhe shpresën. Nika fejohej me Rushen, e më pas kunorë në kishë, djali i parë, këngë e krisma, jeta vazhdon dhe shpresa me të.

Lufta e Dytë Botnore, i kushtoi rëndë dhe shqiptarëve po gjaku i derdhur nuk i dha rrugë bashkimit të shqiptarëve, Shqipnisë Etnike për të cilën pjesa më e madhe e shqiptarëve u përpoq dhe luftoi. Komunizmi në të dy anët që zjarri i kuq që e pengoi, zjarri i kuq që përçau. U vu një kufi edhe më i egër ndarës mes shqiptarëve, kufiri në mes Shqipërisë e Jugosllavisë. UDB, pushkaton. Komunizmi vret në të dy anët. Po historia s'ka mbaruar, shkruan Palushaj. Përsëri duhet punë, dhe bashkimi i shqiptarëve do të vijë. Malësorit, burrit shqiptar i duhet një pushkë, një kullë, një grua dhe fëmijë, djem shumë, një arë, një tufë dhensh, një katund si një bashkësi, disa katunde, shkolla, qytete, një hapësirë shqiptare për të jetuar, një shqiptari për ta mbrojtur dhe ecur drejt progresit të kohës, e plot këngë për të himnizuar jetën.

Kjo botë e malësorit, e shqiptarëve nuk duhet të humbasë, duhet të vazhdojë, po autori e ndjen që një pjesë e asaj botë do ndryshojë, e ngutet që disa nga ato visare të çmuara etnografike që do ikin t'ia kalojë historisë. Përcjellja me besnikëri e asaj që ai vetë e ka përjetuar dhe vullneti për ta mbrojtur dhe përcjellë atë trashëgimi të rrallë etnografike është shtylla e tretë që e mban romanin "Malësorja e Bjeshkëve tona".

Sidoqë kohërat ndryshojnë, dhe lehtësitë e jetesës janë shtuar, maqinat, celularët dhe kompiuterat janë bërë pronë të gjithëve, dhe e malësorëve deri në bjeshkë, dhe Malësi dhe malësorë do ketë gjithmonë, dhe bjeshkë dhe kope dhensh, dhe ara, dhe qytete e qytetarë, dhe emigracion mund të ketë, shkrimtari Palushaj beson se nuk do mundet zhvillimi ta shkatërrojë strukturën shpirtërore të malësorëve të pajisur me celular apo jo, dhe të të gjithë shqiptarëve. Do ndërtohet e ardhmja e përbashkët në trojet tona të bashkuara, dhe u thotë jemi të gjithë bashkë, vlerat tona, identitetin tonë do t'i ruajmë. Shtojmë se as dhe disa figura që rastësisht u bënë drejtues të shqiptarëve po vendin duhet ta kishin në humnerën e antivlerave, nuk do mund të dominojnë e dëmtojnë, se do dominojë kodi gjenetik i shqiptarëve, kodi i vlerave, dhe është ai që do tu kundërvihet.

Do ishte një kundrim i ftohtë formal, standard nëse një lexues, apo kushdo që merr përsipër dhe bën një shkrim kritik, vetëm të numërojë vlera, të gjykojë për nuanca, të shprehë vlerësim apo dhe rezerva për një libër. Krejt ndryshe është kur i frymëzuar nga libri i kthehet një meditim

rikrijues vetiak, dhe një roman ëshë i suksesëshëm pikërisht kur arrin të zgjojë interesimin tek lexuesi për idetë që shtrohen në roman dhe nxit për debate ideshë dhe estetike, goftë dhe të kundërta. Në këtë pikëpamje libri i Palushajt është si një libër që mund ta quajmë “të hapur”, që nuk mbaron në faqen 224, por mëton të nxisë të tjerët të vazhdojnë të thonë fjalën dhe frymëzimet e tyre si një kontribut në vazhdimësi në qëmtimin dhe evidencimin e vlerave që duhen ruajtur dhe forcimin e ndërgjegjes kombëtare.

Dhe mbi të gjitha një libër nuk përballet kurrë me asnjë konkurent, nuk është kurrë në garë me asnjë libër tjetër, nuk i vlen krahasimi, sepse ai është në garë vetëm me vetëveten, dhe ai që e shkruan poashtu. Libri është në garë krijuese vetëm për të arritur plotësinë e tij. Me veçantinë letrare, moralin që përçon, atdhedashurinë, e përsëri atdhedashurinë si mesazh, dhe me kontributin e veçantë në etnografinë si thesar, “Malsorja e Bjeshkëve Tona”, roman i parë i autorit, e ka arritur plotësinë e tij. Një ambicie letrare e arrirë dhe e vyer e shkrimtarit Lulash N. Palucaj.

Skender TEMALI

**“SHTJELLË LETRARE” E Z.VUKAJT
- SHTJELLË VLERASH TË MENDIMIT KRITIK
DHE ESTETIK**

Si zakonisht titulli i nje poezie, tregimi, novele a romani, ashtu si dhe i çdo diskutimi a recensionit, shkruhet kur i ke vënë pikën e fundit së shkruari, ndërsa në këtë rast, ai më erdhi ç’se mbylla faqen e fundit të vëllimit të tij të parë “Shtjellë letrare”. Dhe ja sepse: Në fushë të krijimtarisë ne prej vitesh e dekadash kemi dëgjuar plot emra krijuesish, që herë në mënyrë të merituar e shpesh të pamërituar u kanë bërë karshillëk vlerave të mirëfillta, ose sepse kanë pasë një mbështetje jashtëletrare, ose pse kanë qenë pelivanë lidhjes miqësore. Zija Vukaj nuk i përket kësaj specijeje krijuesish. Ai nuk i njeh këto lloj krushqishë, se e di fort mirë se nuk të çojnë askund.

Unë që e njoh prej vitesh, profilin e tij krijues mund ta krahasoj me një saç të mbushur luledielli, kokëulur e që sheh përtokë, tek rrënjët e kulturës së vërtetë shqiptare e asaj ndërkombëtare, pa u joshur nga superlativat që s’janë gjë tjetër veçse një tokë djerr. S’është ngutur të nxjerrë emrin në gazeta e koopertina librash, se kush u ngut dhe s’u rrëzua!? Zija Vukaj ka dekada që ka punuar në heshtje, pa u dukur. Sa duke kryer shkollat e domosdoshme për jetën, sa duke mësuar në mënyrë autodidakte gjuhë të huaja, sa duke mos lënë autor vendës e të huaj që e meriton pa e shfletuar. Duke e ditur se letërsia e veçmas krijimtaria janë edhe kujtesë, memoria e tij në këtë rrafsh është një kompjuter i gjallë, ku tash të flet për De Radën e tash për Migjenin, tash për Sofokliun e tash për Alberto Moravinë, tash për lirikët shqiptarë bashkëkohës e tash për hermetikët italianë, gjithnjë duke spikatur mbi esencien që ata i ka bërë individualitete të spikatura, me gjurmë të pashlyeshme në kulturën botërore. Dhe këtë bagazh njohurishë ai e ka “shkarkuar” pa ia ndjerë peshën në kushedi sa paraqitje librash, studime, emisione televizive e artikuj kritikë, sidomos në dekadën e fundit. Kisha kohë që e “ngucja” të dilte me një vëllim të kësaj natyre, pasi brumi në magjen e tij kishte ardhur prej kohësh. Madje pak me humor e më shumë në mënyrë të figurshme i thoja se boll ke përkundur autorët e huaj me përkthimet nga italishtja e frëngjishtja, tani ka ardhur e ka kaluar koha të përkundësh “pjellën” tënde. Dhe ja, sot kemi në dorë një vëllim

aq të domosdoshëm e të rrallë për lexuesit e krijuesit, me një spektër ku ndiçon mendimi elitar, bashkëkohës, larg stereotipeve, larg folklorizmeve, pranë thelbit të shumëçkaje për të cilën ka nevojë letërsia e sotme shqipe. E theksoj letërsia e sotme, pasi këto shtjella letrare e orientojnë lexuesin e krijuesin drejt vlerave të mirëfillta, që të dijnë të bëjnë krahasimet me antivlerat që kanë mbirë si këpurdhat pas shiut.

Zija Vukaj është erudit. Erudit e ka edhe mendimin. Atë e lexon tek analiza për kritikën letrare e letërsinë e sotme, me një vertikalizëm në analizë të “Elektrës” së Sofokliut, me refleksionet, analizat e esetë brilante për Migjenin, i ngre pedestalin e merituar këtij kollosi të letërsisë moderne shqiptare, në rragvimet në udhët e veprave letrare të zërit të përveçëm të prozës bashkëkohëse, Skënder Drini, e me radhë të Xhahid Bushatit, Paulin Selimit, Masar Rizvanollit, Rita Petros, Mark Lucgjonaj, Mehmet Gucisë, Isa Alibalit, Shyqyri Mollajt, Qazim Çelës, Hajro Ulqinakut, Skender Sherifit, Ahmet Dursunit, Monika Stafës, Besnik Camajt, Adnan Merovcit, rreth përkthimeve të vëllimeve nga Edvin Cami, Alma Hafizi, Lorena Dedja, dhe të mendimeve e analizave artistike për veprat skenike të Fadil Krajës, Albri Brahushës, Lisandri Kolës, etj.

Ndjem i nderuar që në këtë vëllim dinjitoz, autori Zija Vukaj i ka bërë një analizë të thukët, dashamirëse e vizionare vëllimit tim më të fundit poetik “Të pathënat”.

Diku në parathënie të librit, autori Vukaj ka thënë se më shumë ky vëllim është një sprovë e tij. Modestësisht e tha e për të cilën unë nuk jam dakord. Vëllimi siç e ka titullin ashtu dhe të krijon shtjella mendimesh për zhvillimet letrare, që nga letërsia klasike greke, eposi ynë e deri tek autorët më të rinj, por që sjellin diçka të re.

Nuk duhet anashkaluar edhe një dëshirë e imja e jo vetëm: ky libër, doracak për nga paraqitja, ia heqtë nga dora telefonin celular të rinjve për aq kohë sa duhet për t’u lexuar, gjimnazistëve e mësuesve të tyre, studentëve e krijuesve, i cili, edhe pse pa referenca, e ka një të padukshme: referencë është vetë autori Zija Vukaj. Vëllimi është botim i Shtëpisë Botuese “Albas” në Tiranë dhe ka 300 faqe.

ORTOGRAFIJA E GJUHËS SHQIPE
 ENTI PËR BOTIMIN E TEKSTEVE I REPUBLIKËS
 SOCIALISTE TË SERBISË BEOGRAD 1964

Anëtarët e Komisionit dr Idriz Ajeti, kryetar, dr Pjetër Januara, Sulejman Drini, Hasan Vokshi, Mehdi Bardhi, Latif Mulaku, Murat Isaku, Xhevat Gega dhe Luc Lucaj

Kët ortografi e lejoi për përdorim Sekretariati i arsimit e kulturës së Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë me vendimin e vet numër 07-1412 datë 8 qershor 1964

Kët ortografi e përgatiti për shtyp Reparti i Entit për botimin e teksteve i Republikës Socialiste të Sërbisë në Prishtinë

U shtyp në shtypshkronjën e Ndërmarrjes gazetare-botuese “Rilindja”, Prishtinë

DY FJALË MBI PUNËN E KOMISIONIT T’ORTOGRAFISË

Qe, ma në fund, po u lëshojmë në dorë kët Ortografi të gjuhës shqipe të gjithë atyne që mirren me të shkruem të kësaj gjuhe.

Kjo asht hera e tretë që po mirret në shqyrtim çashtja e ortografisë së gjuhës shqipe ndër Shqiptarët e Jugosllavisë.

Herën e parë kjo çashtje u trajtue në vjetin 1952 dhe të dytën më 1957 në Prishtinë. Natyrisht, këto dy mbledhje dhanë kontributin e tyre në shqyrtimin e çashtjeve t’ortografisë shqipe ndër ne.

Mirëpo, në vjetët e fundit, në fushën e ortografisë së shqipes u banë me të madhe lëkundje drejtshkrimore te na, sidomos n’ato pika gjuhësore, ku mungojshin rregullat e preme drejtshkrimore. Në kët mënyrë u krijue një situatë e re në shkrimin e shqipes te na, punë kjo që kërkoi nevojën e revidimit të një kompleksi të tanë çashtjesh ortografike.

Komisioni i gjuhës dhe letërsisë pranë Pleqsisë së kulturës të Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë, tue dëshirue që ta zgjidhi kët çashtje të randësishme, në fillim të vjetit 1961 zgjodhi një Komision për përgatitjen e projektortografisë së gjuhës shqipe me këta anëtarë: dr. Idriz Ajeti, Sulejman Drini, Hasan Vokshi, Mehdi Bardhi dhe Latif Mulaku.

Ky Komision, në fazën e parë të punës së vet, u muer ma tepër me studimin e problematikës sonë drejtshkrimore, ma parë individualisht, në mënyrë që secili antar të njihej mirë me çashtjet gjuhësore, të cilat do të shkoqiteshin në mbledhjet e mavonshme të përbashkëta, ndërsa në fazën

e dytë, gjatë disa muejsh, në takimet e përhershme, muer në shqyrtim çdo çashtje, që në shkrimin e deritashëm kishte ngelë e diskutueshme a e kontestueshme.

Për disa çashtje antarët nuk ia duelen t'i pjekin mendimet, prandej për një numër pikash ortografike ata paraqitën dy mënyra shkrimi, pikëpamje këto që u shoshitën në mbledhjen e lavruesve të gjuhës si dhe arsimitarëve e intelektualëve të tjerë, që më 14, 15 e 16 kallnor të vjetit 1963 e thirri Pleqsija e arsimit dhe kulturës së Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë, në të cilën muerën pjesë lavrues dhe profesorë të gjuhës ndër shkolla të shkallës së dytë dhe të tretë, përfaqësues redaksish të revistave dhe fletoreve të ndryshme në Kosovë-Metohi, Maqedoni dhe Beograd, u muer në shqyrtim e tanë Projektortografija që paraqitte komisioni përkatës.

Gjatë këtij këshillimi u shoshit çdo pikë e drejtshkrimit, e paraqitun në projektortografi. Mandej, pat rasa ku pjesëmarrësit e këshillimit rrokën shumë pika të tjera, për shkrimin e të cilave Komisioni paraqitej i një mendimi - kërkujshin të hetohen edhe njëherë, pse, simbas mendimit të tyre, drejtshkrimi që propozonte Komisioni nuk mund t'i bante ballë një ortografimi tjetër që paraqitte ky apo ai pjesëmarrës.

Mbasi shqyrtuen të gjitha pikat që i paraqiti Komisioni në Projektortografinë e vet, këshillimi propozoi zgjanimin e Komisionit t'ortografisë edhe me katër antarë të tjerë, të cilët i deleguen Pleqsitë e arsimit dhe kulturës së Republikës Socialiste të Maqedonisë dhe të Malit të Zi (Dr. Pjetër Janura, Xhevat Tahir-Gega, Murat Isaku e Luc Lucaj), që bashkarisht t'i shqyrtojnë vërejtjet dhe propozimet e bame gjatë këshillimit mbi ortografinë e ardhshme.

Si në këshillimin e kallnorit ashtu edhe në mbledhjet e Komisionit të zgjanuem, sadoqë u poqën pikëpamjet për shkrimin e shumicës së pikave në shqyrtim, përsëri nuk qe e mundun të piqen mendimet për të gjitha pikat e ortografisë, prandej ngelën disa dualizma, që po botohen në kët ortografi. Pikat divergjente, u lëshuen si të tilla, tue synue që ato t'i kristalizojë koha, t'i japi përparsi njanës ose tjetrës e që në një mlbedhje t'ardhshme të gjuhtarëve, të zgjidhet edhe çashtja e tyre.

Ma në fund u vendos që, shokët Dr. Pjetër Janura, Mehdi Bardhi dhe Latif Mulaku, të marrin e t'i formulojnë mendimet e paraqituna, vërejtjet e bame dhe propozimet e dhanuna, qoftë në këshillimin e kallnorit, qoftë në mbledhjet e Komisionit të zgjanuem, siç na i paraqesin të botueme në kët Ortografi.

Përmbajtja

1 A. FONETIKA

1.1 I. ZANORET

1.1.1 1. TOGJET ZANORE

1.1.2 2. SHKRIMI I ë-së

1.2 II. BASHKËTINGËLLORET

1.2.1 1. GRUPET BASHKËTINGËLLORE mb, nd, ng, ngj.

1.2.2 2. FJALËT ME PARASHTESAT sh (ç), s (z), zh (xh)

1.2.3 3. FJALËT MË r e rr

1.2.4 4. FJALËT MË s e z

1.2.5 5. FJALËT MË th e f

1.2.6 6. FJALËT MË l, ll, dh

1.2.7 7. FJALËT MË ç e q

1.2.8 8. FJALËT MË q e k (kj)

1.3 III. THEKSI E APOSTROFI

1.3.1 1. THEKSI

1.3.2 2. APOSTROFI

1.4 IV. FJALËT ME BURIM TË HUEJ

1.4.1 1. FJALËT MË ia, ie, io

1.4.2 2. FJALËT GREKE MË y (IPSILON)

1.4.3 3. FJALËT MË c

1.4.4 4. FJALËT MË ks (x)

1.4.5 5. FJALËT MË d e t

1.4.6 6. FJALËT MË g

1.4.7 7. FJALËT MË h

1.4.8 8. FJALËT MË k

1.4.9 9. FJALËT MË s

1.4.10 10. FJALËT MË l

1.4.11 11. FJALËT MË r

1.4.12 12. FJALËT MË oo

1.4.13 13. FJALËT MË b

2 B. MORFOLOGJIA

2.1 I. EMNAT

2.1.1 1. EMNAT FEMNORË MË ë

2.1.2 2. EMNAT FEMNORË MË -a, -e, -i, -o, -u

2.1.3 3. EMNAT FEMNORË MË -je

- 2.1.4 4. EMNAT FEMNORË MË jë
- 2.1.5 5. EMNAT FEMNORË MË MBRAPASHTESËN -z (ë)
- 2.1.6 6. EMNAT FEMNORË MË -ull e -ur
- 2.1.7 7. EMNAT FEMNORË MË më
- 2.1.8 8. EMNAT FEMNORË MË -ël, -ën, -ër, -ërr
- 2.1.9 9. EMNAT MASHKULLORË MË -ë
- 2.1.10 10. EMNAT MASHKULLORË MË -ël, -ën, -ër, -ërr
- 2.1.11 11. EMNAT MASHKULLORË MË -ull e -ur
- 2.1.12 12. EMNAT MASHKULLORË MË -izëm
- 2.1.13 13. EMNAT MË -amë, -emë, -omë
- 2.1.14 14. EMNAT ABSTRAKTË QË FORMOHEN
NGA MBIEMNAT E PJESORET
- 2.1.15 15. EMNAT E MBIEMNAT MË -ian, -jam
- 2.1.16 16. EMNAT MASHKULLORË MË -ue
- 2.1.17 17. SHUMSI I EMNAVE
- 2.2 II. MBIEMNAT
 - 2.2.1 1. MBIEMNAT MË -të
 - 2.2.2 2. MBIEMNAT MË -ëm
 - 2.2.3 3. MBIEMNAT MË -shëm
 - 2.2.4 4. MBIEMNAT MË -ël, -ër
- 2.3 III. NUMRORËT
- 2.4 IV. FJALËT E PËRBAME
- 2.5 V. PËREMNAT
 - 2.5.1 1. PËREMNAT VETORË
 - 2.5.2 2. PËREMNAT DËFTORË
 - 2.5.3 3. PËREMNAT PRONORË
 - 2.5.4 4. PËREMNAT LIDHORË
 - 2.5.5 5. PËREMNAT PYETËS
 - 2.5.6 6. PËREMNAT DHE MBIEMNAT E PAKUFISHËM
- 2.6 VI. FOLJET
 - 2.6.1 1. MËNYRA DËFTORE
 - 2.6.2 2. MËNYRA LIDHORE
 - 2.6.3 3. MËNYRA HABITORE
 - 2.6.4 4. MËNYRA DËSHIRORE
 - 2.6.5 5. MËNYRA URDHNORE
 - 2.6.6 6. MËNYRA PJESORE
 - 2.6.7 7. TRAJTA PËSORE E VETVETORE
- 2.7 VII. NDAJFOLJET

-
- 2.7.1 1. Ndajfolje vendi
 - 2.7.2 2. Ndajfolje kohe
 - 2.7.3 3. Ndajfolje mënyre
 - 2.7.4 VIII. LIDHZAT

3 C. TË NDRYSHME

- 3.1 PËRDORIMI I SHKRONJAVE TË MËDHA
- 3.2 Emnat e përveçëm të huej
- 3.3 Datat
- 3.4 Ndamja e fjalëve në rrokje

A. FONETIKA

I. ZANORET

1. TOGJET ZANORE

1. Emnat me togun zanor **ie** në trup do të shkruhen gjithnji me kët tog: p.sh.: *diell-i, miell-i, qiell-i* etj.

2. Foljet me grupin zanor **ie** që mbarojnë me bashkëtingëllore në temë do të shkruhen me je; p.sh.:

djeg, çjerr, hjedh, mbështjell, mbjell, mjel, ndjek, nxjerr, pjek, pjell, rjep, rjedh, tjerr, vjell, vjerr etj.,

kurse në raste tjera me **ie**: p.sh.: *ziej, përziej, ndiej* (por në të kryemen e thjeshtë dhe në mënyrën dëshirore *zjeva, zjefsha* etj.

3. Foljet apofonike me je, në vetën e dytë të shumsit të së tashmes, në të gjitha vetat e së pakryemes së dëftores e të lidhores, n'urdhnore e në trajtat e pësores e vetvetores, e mbledhin togun zanor në i; p.sh. piqni, ndiqni, digjni, vilni, milni, mbillni, sillni, villni; piqsha, ndiqsha, digjsha, vilsha, milsha, mbillsha, sillsha, villsha; të ndiqsha, të piqsha, të digjsha, të milsha, të vilsha, të mbillsha, të sillsha, të villsha; ndiq, piq, digj, mil, vil, mbill, sill, vill; ndiqem, piqem, digjem, milem, vilem, mbillem, sillem, villem.

4. Foljet e këtij tipi që mbarojnë me k, g, kur mblidhet togu zanor në i k-në e bajnë q e g-në gj; p.sh. piqni, piqsha, të piqsha, piq, piqem; digjni, digjsha, të digjsha, digj, digjem.

5. Foljet apofonike që mbarojnë me grykoret k e g në temë, në të kryemen e thjeshtë, togun zanor ie e mbledhin në o dhe k-në e g-në, e kthejnë në q e gj në të gjitha vetat; p.sh.: poqa, poqe, poqi, poqëm, poqët, poqën; dogja, dogje, dogji, dogjëm, dogjët, dogjën.

6. Foljet tjera të këtij grupi togun zanor ie në të kryemen e thjeshtë në vetën e parë e të dytë të njajsit e mbledhin në o, kurse në vetat tjera e kthejnë në ue; p. sh.: mbolla, mbolle, mbuell a mbolli, mbuellëm a mbollëm, mbuellët a mbollët, mbuellën a mbollën; nxora, nxore, nxuer, a nxori, nxuerëm a nxorëm, nxuerën a nxorët, nxuerën a nxorën.

7. Emnat me ye shkruhen në njajës me kët tog zanor, kurse në shumës togun zanor ye e kthejnë në e; p. sh.: kapërcyell, kërcyell, krye, (njajës); kapërcej, kërcej, krenë (shumës). Por: skërfyell. (nj.), skërfyej (sh.), fyell (nj.), fyej (sh.).

8. Foljet me ye në kohën e tashme, në të pakryemen e dëftores e të lidhores dhe n'urdhnore shkruhen me tog zanor; p.sh. lyej, lyejsha, të lyejsha, lyej; fyej, fyejsha, të fyejsha, fyej; kryej, kryejsha, të kryejsha,

kryej. Përrjashtohen disa folje si me thye, me kthye etj., të cilat togun zanor e mbledhin në e; p.sh.: thej, thejsa, të thejsa, thej; kthej, kthejsa, të kthejsa, kthej.

9. Të gjitha foljet e pikës së sipërme togun zanor ye në njajsin e të së kryemes së thjeshtë e mbledhin në e, kurse në shumës e riejnë; p. sh.: leva, leve, leu, lyem, lyet, lyen etj.

10. Në pësore e vetvetore këto folje shkruhen me zanore të thjeshtë; p.sh.: lyhem, lyhesha, fyhem, fyhesha etj. Por: kthehem, kthehesha; thehem, lyem, lyet, lyen etj.

11. Emnat me ue si krue, ftue, prrue, patkue, drangue, langue, etj. gjatë lakimit e mbledhin këtë tog zanor në o; p.sh.: krue, kroni, kronit, kronin, krojet, krojevet, krojesh etj.

12. Disa emna me togun ue (që në toskënishten shkruhen vetëm me ua) e riejnë këtë tog në të gjitha rasat; p.sh.: buell, muej, duej etj.

13. E riejnë togun zanor ue në të gjitha rasat edhe emnat veprues; p.sh.: këndues, lexues, lëndues, mësues, pushtues etj.

14. Emnat truell e kapruell togun zanor ue nuk e mbledhin në o vetëm n'emnoren, kallxoren e thirroren e njajsit të pashquem; p.sh.: truell, trolli, trollit, trollin, troje, trojesh, trojevet; kapruell, kaprolli, kaprollit, kaprollin, kaproj, kaprojsh, kaprojvet.

15. Emnat me togun zanor ue do të shkruhen vetëm me o; p. sh.: krahnor, laknor, fjalor, drejtor, profesor, puntor etj. (e jo: krahnuer, laknuer, fjaluer, drejtuer, profesuer, puntuer etj.).

16. Gjithashtu edhe mbiemnat me togun zanor ue, analogjikisht me emnat e pikës 15, do të shkruhen vetëm me o; p.sh.: arsimor, javor, kryesor, popullor, shpirtnor, shtetnor, shoqnor, shkollor etj.

17. Në fjalët tjera, togu zanor ue do të ruhet i plotë; p.sh.: mue, due, muej, shkruaj etj., sepse në toskënishtet këtyne fjalëve u përgjigjen mua, dua, muaj, shkruaj, etj. Do të shkruhet me ue edhe fjalza tue.

18. Foljet me ue në trajtën pësore e vetvetore do të shkruhen me zanore të thjeshtë; p.sh.: kruhem, kruhesha; paguhem, paguhesha; shquhem, shquhesha etj. Togun zanor ue e mbledhin në o në të tri vetat e njajsit të së kryemes së thjeshtë në trajtën veprorë e pësore, si edhe në të dy trajtat e dëshirores; p.sh.: krova, u krova, krofsha, u krofsha; shkrova, u shkrova, shkrofsha, u shkrofsha etj.

19. Foljet që në pjesore mbarojnë me -jtë, si: gjuejtë, luejtë, riejtë, vuejtë etj. togun zanor e riejnë të plotë si në të kryemen e thjeshtë ashtu edhe në mënyrën dëshirore; p.sh.: gjuejta, luejta, quejta, riejta, vuejta etj.;

kokërr, kokrre, kokrra, kokrrës, kokrrën, kokrrat, kokrravet, kokrrash; i ulët, i uliti, t'ultit, t'ultin, t'ultit (por t'ulëtvet); e ulët, e ulta, s'ultës, t'ultën, t'ultat, t'ultavet, s'ultash.

6. Derivatet e sajume nga fjalët që mbarojnë më -ëm, -ën, -ër e humbin këtë ë; p.sh.: vetëm-vetmi, vetmitar, vetmoj, i vetmuem; gjarpën-gjarpnoj, gjarpnushë; lakën-laknor; emën-emnoj, emnim, emnorsim; urdhën-urdhnoj, urdhnim, urdhnore, urdhnesë; i epër-epror; letër-letrar; afër-afrim, afro; katër-kator; vepër-veprim, veprimtari, vepro; mjeshtër-mjeshtroj, mjeshtri; zemër-zemroj, zemrim, zemrohëm; tepër-teproj, teprim, tepricë, etj.

7. a) Emnat e prejardhur me mbarpashtesën -si duhet ta rrujë në ë-në e temës sa herë që para mbarpashtesës ndodhen dy a ma shumë bashkëtingëllore; p.sh.: randësi (e jo randsi), mundësi, nxehtësi, saktësi, mëshehtësi, fatbardhësi, ftohtësi, aftësi, shterpësi etj.

b) Emnat e prejardhur me këtë -si që dalin prej fjalëve që kanë vetëm një bashkëtingëllore para mbarpashtesës mund të shkruhen pa ë të temës; pra: gjuhsi, mirsi, mbarsi, gjithsi, dobsi, butsi, ngutsi, thellsi, kënaqsi, udhëheqsi, bimsi, parsi, gryksi etj., por mund të shkruhen edhe me ë të temës; pra: gjuhësi, mirësi, mbarësi, gjithësi, dobësi, butësi, ngutësi, thellësi, kënaqësi, udhëheqësi, bimësi, parësi, grykësi etj.

c) Emnat e prejardhur me -si, të cilët dalin prej fjalëve që s'kanë në temë -ë nuk marrin -ë për analogji para mbarpashtesës, por shkruhen: popullsi, nënshtetësi, miqsi etj.), e jo: popullësi, nënshtetësi, miqësi, etj.).

8. Emnat femnorë paroksitonë duhet të shkruhen me ë në fund në trajtën e pashqueme; p.sh.: bukë, fjalë, hundë, lopë, punë, etj dhe këto do ta mbajnë gjatë lakimit.

9. Analogjikisht me pikën e sipërme duhet të shkruhen me ë në fund edhe emnat mashkullorë që në trajtën e shqueme marrin nyjën a dhe lakohen si emnat femnorë; p.sh.: babë, Gegë, Toskë, Kolë, Llukë, Nikollë etj.

10. Me ë në fund duhet të shkruhen edhe emnat e gjinisë asnjansë, qofshin në trajtën e gjinisë asnjansë qofshin n'ate të mashkullores; p.sh.: ujë-ujët, ujë-ujë; djathë-djathët, djathë-djathi; mjaltë-mjaltët, mjaltë-mjalti; bru-më-brumët, brumë-brumi; drithë-drithët, drithë-drithi; dyllë-dyllët, dyllë-dylli; gjalpë-gjalpi, etj.

11. Të shkruhen me ë në fund emnat mashkullorë që shqiptohen me ë në toskënishtet e me zanore të gjatë në gegnishtet; p.sh.: burrë, djalë, gjumë, kalë, vjamë etj. Por lum.

12. Emnat femnorë oksitonë me a, e, i, o, u, në rasat e zhdrejta të

trajtës së shqueme të numrit njëjës do të shkruhen me ë në fund; p.sh.: kala-kalasë, kalanë; rrufe-rrufesë, rrufenë; qersh-qershisë, qershinë, byro-byrosë, byronë; dru-druja, drusë, drunë. Gjithë këta emna n'emnoren, kallxoren e thirroren e shumsit të shquem do të shkruhen me ë në fund, p.sh.: kalatë, rrufetë, qershitë, byrotë, drutë.

13. a) Emnat (mbiemnat) e prejardhun me -ës (-s) duhet ta riejnë ë-në e temës sa herë që nuk vjen mbas mbrapashtesës -ës (-s) një zanore; p.sh.: korrës, korrësvet, korrësja; mbjellës, mbjellësvet, mbjellësja, nëpunës, nëpunësvet, nëpunësja; nxanës, nxanësvet, nxanësja; zgjedhës, zgjedhësvet, zgjedhësja etj.

b) Këta emna mund të shkruhen dy mënyrash kur mbas mbrapashtesës -ës (-s) vjen një zanore; e para - mund ta riejnë ë-në e temës në të gjitha rasat; si: korrësi, i korrësit, korrësish, korrësit, korrëse, korrësen, korrëset; mbjellësi, mbjellësit, mbjellësin, mbjellëse, mbjellëses, mbjellëset; nëpunësi, i nëpunësit, nëpunësish, nëpunësit, nëpunëse, nëpunësevet, nëpunësesh; zgjedhësi, zgjedhësin, zgjedhësit, zgjedhësish, zgjedhëse, zgjedhëses, zgjedhëset etj.; e dyta - mund të mos e riejnë ë-në e temës; si: korrsi, i korrsit, korrsish, korrsit, korrese, korrsen, korrsset, nëpunsi, e nëpunsit, nëpunsish, nëpunsit, nëpunse, e nëpuneses, nëpuneses, nëpunsevet, nëpunesesh etj.

c) Kur gjindet para mbrapashtesës -s i njëjti tingull (dmth. -s-ja) si edhe tingulli t do të ruhet ë-ja në të gjitha rasat; p.sh.: presës - presësi, vrasës - vrasësi, vrasëse; tutës - tutësi, tutëse, shitës - shitësi, shitëse, i shitëses etj.

Gjithashtu do të ruhet ë-ja kur para mbrapashtesës -s gjinden dy ose më shumë bashktingëllore: bishtatundësi, i bishtatundësit, bishtatundësin; mundësi, e mundësit, mundësish, mundësit; bartësi, bartëse etj.

14. Ë-ja do të ruhet edhe n'emna të prejardhun më -ësh; p.sh.: pesësh - pesëshi, dhetësh - dhetëshi, katërkambëshit, i dhetëshit, pesëshat, i pesëshit etj.

15. Me t do të mbarojnë në shumsin e shquem emnat që në gegnishtet në trajtën e pashqueme të njëjtit kanë një zanore hundore; p.sh.: kalama-kalamajt; pe-pejt, mulli-mullijt; dru-druni-drujt (e jo kalamajtë, pejtë; mullijtë, drujtë).

16. Emnat femnorë me -ull e -ur që n'emnoren e shqueme të njëjtit janë proparoksitonë, si kumbulla, flutura, do të shkruhen n'emnoren e kallxoren e pashqueme të njëjtit pa ë në fund; p.sh.: kumbull, flutur.

17. Emnat mashkullorë oksitonë që mbarojnë me i të gjatë në shumsin e shquem duhet të shkruhen me t; p.sh.: barijt, zotnajt etj. (e jo: barijtë e

baritë, zotnijtë a zotnitë).

18. Emnat mashkullorë që mbarojnë në shumës të pashquem me rrokje të mbyllun, si edhe emnat abstraktë që vijnë nga mbiemnat njirrokësh në trajtën e shqueme të shumsit duhet të shkruhen me t; p.sh.: fiqt, miqt, zogjt, thojt, të keqt, të kuqt etj. (e jo fiqtë, miqtë, zogjtë, thojtë, të keqtë, të kuqtë etj.).

19. Ë-ja nuk duhet të shkruhet në fjalët e prejardhuna, të cilat në temë nuk e kanë këtë ë; p.sh.: paksoj, paksim; shoqni, shoqnoj; tregti etj. (e jo: pakësoj, pakësim; shoqëni, shoqënoj; tregëti etj.).

20. Emnat mashkullorë që e bajnë shumsin më -ën, -ëz e humbin ë-në në trajtën e shqueme; p.sh.: atë-etën, etnit (por etënvët); kunat-kunetën, kunetnit (por kunetënvët); prift-priftën, priftnit (por priftënvët); njeri-njerëz, njerzit (por njerëzvet) etj.

21. Disa emna asnjans e femnorë që e kanë në njajës ë-në, në shumës e humbin këte; p.sh.: djathë-djathna, ujë-ujna, erë-erna, cohë-cohna, kohë-kohna a kohë etj.

22. Ë-ja fundore e fjalës gjithë bie në fjalët e përngjituna, si: gjithçka, gjithherë, gjithçmos, gjithfarë, gjithkah, gjithkund, gjithkush, gjithmbarë, i gjithmbarshëm, gjithmonë, i gjithmonshëm, gjithnduersh, gjithnji, gjithqysh, gjithsaherë, gjithsecili, gjithsejt, gjithsesi.

23. Ë-ja nuk do të shkruhet në ndajfoljet aq, kaq e shum, si edhe në fjalët e përngjituna me to, si: aqsa, gjithaq, sakaq, shumfish, i shumfishtë, i shumllojshëm, i shumngjyrshëm, shumkush, shumsi. Gjithashtu pa ë do të shkruhen edhe fjalët: shumzim, shumzot, shumzor, i shumzuemi, shumzuesi.

24. Ë-ja ruhet në kompozita: p.sh.: bashkëpuntor, botëkuptim, qafëjatë, dorëheqje, udhëkryq, vetëdije, vetëvendosje, vetëvrasje, vetëveprim etj. Por: vetvete, vetvetiu, i vetvetishëm.

II. BASHKËTINGËLLORET

1. GRUPET BASHKËTINGËLLORE mb, nd, ng, ngj.

Grupet bashkëtingëllore mb, nd, ng, ngj do të ruhen të plota në shkrim, p.sh.: mbaj, mbret, mbin, mbasi, mbyll; ndaj, ndër, këndoj, këndeje, andej; ngarkoj, ngërthej; ngjall, ngjalë, ngjan etj. (e jo maj, mret, min, a bin, masi, myll; naj, nër, knoj a kënoj, kënej, anej; narkoj, nërthej, njall, njalë, njan etj.). Por: njomë, ulem, më, në e jo: i ngjom, ungjem, mbë, ndë).

2. FJALËT ME PARASHITESAT sh (ç), s (z), zh (xh)

1. Fjalët që nisin me bashkëtingëllore të pazashme e shqiptohen herë

me parashtesën sh e herë me parashtesën ç, do të shkruhen me parashtesën sh; p.sh.: shkallmoj, shkarkoj, shkujdesem, shkëmbej, shkul, shkoqitje, shndrit, shpall, shpagim, shpërblim, shpërlaj, shkatrim, shkëmbim, shkreh, shkëputje, shkokrojt, shkrihem, shlodhje, shlyej, shlyemje, shpërdorim, shpërdorim, shpërndaj, shpërnderoj, shpërnderim, shpërngul, shpërngulje, shpif, shpifje, shpifës, shpik, shpikës, shpikje, shpoj, shprish, shpronsoj, shpronsim, shpronsojes, shpulpoj, shpuploj, shpyllzim, shpyllzoj, shqep, shqetsim, shqetsoj, shqirrem, shquej, i shquem, shqyej, etj. Por: çkëshilloj, çkombtarizim, çkunorzoj, çkurdis, çthur.

2. Fjalët që nisin me bashkëtingëlloren f të ndjekun nga një zanore, do të shkruhen me parashtesën ç: çfajsoj, çfaq, çfaros, çfuqizoj, çfaqje, çfarosje, çfajsim.

3. Fjalët që nisin me bashkëtingëlloren f të ndjekun nga një l a r, do të shkruhen me parashtesën sh: shfletoj, shfryj, shfrej, shfryzim, shfrytzoj.

4. Fjalët që nisin me zanore dhe me bashkëtingëllore l, r, rr, m, n, nj, do të shkruhen me parashtesën ç: çansim, çarmatim, çarmatos, çorganizim, çorientim, çorientoj; çlirim, çliror, çlirimtar, çlodhje, (por edhe shlodhje); çregjistrim, çregjistroj, çrregullim, çrregulloj, i çrregullt, çrrethoj, çrranjor, çmallem, çmendinë, çmësohem, çmilitarizoj, çmobilizim, çmobilizoj, çnderim, çnderoj (por edhe shnderim, shnderoj), çnjerzor. Por: shlyej, shlyemje.

5. Fjalët që nisin me bashkëtingëlloret e zashme b, d, g, v, do të shkruhen me parashtesën zh, gjegjësisht xh: zhbij, zhbirojt, zhbrej, zhburrnojt; zhdaravis, zhdredhje, i zhddrejtë, zhdukem, i zhdërvjellët, zhdryj; zhgarkoj, zhgardhnojt, zhgreh, zhgrryjt, zhgul, zhguris; zhvillim, zhvillojt; xhvesh, xhvoshk (e jo çbij a shbij, çbirojt a shbirojt, çbrey a shbrey, çburrnojt a shburrnojt; çdaravis a shdaravis; çdredhje a shdredhje, i çdrejtë a i shdrejtë, çdukem a shdukem, i çdërvjellët a i shdërvjellët, çdryjt a shdryjt; çgarkoj a shgarkoj, çgardhnojt a shgardhnojt, çgreh a shgreh, çgrryjt a shgrryjt, çgul a shgul, çguris a shguris; çvillim a zhvillim, çvillojt a zhvillojt; çvesh a shvesh, çvoshk a shvoshk). Bajnë përjashtim fjalët: çbaj, çgjaksim, çgjaksom, çvendos, çvidhos, çflehtësojt a çvleftosoj, çvulos.

6. Parashtesa s shkruhet para një bashkëtingëllore të pazashme; p. sh.: skamje, skamnor, skamës, skuq etj., kurse parashtesa z para një bashkëtingëllore të zashme; p.sh.: zbraz, zbres, zbardh, zgjim, zgjoj etj. Po kështu shkruhen edhe fjalët tjera që fillojnë po me ato togje tingujsh: spastrim, sprovë, skutë, skërfyell, skërmit, stërvit; zbath, zbojt, zbokth, zmadhim, zmadhojt, zvetnim, zvetnojt, zverë, zvjerdhë, zvoglojt, etj.

3. FJALËT MË r e rr

Fjalët me r e rr do të shkruhen simbas shqiptimit të gegnishtes, pra me rr: rrah, rrafsh, rranjë, rrallë, rrap, rrasë, rrashtë, rregull, rranzë, rrapllimë, rrenë, rreckë, i rreptë, rrenim, rresht, rreth, rreze, rrezik, rrëmbim, rrëmujë, rrësim, rrëshqitje, rrjedhë, rrogë, rrogtar, rrokje, rrobe, rrotë, rrotull, rrudhë, rrufe, rrufë, rrugë, rrush, rruzull, rrymë, rryp; andërr, derr, marr, marrëdhanie, marrëveshje, ndërmarrje, prallë, prrue, nxjerr, turr, vjerr, tjerr etj. Por do të shkruhen me r fjalët: radhë, ranë, respekt, rënkim, vjershë, rol, Romë, roman, rjep, rob, repë, mora, nxora etj.

4. FJALËT MË s e z

Edhe fjalët që shkruhen herë me s e herë me z, do të shkruhen simbas shqiptimit ma të përhapun të gegnishtes. Me s do të shkruhen: ujdhesë, mëngjes (por mëngjezi), mes, mesatar, haptas, (por haptazi), qartas (por qartazi), lehtas (por lehtazi), baras, barasim, konservim, president, presidium, universitet etj., kurse me z: brez, ekzekutiv, ekzekutoj, ekzistoj, ekzistencë, njerëz, vidhëz etj.

5. FJALËT MË th e f

Fjalët që shkruhen me th e f do të përdoren simbas shqiptimit ma të përhapun, me th: thellë, thellsi, thellsinë, therrë, i kthjellët etj., kurse me f: fëllanzë, ufull etj. (e jo thëllanzë, uthull).

6. FJALËT MË l, ll, dh

Do të shkruhen me l: lurbë, filozof, lokandë, lustër, psikolog, sociolog, valë, vulë etj., me ll: Gadishulli Ballkanik, vullkan, lloç, llom, llogore, llogari, etj., me dh: ndodh, dhomë, dhamb etj.

7. FJALËT MË ç e q

Do të shkruhen me ç: veç, përveç, çadër, çdo, çel, çoj, çekiç, çengel, çerdhe, çarapë, çift, çiflik, çifçi, çibuk, çiban, çikrik, çirak, çizme, çark (vegël) etj., kurse me q: qafë, qark (rreth), qebap, qel, qeros, qelq, qingël, qeramidhe, qerpiç, qerpik, qek, qilim, qira, qiriç, qofte, qokë, squkë etj.

8. FJALËT MË q e k (kj)

Fjalët që shkruhen herë me q e herë me k e kj, do të shkruhen vetëm me q; p.sh.: heq, tërheq, udhëheq, qartë, qartas, qaj, sqep, etj. (e jo: hek, tërhjek, udhëhjek, kjartë, kjartas, kjaj a kaj, skjep etj.). Por: shikoj, parashikim, shikue.

III. THEKSI E APOSTROFI

1. THEKSI

Për punë thjeshtimi e lehtësimi të shkrimit, theksi do të përdoret vetëm në paronime; p.sh.: pusi e pusí, drejtori (person) e drejtorí (zyrë), asht e âsht, bân (me bâ) e ban (me bajtë), pra e prâ etj.

- Shënim: Nëqoftëse dallohet kuptimi nga konteksti lehtë, atëherë as në këto pak raste nuk duhet me i përdorë theksat.

2. APOSTROFI

Apostrofi do të përdoret vetëm në disa raste kur bie ë-ja.

1. Te përemnat vetorë proklitikë më e të kur ndodhen:

a) përpara proklitikës i; p.sh.: m'i dha, t'idha, m'i muer, t'i muer, etj. (e jo më i dha, të i dha, më i muer, të i muer etj.);

b) përpara të së kryemes së thjeshtë të pësores e vetvetores që e ka përpara zanoren u; p.sh.: m'u muer goja, t'u dha e drejta etj. (e jo: më u muer goja, të u dha e drejta etj.);

c) përpara foljevet që fillojnë me zanore; p.sh.: m'erdhi, t'erdhi, m'arriti, t'arriti, m'agoi, t'agoi etj. (e jo: më erdhi, të erdhi, më arriti, të arriti, më agoi, të agoi etj.).

2. Në lidhën të kur ndodhet:

a) përpara përemnavet vetorë proklitikë i, u, ia, ju, jua, ua; p.sh.: t'i shkrujesh, t'u japish çka kërkujnë, t'ia them, t'ju vijë mirë, t'jua mbushi mendjen, t'ua marrish librat etj. e jo: të i shkruesh, të u japish çka kërkujnë, të ia them, të ju vijë mirë, të jua mbushi mendjen, të ua marrish librat etj.);

b) përpara foljevet që fillojnë me zanore; p.sh.: t'iki, t'agojë, t'arrijë, t'arrijë etj. (e jo: të iki, të agojë, të arrijë, të arrijë etj.).

3. Në nyjën të t'emnave të nyjshëm që fillojnë me zanore; p.sh.: t'ardhunat, t'ejten, t'ikunit, t'ecunit, t'endunit etj. (e jo: të ardhurat, të ejten, të ikunit, të ecunit, të endunit etj.).

4. Në nyjet e lidhuna të e së përpara fjalëvet që fillojnë me zanore; p.sh.: djalit t'urtë, prej kallinit t'artë, vajzës s'urtë etj. (e jo: djalit të urtë, prej kallinit të artë, vajzës së urtë etj.).

5. Në parafjalën në kur mbas saj vjen një fjalë me zanore; p.sh.: n'arë, n'ato, n'Egjipt, n'oborr, n'orën, etj. (e jo: në arë, në ato, në Egjipt, në oborr, në orën etj.).

6. Në përemnin e mbiemnin pyetës ç, si para një zanorje ashtu edhe para një bashkëtingëllorje; p.sh.: ç'asht, ç'pyetje, ç'ban, ç'do, ç'burrë etj.

7. Në ndajfoljen e mohimit s' që shkruhet gjithmonë me apostrof para

zanorevet e bashkëtingëlloreve; p.sh.: s'asht, s'e di, s'duhet, s'kam, s'jam, s'punoj etj.

8. Në raste tjera, kur ë-ja fundore e fjalëvet përpiqet me fjalët tjera që nisin me zanore, nuk apostrofohet: p.sh.: vajzë e urtë, djalë i mirë, fushë e gjanë, që atëherë, shkojmë atje, u thanë atyne, shtëpinë e madhe, hanë e pinë etj. (e jo: vajz' e urtë, djal' i mirë, fush' e gjanë, q'atëherë, shkojm' atje, u than' atyne, shtëpin' e madhe, han' e pinë etj.).

9. Nuk apostrofohen edhe përemnat e mbiemnat çfarë e çdo.

10. E-ja apostrofohet vetëm në mbiemnin pronor jote kur gjindet para emnit amë jot' amë, (e jo jote amë).

- Shënim: Për trajtat ma, ta shih kapitullin Morfologjia - Përemnat vetorë.

-

IV. FJALËT ME BURIM TË HUEJ

Fjalët e hueja do të shkruhen simbas këtyne rregullave:

1. FJALËT MË ia, ie, io

Fjalët greke, latine e neolatine me ia, ie e io, do të shkruhen me i dhe jo me j, si: akcion, aviacion, aziatik, diabetik, diafragmë, diagnozë, diagonale, diagram, dialekt, dialektikë, dialektologji, dialog, diamant, diametër, entuziazëm, epikurian, esencial, fiasko, financiar, gjenial, hiat, imperialist, industrial, iniciativë, iniciator, italian, kambial, kardiak, kredencialet, kristian, kolegjal, kolonial, labial, labiatet, liliacet, makiavelizëm, material, materialist, materializëm, matriarkat, miazmë, miliardë, miniaturë, miriapodët, noterial, olimpiadë, patriark, patriarkal, patriarkat, pediatri, persian, pianist, piano, potencial, proverbial, provincial, provincializëm, psikiatër, psikiatri, radiator, sekretariat, socialist, socializëm, socializim, special, specialist, specialitet, specializim, arie, abiturient, ambient, bentonier, bankier, barierë, financier, higjienë, infermier, kantier, karierë, karierist, karrocier, kavalier, kamerier, klient, koeficient, korier, magazinier, minierë, motovelier, muzicient, oficiel, portier, premierë, principiël, relief, rentier, romancier; abstracion, agjitacion, ambicion, ambicioz, akcion, afion, asimilacion, batalion, deklinacion, delegacion, diskriminacion, diversion, divizion, dominion, ekspansionist, ekspansionizëm, ekuacion, embrion, embrional, emigracion, emulacion, emulsion, evolucion, fiziologji, fizionomi, fluktuation, formacion, funksion, funksionim, funksionar, gjeneracion, iktiologji, iluzion, imitacion, inflamacion, injekcion, inklinacion, inkuzicion, inovacion, inspiracion, institucion, instruksion, interjekcion, internacional,

internacionalizëm, intuicion, investicion, izolacion, juridikcion, kamion, kampion, kampionat, koalicion, kohezion, komunikacion, koncesion, kondicional, kongjestion, konkluzion, kontrakcion, konvencional, kuestionar, legjionar, legjislacion, lekcion, licitacion, lokucion, milion, mision, motivacion, municion, nacional, nacionalitet, nacionalizim, obstrukcion, obstrukcionista, obstrukcionizëm, pozicion, procesion, profesion, profesional, profesionalist, progresion, projekcion, proporcion, prostitucion, provokacion, racion, racional, racionalist, racionalizator, racionalizëm, racionalizim, radio, reacion, reacionar, recension, refleksion, revizion, revizionim, revizionizëm, revolucion, revolucionar, sanksion, sekcion, selekcionim, sensacion, studio, supersticion, superstacioz, l televizion, transmision, union, variacion, vegjetacion, violencë, violinë, violinist, etj.

Fjalët: materje, malarje, sovjet, sovjetik, fjorë, shkruhen me j, sepse janë rranjosë në shqipet me këtë shqiptim.

2. FJALËT GREKE MË y (IPSILO)

Fjalët greke me y (ipsilon) në shqipet do të shkruhen me i; p. sh.: analizë, etimologji, fizikë, gjimnaz, gjimnastikë, higjienë, himn, hiperbolë, hipertrofi, hipotezë, hipokrit, hipotenuzë, metonimi, psikologji, sinekdokë, sintaksë, sintezë.

3. FJALËT MË c

Fjalët e hueja me c nga burimi latin a neolatin do të shkruhen me c e jo me s, si: akcion, aviacion, iniciativë, iniciator, financiar, agjitacion, celebrim, central, abstracion, ambicion, ambicioz, asimilacion, delegacion, deklinacion, diskriminacion, ekuacion, emigracion, emulacion, evolucion, formacion, funksion, gjeneracion, imitacion, infekcion, inklinacion, inkuzicion, inovacion, inspiracion, institucion, instrukcion, interjekcion, internacional, intuicion, investicion, izolacion, juridikcion, koalicion, kolekcion, kombinacion, kompozicion, komunikacion, koncesion, kondicional, koniukcion, kontradikcion, konvencional, legjislacion, lekcion, licitacion, lokucion, motivacion, municion, nacional, obstrukcion, potencial, procedurë, proces, projekcion, proporcion, prostitucion, provokacion, racion, reacion, revolucion, selekcion, sensacion, special, stacion, supersticion, variacion, vegjetacion.

Fjalët sanksion, seksion e fjalët tjera të një tipi me to, simbas shqiptimit ma të përgjithshëm, shkruhen me ks e jo me kc.

4. FJALËT MË ks (x)

Fjalët latine me ks do të shkruhen me kz, kur ky grup ndodhet përpara një zanorje, kurse me ks, kur ai ndodhet përpara një bashkëtingëllorje, p.sh.: ekzekutiv, ekzekutoj, ekzistencë, ekspeditë, eksperiencë. Fjalët greke e riejnë ks-në në çdo rast; p.sh.: aksionë, heksametër, oksigjen.

5. FJALËT MË d e t

Fjalët ndërkombëtare të formueme me elemente të burimit grek do të shkruhen me d e t dhe jo me dh e th; p.sh.: dialektikë, pedagogji, Herodot, Iliada, Odiseja, metodë, metodikë, aritmetikë, etnik, etnografi, hipotenuzë, hipotezë, kartotekë, matematikë, ortografi, simpati, sintezë, teatër, tematikë, temë, tez, teolog, Atinë, Etiopi, Teba, Termopilet, Korinti.

6. FJALËT MË g

Fjalët me burim grek a latin që kanë një g përpara zanorevet i dhe e shkruhen me gj ashtu si shqiptohen; p.sh.: agjenci, agjitacion, borgjezi, elegji, gjeografi, gjeometri, gjeneratë, gjenezë, gjimnastikë, higjienë, legjion, legjislativë, origjinë, vegjetacion etj.

7. FJALËT MË h

Fjalët me h nga burimi grek a latin do të shkruhen me h edhe në shqipet; p.sh.: harmoni, heterogjen, hidraulik, hidrografi, hidrohigjienë, himn, hipodrom, hipokrit, hipotezë, histologji, histori, homogjen, homonim, horizont, horizontal, humanizëm, hemisferë, koherent, kohezion, hiat, heksametër, hibrid, honorar, hiperbolë, hipotekë, Hesiod, Hipokrat, Homer, Horac etj.

8. FJALËT MË k

1. Fjalët e terminologjisë teknike-shkencore, që janë me k në greqishten e vjetër, shkruhen me k edhe në shqipet; p.sh.: kinema, kimi, kitarë, klinikë etj.

Por do të shkruhen me q emnat si Maqedoni, dioqezë etj.

2. Fjalët greke me k përpara një y (ipsiloni) në shqipet shqiptohen e shkruhen me ci; p.sh.: cikël, ciklop, ciklostil, cilindër, cinik, cinizëm.

3. Fjalët me h të fortë në trup të fjalës në greqishten e vjetër në shqipet shkruhen me k, p.sh.: anakronizëm, anarki, arkaizëm, arkeologji, arkitekturë, arkiv, Akileu, Eskili, Arkiloku.

9. FJALËT MË s

Fjalët me burim grek e latin me një s intervokalike, në shqipet shqiptohen e shkruhen me z, p.sh.: filozofi, fizikë, fiziologji, hipokrizi, hipotenuzë, muzikë, rezolucion, sintezë, muze, Azi.

10. FJALËT MË l

Fjalët me l, që kanë origjinë greke ose vijnë prej ndonji gjuhe tjetër europiane, do të shkruhen me l e jo me ll, p.sh.: analizë, analogji, arkeologji, antologji, biologji, blok, deklaratë, diplomë, fiziologji, gjeologji, ideologji, ilustrim, koloni, komplot, logaritëm, logjikë, mineralogji, neologjizëm, psikologji, silogjizëm, spekulim, etj. Por do të shkruhen me ll: llogari, llogaritar, kontroll, kontrollim, kontrolloj, kontrollor, vullkan (e jo: logari, logaritar, kontrol, kontrolim, kontroloj, kontrolor, vulkan).

Fjalët sllave me l të fortë (ll) në mes të fjalës do të shkruhen edhe në shqipet me ll: Çekosllavak, Sllav, sllavisht, Jugosllavi, jugosllav, Sllovak, slllovakisht, Sllavoni, Slloveni, sllovenisht, Sllloenski Shollohov, Millan, Milladin, Millovan, Milloje, Millutin, etj. Por, kur mbas këtij tingulli vijnë zanoret i dhe e, që në sllavishtet shqiptohet ma butë se ll-ja e shqipes, do të shkruhen me l dhe jo me ll; p.sh.: Gligorije, Glisha, Milentije, Milica, Mileva etj. (e jo: Glligorije, Gllisha, Millentije, Millica, Milleva etj.).

Fjalët me l në fillim dhe në fund të fjalës shqiptohen dhe shkruhen në shqipet kurdoherë me l, pamvarsisht nga shqiptimi që kanë në gjuhën nga janë marrë; p.sh.: Bajkal, Ladoga, Lenin, Leningrad, Lermontov, Ural etj. Por Llaza Llazareviq.

11. FJALËT MË r

Fjalët e hueja me r do të shkruhen me r dhe jo me rr edhe n'ato raste kur në gjuhën e origjinës shkruhen me dy r (rr); p.sh.: konkurrencë, konkurs, korespondent, koridor, rebel, regjistër, rol, Romë, romak, romantizëm etj.

12. FJALËT MË oo

Fjalët e hueja me dy o (oo) do të shkruhen me oo edhe në shqipet; p.sh.: alkool, alkoolik, alkoolizëm; kooperativë, kooperativist, kooperativizëm, kooperim, kooperohem, i kooperuem; kooptim, kooptoj, koordinatat, koordinim, koordinoj; zoolog, zoologji, zoologjik, zootekni, zooteknik.

13. FJALËT MË b

Fjalët me burim të huej, që shkruhen me b, do të shkruhen me b edhe

në shqipet; p.sh.: absolut, absolutisht, absolutizëm, absorboj, abstenim, abstenoj, abstrakcion, abstrakt, absurd, absurditet, abshise (e jo: apsolut, apsolutisht, apsolutizëm, apsorboj, apstenim, apstenoj, apstrakcion, apstrakt, apsurd, apsurditet, apshise).

B. MORFOLOGJIA

I. EMNAT

1. EMNAT FEMNORË MË ë

Emnat femnorë paroksitonë, që në trajtën e pashqueme mbarojnë me ë, do të shkruhen me ë, pamvarsisht nga shqiptimi i këtij tingulli në të folun; p.sh.: barrë, bletë, bukë, fjalë, flakë, fletë, gjuhë, hundë, kambë, lopë, lugë, pemë, punë etj.

Këta emna e ruejnë ë-në gjatë lakimit, në njajës e në shumës; p.sh.: punë, punës, punën, punë, punëve, punësh, punët, punëvet; pemë, pemës, pemën, pemë, pemëve, pemësh, pemët, pemëvet; kambë, kambës, kambën, kambë, kambëve, kambësh, kambët, kambëvet etj.

Fjalët ditë e natë edhe në shumsin e pashquem do të shkruhen me ë, pamvarsisht nëse ndihet ky tingull apo jo në të folun: ditë e netë (e jo dit e net).

2. EMNAT FEMNORË MË -a, -e, -i, -o, -u

1. a) Emnat femnorë që mbarojnë më -a, -e, -o, -u të theksueme, në rasat e zhdrejta të njajsit të pashquem dhe n'emnoren e shqueme, marrin, përveç mbaresës rasore -e dhe nyjës së mbrapme -a, edhe një j eufonike (epentetike); p.sh.: gja-gjaje, gjaja, hua-huaje, huaja: kala-kalaje, kalaja; mera-meraje, meraja; fe-feje, feja; fole-foleje, foleja; re-reje, reja; rrufe-rru-feje, rrufeja; ve-veje, veja; byro-byroje, byroja; Baku-Bakuje, Bakuja; Ba-tu-Batuje, Batuja; dru-druje, druja; û-je, uja etj.

b) Emnat femnorë që mbarojnë më i të theksueme, në rasat e zhdrejta të njajsit të pashquem edhe n'emnoren e shqueme mund të shkruhen me j ose pa te; p.sh.: shtëpi-shtëpije a shtëpie, shtëpija a shtëpia; liri-lirije a lirie, liriya a liria; selvi-selvije a selvie, selvija a selvia; shprehi-shprehije a shprehie, shprehija a shprehia; dhi-dhije a dhie, dhija a dhia; Jugosllavi-Jugosllavije a Jugosllavie, Jugosllavija a Jugosllavia etj.

2. Kët j eufonike e marrin edhe:

a) emnat femnorë që mbarojnë me e të patheksueme; p.sh.: cule-culje, culja; dele-delje, delja; lule-lulje, lulja; zhele-zhelje, zhelja etj.;

b) emnat mashkullorë që mbarojnë me o të theksueme; p.sh.: laro-

laroje, laroja; murro-murroje, murroja etj.;

c) emnat mashkullorë që mbarojnë me o të patheksueme, p.sh.: Beqo-Beqoje, Beqoja; balo-baloje, baloja; Koço-Koçoje, Koçoja; Meto-Metoje, Metoja; Pirro-Pirroje, Pirroja etj.

3. Emnat femnorë që mbarojnë me -a, -e, -i, -o, -u të theksueme, në rasat gjindore, dhanore e rrjedhore të njajsit të shquem, do të shkruhen me -së dhe në rasën kallxore me -në; p.sh.: gja-gjasë, gjanë; hua-huasë, huanë; kala-kalasë, kalanë; mera-merasë, meranë; fe-fesë, fenë; fole-folesë, folenë; ide-idesë, idenë; re-resë, renë; rufe-rrufesë, rrufenë; ve-vesë, ve-në; dhi-dhisë, dhinë; Jugosllavi-Jugosllavisë, Jugosllavinë; liri-lirisë, lirinë; selvi-selvisë, selvinë; shprehi-shprehisë, shprehinë; shtëpi-shtëpisë, shtëpinë; byro-byrosë, byronë; dru-drusë, drunë etj.

N'emnoren e kallxoren e shumsit të shquem këta emna do të shkruhen me të p.sh.: huatë, kalatë; fetë, foletë, retë, rrufetë, vetë, shprehitë, shtëpitë, byrotë, drutë etj. dhe në rrjedhoren e shumsit të pashquem me -sh (e jo -shë); p.sh.: huash, kalash; fesh, folesh, resh, rrufesh; shprehish, shtëpish, byrosh, drush etj.

3. EMNAT FEMNORË MË -je

Emnat femnorë foljorë me mbrapashtesën -je e ruejnë j-në në trajtën e pashqueme dhe të shqueme të njajsit e të shumsit; p.sh.: ardhje, derdhje, dredhje, dridhje, dalje, kapje, korrije, lidhje, marrje, mbështetje, ndodhje, pritje, prishje, shitje, tretje, si edhe: dije, pije, bashkë me derivatet e tyne, si: dijeni, dijetar, pijetore etj. Por ku bashkohet j-ja me n-në, do të shkruhen nie dhe jo nje; p.sh.: dhanie, marrëdhanie, parathanie, zanie etj. Kështu do të shkruhet edhe gie dhe jo gje djegie (e jo djegje), shmangie, lagie etj. Me j do të shkruhen edhe emnat femnorë me -ije dhe -ijë, në të cilët j-ja i përket temës së fjalës dhe ndihet kudo; p.sh.: anije, anija; fije, fija; shije, shija; bijë, bija; mijë, mija; vijë, vija, fëmijë, fëmija, fëmijët a fëmi, fëmija, fëmijt etj.

4. EMNAT FEMNORË MË jë

Emnat femnorë më -jë do të shkruhen me -një (e jo me -jë); p.sh.: brinjë, shkronjë, ulkonjë, rranjë, banjë etj. por mburojë.

5. EMNAT FEMNORË MË MBRAPASHTESËN -z (ë)

1. Ë-ja fundore e mbrapashtesës zvogluese -zë kur u ngjitet emnave femnorë paroksitonë (e rrallë emnave mashkullorë) bie: p.sh.: copëz,

degëz, dorëz, dosëz, drrasëz, dhambëz, gjuhëz, hanëz, shkurtëz, vashëz etj.

2. Ë-ja e temës së këtyne emnave bie gjatë lakimit në njajës e shumëz, si në trajtën e pashqueme ashtu edhe në trajtën e shqueme; p.sh.: copëz, copze, copzës, copzën, copza, copzave, copzash, copzat, copzavet; degëz, degza, degzës, degzën, degza, degzave, degzash, degzat, degzavet; dorëz, dorze, dorza, dorzës, dorzën, dorza, dorzave, dorzash, dorzat, dorzavet etj.

3. Ë-ja e temës së këtyne emnave ruhet kur para ë-së gjenden tingujt -s, sh dhe t; p.sh.: dosëz, dosëze, dosëza, dosëzës, dosëzën, dosëza, dosëzave, dosëzave, dosëzash, dosëzat, dosëzavet; vashëz, vashëze, vashëza vashëzës, vashëzën, vashëza, vashëzave, vashëzash, vashëzat, vashëzavet; drrasëz drrasëze, drrasëza, drrasëzës, drrasëzën, drrasëza, drrasëzave, drrasëzash, drrasëzat, drrasëzavet; dritëz, dritëze, dritëza; shpatëz, shpatëze, shpatëza, i shpatëzës etj.

4. Ë-ja e mbrapashtesës zvogluese -zë ruhet, kur u ngjitet emnavet femnorë oksitonë, p.sh.: lajthizë, qelizë, shtëpizë, vezë etj.

6. EMNAT FEMNORË MË -ull e -ur

Emnat femnorë me -ull e -ur, që n'emnoren e shqueme të njajsit janë proparoksitonë, si p.sh.: rregulla, flutura, do të shkruhen pa ë-në fundore n'emnoren e kallxoren e pashqueme të njajsit; p. sh.: kërdhokull, kumbull, ndrikull, mjegull, nofull, rregull, strofull, shpatull, ufull, vetull; flutur, etj.

Këta emna në gjindore, dhanore, kallxore e rrjedhore të njajsit të shquem e ruejnë ë-në; p.sh.: kumbulla-kumbullës, kumbullën; flutura, fluturës, fluturën etj.

Po ashtu këta emna e ruejnë edhe u-në mbastheksore gjatë lakimit në njajës e shumëz, si në trajtën e pashqueme ashtu edhe në trajtën e shqueme; p.sh.: vetull-vetulle, vetulla, vetullës, vetullën, vetulla, vetullave, vetullash, vetullat, vetullavet; flutur-fluture, flutura, fluturës, fluturën, flutura, fluturave, fluturash, flutuat, fluturavet etj.

7. EMNAT FEMNORË ME më

Emnat femnorë të parmë e të prejardhun, që diku shqiptohen me -më, e diku me -ëm, do të shkruhen me -më, p.sh.: darsmë, krisëm, gjysëm, ndihmë etj. (e jo: darsëm, krisëm, gjysëm, ndihëm etj.).

8. EMNAT FEMNORË MË -ël, -ën, -ër, -ërr

Emnat femnorë më -ël, -ën, -ër, -ërr, e humbin ë-në gjatë lakimit në njajës e shumëz, si në trajtën e pashqueme ashtu edhe n'ate të shqueme:

gogël- gogle, gogla, goglës, goglën, gogla, goglave, goglash, goglat, goglavet; femën-femne, femna, femnës, femnën, femna, femnave, femnash, femnat, femnavet; zemër-zemre, zemra, zemrës, zemrën, zemra, zemrave, zemrash, zemrat, zemravet; kokërr-kokrrë, kokrra, kokrrës, kokrrën, kokrra, kokrrave, kokrrash, kokrrat, kokrravet. Kështu shkruhen edhe emnat: vegël, pendël, dhelpën, thekën, gënjeshtër, kandër, kthetër, thundër, vedër; andërr, mjekërr, vjehërr etj.

9. EMNAT MASHKULLORË MË -ë

Do të shkruhen me ë në fund n'emnoren e kallxoren e trajtës së pashqueme:

a) disa emna që në përgjithsi tregojnë landë, pamvarsisht se a përdoren në gjininë mashkullore apo asnjanse, p.sh.: brumë-brumi ose brumë-brumët; djathë-djathi ose djathë-djathët; drithë-drithi ose drithë-drithët, dyllë-dylli ose dyllë-dyllët; grunë-gruni ose grunë-grunët; mjaltë-mjalti ose mjaltë-mjaltët; ujë-uji ose ujë-ujët etj.

b) emnat mashkullore që në trajtën e shqueme marrin nyjën a dhe shkojnë mbas lakimit t'emnavet femnorë: p.sh.: babë, bacë, Gegë, Kolë, lalë, Lekë, Llukë, Toskë, etj.

c) disa emna mashkullore, si: ballë, burrë, djalë, gjumë, kalë. Por lum (e jo lumë).

10. EMNAT MASHKULLORË MË -ël, -ën, -ër, -ërr

Emnat mashkullore me -ël, -ëm, -ën, -ër, -ërr, si: tambël, pezëm, emën, bakër, vjehërr etj. humbin ë-në gjatë lakimit, me përjashtim t'emnores e kallxores njajës të pashquem, në të gjitha rasat e njajësit e të shumsit, si në trajtën e pashqueme ashtu edhe n'ate të shqueme; p.sh.: tambël-tambli, tamblit, tamblin; emën-emni, emnit, emnin, emna, emnave, emnash, emnat, emnavet; bakër-bakri, bakrit, bakrin; vjehërr-vjehërrri, vjehërrit, vjehërrin, vjehërrit (por vjehërrvet).

11. EMNAT MASHKULLORË MË -ull e -ur

Emnat mashkullore me -ull e -ur, e rruajnë u-në patheksore gjatë lakimit; p.sh.: akull-akulli, akullit, akullin; brumbull-brumbulli, brumbullit, brumbullin; kungull-kungulli, kungullit, kungullin; popull-populli, popullit, popullin; flamur-flamuri, flamurit, flamurin; hekur-hekuri, hekurit, hekurin; lepur-lepuri, lepurit, lepurin etj.

12. EMNAT MASHKULLORË MË -izëm

Emnat e terminologjisë shkencore e fjalë tjera ndërkombtare që mbarojnë më -izëm, e humbin ë-në e mbrapashtesës gjatë lakimit; p.sh.: komunizëm-komunizmi, komunizmit, komunizmin; idealizëm-idealizmi, idealizmit, idealizmin; patriotizëm-patriotizmi, patriotizmit, patriotizmin; realizëm-realizmi, realizmit, realizmin; romantizëm-romantizmi, romantizmit, romantizmin; reumatizëm-reumatizmi, reumatizmit, reumatizmin; socializëm-socializmi, socializmit, socializmin etj.

13. EMNAT MË -amë, -emë, -omë

Emnat e burimit grek më -amë, -emë, -omë, në shqipet janë në përgjithsi të gjinisë femnore; p.sh.: dramë-drama, emblemë-emblema, poemë-poema, teoremë-teorma, aksiomë-aksioma.

Këta emna shumsin e bajnë më -a: drama-t, emblema-t, poema-t, teorema-t, aksioma-t.

Disa emna të kësaj katgorije janë të gjinisë mashkullore dhe shkruhen pa ë në fund: program-programi; problem-problemi, sistem-sistemi etj. dhe shumsin e bajnë më e: programe-t, probleme-t, sisteme-t.

14. EMNAT ABSTRAKTË QË FORMOHEN NGA MBIEMNAT E PJESORET

Emnat abstraktë që formohen nga mbiemnat e pjesoret, trajtën e shqueme e kanë me -ët, nëse vijnë nga mbiemnat e nga pjesorja që mbarojnë me ë: i butë, të butët; i naltë, të naltët; i randë, të randët; dalë, të dalët; thanë, të thanët etj.

Emnat abstraktë e kanë trajtën e shqueme me -it, nëqoftëse formohen nga mbiemnat që mbarojnë me -ët a -të dhe nga pjesoret që mbarojnë me bashkëtingëllore; p.sh.: të ftohët, të ftohtit; ikun, t'ikun, t'ikunit; folun, të folun, të folunit etj.

Emnat abstraktë që formohen nga mbiemnat njirokësh trajtën e shqueme e bajnë me -t; psh.: të keqt, të kuqt, të madht. Por të zitë.

15. EMNAT E MBIEMNAT MË -ian, -jam

Emnat e mbiemnat që formohen nga emnat e vendeve të huaja me -i dhe e marrin mbrapashtesën -an, do të shkruhen më -ian (e jo -jan), p. sh.: Austri, Austrian-e; Australi, Australian-e, australian-e; Itali, Italian-e, italian-e; Indi, Indian-e, indian-e, etj. Po kështu do të shkruhen me i dhe jo me j emnat e mbiemnat analogë me mbrapashtesën -ian, psh.: Brazilian-e,

brazilian-e; European-e, european-e etj.

Disa emna shqip që tregojnë banorët e një vendi e kanë mbrapashtesën -jan (të shumtën e herës ajo është rezultat i zhvillimit të mbrapashtesës -njan); p.sh.: Lumë, Lumjan; Mat, Matjan, Shalë, Shaljan.

16. EMNAT MASHKULLORË MË -ue

Emnat mashkullorë që mbarojnë me -ue, në rasat e zhdrejta dhe në trajtën e shqueme të njajstit togun zanor e kthejnë në o dhe para nyjës dhe mbaresës rasore i marrin një n, p.sh.: ftue-ftoni, ftonit, ftonin; krue-kroni, kronin; thue-thoni, thonit, thonin; prrue-prroni, prronit, prronin etj.

17. SHUMSI I EMNAVE

1. Emnat dhe mbiemnat mashkullorë që mbarojnë më -ac, -aç, -ak, -al, -an, -ant, -aq, -ar, -at, -ec, -ent, -er, -ik, -ist, -it, -jan, -nik, -ok, -or, -ot, -tar, -tor, - uk, në shumës do të shkruhen me ë (dhe jo me a ose e) dhe këte e riejnë në të gjitha rasat e shumsit; p.sh.: përtac, përtacë; rruç, rruçë; dinak, dinakë; kuqal, kuqalë; industrial, industrialë; zeshkan, zeshkanë; praktikant, praktikantë; hutaq, hutaqë; argjendar, argjendarë; Vlonjat-Vlonjatë; kambanec-kambanecë; student, studentë; oficer, oficerë; cilindrik, cilindrikë; komunist, komunistë; selenit, selenitë; Shaljan, Shaljanë; besnik, besnikë; misrok, misrokë; drejtor, drejtorë; Suliot-Suliotë; peshkatar, peshkatarë; puntor, puntorë; vjeshtuk, vjeshtukë etj.

2. Emnat që shënojnë banorin e një vendi e krahine të huej dhe mbiemnat që lidhen me ta, e bajnë rregullisht shumsin me ë, p.sh.: Grekë, grekë; Gjermanë, gjermanë; Rusë, rusë, Rumunë, rumunë, Serbë, serbë; Kroatë, kroatë; Sllovenë, sllovenë etj.

Por nuk marrin ë emnat e mbiemnat që në njajës mbarojnë me dy bashkëtingëllore, nga të cilat fundorja është një k a g; p.sh.: Turk-turq; Freng-Frengj, freng-frengj etj.

3. Emnat mashkullorë që e bajnë shumsin e pashquem më -ën, n'emnoren e kallxoren e shumsit të shquem e humbin ë-në dhe para nyjës t marrin një i anaptike, atë-etën, etënve, etnit; mbret-mbretën, mbretënve, mbretnit; nip-nipën, nipënve, nipnit; gjysh-gjyshën, gjyshënve, ghyshnit; prift-priftën, priftënve, priftnit etj.

4. Emnat mashkullorë që e formojnë shumsin e pashquem me -j, në shumsin e shquem marin t (dhe jo të), p.sh.: gjarpij-t, lamalaj-t, mullij-t, ullij-t, dej-t, etj. Kështu shkruhen edhe emnat mashkullorë që marojnë më -ull e -ur; p.sh.: kungull-kunguj-t, brumbull-brumbuj-t; flamur-flamuj-t,

lepur-lepuj-t etj.

5. Emnat mashkullorë që mbarojnë më -as, -ës, -ues, shumsin e pashquem e kanë të njajtë me njajsin e pashquem dhe në trajtën e shqueme para nyjës t marrin një i anaptike; p.sh.: një vendas, shumë vendas, vendasit; një nxanës, shumë nxanës, nxanësit, a nxansit (por nxanësvet); një mësues, shumë mësues, mësuesit etj.

6. Emnat femnorë që mbarojnë me -a, -e, -i, -o, -u të theksueme, n'emnoren e kallxorene shumsit të shquem marrin të; p.sh.: kalatë, rrufetë, shtëpitë, byrotë, drutë etj.

7. Emnat mashkullorë që mbarojnë në shumsin e pashquem me rrokje të mbyllun, n'emnoren e kallxoren e shumsit të shquem marrin t (dhe jo të); p.sh.: fiqt, miqt, limojt, kalamajt, thojt etj. (e jo: fiqtë miqtë, limojtë, kalamajtë, thojtë etj.)

8. Emnat asnjanes (mashkullorë) e femrorë më ë, do të shkruhen pa ë në shumës; p.sh.: djathë-djathna, drithë-drithna, ujë-ujna, erë-erna, cohë-cohna etj.

9. Emnat mashkullorë që shënojnë njësi mase e peshe, zakonisht shumsin e kanë të njajtë me njajsin; p.sh.: një gram, dy gram; një kuintal, tre kuintal; një volt, pesë volt etj. Por emnat masash me ër, si litër, metër, shumsin e bajnë me a, p.sh.: një litër, katër litra; një metër, gjashtë metra.

10. Emnat mashkullorë me shumsin më -e, -na, -a

a) Emnat mashkullorë që e bajnë shumsin me e i kërkojnë fjalët përcaktuese në gjininë femnore; p.sh.: ato male, vende pjellore, tri gabime etj.

b) Trajtën e gjinisë femnore në shumës e marrin edhe mbiemnat që lidhen me emnat asnjanes më -na, p.sh. ujna të ftohta etj.

c) Gjithashtu edhe disa emna mashkullorë që mbarojnë në shumës me -na, kërkojnë mbiemna në gjininë femnore; p.sh.: barna të njoma, mallna të mira. Por eshtna të fortë.

d) Disa emna mashkullorë që tregojnë landë, si hekur, bakër, si edhe emnat petk, libër, në shumës kërkojnë mbiemna të gjinisë femnore; p.sh.: hekura të trasha; petka të mira; libra të çmueshme.

II. MBIEMNAT

1. MBIEMNAT MË -të

1. Ata mbiemna që përftohen nga emna njirrokësh, si edhe prej emnash shumrrokësh të theksuem në rrokjen e fundit, që në të shumtën tregojnë landë, marrin mbrapashtesën -të, bie fjala: ar-i, i artë; gur-i, i gurtë; dhi-a, i

dhintë; dyllë-i, i dylltë; elb-i, i elbtë; li-ni, i lintë; grunë-i, i gruntë (i gryjtë a i grytë); lesh-i, i leshtë, presh-i, preshtë, pambuk-i, pambuktë, argjend-i, argjentë etj.

N'anën tjetër, kur ata dalin nga emna të theksuem në rrokjen e parafundit tue u nisë prej mbarimit të fjalëve, marrin mbrapashtesën -t; p.sh.: akull-i akullt, avull-i avullt, hekur-i hekurt, rregull-i rregullt, mjegull-i mjegullt etj.

2. Numrorët sosin me -të p.sh.: dy-i dytë, tre-i tretë, pesë-i pestë. Nga kjo rregull ban përjashtim katër-i katërt.

Në lidhje me numrorët rreshtorë do theksue ndërkaq një prirje e përgjithshme për thjeshtimin e geminateve, fjala vjen shtatë, tetë dhjetë që duket se kanë kalue nëpërmjet të fazës tingullore me geminate i shtatti, i tetti, i dhetti.

3. Mbiemnat që rrjedhin prej foljeve me temë në bashkëtingëllore, mbarojnë më -ët, p.sh.: ulë - i ulët; çelë - i çelët; shtrydhë - i shtrydhët; lagë - i lagët; mbledhë - i mbledhët; rrasë - i rrasët; ngathem - i ngathët; shkathem - i shkathët; ngordhë - i ngordhët; ngopë - i ngopët; ngrohë - i ngrohët; ngrysë - i ngrysët; ngjeshë - i ngjeshët. Disa mbiemra shkruhen edhe: i ftoftë a i ftohtë, i ngroftë a i ngrohtë. Por i nxehtë.

4. Ata mbiemna që dalin nga folja me temë më a, e, i, o, y, do të shkruhem me të, p.sh.: tha - i thatë, me(j) - i metë, zbe(j) - i zbetë mpi(j) - i mpitë; ndy(j) - i ndytë; ndërësa mbiemnat që vijnë nga pjesoret e shkurtueme me -ue do të sosin me t: lirue - i liruet, sque - i squet, shëmtue - i shëmtuet, kullue - i kulluet etj.

5. a) Në lidhje me shkrimin e mbiemnavet që mbarojnë me -ët, ruhet ë-ja para t-së kur para mbrapashtesës gjinden dy ose ma shumë bashkëtingëllore si: i përbashkët - i përbashkëti - e përbashkëta; i kalbët - i kalbëti - e kalbëta, të kalbëtës; i flashkët - i flashkëti - e flashkëta, etj.

b) Ë-ja bie kur para saj gjindet vetëm një bashkëtingëllore, si: i, e lagët, i lagti, e lagta; i, e dobët, i dobt, e dohta; i, e zbrazët, i zbrazti e zbrazta; i, e cekët, i cekti, e cekta; i, e athët, i athti, e athta; i, e vokët, i vokti, e vokta, të vokitit etj.

c) Mbiemnat më -të që formohen prej ndajfoljeve njirroshe ose të theksueme në rrokjen e fundit, e riejnë ë-në fundore të mbrapashtesës: pak - i paktë; ndërsa ata që theksohen në rrokjen e parafundit, e humbin këtë ë: afër - i afërt, tepër - i tepërt.

2. MBIEMNAT MË -ëm

1. Mbiemnat e prejardhun formue prej emnash e ndajfoljesh me anë të mbrapashtesës -ëm a -më, në gegnishten do të shkruhen vetëm me -ëm, p.sh. fis - i fisëm, jashtë - i jashtëm, mes - i mesëm, sot - i sotëm. Në gjininë femnore ë-ja para m-së bie si: e mesme, e jshtme, e sotme (e jo e mesëme etj.).

2. N' anën tjetër, mbiemnat që përpara m-së kanë një -j e -r ose një zanore të theksueme, do të shkruhen me -më; p.sh.: i majmë, e majme, i ndermë, e nderme; i pastajmë, e pastajme; i parmë, e parme; i përparmë, e përparme; i andejmë, e andejme; i përtejmë, e përtejme, i pafajmë, e pafajme.

3. Ata mbiemna që sosin më -më e që janë formue nga ndajfoljet që mbarojnë me r dhe janë të theksuem në rrokjen e parafundit, e humbin ë-në fundore; p.sh.: nesër - i nesërm, sipër - i sipërm, tepër - i tepërm, afër - i afërm etj.

Ë-ja e mbiemnave më -ëm bie gjatë lakimit: ajo mbahet në trajtën e gjindores - dhanores së shumsit të shquem e të pashquem të gjinisë mashkullore.

Kështu duket lakimi i tyre:

Gjinija mashkullore

njajës

- Trajta e pashqueme/Trajta e shqueme
- emn. i jashtëm/i jashtmi
- gjind. (i,e) të jashtmi/(i,e) të jashtmit
- dhan. të jashtmi/të jashtmit
- kallx. të jashtëm/të jashtmin
- rrjedh. së, të jashtmi/së,të jashtmit

shumës

- Emn. të jashtëm/të jashtmit
- gjind. (i,e) të jashtëmve/(i,e) të jashtëmvet
- dhan. të jashtëmve/të jashtëmvet
- kallx. të jashtëm/të jashtmit
- rrjedh. së, të jashtish/së, të jashtëmvet

Gjinija femnore

njajës

- emn. e jashtme/e jashtmeja
- gjind. (i,e) së jashtmeje (jashtmeje)/(i,e) jashtmes
- dhan. të jashtmeje (jashtmeje)/së jashtmes
- kallx. të jashtme/të jashtmen

- rrjedh. së jashtnje (jashtmeje)/së jashtmes shumë
- emn. të jashtme/të jashtmet
- gjind. (i,e) së jashtmeve/(i,e) së jashtmevet
- dhan. së jashtmeve/së jashtmevet
- kallx. të jashtme/të jashtmet
- rrjedh. së jashtmesh/së jashtmevet

Po kështu lakohen edhe emnat e tjerë të këtij tipi, si: i fisëm, i mesëm, i vetëm.

3. MBIEMNAT MË -shëm

Mbiemnat që formohen me mbrapahtesën -shëm e që burojnë nga foljet, emnat, mbiemnat e të tjera kategori, nuk do të marrin kurrfarë ë-je eufonike, e po e patën, ndër rase të zhdrejta do ta zhdukin saherë që mbrapashtesqa -shëm i ngjitet fjalës me temë me çfarëdo bashkëtingëllore, si: i mbrendshëm, i nevojshëm, i tmershëm, i rrezikshëm; e mbrendshme, e nevojshme, e tmerrshme, e rrezikshme etj.

SHËNIM I: Kur sh-ja e mbrapahtesës -shëm ndeshet me t-në e temës së mbiemnit, pse t-ja me sh-në në shumë vise shkrihet në shqiptim në një -ç, atëherë mbiemnat e tillë mund të shkruhen me -çëm a me -tshëm, bie fjala: i çudiçëm, a i çuditshëm, i mërziçëm a i mërzitshëm. Asht mirë të përdoren me ç ata mbiemna që kaheerë janë formue dhe shqiptohen njashu në shumicën e të folmeve të shqipes, ndërsa ata që tash vonë janë përfutur me mbrapashtesën -shëm, do të shkruhen me tsh, i përmortshëm, i përshtatshëm, i tretshëm, etj. (e jo: i përshtaçëm).

4. MBIEMNAT MË -ël, -ër

Mbiemnat e tipit i vogël, i egër, do të lakohen si emnat me ël, ër, ërr, ëm që shumë ngoje ma naltë e kjo do të thotë që ata, përjashtue rasat emnore e kallxore të njajsit të pashquem, nuk e rrujnë ë-në gjatë lakimit në rasat e tjera; p.sh.: i ambël, i ambli, e ambla, t'ambli, t'ambli, e ambla, t'ambliash, t'ambliat, t'ambliavet, (por t'ambëlvet), i egër, i egri, t'egrit, të egrin, e egër, s'egre, e egra, s'egrës, t'egrën, t'egrish, t'egrit, t'egra, s'egrash, t'egrat, t'egravet, (por t'egërvet). Kështu do të shkruhen edhe mbiemnat: i vjetër, i ashpër.

Ë-ja e mbiemnavë të sipërm do të ruhet në gjindoren dhe në dhanoren e shumsit të gjinisë mashkullore, pra: t'ashpërve-t, të vjetërve-t etj.

III. NUMRORËT

Numrorët themelorë 5, 6, 7 8, 9, e 10 si edhe kompozitat që dalin prej tyre, si: 15, 16, 17, 18, 19; 50, 60, 70, 80, 90 etj., shkruhen me ë, pra: pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nandë, dhetë, pesëmbëdhjetë shtatëmbëdhjetë, gjashtëdhjetë, tetëdhjetë, nandëdhjetë etj.

Numrorët themelorë të përngjitun që nga 11 e deri më 19 do të shkruhen me një fjalë; p.sh.: njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, katërmëdhjetë etj.; gjithashtu me një fjalë do të shkruhen edhe ata numrorë që tregojnë dhetësja, qindësja, mijësja, p.sh.: njëzet, dyzet, gjashtëdhjetë, dyqind, njëmijë, dymijë, etj.

Ata numrorë që janë të përbamë prej dhetëshash, qindëshash dhe mijëshash do të shkruhen me tri a ma shumë fjalë, p.sh.: njëzet e dy, tridhjetë e pesë, treqind e katër, njëmijë e pesëqind e gjashtë etj.

Numrorët dy e tre në gjininë mashkullore do të shkruhen: të dy, të tre, dhe në gjininë femnore: të dyja, të trija.

(vijon në numrin e ardhshëm)

